Mimoza Gjokutaj Anila Mullahi Tereza Babasuli Ragip Gjoshi

Gjuhë shqipe 6

ISBN: 978-9951-786-11-9

Çmimi 5 euro

Mimoza Gjokutaj Anila Mullahi Tereza Babasuli Ragip Gjoshi

Gjuhë shqipe 6

Mimoza Gjokutaj Anila Mullahi Tereza Babasuli Ragip Gjoshi

Gjuhë shqipe 6

BOTIME

pegi

Prof.dr. Mimoza Gjokutaj Prof.as.dr. Anila Mullahi Tereza Babasuli Prof.as.dr. Ragip Gjoshi

GJUHË SHQIPE 6

Për klasën e 6-të të arsimit 9-vjeçar

BOTIME

pegi

Prishtinë, 2021

BOTIME

Drejtoi botimin: Valmira MUSHI
Recensentë të MASHT-së: Prof. asoc. dr. Haki HYSENAJ
Dr. Imri BADALLAJ, Arianit BEHRAMI, Kushtrim MALOKU
Redaktore letrare: Tereza BABASULI
Korrektore: Erina ÇOKU, Eni MYRTOLLARI
Paraqitja grafike: Elvis BEJTJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-786-11-9

© Botime Pegi sh.p.k., dega në Kosovë, ribotim 2021
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Të gjitha tekstet letrare dhe joletrare të këtij libri janë përshtatur dhe redaktuar për qëllime didaktike.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Sektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Hyrje

Teksti *Gjuha shqipe 6* mbështetet në kërkesat dhe kriteret e caktuara nga programi i lëndës së Gjuhës shqipe, shpallur nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë, dhe zbërthen kompetencat kyçe dhe ato të lëndës, të strukturuara sipas fushave të studimit.

Gjuha shqipe 6 synon t'i përfshijë nxënësit në veprimtari të gjera të të nxënit, përmes të cilave pritet të fitojnë aftësi, shprehi dhe vlera të gjithanshme.

Përmes këtij teksti, nxënësit do të aftësohen për ta përdorur gjuhën në situata të larmishme dhe do të fitojnë shprehi që lidhen me aftësitë e tyre për ta dëgjuar, folur, lexuar dhe shkruar atë në një nivel të përshtatshëm për moshën e tyre.

Kjo gjë do të arrihet përmes përfshirjes së tyre në veprimtari të gjera ndërvepruese dhe bashkëpunuese, në veprimtari krijuese dhe në projekte, duke i zhvilluar dhe rritur intelektualisht dhe gjuhësisht.

Përmes këtij libri, do të zhvillohen edhe shumë kompetenca kyçe, të tilla si: zhvillimi i të menduarit kritik dhe krijues, human, digjital, social etj., të cilat do t'u shërbejnë nxënësve për ta përdorur drejt gjuhën në situata konkrete komunikimi.

Për të përmbushur synimet e mësipërme, të shpalosura në program, struktura e këtij teksti i orienton nxënësit në zhvillimin e shkathtësive të komunikimit në situata të ndryshme, zhvillimin e kulturës gjuhësore dhe formimin kulturor, zhvillimin emocional, krijues dhe estetik përmes shkathtësive të komunikimit, zhvillimin e vetëbesimit dhe të të menduarit kritik e të pavarur, zhvillimin e përdorimit të gjuhës letrare, si dhe përgatitjen e nxënësit për të mësuar gjatë gjithë jetës.

Teksti përbëhet nga dy pjesë.

Pjesa e parë përfshin fushat përmbajtësore të programit, që lidhen me: me zhvillimin e shkathtësive të komunikimit: ***të lexuarit***, ***të shkruarit, të dëgjuarit*** dhe ***të folurit***, të cilat, të gërshetuara me njëra-tjetrën, krijojnë një ansambël njohurish dhe praktikash ndërvepruese në tërë rrjedhën e tekstit.

Pjesa e dytë e tekstit, e emërtuar "Njohuri për gjuhën", zbërthen në mënyrë shkencore dhe didaktike tema dhe kompetenca, të cilat lidhen me leksikologjinë, gramatikën (fonetikën, morfologjinë dhe sintaksën e shqipes), në vazhdimësi të programit të klasës së gjashtë.

Kjo pjesë krijon mundësinë për ta njohur dhe përdorur drejt sistemin morfo-sintaksor dhe drejtshkrimor të shqipes.

Gërshetimi i pjesës së parë të lëndës me pjesën e dytë është një tipar tjetër i *Gjuhës shqipe 6*, i cili mundëson dhe lehtëson punën me llojet e teksteve dhe me njohuritë për gjuhën.

Ju urojmë rrugëtim të mbarë në eksplorimin e gjuhës sonë!

PËRMBAJTJE

TEKSTI LETRAR

Rrëfime popullore

Rrëfime nga e kaluara 12
Hana dhe Dielli në pasi 12
Molla e artë 13
Grami dhe vreshti 13
Shkëmbi i Skënderbeut 14
Fuqia e Mujit 17
I lumtur është njeriu që s'ka nakar 21
Prometeu i lidhur 24
Pëllumbi dhe milingona 28
Kërcimtarja e Dukagjinit 30
Grimca humoristike 33

Tekste reale

Pikat e shiut 37
Udhëve të fëmijërisë 41
Sarajet e bardha 45
Fshati i pesë kodrave 50
Droja 54
Gjyshja ime 61
Mësuesi ynë i dashur 65
Provimi 68

Tekste fantastike

Ishulli i thesarit 71
Ishulli i delfinëve të kaltër 75
Princi dhe i varfri 79
Klorela 83
Momoja dhe lodrat e reja të miqve të saj 87
Momo takon zotërinë gri 91
Stinët në planetin e kuq 94
Shelgu goditës 97

Tekste poetike

Vargje kushtuar gjuhës shqipe 102
Lulëkuqja 105
Prandvera 107
Nana 109
Më tha një plak dikur 111
Mbarim vjeshte 113
Horizonti 115
Në natyrë 116
Secili udhëtar përshëndet në mënyrë të vet 117
Ne ishim, ne jemi, ne do të jemi këtu... 119
Trashëgimi 121
Detyrë klase 123

Tekste dramatike

Mbreti Lir 125
Shqyptarja e qytetrueme 129
Vdekja e një mbretëreshe 133

TEKSTI JOLETRAR

Tekste rrëfyese

Stivi dhe problemat e matematikës 138
Një shoqe e re 141
Rrëfimet në vetë të parë: Tirana, Durrësi, Kruja 144
Dekada e Majlinda Kelmendit 148
Nexhmije Pagarusha, me zërin e saj e vulosi shekullin e njëzetë! 151
Bjeshkët e Rugovës - mirë se vini në mbretërinë e natyrës! 154
Në Beratin e një mijë e një mrekullive 157

Tekste informuese-paraqitëse

Shtatë mrekullitë e botës antike 161
Liqeni i Ohrit 165
Qyteti i Pogradecit 166
Raport për popullsinë e Kosovës 168
Familja shqiptare dikur dhe sot 171

Tekste udhëzuese

Rregullorja e bibliotekës së shkollës 174
Shtegu më i bukur i Shqipërisë 177

Tekste argumentuese

Fjalimi i Adem Demaçit pas marrjes së çmimit "Sakharov" 179
Celulari: mik apo armik? 182

Tekste përshkruese

Biblioteka Kombëtare e Kosovës, thesar i diturisë 185
Prizreni: qyteti me trashëgimi kulturore 188

Njohuri për gjuhën

Fonetikë

Theksi i fjalës 192
Intonacioni dhe theksi i fjalisë 195
Bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme 197

Drejtshkrim

Apostrofi 201
Drejtshkrimi i lidhëzave 202
Drejtshkrimi i parafjalëve 203

Fjalëformim

Përbërësit e fjalës 205
Fjalë të parme dhe jo të parme 206
Parashtesat 208
Prapashtesat 209

Leksikologji

Fjala dhe kuptimi i saj 211
Dialektet e gjuhës shqipe 213
Gjuha standarde, roli dhe rëndësia e përdorimit të saj 215

Morfologji

Klasat e fjalëve 217
Emri 219
Gjinia dhe numri i emrit 222
Trajtat e emrit 224
Lakimi i emrave 225
Ushtrime për emrat 227
Mbiemri 228
Përshtatja e mbiemrit me emrin 230
Përemrat 232
Folja 234
Mënyrat dhe kohët e foljes 237
Forma veprore dhe forma joveprore e foljeve 240
Zgjedhimi i foljeve në formën veprore të mënyrës dëftore 241
Zgjedhimi i foljeve në formën veprore të mënyrës lidhore 244
Zgjedhimi i foljeve në formën joveprore të mënyrës dëftore dhe lidhore 246
Ushtrime për foljet 249
Ndajfolja 250
Lidhëzat 252
Parafjala 255
Numërorët 258

Sintaksë

Teksti, paragrafi, fjalia, gjymtyra 261
Përbërësit e fjalisë së thjeshtë 263
Fjalia foljore dhe fjalia jofoljore 265
Fjalia dëftore dhe fjalia pyetëse 268
Fjalia dëshirore dhe fjalia nxitëse 270
Format pohore dhe mohore të fjalive 271
Fjalia e përbërë 272
Kryefjala 275
Kallëzuesi 277
Përcaktorët 279
Ndajshtimi 281
Kallëzuesori i kryefjalës 282
Kundrinorët. Kundrinori i drejtë 284
Kundrinori i zhdrejtë 286
Rrethanorët 288
Rrethanori i shkakut dhe rrethanori i qëllimit 291

Struktura e tekstit

Lexojmë

Tregon që mësimi përmban një tekst letrar ose joletrar, i cili zhvillon shkathtësinë e të lexuarit dhe analizohet nëpërmjet pyetjeve që përmban rubrika "Studim teksti".

Studim teksti



Para leximit

Përmbajnë të dhëna rreth autorit dhe veprës prej së cilës është shkëputur fragmenti. Me to ndërtohet situata hyrëse e mësimit.

Autori

Fjalor

Përmban shpjegimin e fjalëve të reja të pjesës letrare ose joletrare që studiohet, të cilat në tekst janë të shënuara me ngjyrë blu.

Njohuri teorike për llojet e tekste

Përmban njohuri teorike për llojet e tekste letrare dhe joletrare, duke u përqendruar në karakteristikat e përgjithshme të tyre.

Tregon një nga pesë ndarjet e mëdha të tekstit joletrar.

Njohuri teorike për figurat letrare

Përmban njohuri teorike për figurat letrare që ndeshen më shpesh, duke u përqendruar në karakteristikat e përgjithshme të tyre.



Shkruajmë

Përmban udhëzime për të realizuar lloje të ndryshme shkrimesh, për qëllime funksionale dhe personale, të cilat zhvillojnë shkathtësinë e të shkruarit.



Bashkëbisedojmë

Përmban tema, pyetje, udhëzime, për të realizuar diskutime të ndryshme që zhvillojnë shkathtësitë e të folurit dhe të të dëgjuarit.

Struktura e tekstit

Fonetikë



Drejtshkrim

Njohuri për gjuhën

Fjalëformim



Leksikologji



Sintaksë



Morfologji



Sintaksë



SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT

BASHKËBISEDOJMË		LEXOJMË	SHKRUAJMË
DËGJOJMË	FLASIM		
Dallojmë të ndierit nga të dëgjuarit.	Dallojmë të folurit e thjeshtë nga të folurit bukur.	Dallojmë të lexuarit thjesht nga të lexuarit bukur.	Dallojmë të shkruarit thjesht nga të shkruarit bukur.
Përdorim teknika të të dëgjuarit.	Përdorim teknika dhe strategji që zhvillojnë të folurin.	Zbulojmë ngjashmëritë dhe ndryshimet mes teksteve që lexojmë.	Shkruajmë sipas rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore.
Dëgjojmë në mënyrë individuale.	Zhvillojmë veprimtari të të folurit.	Lexojmë me zë në mënyrë të qartë, korrekte dhe shprehëse; respektojmë pauzat.	Shkruajmë duke respektuar rregullat e vendosjes së shenjave të pikësimit.
Mbajmë mend fjalë dhe informacione.	Rrëfejmë një tekst përshkrues.	Lexojmë në mënyra të ndryshme: me zë, në heshtje; reflektojmë nëse pjesa e lexuar ka rjedhë logjike.	Mësojmë të shkruajmë sipas një strukture të caktuar, duke lidhur elementet e tekstit në mënyrë logjike.
Plotësojmë tekste dhe fraza.	Rrëfejmë përralla dhe fabula.	Lexojmë tekste letrare dhe joletrare që u përkasin periudhave të ndryshme, tekste të letërsisë shqipe dhe botërore.	Shkruajmë për qëllime dhe lexues të ndryshëm.
Njohim intonacionin, theksin e fjalës dhe të fjalisë.	Përshkruajmë persona, sende dhe dukuri.	Kuptojmë, interpretojmë, analizojmë, vlerësojmë dhe gjykojmë tekstet që lexojmë.	Ndjekim gjatë të shkruarit hapa, si: planifikimi, organizimi i ideve dhe rishikimi i tekstit.
Dallojmë llojet e teksteve.	Japim udhëzime.		
Identifikojmë tekstet përshkruese, udhëzuese, argumentuese etj.	Bëjmë pyetje dhe japim përgjigje. Diskutojmë dhe krahasojmë argumentet tona.		
Dallojmë informacionin kryesor nga ai dytësor.	Shprehim emocione dhe ndjenja.		

TEKSTET DHE LLOJET E TYRE



Çdo gjë që lexojmë, e marrim përmes teksteve, të cilat janë të ndryshme.
Pavarësisht dallimeve, tekstet kanë një strukturë të caktuar.
Çdo tekst ka:

Një titull:	Tregon se për çfarë do të flitet.
Një sasi materiali gjuhësor:	Tregon gjithçka që është shkruar.
Pjesë:	Kur një tekst i caktuar është i gjatë, ai mund të ndahet edhe në pjesë, p.sh. romanet.
Kapituj:	Pjesët përbërëse të tekstit. Çdo kapitull mund të ketë edhe nëntituj.
Paragrafët:	Përfshijnë fjalitë nga njëra kryeradhë te tjetra, që shprehin një mendim pak a shumë të plotë e të pavarur.
Fjalitë:	Çdo paragraf përbëhet nga fjali që shprehin kuptime të caktuara, por që janë të lidhura me njëra-tjetrën për të zbërthyer një ide më të madhe.

Teksti letrar		
Tipi i tekstit/ gjinia	*Karakteristika*	*Lloji*
tekst rrëfimtar letrar	Transmeton ngjarje, përvoja, ka personazhe, me anën e të cilave organizohet dhe tregohet ngjarja dhe vlerat njerëzore.	fabul, përrallë, legjendë, tregim, novelë, roman etj.
tekst poetik	Përcjell ide, emocione, mbresa. Organizohet në vargje dhe strofa.	poezi, poemë etj.
tekst dramatik	Historia shkruhet në formë dialogu dhe marrin pjesë shumë personazhe.	tragjedi, komedi, dramë etj.

Teksti joletrar		
Tipi i tekstit	*Karakteristika*	*Lloji*
tekst rrëfyes	Tregon ngjarje reale që kanë në qendër njerëz realë.	kronikë, shënime udhëtimi, biografi, intervistë, ditar etj.
tekst informues	Paraqet të dhëna, informacione; shpjegon koncepte.	njoftime, zëra nga enciklopeditë, raporte, relacione, fjalorë etj.
tekst udhëzues	Udhëzon, këshillon, urdhëron për të mbajtur qëndrime të caktuara.	udhëzime, urdhra, receta, ligje, rregullore etj.
tekst argumentues	Argumenton duke mbështetur ose kundërshtuar ide, opinione, fakte; vlerëson punime.	ese, artikuj, fjalime me karakter nga jeta sociale, ekonomike, politike etj.
tekst përshkrues	Përshkruan njerëz, vende, kafshë, objekte.	guida turistike, enciklopedi, tekste shkencore etj.

Rrëfime nga e kaluara

Para leximit

Miti, përralla, legjenda dhe fabula janë ndërthurur më poshtë për t'ju paraqitur forma të ndryshme, të hershme, të krijimit popullor, si dhe format e tyre të mëvonshme të përpunuara. Ata shfaqin ndërmjet tyre shumë ngjashmëri, por edhe ndryshime. Përmes fantazisë që i përbashkon këto krijime dhe nëpërmjet tematikave të ndryshme dhe larmisë së personazheve, shfaqet jeta me ndërlikimet e saj.

Hana dhe Dielli në pasi

Çohet një ditë prej ditësh Hana e shkon në pasi te Dielli, mbreti i dritës. Shkëlqente me ta pasë anda e, përveç do dhuntive të bukura, mblodh nëpër qiell edhe do tubëza yjsh e ia çoi Diellit. Si kreu detyrën e vet ktheu prap' në cakun e mëparshëm.

Tash i përkiste Diellit me ia kthye pasinë, por kishte ra ngushtë e s'dinte ç'dhunti me i çue. "Çka t'i çoj?!... Çka t'i çoj?!" I ra në mend me i çue nji palë petka të bukura të preme për shtat të saj. Thirri ma të mirin yll-terzi e ia dëftoi dëshirën; e ylli po e qet në shteg për nji punë, që veç ata yjtë që rritshin përreth Hanës tue e prrallë me të e kishin hetue.

– Po unë, more mbret, – po i thotë ylli-terzi Diellit, – si t'ia pres këto petka Hanës, që s'ma ka kurrë nji ditë shtatin barabar, por sot fryhet e rrumbullakoset, nesër thithet e mbas do ditësh krruset si drapni e bahet si nanëza e shtrigave? Tash, ti që sundon mbi ne e din sa s'dijmë të tanë na së bashku, a më mëson ti si t'ia pres këto petka?

– Lenie, lenie! – përgjigjet Dielli. E dirgjet fill te Hana. Hana mundohet me i ba nder e me i ardhë rreth mbretit të qiellit, por kur e sheh me duar thatë, nisi disi me u vra vetullash e i thotë:

– Kur kam ardh me të pa, kam ardh me njëmijë të mira e përcjellun prej yjve ma të bukur që kam mujt me bashkue rrugës, ti, le që erdhe vetëm, por asnji send, me thanë, s'je kujtue me ma prue!

– Ashtu asht, – ia ktheu Dielli, – por jo krejt si thue ti. Tanë punë e dhuntisë më ka ba me shty ditë në tjetrën e mos me ardhë me të pa. Mendova, mori bijë, me të pru nji palë petka e thirra ma të mirin yll-terzi me t'i pre. Por, kur ai më tha se ty po të ndërronte fytyra e shtati dita me ditë, e lashë petkun e ardha nji kështu si po më shef, veç mos me u korit me ty. Nji fjalë po ta them: për në paç nevojë për dritët teme, merr në të sa të duesh për me e hijeshue trupin tand, për tjetër, të mirë u pafshim! – e u çue e shkoi.

Hana u zbeh prej idhnimit e, prej atë ditë e atë ditë zu me e kqyrë Diellin disi tërthuer.

Fjalor

pasi – vizitë.
tubëz – grup, tufë.
kishte ra ngushtë – ishte ndjerë në vështirësi
të preme – të prera dhe të qepura.
terzi – rrobaqepës.
nanëza – nëna.
lenie – lëre.
dirgjet – zbret, shkon.
me u vra vetullash – me u mërzit.
prue – sjell
mos me u korit – për të mos u turpëruar.
idhnim – inat.
tërthyer – këtu: vëngër.

Molla e artë

Në kohërat e lashta jetonte në Ftia një mbret i dëgjuar, Peleu. Kaq i dëgjuar e i pasur ishte, sa vendosi të bënte dhëndër një hyjni, Nereun, që e kishte mbretërinë në fund të detit. I dha për grua vajzën e tij, Tetidën.
Në pallatet e hyjnive, lart në majat e pashkelura të Olimpit plak, u bë dasma e Peleut me Tetidën. Ishin të ftuar të gjithë hyjnitë. E ç'nuk sollën për dhuratë! Poseidoni dy kuaj të pavdekshëm për dhëndrin, Hera dy mbulesa të qëndisura bukur për nusen, shpatë të bukur për dhëndrin hyu i çalë Hefest, kupë të artë për të pirë verën e tyre Afërdita dhe sa e sa të tjera! U ndez e mori flakë gostia. Apoloni i binte lirës dhe muzat s'reshtnin vallet e tyre të mrekullueshme.
Por hyjnitë kishin lënë vetëm një pa ftuar: Eridën. Ngatërrestare ishte ajo dhe kudo ku shkonte i bënte lesh e li. Në çast ndizeshin grindje të tmerrshme dhe gostia prishej. Pra ç'ta donin mes tyre? Por ngatërrestarja u inatos që nuk e ftuan dhe vendosi t'ua prishte harenë dhe të mbillte një sherr të madh mes tyre. U afrua fshehtas në pallatet ku po dëfrenin dhe nga dritarja hodhi brenda një mollë të artë. Sipër mollës ishin shkruar këto fjalë: "Ta marrë më e bukura."
Hyjneshat, sapo panë mollën, u derdhën të tëra kush e kush ta merrte e para, ngaqë secila besonte se ishte më e bukura. U ndez në çast një grindje e tmerrshme mes hyjneshave. Më në fund shumica i bëri vend zemërimit dhe u tërhoq. Por ama mbetën tri që s'donin t'ia dinin.
Secila ngulmonte se ajo ishte më e bukura. Ato të tria ishin: Hera, gruaja e Zeusit; Athinaja, hyjnesha e diturisë dhe Afërdita, hyjnesha e dashurisë. Hynë në mes hyjnitë që t'i qetësonin e t'i paqtonin, por s'ia dolën mbanë.
– Pushoni, pushoni! Të gjitha të bukura jeni. Por, asgjë. Secila ngulte këmbë se ajo ishte më e bukura.

Grami dhe vreshti

Një ditë grami vajti te vreshti dhe i tha:
– Të lutem shumë, më lër pak vend, fare pak, ja këtu në qoshëz dhe të jemi miq përjetë.
Vreshti mendoi: "Ç'punë do të më prishë, le të rrijë; një qoshëz të vogël do". Dhe i tha gramit:
– Hyr, po këtu në qoshe.
Grami hyri, lëshoi rrënjët thellë, u përhap në gjithë vreshtin.
– Mos u hap kështu, se më zure frymën! – i tha vreshti.
– Si të kesh qejf, – tha grami, – në daç rri, në daç ik.

Fjalor

gram – barishte shumëvjeçare, me kërcell të nyjëzuar e të shtrirë përtokë.
vresht – hardhi e mbjellë në tokë.
në daç... në daç – ose... ose.

Shkëmbi i Skënderbeut

Fjalor

fuqi – këtu: ushtri.

Simboli

Simboli është ajo figurë letrare, e cila paraqet në mënyrë të figurshme një send, një qenie a një dukuri nëpërmjet një sendi, një qenieje a një dukurie tjetër, sipas karakteristikave të përafërta. Simboli është figurë poetike me kuptim të dyfishtë. Kështu p. sh., në këngët popullore të dashurisë vasha simbolizohet me thëllëzën, djali me pëllumbin e bilbilin. Simboli haset shpesh edhe në poezinë e shkruar. Disa shembuj të simbolit janë: Flamuri simbolizon shtetin, kombin. Lepuri simbolizon frikën. Dhelpra simbolizon dinakërinë etj

Skënderbeu ishte me nji fuqi të vogël në Rrajcë. Turqit, me një fuqi të madhe, po vinin nga lindja. Skënderbeu donte me u dal në ballë dhe i preu rrugën nji shkamb.

Ç'ban ai? Nxjerr shpatën dhe i bie shkambit fap dhe e ndan më dysh. Pastaj u ra turqve dhe i prishi krejt.

Shkambi duket sikur asht pre sot dhe quhet *Shkambi* i Skënderbeut.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1. Në cilin prej teksteve flitet për një vend gjeografik real? Po për një personazh real?
2. Në disa tekste letrare, e kemi të pamundur të përcaktojmë kohën kur ndodhin ngjarjet. Përcaktoni në cilën nga pjesët e mësipërme ndodh kështu. Si mendoni, pse ndodh kjo gjë?
3. Në përrallën "Hana dhe Dielli në pasi":
   a) Pse ishte e vështirë për yllin-terzi t'i qepte rroba Hanës?
   b) Çfarë i bëri Hana dhuratë Diellit?
   c) Po Dielli, çfarë i dhuroi Hanës?
4. Në mitin "Molla e artë":
   a) Pse nuk ishte e ftuar në dasmë perëndesha Eridë?
   b) Çfarë ishte shkruar mbi mollë?
   c) Çfarë pasojash solli molla e Eridës në dasmën ku ishin duke festuar perënditë?
5. Cilat janë problemet me të cilat përballen personazhet kryesore të këtyre teksteve.

Personazhi	Problemi
Grami	
Skënderbeu	
Dielli	
Hera, Afërdita, Athinaja	

Studim teksti

Analizojmë tekstin

6 A mendoni se Hana nuk e vlerësoi siç duhet dhuratën e Diellit? Shpjegoni vlerën e vërtetë të dhuratës që i bëri Dielli.

7 Në këto tekste ndërthuren elementet reale me ato të jashtëzakonshme. Cilat janë elementet e jashtëzakonshme?

Grami dhe vreshti	
Shkëmbi i Skënderbeut	
Hana dhe Dielli në pasi	
Molla e artë	

8 Përcaktoni elementet kryesore të strukturës së përrallës "Hana dhe Dielli në pasi".

Hyrja _____

Zhvillimi_____

Mbyllja_____

9 Shkruani tiparin kryesor të këtyre personazheve:

Skënderbeu	
Grami	
Dielli	
Erida	
Vreshti	
Zeusi	

10 Klasifikoni në tabelë personazhet e pjesëve të mësipërme. Argumentoni zgjedhjen.

Titulli	Personazh historik	Personazh i krijuar nga fantazia
Skënderbeu		
Molla e artë		
Grami dhe vreshti		
Hana dhe Dielli në pasi		

Interpretojmë tekstin

11 Ç'lidhje vërejmë mes titujve dhe personazheve kryesore. Pse ndodh një gjë e tillë?

12 Fabulat përcjellin mesazhe. Pasi të keni lexuar fabulën, shkruani mesazhin që përcjell ajo.

_____

13 Përndritë janë personazhe shumë të rëndësishme në mite. Si paraqiten ato në mitin e mësipërm: të ngjashme apo të ndryshme nga njerëzit?

Studim teksti

Gjuha e tekstit

14 Shënoni me ✓ tiparet karakteristike për gjuhën e përrallës, të fabulës, të legjendës dhe të mitit.

- ☐ e thjeshtë
- ☐ situata të papritura
- ☐ gjuhë e ndërlikuar
- ☐ e kuptueshme
- ☐ fjali të gjata
- ☐ mendime të ndërlikuara
- ☐ e paparashikueshme
- ☐ e qartë
- ☐ gjuhë me fjalë teknike
- ☐ situata të papritura
- ☐ shpjegon dhe argumenton ide

15 Grami dhe vreshti flasin. Ç'ngjyrë i jep ky element artistik dhe fantastik rrëfimit?

Reflektojmë rreth tekstit

16 Vini veten në vendin e personazhit të fabulës. Si do të ndiheshit dhe si do të vepronit ju në një situatë të ngjashme?

17 Në ditët e sotme përdoret shumë shprehja: "molla e sherrit", e cila i ka fillesat nga miti i mësipërm. Shpjegoni përdorimin e kësaj shprehjeje me shembuj nga e përditshmja.

18 Pasi lexuat format e ndryshme të krijimtarisë popullore (një legjendë, një përrallë, një mit dhe një fabul), diskutoni rreth ngjashmërive dhe ndryshimeve mes tyre.

19 Me ndihmën e mësueses, por edhe nëpërmjet kërkimit të informacioneve në internet, diskutoni në klasë për pasojat që pati "kjo mollë" në marrëdhëniet mes njerëzve dhe perëndive.

Detyrë

- Kërkoni informacion për ekzistencën reale të Shkëmbit të Skënderbeut.
- Gjeni legjenda të tjera, të cilat kanë në qendër të tyre figurën historike të Skënderbeut.

Miti

Miti është një rrëfim fantastik që shpjegon lindjen e elementeve të natyrës. Qëllimi i mitit është të shpjegojë origjinën e botës e të njerëzve. Protagonistë të miteve mund të jenë perënditë, njerëzit me fuqi të jashtëzakonshme, heronjtë, përbindëshat dhe krijesa të tjera fantastike. Koha se kur ka ndodhur ngjarja nuk është e përcaktuar (njëherë e një kohë, shumë e shumë kohë më parë etj.).

Fabula

Fabula është një rrëfim fantastik, në të cilin kafshëve dhe sendeve u vishen tipare, virtyte dhe të meta njerëzore. Ka protagonistë kafshë dhe sende që flasin. Ka qëllim t'u përcjellë lexuesve një mësim të veçantë, që quhet moral.

Legjenda

Legjenda është një rrëfim fantastik, që ka si pikënisje një fakt të vërtetë (real). Protagonist i saj mund të jetë një vend, bimë, lule ose kafshë. Zakonisht përfundon me shprehjet: Ja përse... Që atëherë... etj.

Përralla

Përralla është një rrëfim fantastik, në të cilin hyrja zakonisht fillon me një formulim të gatshëm, si: "Na ishte njëherë....", "Na ishte ç'na ishte..." etj. Personazhet e përrallës janë princër e princesha, mbretër, zana e shtriga, kafshë etj. Ngjarjet që tregohen përmbajnë shumë elemente fantastike dhe magjike. Përrallat zakonisht mbarojnë me një fund të lumtur.

Fuqia e Mujit

Para leximit

Kjo pjesë është shkëputur nga përmbledhja "Tregime të moçme shqiptare" dhe rrëfen për takimin e papritur të Mujit me zanat e malit, që trajtohet në një nga këngët e Eposit të Kreshnikëve. Ngjarja zhvillohet në bjeshkët e larta, atje ku besohej që jetonin zanat.
Muji, ndërsa ka humbur rrugën, dëgjon dy fëmijë duke qarë, i vjen keq dhe kujdeset për ta pa e ditur se të kujt janë. Zanat, të cilat shohin këtë skenë, arrijnë të kuptojnë se Muji është një njeri i mirë dhe i dhembshur, ndaj ofrohen t'i plotësojnë një dëshirë.

Pas mesnate, papritur, u dukën majë shkëmbit dy drita të bardha që të verbonin sytë. Jo, s'ishin drita, por ishin dy zana të veshura me dritë. Ato e panë Mujin tek po përkundte lehtë djepet e foshnjave dhe e dëgjuan tek u fliste butë, ëmbël. U çuditën dhe e pyetën:
– Cili je ti? Ç'kërkon në këtë vend? A mos ke humbur gjësend e ke dalë ta kërkosh?
– Unë jam bari lopësh, rrogëtar për bukë e kripë, – u tha Muji.
– Gjithë ditën bredh bjeshkëve pas kullotave. Sot më ndodhi një e keqe e madhe: humba lopët e tim zoti e dola t'i kërkoj. Nata më zuri në këtë vend e u ula të prehem, të fle. S'munda të mbyll sy, se qanin këto dy foshnja. M'u dhimbsën e u përkunda djepet. Mezi i vura në gjumë… Po ju, ç'jeni? Ç'e keni tërë këtë dritë të bardhë që ju ka veshur fytyrën e shtatin?
Ato e njohën sakaq Mujin, se e kishin parë shumë herë nga larg bjeshkëve e mrizeve tek kulloste e mërzonte lopët. I thanë:
– Ne jemi zana, Muj. Dolëm, si çdo natë, lart e poshtë nëpër botë që të ndihmojmë njerëzit e mirë e të drejtë. I lamë foshnjat vetëm. Ti Muj, paske qenë njeri i mirë, i paske përkundur e i paske vënë në gjumë. Rrofsh e qofsh! Na thuaj tani, o Muj, ç'kërkon të të japim ne për të mirën që na bëre? A do forcë, Muj? A do luftë të luftosh? A do mall e gjë? A do dije? A do gjuhë? Kërko ç'të duash e ne do të ta japim.
Ja ç'u thotë Muji zanave:
– Mua, moj zana të bardha, më kanë halë në sy barinjtë e tjerë. Më ngacmojnë, moj zana, më bien në qafë. A e keni në dorë të më bëni të fortë, që t'i mund të gjithë?
– Vetëm kaq do, Muj?
– Kaq.
I thotë zana zanës:
– Motër, a i japim Mujit qumësht gjiri që ta bëjmë të fortë?
– I japim, motër.

Zanat i japin Mujit qumësht gjiri dhe e nginjin me tri pika.

Fjalor

zanë – figurë e besimeve popullore shqiptare, e përfytyruar si vajzë shumë e bukur, që jeton në male e pyje dhe u jep ndihmë trimave, por që ka edhe fuqi për të ndëshkuar duke shituar.
bari – ai që ruan e kullot bagëtinë, çoban.
rrogëtar – dikush që paguhet me një rrogë të caktuar.
bjeshkë – mal i lartë me kullota verore.
kullotë – vend me bar a me bimë, ku çohen për të kullotur bagëtia, bletët.
shtat – trupi i njeriut nga koka deri te këmbët.
mriz – vend i freskët e me hije ku kalojnë vapën bagëtia.
mërzen – pushon në hije në kohën e vapës.
e ka halë në sy – nuk e duron dot.
nginjet – shuan urinë, ngopet.

Muji e ndien veten menjëherë shumë të fortë, sa mund të shkulë nga rrënja një lis bjeshke. Zanat i thonë:
– Pa të shohim, Muj, sa i fortë je tani. Kape atë shkëmb që ke pranë dhe ngrije lart.
Zanat i tregojnë Mujit një shkëmb që peshon tri pendë qe bashkë. Muji ulet, e kap shkëmbin, e shkul nga vendi, e peshon në duar, e ngre deri te nyja e këmbës. Më lart nuk e ngre dot. E lëshon poshtë.
Prapë i thotë zana zanës:
– Duhet t'i japim edhe pak qumësht Mujit tonë që të bëhet më i fortë.
Muji pi rishtas qumësht zane, e kap shkëmbin, e peshon në duar, e ngre gjer në gju. Më lart nuk e ngre dot. E lëshon poshtë e ulet të prehet.
– T'i japim edhe një herë gji.
Mujit i shtohet fuqia. Merr shkëmbin, e peshon mirë e mirë në duar, e ngre gjer në brez. Më lart nuk e ngre dot. Zanat e shohin e i thonë shoqja-shoqes:
– Prapë duhet t'i japim gji Mujit.
Muji pi edhe një herë qumësht zane e bëhet më i fortë se një dragua. E ngre shkëmbin dhe e vë në cep të supit, e mban lart dhe qëndron shtyllë, s'tundet fare. I pyet zanat:
– Më thoni, moj zana të bardha, ku ta flak këtë shkëmb. Ta hedh në

Fjalor

tri pendë qe – tri çifte qesh.
prehem – çlodhem.
shushërin – fëshfërin.
vikat – bërtet.
këndell – i jep fuqi e gjallëri dikujt, përtërin.
gërxh – shkëmb i ashpër me thepa.
oshtin – ushton, lëshon një zhurmë të mbytur e të fuqishme.

Mitrush Kuteli

Mitrush Kuteli (1907-1967) është pseudonimi i Dhimitër Paskos. Ai ka qenë shkrimtar, përkthyes, kritik. Krijimtaria e tij letrare përfshin: "Tregime të moçme shqiptare", "Net shqiptare", "Shënime letrare", "Sulm e lotë", "Mall e brengë" etj.
Në krijimet e tij gjejmë tema nga më të ndryshmet, si: kurbeti, dashuria për atdheun, dashuria për njerëzit dhe përbuzja ndaj gjithçkaje të huaj që shkatërron identitetin dhe traditën. Shpesh në krijimet e Kutelit shkrihen dramaciteti dhe humori shumë i hollë, duke mbizotëruar optimizmi dhe pasionet e fuqishme.

Hiperbola

Paraqet në mënyrë shumë të zmadhuar dukuri, sende a qenie, apo tipare të veçanta të tyre, për të rritur efektin emocional. Për shembull:
"përmbi kryet topuzi i ka fjurue, dymbëdhetë pash m'ledinë u ngul topuzi, dymbëdhetë pashë përpjetë, si re, u çue pjuhni".
(Gjergj Elez Alia)

Lugjet e Verdha, apo ta flak në fushë të Jutbinës?
Zanat e shikojnë me buzë në gaz e i thonë shoqja-shoqes:
– Të mos i japim më gji Mujit, se, po t'i japim, e shemb botën anembanë.
Pastaj zanat e pyesin Mujin hollë e hollë për nënë e babë, për vëlla e motër, për gjithë Jutbinën e Krahinën. Ndërkaq, hëna e bardhë rri lart mbi krye të tyre e i këqyr kur kuvendojnë. Hija e shkëmbit të madh nis e zgjatet prapa, mbi gremina. Në bjeshkë del e fryn flladi i freskët i natës. Shushurijnë gjethet e aheve, këndojnë krojet e ftohta e ua mbajnë zërin lumenjve që hidhen prag më prag.
Si e pyesin mirë e mirë, ja se ç'i thonë zanat Mujit:
– O Muj, ne duam të të bëjmë vëllam. Ti ç'thua?
– Vëllam më doni, vëllam më paçi, o zana të bardha, – u thotë Muji. – Kur të jem ngushtë, do t'ju thërras të vini të më jepni dorën; kur t'ju fyejë ndokush, të më thërrisni e unë do të hidhem t'ju marr krahun.
– Të lumtë goja, vëllam; kur të jesh ngushtë, vikat e do të vijmë, kur të na fyejë ndokush, do të të ankohemi.
Kur nis të përskuqë qiellin agu i ditës, zanat marrin djepet, i varin në shpinë e zhduken duke lënë prapa një vilar drite.
Muji fërkon sytë e mundohet të shohë se ç'u bënë zanat, por nuk sheh veçse vragën e atij vilari që tretet nëpër bjeshkë. Dhe thotë me vete: "A mos pashë ëndërr?" Shkon lan sytë në krua. Ujët e ftohtë e këndell. Aty pranë sheh një gur të madh që nuk e mbanin dot as njëzet burra bashkë. Ulet, e mbërthen me të dy duart dhe e vë në sup. Qesh e thotë: "Jo, s'pashë ëndërr…" dhe e hedh gurin, që kërcet gërxh më gërxh gjersa zhduket në luginë. Oshtijnë gjithë bjeshkët…

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve:

a) Çfarë pune bënte Muji për të jetuar?
b) Me çfarë po merrej Muji kur u shfaqën zanat?
c) Cila është arsyeja që Muji ishte ngjitur në majë të shkëmbit?
- Muji donte të takonte zanat.
- Muji po kërkonte lopët e të zotit.
- Muji po kërkonte një thesar të fshehur.
- Zanat e kishin thirrur Mujin të shkonte atje.

ç) Çfarë i ofrojnë zanat Mujit? Po Muji çfarë zgjedh nga ato që i ofrojnë zanat?
d) Çfarë është në gjendje të bëjë Muji pas takimit me zanat?
dh) Çfarë i japin zanat Mujit për të realizuar dëshirën e tij?
e) Për çfarë e pyesin zanat, Mujin?
ë) Çfarë pakti bëjnë mes tyre Muji dhe zanat?

Analizojmë tekstin

2 Gjeni në tekst një element dallues të zanave në pamjen e jashtme, i cili i bëri përshtypje Mujit.

Studim teksti

3 Renditni dukuritë reale dhe dukuritë fantastike që ndodhin në këtë pjesë.

Dukuri reale	Dukuri fantastike

4 Cilat janë personazhet reale dhe cilat janë personazhet fantastike të kësaj pjese?

Interpretojmë tekstin

5 Çfarë arsyesh dhe rrethanash i shtyjnë zanat që ofrohen t'i plotësojnë çdo lloj dëshire që shpreh Mujit?

6 Pasi largohen zanat, Muji thotë: A mos pashë ëndërr? Pse ai mëdyshet për vërtetësinë e asaj që ndodhi?

7 Duke analizuar paktin që bëjnë zanat me Mujin, shpjegoni se si mund të jenë raportet mes zanave dhe njerëzve në Eposin e Kreshnikëve.

Gjuha e tekstit

8 Gjeni në tekst figurën e hiperbolës dhe analizoni si është ndërtuar ajo.

9 Lidhni me vijë fjalët njëra me tjetrën, numrin me përcaktorin.

dy	lis
dy	burra
dy	duart
dy	pendë
tri	zana
tri	drita
njëzet	foshnja
një	pika

10 Ky tekst është një përshtatje në prozë e një këngë të Eposit të Kreshnikëve që përbëhet nga rrëfime mitologjike. Shpjegoni me ndihmën e mësueses praninë e një shumësie numrash që janë tregues i konkretësisë në një rrëfim fantastik.

11 Shpjegoni me fjalët tuaja shprehjet e mëposhtme.

- *nata më zuri në këtë vend*
- *s'munda të mbyll sytë*
- *më kanë halë në sy*
- *më bien në qafë*

Reflektojmë rreth tekstit

12 Duke u nisur nga ky tekst, diskutoni në lidhje me temën: Njeriu shpërblehet gjithmonë për të mirat që bën. A mendoni se është gjithmonë kështu?

Detyrë

- Gjeni rrëfime të tjera në lidhje me figurën e Mujit.

I lumtur është njeriu që s'ka nakar

Para leximit

Përrallat janë krijime në të cilat spikat në mënyrë të veçantë fantazia, por përmes tyre shpeshherë përcillen edhe mesazhe në të cilat shkrihet mençuria e popullit, që është e vlefshme në çdo kohë. Në përrallën e mëposhtme synohet të gjendet përgjigjja për një nga pyetjet më të shpeshta që bëjnë njerëzit: «Si të jem i lumtur?» Cila është kjo përgjigje? Mjafton të lexoni me kujdes përrallën e mëposhtme dhe do ta merrni këtë përgjigje.

Një mullixhi rronte njëherë në një katund të vogël fare dhe qe i lumtur nga të gjithë se nuk qe lakmonjës.

E kish ndërtuar mullirin pranë një lumi të vogël, që shkonte përmes fshatit të tij. Punonte gjithë ditën në mulli me gëzim duke kënduar dhe duke lojtur valle dhe kurrë nuk thyente zemrën për asgjë. Qe i lumtur në punën e vet, nuk kish nakar për asnjeri, por shikonte punën, nxirrte të holla për rrojtjen e vet, e nuk desh më.

Gjithë njerëzia e kishin nakar, se qe i lumtur ky njeri.

Shumë herë e pyesnin:

– Përse je i lumtur?

Ai u thonte:

– Jam, se nuk kam asnjeri nakar.

Fjalor

mulliri – ndërtesa ku është vendosur një pajisje nëpërmjet së cilës bluhet drithi që vihet në punë me forcën e ujit.
mullixhi – ai që punon në mulli, atje ku prodhohet mielli.
lakmonjës – ziliqar, një njeri i pangopur që synon në mënyrë të padrejtë për të pasur vetë gjithçka.
nakar – smirë, zili.

Kështu mori ky emër të mirë në gjithë katundin. Një mbret që mbretëronte n'atë katund, qe shumë i pasur, po, me gjithë që qe mbret, kishte edhe punëra shumë. Lodhej me ato punëra e desh të hiqte dorë nga ajo punë, po veç të rronte i lumtur si ai. Po nuku dinte se si. Një ditë, kur po rrinte, po mejtoheshe, i thotë një njeriu të tij:
– A s'ka ndonjë njeri të lumtur këtu, që të bëhem edhe unë i lumtur?
Dhe ai i tha se "në filan vënt ndodhet një njeri i lumtur". Mbreti niset e vete që ta shikojë. Porsa vete atje, dëgjoi mullixhinë që po këndonte e po punonte. Si ndejti pak dhe si e dëgjoi mirë e mirë, hyri brënda dhe e pyeti:
– Ç'të bëj unë që të jem i lumtur si ti?
Mullixhiu i thotë:
– Unë s'mund të të ndihmoj për këtë gjë.
Ahere i thotë mbreti:
– Përse je kaq i lumtur?
Dhe ai i tha:
– Jam i lumtur se s'kam asnjë njeri nakar, po veç shikoj punën time.
– Nuku më thua, a mund të bëjmë ndonjë punë bashkë?
– Çfarë pune? – e pyeti mullixhiu mbretin.
– Unë jam mbret dhe dua të ta jap ty mbretërinë, ti të më japësh mullirin.
– Kjo është punë që s'bëhet, – i tha mullixhiu, unë jam i lumtur, se ky lumë që rrjedh këtu nget gurin të vijë rrotull e më mban zënë kur këndoj e jam plot gas e i lumtur.
Mbreti tha:
– Unë jam më i lumtur të jem si ti.
Mbreti, si pa që kish të drejtë mullixhiu, hiku e vate në pallat dhe zuri të rrojë i lumtur si ai.
Dhe kështu rronin që të dy të lumtur se nuk e thyenin zemrën e vet, po rronin me gas e nuk i kishin zili asnjeriu.

Folklor shqiptar, Proza popullore 1, Tiranë 1963

Krahasimi

Krahasimi është ajo figurë letrare, e cila krijohet nga vënia ballë për ballë e dy sendeve, dy frymorëve ose dy dukurive për të ndriçuar më mirë njërin prej tyre, si dhe për ta bërë më të gjallë e më të pasur mendimin. Nga ndërtimi sintaksor, krahasimi ka dy pjesë: të krahasuarit dhe krahasuesin, që lidhen ndërmjet tyre me lidhëzat: *si, ashtu si, porsi, sikurse*. P.sh.: *trim si luan*.

Fjalor

gas – humor, gëzim.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Lexoni përrallën dhe përgjigjuni pyetjeve:

a) Cilat janë personazhet kryesore të kësaj përralle?
b) Kush prej tyre është më i pasuri? Ai që është më i pasuri është edhe më i lumturi?
c) Cili prej tyre dëshiron ta ndërrojë jetën e tij me atë të tjetrit?
ç) Cila është kështilla që kërkon mbreti? A e merr ai një përgjigje të saktë për atë që kërkon dhe a e zbaton atë?

Studim teksti

Analizojmë tekstin

2. Gjeni në tekst treguesit që mullixhiu është vërtet i lumtur.
3. Mullixhiu ka një shpjegim për lumturinë e tij, të cilën ai e përmend vazhdimisht. A është ky shpjegim i njëjtë me këshillën që ai ua jep të gjithëve kur e pyesin?
4. Mullixhiu nuk e pranon propozimin e mbretit, sepse:
   - nuk donte që edhe mbreti të ishte i lumtur si ai;
   - lumturia nuk është diçka që blihet e shitet;
   - lumturia është diçka që e krijon vetë personi me zgjedhjet që bën në jetë.

Interpretojmë tekstin

5. Mullixhiu vazhdimisht thotë: "Jam i lumtur, se nuk kam nakar". Si e interpretoni këtë frazë?
6. Në fund të përrallës thuhet: "[…] rronin që të dy të lumtur se nuk e thyenin zemrën e vet [...]". Pse ndikon negativisht zilia në jetën e njerëzve?

Gjuha e tekstit

7. Cila është fjala kyçe në këtë përrallë? Numëroni sa herë është përmendur. Pse mendoni që është përdorur kaq shumë dhe çfarë ndjesie na jep si lexues?
8. Për fjalët dialektore të mëposhtme, gjeni formën e tyre në gjuhë letrare.

katund	
mejtohesh	
vate	

Reflektojmë rreth tekstit

9. A mendoni se pasuria të bën të lumtur?
10. Radhitni gjërat që mendoni se e bëjnë një njeri të lumtur në jetë. Po juve, çfarë ju bën të lumtur?
11. Bëni një pesëvargësh për fjalën: Lumturia.



Shkruajmë

- Mendoni sikur përralla ka një fund ndryshe. Për shembull, imagjinoni sikur mbreti të bëhej mullixhi dhe mullixhiu mbret. A mendoni se mullixhiu do të vazhdonte të ishte i lumtur? Po mbreti, a do të arrinte të bëhej i lumtur? Shkruani një fund tjetër për këtë përrallë.

Prometeu i lidhur

Para leximit

Kjo pjesë është përshtatje në prozë e tragjedisë "Prometeu i mbërthyer" të Eskilit, i cili është një nga shkrimtarët më të mëdhenj të Greqisë së Lashtë. Në qendër të kësaj vepre është një figurë e njohur e mitologjisë, Prometeu. Ai është një nga perënditë e Olimpit, malit ku jetojnë perënditë, të cilat kanë në krye të tyre, Zeusin. Prometeu, në kundërshtim më dëshirën e Zeusit i ndihmon njerëzit, ndërmjet të tjerave, duke u dhuruar zjarrin që është simbol i zhvillimit dhe përparimit. Zeusi është shumë i zemëruar me Prometeun ndaj vendos ta ndëshkojë atë. Dënimi që ka vendosur t'i japë Prometeut, është i tmerrshëm.

– Ja ku arritëm këtu në fundin e botës, në këtë mal tepër të lartë e të egër të Skithisë. Përpara, pra, gjithë sa urdhëroi Zeusi të kryejmë dhe këtë kryengritës ta lidhim fort me zinxhirë në shkëmbin më të lartë, meqë guxoi t'u vidhte perëndive zjarrin e t'ua dhuronte njerëzve. Për guximin e tij meriton këtë ndëshkim, që të mësojë tani e tutje të mos ngrejë krye kundër sundimit e të mos dëshirojë më t'u bëjë të mira njerëzve.

E iu përgjigj Hefesti:

– S'më bën zemra të mbërthej një perëndi në këto male të larta. Por dhe ndryshe nuk mund të bëj. Ashtu ka urdhëruar Zeusi.

Pastaj i foli Prometeut:

– O i madhi Promete! Dua s'dua, do të të mbërthej në këtë majë të pashkelur, ku nuk do të shohësh më njeri, as zë njeriu do të dëgjosh. Do të të përcëllojë dielli e do të presësh me ankth kur të vijë nata që të freskohesh, por ditën tjetër do të fillojnë prapë po ato gjëra dhe askush nuk do të mund të ta lehtësojë dhembjen. Kot do të rënkosh e do të vajtosh, o i mjerë! Zeusi është i ashpër e nuk do t'i dhimbsesh. Në këtë mënyrë do të shpërblehesh për dashurinë e shfaqur ndaj njerëzve!

E merr fjalën Pushteti e i thotë Hefestit:

– Përse vonohesh e nuk i vihesh punës? Perse të dhimbset ky kryengritës?

– Ai është i afërmi im, si mund të mos më dhimbset?

– E do të guxosh të mos dëgjosh urdhrin e Zeusit?

– Gjithnjë ashtu je ti, shpirtlig e i ashpër.

– E ç'nxjerr dikush duke qarë? Ajo që dëshiron Zeusi, do të bëhet! Ai është zotëria ynë, shpejt, pra, lidhe mirë e mirë! Vër gjithë fuqinë tënde e shtrëngoja fort duart!

Hefesti e lidhi Prometeun me zinxhir të trashë.

– Dhe tani me vare nguli gozhdët, që ky këtu të mos mund të lëvizë aspak.

Hefesti fillon të mbërthejë gozhdë në shkëmb e Pushteti vazhdon t'i thotë:

Fjalor

Skithi – vend në veri të Detit të Zi, në Kaukaz. Prometeun e mbërthejnë në një mal të Skithisë.
Hefesti – një nga perënditë e Olimpit; perëndia e zjarrit, e zejeve të ndryshme, e artit dhe e metalurgjisë.
Pushteti – një nga perënditë e Olimpit, servile e Zeusit, zbaton verbërisht urdhrat e tij.
vare – çekan i madh hekuri për të thyer gurë, për të rrahur hekurin e skuqur.

– Godit! Godit akoma mbi gozhdë! Dhe bëj kujdes që zinxhirët të rrinë sa më shtrënguar!
Hefesti iu përgjigj:
– Njërën dorë ia lidha aq mirë, sa s'mund ta lëvizë fare.
– Tani mbërtheja tjetrën.
Hefesti i lidh fort dorën tjetër dhe mbërthen zinxhirët në shkëmb.
– Ashtu, të lumtë! – i thotë Pushteti. – Që të mësojë të mos matet me Zeusin. Kaloi tani edhe sipër gjoksit një pykë të fortë hekuri që të mos ketë mundësi të lëvizë sadopak.
Kur mbaruan të gjitha këto, Hefesti tha i pikëlluar:
– Mjerë ti, o Promete! Fatin tënd të zi po qaj!
– Nuk di të mbash gjuhën dhe kjo s'është gjë e mirë. Por, pa na thuaj çfarë i bëre Zeusit, që të dënoi në këtë mënyrë?
– Ja, po jua them. Kur ranë në luftë perënditë, unë me këshillat e mia e ndihmova Zeusin të dilte fitimtar. Dhe ai ja se si ma shpërbleu. Kështu veprojnë të gjithë tiranët që tregohen të pabesë me miqtë e tyre. Zeusi, si zuri mirë fronin, nisi t'u ndante hyjnive ndere, ndërsa për njerëzit as që çante kokën. Jo vetëm kaq, por donte t'i shfaroste e në vend të tyre të mbillte të tjerë. Asnjë nga hyjnitë nuk ia kundërshtoi këtë plan, por unë nuk u përmbajta dhe mora anën e njerëzve. Dhe përfundimi ishte, ja, shihmëni!

Fjalor

pykë – *copë druri a metali, e mprehtë nga njëra anë, që përdoret për të çarë drutë, duke e goditur me vare.*
tiran – *sundimtar i vetëm e me pushtet absolut që qeveris me dhunë.*
eter – *sipas përfytyrimeve të lashta, eteri ishte një lëndë që zinte gjithë hapësirën mbi atmosferë.*



Shënim

Mitologjia greke është tërësia e miteve dhe e legjendave që u përkasin grekëve të lashtë. Ajo bën fjalë për perënditë dhe heronjtë e tyre, për natyrën dhe origjinën e botës, për prejardhjen e tyre si popull etj. Ajo luante rolin e fesë në Greqinë e lashtë.

Epiteti

Epiteti është një fjalë përcaktuese, e cila formohet me një mbiemër që i shtohet një emri për t'i pasuruar kuptimin, duke i dhënë bukuri artistike dhe ngarkesë emocionale. Epiteti është një figurë me përdorim shumë të gjerë, që shpesh bëhet edhe përcaktues i stilit. P.sh.: Akil këmbëshpejti, shpirt i helmuar etj.

– Sa dhimbje ndiejmë tok me ty! Pa na thuaj tani, ç'bëre për hatrin e njerëzve?

– Unë u mësova të shërojnë sëmundjet, u dhashë zjarrin me të cilin do të shpikin tani shumë mjeshtëri.

– Për këto të mundon me aq egërsi Zeusi?

– Pikërisht për këto. Dhe s'e di si do të më sosen kusuret.

Por s'e mohoj se me dëshirë bëra gjithë ato që bëra për të ndihmuar njerëzit.

Fillon të vetëtijë dhe gjëmime të tmerrshme dëgjohen paprerë. Thotë Prometeu:

Fjalët mbaruan. Ja ku nisi të gjëmojë toka dhe bubullima të frikshme dëgjohen. Rrufetë si gjarpërinj të ndritshëm po shqyejnë terrin. Një ciklon i tmerrshëm po ngre lart pluhurin, erërat ulërijnë. Zeusi po dërgon mbi mua një re të zezë që sjell tmerr. Nënëzë e dashur! Dhe ti Eter, që me dritën tënde mbështjell çdo gjë! Shihni se si po vuaj pa pasur asnjë faj!

Zeusi ashtu siç kërcënoi, po ashtu veproi. Dërgoi një shqiponjë që ia hante mëlçinë Prometeut. Por natën mëlçia rritej përsëri, ditën tjetër shqiponja zbriste dhe e hante, e njëjta gjë përsëritej. Afro katërqind vjet vazhdoi kjo torturë e Prometeut.

Fragment i shkëputur nga "Eskili në prozë", J. Benekos

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve:

a) Cilat perëndi ka caktuar Zeusi për të lidhur me zinxhirë Prometeun?

b) Pse Hefesti shfaq keqardhje për fatin e Prometeut? Çfarë e lidh Hefestin me Prometeun?

c) Si ishte marrëdhënia e mëparshme e Prometeut me Zeusin? Çfarë ndodhi më pas? Pse e quan Prometeu mosmirënjohës Zeusin?

d) Cili ishte plani i Zeusit për njerëzit? A ishin dakord perënditë e tjera me këtë plan? Po Prometeu?

dh) Cili është dënimi që Zeusi i jep Prometeut?

e) Sa vjet zgjati dënimi i Prometeut?

Analizojmë tekstin

2 Prometeu, Zeusi dhe Pushteti janë perëndi. Cilat janë karakteristikat që tregojnë superioritetin e tyre ndaj njerëzve?

3 Prometeu e quan Zeusin tiran. Cilat janë karakteristikat e karakterit të Zeusit që e bëjnë atë të tillë?

Studim teksti

4 Renditni të mirat që u bëri Prometeu njerëzve.

a. _____

b. _____

5 Nëpërmjet diagramit të Venit vini në dukje ngjashmëritë dhe dallimet mes Prometeut dhe Zeusit.



6 Pushteti është një shërbëtor i përulur i Zeusit. Nga e kuptoni këtë?

Interpretojmë tekstin

7 Pushteti e quan Prometeun "kryengritës". Pse e etiketon atë në këtë mënyrë? Çfarë ka bërë ai?

8 Interpretoni frazën: "Shihni si po vuaj pa pasur asnjë faj". Pse nuk mund të quhet faj veprimi i Prometeut?

9 Përshkruani emocionet dhe ndjesitë e Prometeut në momentin kur fillon të vuajë dënimin.

Gjuha e tekstit

10 Ky tekst është i mbushur me epitete. Gjeni 10 shembuj të tillë. P.sh.: *greminat e egra*.

11 Shpjegoni me fjalë të tjera këto shprehje të figurshme:

- *në fund të botës* _____
- *të mos matet me Zeusin* _____
- *nuk di të mbash gjuhën* _____
- *s'e di si do të më sosen kusuret* _____

Reflektojmë rreth tekstit

13 Si i kuptoni frazat e mëposhtme?

Kur ranë në luftë perënditë, unë me këshillat e mia e ndihmova Zeusin të dilte fitimtar. Dhe ai ja se si ma shpërbleu. Kështu veprojnë të gjithë tiranët që tregohen të pabesë me miqtë e tyre.

Detyrë

- Si e imagjinoni pamjen e jashtme të Prometeut pasi lexoni këtë pjesë? Bëni një përshkrim të shkurtër për ta paraqitur atë.
- Gjeni një personazh tjetër nga mitologjia, emri dhe veprimet e të cilit janë kthyer në simbol. P.sh.: *Helena e Trojës është simbol i bukurisë.*

Pëllumbi dhe milingona

Para leximit

Në fabulën "Pëllumbi dhe milingona", rrëfehen dy ndodhi që kanë lidhje me një pëllumb dhe me një milingonë. Pëllumbi fluturon lart në qiell, ndërsa milingona është shumë e vogël dhe zvarritet gjithë jetën nëpër tokë. Në pamje të parë duket sikur pëllumbi s'mund të ketë kurrë nevojë për milingonën, por në fund do të rezultojë ndryshe.

Një milingonë, një herë,
ra në një pellk mjaft të gjerë,
dhe, duke mos ditur not,
do të mbytej se s'dil dot.
Një pllumb q'u ndoth n'ato anë
merr një kasht' e ia heth pranë.
Kur u ngjit në këtë kashtë
milingona doli jashtë.
Tatëpjetë, nga një brek
vjen një gjahtor me dyfek
dhe bëhet gati të shtjerë
dhe të vrasë pllumbn'e mjerë.
Pandeh q'e ka në tenxhere;
Po milingona ahere,
kur e pa gjahtorë
me pushkë në dorë,
që bën gati plumbnë
për të vrarë pllumbnë,
e zuri me dhembë
ndë një gisht ndë këmbë,
gjahtori ul kokën
për të kqyrë tokën;
pllumbi kupëtoi,
me vrap fluturoi
dhe u ngre në qiell;
gjahtori mbeti mbë diell...

përkthyer nga A. Z. Çajupi

Zhan de la Fonten

Zhan de la Fonten (1621-1695) lindi në Francë. Ai mbahet si fabulisti më i madh francez, si dhe një nga shkrimtarët më të njohur të shekullit XVII. Fabulat e tij janë një sërë rrëfimesh mbresëlënëse me plot mesazhe filozofiko-etike.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Lexoni fabulën dhe përgjigjuni pyetjeve:

a) Cilët janë protagonistët e kësaj fabule?
b) Çfarë i ndodhi milingonës?
c) Cili e ndihmoi milingonën kur po mbytej?
d) Çfarë ka në krah gjahtari dhe cili është qëllimi i tij? A ia arrin qëllimit? Pse?

Analizojmë tekstin

2 Në sa pjesë mund ta ndani fabulën? Sa ngjarje ka brenda saj? Vendosini çdo pjese nga një titull. Çfarë i lidh në një fabul këto pjesë?

3 Shpjegoni si e kuptoni vargun e fundit: *Gjahtori mbeti mbë diell...*

4 Një shprehje popullore thotë: "*Bëni një të mirë dhe hidheni në det*". Pëllumbi kur e shpëtoi milingonën e bëri këtë se mendonte që do të vinte një moment kur ajo do ta ndihmonte, apo thjesht sepse kështu duhet të veprojë çdokush kur ka pranë dikë që ka nevojë për ndihmë?

Interpretojmë tekstin

5 Çfarë përfaqëson pëllumbi? Po milingona?

6 Në fabula personazhet janë kafshë, por në to jepen mësime për njerëzit. Çfarë mesazhesh përcjell kjo fabul?

Gjuha e tekstit

7 Teksti është i shkruar në vargje. Përcaktoni ç'lloj rime është përdorur.

8 Kthejini këto fjalë të përdorura në dialektin toskë në gjuhën standarde.

pellk	
pllumbnë	
ndoth	
heth	
brek	
gjahtorë	
kqyrë	
ndë	

Reflektojmë rreth tekstit

9 A duhet t'i ndërtojmë marrëdhëniet vetëm në bazë të interesit që kemi me të tjerët? Çfarë duhet të vëmë në bazë të tyre?

Detyrë

- Jepni shembuj nga jeta juaj ose e shokëve tuaj, në të cilët të tregoni se mosha nuk ju ka penguar t'i ndihmoni të tjerët.

Fabula

Fabulat janë tekste që përcjellin në mënyrë të tërthortë një ide apo një mesazh. Autori nuk e shpreh mendimin në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në bazë të fabulave është **figura e alegorisë**. *Alegoria është ajo figurë letrare me anë të së cilës theksohet një mendim, që nuk është shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë, por duhet nënkuptuar.*

Kërcimtarja e Dukagjinit

Para leximit

Në Dukagjin na ishte një herë një vajzë shumë e bukur, që quhej Lule. Ajo ishte mbesa e Lekë Dukagjinit, princit të njohur shqiptar. Lulja, ndonëse shumë e bukur, ishte e plogët dhe tejet e ndrojtur. Skënderbeu, pas një beteje të fituar kundra turqve, mblodhi në Krujë gjithë parinë e Shqipërisë dhe bajlozë të huaj për të festuar. Në këtë festë merrte pjesë edhe Leka bashkë me familjen. Ditën e fundit, mbreti lajmëroi një konkurs për vajzën a gruan që do të kërcente më bukur përpara të gjithëve. Valltare të ardhura nga jashtë vendit kërcyen duke i magjepsur njerëzit. Mbreti deshi t'ia jepte çmimin një turkeshe të panjohur. Atëherë, kur dukej se konkursi kishte një fituese, para të gjithëve në mënyrë të papritur doli Lulja, e cila mahniti gjithë publikun me zhdërvjelltësinë e lëvizjeve të saj. Edhe gjatë rrugës së kthimit, Lulja në majë të kalit vazhdoi t'i mahniste bashkudhëtarët me shkathtësinë e saj. Të nesërmen, e ëma vuri re se vajza ra në plogështinë e zakonshme. Madje nuk mbante mend as Krujën, as që të kishte kërcyer ndonjëherë në jetën e vet. Ç'kishte ndodhur? Zanat e Dukagjinit deshën të qitnin zërin e maleve të tyre, prandaj e zëvendësuan Lulen me njërën prej tyre.

Fjalor

turulluqe – e qullët, e plogësht.
tyrkinë – turkeshë.
shtrojë – mbulesë.
hyrija – këtu: bukuria.
amë – aromë.
i vërgjilët – i zhdërvjellët.
apoteozë – hyjnizim.
rremtha – degëza.
kind – cepi, pala që valëvitet.
emnoi – emëroi.

Metafora

Metafora është ajo fjalë a shprehje që emërton një send a një dukuri me emrin e një sendi a dukurie tjetër, që i ngjan. Shpesh metafora shpjegohet edhe si krahasim pa lidhëzën krahasore. Një lloj metafore që përdoret shpesh është kur shpirtëzohen sendet a dukuritë, d.m.th., kur tiparet e karakteristikat e një frymori kalohen te një jofrymor.

"Paska qenë dikur në Dukagjin një vajzë mrekullisht e hijshme. Për në dhe tonë, asokohe mund të thuhej se nuk kishte m'u gjetën nji tjetër ma e bukur. Hijeshia e fytyrës dhe përsosja e të gjithë pjesëve të trupit, lente për një copë herë pa mend para saj këdo që e shifte së pari, kryet, krye perëndeshe, duert, duer zanash, këmbët aq të vogla e të lehta sa me t'u ba se po qasin fletë e po e çojnë fluturimin n'ajri. Me dy fjalë nji kryevepër natyre.
Por…
Kapriçot e nanës natyrë janë vërtetë të çuditshme. Vasha ma e bukur e dheut tonë ishte e ngathët, e trashë, turulluqe."
Si u këshillue me bajloza, Mbreti dau me ia dhanë çmimin e premtuem tyrkinës së panjohun e ishte kah jepte urdhën të shpallej ky vendim, kur nji kërcimtare e papritun e ndaloi tue dalë në mes të shtrojës.
Ishte princeshë Lulja, mbesa e Lekë Dukagjinit.
Si u ba? Ça ndodhi?
Porsa hyrija malsore çoi duert e luejti kambët, nji habi e ambël kapi gjith shpirtnat. Nëpër tanë salonin u ndie si nji amë lulesh mali e si nji gurgullim krojesh të ngrita.
Sy njeriu s'kishte pa as valle ma të mrekullueshme, as kërcimtare ma të bukur. Lëkura e fytyrës së saj gjante e endun me rreze e fletëza prilli. Trupi i vërgjilët përhapte anë për anë nji njomsi si lule qi sapo ka çelë.
Të gjithve iu bante se shifshin rreth saj tue

lulzue e tue u shfletëzue, si n'andërr, lulishta madhshtore. Ishte nji apotheozë lulesh: lule të denduna të panjehuna iu çelshin nën kambët e lehta, reshëshin mbi flokë të lëshuem, dridheshin ndërmjet gishtave të bardhë, derdheshin mbi trup hyjnuer.

Tash gjante si t'ish tue luejtë foshnjisht me përfytyrimin e saj në pasqyrën e nji uji të kulluet; mbandej dukej të këputte rremtha të lulzuem, tue u ngritë maje gishtave të vogjël. Herë ngitte nëpër shtroje si të ndiqte ndonji flutur ari; herë valavitej si t'a perkundte jehu i nji jonës së largët qi ngjallë malle të paprituna.

Merrte m'u ngjitun nëpër nji shkallë ajrore, largonte gjeth e lule të padukshme qi ia ndalojshin hovin, hidhej përpara si të biente zhyt në ndonji krue, shtrinte dorën me kapë shoqe tjera e sillej me mënyrën e asaj qi u prin nji vargu të gjatë vajzash kërcyese.

E drejtë si curril uji gufues, e lakueshme si gem i njomë, e shpejtë, si hije reje, e dridhshme si drita në krue, endej shpejt, kadalë, hovshëm, pritueshëm. Kërcimi i saj ishte i freskët si lirija e maleve, i lehtë si kind flamuri qi valon ndër maje t'epra, i egër si fluturimi i shqipeve, i përmallshëm si kangë e harrueme qi ngjallet në fund të zemrës.

Sa mbaroi, nji brohori e përgjithshme e emnoi mbretneshë të kërcimtareve. Mbreti vetë erdhi m'e marrë për dore. Princat, kapidanat, bajlozat, bujarët, kalorsit, e rrethuen tue e mbulue me lavde e tue i ngjitë mbiemna të bukur. - Zana me flatra! - Hyjneshë e kërcimit! - Dritë hane në prrue! - Fllad fluturues! - Lule n'erë! Flutura e Shqipnis; Bajlozi i Venedikut i pëshpëriti: - Tersicore! E ama, Zoga, me çudin ma të madhe qi mund t'i shprehte fytyra, u lëshue kah ajo: - Po kush të ka mësue, moj, ty me kërcye ashtu?

Ernest Koliqit

Ernest Koliqi (Shkodër, 20 maj 1903 – Romë, 15 janar 1975) ka qenë poet, prozator, eseist, përkthyes, gazetar, botues etj. Ai dhe Mitrush Kuteli janë cilësuar si bashkëthemelues të tregimit modern shqiptar. Ernest Koliqi ka mbajtur edhe postin e ministrit të Arsimit. Gjatë kësaj kohe, ka meritë të veçantë për dërgimin e 200 arsimtarëve drejt Kosovës, në shtator të vitit 1941. Ky veprim krijoi mundësinë për hapjen e një numri të madh të shkollave fillore dhe shkollave të mesme në shumë krahina. Mund të përshkruhet si historike, hapja e shkollës së parë në gjuhën shqipe, më 12 dhjetor 1941. Këto shkolla u bënë bazë thelbësore për zhvillimin dhe përparimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare në territorin e Kosovës.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve:

a) Në çfarë periudhe zhvillohen ngjarjet? Cilat figura historike përmenden në këtë prozë?

b) Cila ishte kërcimtarja që pothuajse u bë fituese e garës? Pse nuk arriti ajo të shpallej fituese?

c) Lulja pëson një ndryshim të jashtëzakonshëm. Çfarë lloj ndryshimi pëson Lulja: së jashtmi apo së brendshmi?

d) Kush e fiton konkursin?

dh) Çfarë ndodhi me Lulen kur u kthye në vendlindjen e saj?

Studim teksti

Analizojmë tekstin

2 Lulja e bukur dhe e ngathët në konkursin e kërcimit shndërrohet në një Lule tjetër. Përcaktoni ndryshimet dhe plotësoni tabelën.

Lulja para konkursit	Lulja (zana) në konkurs

3 Në këtë prozë Koliqi ka futur një element karakteristik përrallor. Cili është ky element?

4 Lulja i mahniste njerëzit me bukurinë e saj fizike, por gjatë kërcimit i mahniti me diçka tjetër. Çfarë e bëri atë të dallojë nga të tjerat?

5 Në këtë prozë, përshkrimi i zanës nis nga këmba, sepse këmbët janë objekt kryesor i kërcimit. Nëpërmjet zanës Lulja arrin harmoni mes sjelljes e bukurisë. Si e cilësojnë njerëzit që e shikojnë të kërcejë Lulen?

6 Përcaktoni elementet e përrallës që gjenden në prozën e Koliqit.

Interpretojmë tekstin

7 Ndaluni në reagimin e personazheve në fund të fragmentit. Jepni një karakteristikë të këtij reagimi. Pse nëna habitet njësoj si të tjerët?

8 Zanat e Dukagjinit e kishin tjetërsuar Lulen. Njëra prej tyre kishte ndërhyrë për ta arritur fitoren e dëshiruar. Cila është arsyeja e ndërhyrjes së zanave në mënyrë që Lulja të dalë fitimtare?

Gjuha e tekstit

9 Shpjegoni rolin e epitetit të nënvizuar në fjalinë: *Porsa hyrija malsore çoi duert e luejti kambët, nji habi e ambël kapi gjith shpirtnat...*

10 Cila figurë është përdorur në shprehjen karakterizuese për Lulen: *Flutura e Shqipnis?*

- Hiperbola.
- Metafora.
- Epiteti.
- Krahasimi.

11 Gjeni në tekst krahasimet e përdorura për kërcimin e Lules.

Reflektojmë rreth tekstit

13 Para daljes së papritur të Lules, mbreti kishte vendosur t'ia jepte çmimin e premtuar turkeshës së panjohur. Shqipërisë i kanosej rreziku i ushtrisë turke në çdo moment. Si e interpretoni faktin që populli i përkulet bukurisë së artit, nuk i trembet, por e pranon, e respekton dhe e shijon pavarësisht origjinës? Çfarë mund të cilësohet si e jashtëzakonshme në këtë akt?

Detyrë

- Gjeni legjenda nga folklori që kanë pjesë të tyre figurën e Skënderbeut. Diskutoni rreth mënyrës se si është ndërtuar figura e heroit tonë.

Grimca humoristike

Para leximit

Anekdotat janë tregime të shkurtra, në të cilat me një humor të këndshëm e goditës vihen në dukje të metat e përgjithshme njerëzore, qëndrimet, sjelljet dhe dobësitë e tyre, dukuritë e ndryshme shoqërore. Ato japin një pasqyrim metaforik, por edhe alegorik të realitetit tonë me të cilin përballemi çdo ditë. Ato janë dëshmi e zgjuarsisë dhe e mendjemprehtësisë natyrore të popullit që i tregon. Në to jepen ngjarje reale dhe historike, ndodhi të njerëzve të thjeshtë, por dhe të personaliteteve të njohura etj.

Shqiptarët janë si shqipet

Në një ndejë në Mal të Zi, Mark Milani i thotë Ali Pashë Gucisë:

– Ju shqiptarët jini sikur dhitë e egra. A i ke parë dhitë e egra, njëra në atë rrëpirë, tjetra në rrëpirën përballë, thërrasin e bërtasin se nuk u rrihet vetëm, por kur bëhen bashkë, të parën punë që bëjnë, godasin njëra-tjetrën në lule të ballit, veç në këmbë të prapme për të bërë belanë...

Ali Pashë Gucia buzëqeshi e tha:

– E more Mark Milani, me sa di unë, edhe ti prejardhjen e ke shqiptare, por pasi u bëre malazez "të koftë me sherr kombi i ri..." E për dhitë e egra, po them, e ke gabim!

– Pse e kam gabim?

– Sepse shqiptarët nuk janë sikur dhitë e egra, por janë shqiponja. I ke parë buburrecat? Ata janë të vegjël, qyqarë, rrinë bashkë e punojnë bashkë se vetëm nuk ua mban dhe s'ia dalin dot. E shqiptarët sillen sikur shqiponjat. I ke parë shqiponjat në fluturim, i bien qiellit kryq e tërthor e askënd s'e mbajnë afër vetes, sepse ato janë sundimtare të plota të qiellit e nuk ia kanë nevojën kujt për ndihmë.

– Hollë ke qitur Ali Pashë Gucia!...

– Jo, s'thashë gjë të re, o Mark Milani! Shqiptarët prej shqipeve e kanë marrë emrin, e mjerë ata që s'kanë ndenjur me shqipe, po janë bërë bashkë me buburrecat!

Fjalor

ndejë – këtu: në një qëndrim së bashku.
rrëpirë – faqe mali a kodre shumë e pjerrët; vend i gërryer e i thelluar nga një përrua.
në lule të ballit – në shenjë.
për të bërë belanë – këtu: për të krijuar ngatërresa, probleme.
të koftë me sherr – të qoftë me sherr.
sundimtar – ai që ka pushtetin në një vend.
hollë ke qitun – je treguar i zgjuar.

Shënim

Mark Milani dhe Ali Pashë Gucia janë dy figura të njohura në histori.
Ali Pashë Gucia ishte kundërshtar shumë i fortë i synimeve shoviniste serbe dhe malazeze ndaj tokave shqiptare. Një ndër nismëtarët e themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.
Mark Milani ka qenë gjeneral dhe shkrimtar malazez. Ai u bë armik i shqiptarëve kur u printe ushtrive serbo-malazeze për të grabitur trojet shqiptare pasi Perandoria Osmane po shkatërrohej.

Si të premtoi koha me i numërue?



Në një ndejë dimri tek po bisedonin disa veta, befas u dëgjuan të lehura të ashpra qenësh. Pasi pushuan së lehuri qenët, priti e foli njëri: – Burra, para dy ditësh, herët në mëngjes sa nuk më kanë bërë copë e grimë tre qenë!
Priti e foli njëfar Delia nga Gjilani: – He, ty tre, po mua që besa para një jave desh më shkyen nja 25 qenë!
– Nuk po habitem se si paske shpëtuar, – ja priti tjetri, – sa po habitem se si paske mundur t'i numërosh aq sakt në gjithë atë rrëmujë...

Leje diellin me shkue per qejf t'veti

Njani kish pasë do argat tuj prashitë kallamoq. Kish pasë dalë ara e shtirë e argat' ishin lodhë. Kur hanë drekë e i qesin do rena, njani lodhet fort edhe po e k'qyr diellin. Hala ish nalt. Ja ban me dorë diellit qi me hecë ma shpejt e me prarue.
I zoti i shpisë e kish pas pa edhe kujtoi se mos po e ngon dielli e po hec ma shpejt e po i metet ara pa marue. E çoi dorën edhe ai e po i jep shej diellit me shkue m'rapa. Njani pej argatëve i pa edhe u tha:
– Mosni bre! Leneni diellin me shkue për qef t'vet!

Mbledhur nga Anton Çeta "Letërsi popullore", Vëllimi XV

Fjalor

argat - punëtor me mëditje te një pronar tokash.
kallamoq – misër.
hala – ende, akoma.
po i jep shej – po ia bën me dorë.
me shkue m'rapa – me u kthye pas.

Djali përtac

Ni babë i kish pas dy djem: i madhi Hamza, i vogli Hasani.
I tha plaku 'i mramje djalit t'vogël:
– Qitma, Hasan, 'i gotë ujë! – Hasani ish kanë lodhshëm. Bani kishe s'po nin e s'luejti venit.
– Uh, bre babë! – ja priti djali i madh, Hamza, – po ti e di mirë qi s'asht i hajrit Hasani. Qou vetë e pi uj, e qitma edhe mue 'i gotë.

Fjalor

bani kishe s'po nin – bëri sikur nuk dëgjonte.

Djali i sgjuar dhe i verbri

Fjalor

fanar – ndriçues, llampë, fanar.
e prëpoq – e takoi.

Një i verbërë ecën me fanar ndë dorë natënë ndëprë dhrome ndë të madhe erësirë, e kish në krahë edhe një shtamnë t'ujit.
Një dialë i zgjuarë shumë e prëpoq këtë të verbërinë e shastisi ç'e pa me fanar ndë dorë e i thotë:

– Vre i pamençimë! Çë të vëlen ti drita çë ke ndë dorë, dita edhe nata prë ti s'ishtë një lojishi?
I verbëri i prëgjegjhetë pse: – Dritënë nëkë e mbanj për vetëhenë time, po e mbanj për të të marr njerës, ç'edhe ti u nglet atyre, çë, po të më shohënë, të bënjënë nga bënda, të mos më vinjënë ndë malë të më shtinjënë e më çonjënë edhe shtamnënë.

Mbledhur nga G, Majër, Studime shqiptare V

Fjalor

çë të vëlen – çfarë të vlen.
prë ti s'ishtë një lojish – për ty s'është njëlloj.
nëkë – nuk.
të bënjënë nga bënda – të bësh nga brenda; këtu: të ndryshosh drejtim.
shtambënë – enë balte për ujë, e gjerë në mes, me vegjë dhe me grykë të ngushtë.

Anekdota nga bashkëkohësia

Genti u kthye në dyqan me lapsin që kishte blerë para tri ditësh. Shitësi e pyet pse e ktheu dhe Genti përgjigjet: – Bën shumë gabime ortografike!

– Vizatojeni trenin duke ecur! – u kish thënë mësuesja nxënësve.
Beni vizatoi vetëm binarët.
– Ku është treni? – pyeti mësuesja.
– Qe sapo kaloi, – qeshi Beni.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Lexoni anekdotat dhe përgjigjuni pyetjeve:

a) Plotësoni tabelën duke shënuar personazhet për secilën anekdotë dhe llojin e tyre.

Titulli	Personazhet	Lloji (historik, i trilluar)
Shqiptarët janë si shqipet		
Si të premtoi koha me i numërue		
Leje diellin me shkue per qejf t'veti		
Djali përtac		
Djali i sgjuar dhe i verbri		
Anekdota nga bashkëkohësia 1		
Anekdota nga bashkëkohësia 2		

Studim teksti

b) Me çfarë i krahason Mark Milani shqiptarët? Po Ali Pashë Gucia?

c) Në anekdotën "Si të premtoi koha me i numërue", zhvillohet një dialog. Përcaktoni:
- Në çfarë ambienti zhvillohet ai?
- Për cilat kafshë flitet?
- Cilët numra përmenden?

ç) Cila është dëshira e argatit në anekdotën "Leje diellin me shkue per qejf t'veti"? Po dëshira e të zotit të shtëpisë?

d) Në anekdotën "Djali përtac":
- Sa fëmijë kishte babai i anekdotës?
- Çfarë i kërkon ai djalit të vogël? A ia kryen porosinë ai? Po djali i madh?

dh) Për çfarë i duhej fanari të verbrit natën, në errësirë, në anekdotën "Djali i sgjuar dhe i verbri"?

Analizojmë tekstin

2 Analizoni frazën e anekdotës "Shqiptarët janë si shqipet:

[...] ti prejardhjen e ke shqiptare, por pasi u bëre malazez "të koftë me sherr kombi i ri"...

3 Ali Pashë Gucia në fund i thotë Mark Milanit: "e mjerë ata që s'kanë ndenjur me shqipe, po janë bërë bashkë me buburrecat!" Cilët janë buburrecat? Çfarë synimesh kanë ata ndaj shqiptarëve?

4 Çfarë vesi goditet në anekdotën "Si të premtoi koha me i numërue"?

5 Pse i zoti i shtëpisë dhe argati kanë dëshira të kundërta në anekdotën "Leje diellin me shkue per qejf t'veti"?

6 Në anekdotën "Djali përtac", cili është vesi i djalit të vogël që e shqetëson babain? Po djali i madh, a ngjan me vëllain e vogël?

7 Në anekdotën "Djali i sgjuar dhe i verbri", cili rezulton më i zgjuar, djali apo i verbri? Pse?

8 Anekdotat nga bashkëkohësia na bëjnë të qeshim për shkak:

a) të mungesës së inteligjencës;
b) të naivitetit fëmijëror;
c) të rrethanave të pakuptueshme.

Interpretojmë tekstin

9 Interpretoni reagimin e Ali Pashë Gucisë ndaj krahasimit të shqiptarëve me dhi të egra që bën Mark Milani.

10 Çfarë i bashkon shqiptarët me shqiponjat? Renditni disa tipare.

11 Pse na vjen për të qeshur nga situata që krijohet mes babait dhe djemve në anekdotën "Djali përtac"?

Reflektojmë rreth tekstit

12 Në anekdotën "Djali i sgjuar dhe i verbri", si e gjykoni sjelljen e djalit ndaj të verbrit? Çfarë karakteristike të djalit tregon kjo sjellje?

Detyrë

- Gjeni disa anekdota të tjera me personazhe historike ose jo.

Pikat e shiut

Para leximit

Kjo pjesë është shkëputur nga romani "Kronikë në gur", i shkrimtarit të njohur shqiptar Ismail Kadare. Ky roman rrëfen kujtimet e fëmijërisë së një djali në qytetin e tij të lindjes. Bota shihet me sytë e një fëmije.
Në këtë pjesë rrëfehet se si në një natë dimri, një shi i furishëm kishte mbushur plot sternën poshtë shtëpisë duke rrezikuar të dëmtonte, madje të prishte, themelet e saj. Qyteti në të cilin zhvillohen ngjarjet është kodrinor dhe pjerrësia e tij e ndihmon forcën dëmtuese të ujit. Në këtë pjesë përshkruhet perceptimi i një fëmije për ngjarjet që ndodhin në jetën e përditshme të familjes dhe të qytetit të tij. Nëpërmjet naivitetit të tij në dukje, fëmija paraqet çështje dhe probleme të rëndësishme.

Përjashta nata dimërore kishte mbështjellë çdo gjë me ujëra, mjegull dhe erë. Duke futur kokën nën jorgan, unë dëgjoja mbyturazi zhurmën monotone të pikave të shiut mbi çatinë e madhe të shtëpisë sonë.
E merrja me mend se si pikat e panumërta rrokulliseshin tani në faqet e pjerrëta të çatisë, duke shpejtuar të binin sa më parë në tokë, që pastaj të avulloheshin dhe të ngjiteshin prapë atje lart, në qiellin e bardhë. Ato nuk e dinin se në strehët e çatisë i priste një grackë e panjohur, qyngji prej llamarine. Tamam në çastin kur bëheshin gati të kërcenin nga çatia në tokë, pikat e shiut gjendeshin befas në qyngjin e ngushtë, bashkë me mijëra e mijëra shoqe të tjera, që pyesnin të frikësuara: "Ku po shkojmë kështu, ku po na çojnë?" Dhe, pa e mbledhur veten mirë nga ky vrap i çmendur nëpër qyngj, binin papritur në një burg të thellë e të errët nën tokë, në sternën e madhe të shtëpisë sonë.
Kur shirat vazhdonin tri-katër ditë rresht, babai e shkëpuste qyngjin në një vend, që sterna të mos mbushej më tepër se ç'duhej. Sterna ishte shumë e

Ismail Kadare

Ismail Kadare lindi në vitin 1936 në Gjirokastër. Ka shkruar poezi, tregime, novela, romane, kritikë letrare, publicistikë etj. Veprat e tij janë botuar në shumë gjuhë të vendeve të ndryshme të botës. Veprat e tij më të njohura janë "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Kështjella", "Kronikë në gur", "Dimri i madh", "Ura me tri harqe", "Pallati i ëndrrave" etj.

madhe. Ajo shtrihej pothuaj nën gjithë sipërfaqen që zinte shtëpia jonë dhe, në qoftë se shpërthente, mund të përmbyste në fillim kubenë dhe pastaj të shkatërronte krejt themelet e shtëpisë, sepse qyteti ynë ishte i pjerrët, dhe në këtë qytet mund të ndodhte çdo gjë.

Ndërsa po vrisja mendjen se cili e kishte më vështirë të duronte burgimin, njeriu apo uji, dëgjova hapat e gjyshes dhe pastaj zërin e saj nga dhoma tjetër:

– Ngrehuni, ngrehuni, kemi harruar të heqim qyngjin.

Babai dhe nëna u ngritën menjëherë të alarmuar. Babai vrapoi në errësirë nëpër korridor, me mbathjet e gjata të bardha, hapi dritaren e vogël të qoshkut dhe me një shkop të gjatë e mënjanoi qyngjin. U dëgjua zhurma e ujit që filloi të binte në oborr.

Ndërkaq, nëna ndezi llambën me vajguri dhe bashkë me babanë e me gjyshen zbriti shkallët. Unë u afrova te dritarja dhe u mundova të vështroja përjashta. Era e përplaste shiun me furi pas xhamave dhe mazgallat e vjetra të shtëpisë rënkonin.

Nuk m'u durua dhe zbrita shkallët të shikoja se ç'bëhej poshtë. Ata të tre ishin të shqetësuar dhe nuk më vunë re. Kishin hequr kapakun e grykës së sternës dhe po mundoheshin të vështronin ç'ndodhte atje brenda. Nëna mbante llambën dhe babai vështronte.

Ndjeva një rrëqethje në trup dhe u kapa pas rrobave të gjyshes. Ajo më vuri dorën në kokë. Porta e jashtme dhe e brendshme dridheshin nga era.

– Ç'është ky kiamet! – tha gjyshja.

Babai, i përkulur i tëri, po mundohej të shikonte brenda në sternë.

– Bjer një copë gazetë, – i tha nënës.

Ajo e solli. Babai e mblodhi shuk gazetën, e ndezi dhe e lëshoi në sternë. Nëna lëshoi një klithmë të vogël.

– Ujët është ngjitur gjer te gryka, – tha babai.

Gjyshja filloi të murmuriste një lutje.

– Shpejt, – thirri babai, – ndiz fenerin.

Nëna, dyllë e verdhë, me duart që i dridheshin ndezi fenerin, ndërsa babai hodhi në kokë mushamanë e zezë, ia mori fenerin dhe shkoi të hapte portën. Edhe nëna hodhi një rrobë të vjetër mbi kokë dhe i shkoi pas.

– Gjyshe, ku vanë ata? – pyeta i trembur.

– Të thërresin fqinjët, – tha gjyshja.

– Pse?

– Të na ndihmojnë të pakësojmë ujët e sternës.

Jashtë, midis zhurmës së madhe të shiut, u dëgjua mbyturazi një trokëllimë porte. Pastaj një tjetër, një tjetër.

– Gjyshe, si do ta pakësojmë ujët?

– Me kova, bir.

Fjalor

sternë – depo e madhe e gërmuar poshtë shtëpive për të mbledhur ujin e shiut.
qyngj prej llamarine – gyp i gjerë prej llamarine ku kalon uji i shiut.
kube – çatia ose mbulesa në formë gjysmë rrethi e një ndërtese.
llambë prej vajguri – mjet ndriçimi me vajguri.
mazgallë – vrima ose të çara të mëdha nëpër muret e shtëpisë.
kiamet – katastrofë; këtu: shtrëngatë me shi dhe furtunë.
fener – mjet ndriçimi me vajgur ose bateri.
trokëllimë – zhurmë e shkurtër dhe e rregullt kur godasim diçka.
zëri i zvargur – zëri i zgjatur më shumë se zakonisht, i zvarritur.
me furi – me vrull të madh, me forcë.
binte me shtamba – binte më shumë se normalja.

Unë iu afrova grykës dhe vështrova poshtë. Errësirë. Errësirë dhe frikë.
– Auu, – ia bëra me zë të butë. Por sterna nuk m'u përgjigj. Ishte hera e parë që nuk më përgjigjej. Unë e doja shumë sternën dhe shpesh i flisja gjithfarë gjërash, duke u përkulur në grykën e saj. Ajo kishte qenë gjithmonë e gatshme të më përgjigjej me atë zërin e saj të zvargur e të thellë...
– Auu, ia bëra prapë, por ajo përsëri heshti. Kjo donte të thoshte se ishte egërsuar shumë.
Tani e merrja me mend se si pikat e panumërta të shiut po bashkonin me njëra – tjetrën zemërimin e tyre atje poshtë, në sternë. Ato të vjetrat, që dergjeshin prej kohësh, po bashkoheshin me të rejat, me pikat e tërbuara të furtunës së kësaj nate dhe diçka të keqe donin të bënin. Sa keq që babai kishte harrur të hiqte qyngjin. Nuk duhej lënë në asnjë mënyrë që ujërat e furtunës të futeshin në sternën tonë të urtë dhe ta shtynin atë të ngrinte krye.
Te porta u dëgjua një zhurmë dhe hynë njëri pas tjetrit, të lagur qull, Xhexhoja, Mane Vocoja dhe Nazoja bashkë me nusen e djalit. Pastaj hyri babai dhe pas tij nëna, që po dridhej nga të ftohtët. Porta kërciti prapë dhe hyri me vrap Javeri, bashkë me Maksutin, djalin e Nazos, me nga një kovë të madhe.
M'u ngroh zemra kur pashë kaq njerëz. Kërcitën litarët, zinxhirët, kovat. M'u duk sikur ato kova tingëlluese po më hiqnin nga shpirti ankthin. Rrija te parmaku dhe po vështroja njerëzit që filluan të punonin me zhurmë, Mane Vocon, të gjatë e të hollë me leshrat e thinjura, djalin dhe nusen e bukur të Nazos, me sytë e përgjumur, Xhexhon, që mezi merrte frymë. Mane Vocoja, Xhexhoja dhe Nazoja nxirrnin kovat njëra pas tjetrës, ndërsa babai, nëna dhe nusja e Nazos me burrin e saj dhe me Javerin, i zbraznin te dera e oborrit. Jashtë shiu vazhdonte të binte me shtamba dhe herë pas here Xhexhoja thoshte me zërin e saj me hundë:
– Pupu, ç'kiamet!

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Përgjigjuni pyetjeve:

a) Në ç'kohë ndodh ngjarja? Në ç'vend?
b) Ku shtrihej sterna e shtëpisë? Pse nuk iu përgjigj sterna thirrjes së djalit?
c) Çfarë rreziku i kanosej shtëpisë së djalit?
ç) Pse i nevojitej babait copa e gazetës?
d) Çfarë bënë ata për të shpëtuar shtëpinë?
dh) Kush e ndihmoi familjen e djaloshit të vogël për të shpëtuar nga "pikat e tërbuara"?

Analizojmë tekstin

2 Çfarë konsiderohet nga fëmija si "gracka e panjohur" për pikat e shiut?

3 Krahasoni: çfarë bënë të rriturit dhe çfarë bëri djali për të diktuar se deri ku kishte mbërritur uji në sternë.

Studim teksti

4 Të gjithë anëtarët e shtëpisë janë të shqetësuar për atë që po ndodh. Gjeni në tekst fjalët që tregojnë shqetësimin që ka secili pjesëtar i familjes.

Djali	
Nëna	
Gjyshja	
Babai	

5 Në kohën kur zhvillohen ngjarjet fëmijët nuk kishin shumë mënyra për t'u argëtuar. Ata luanin me objektet që i rrethonin, me ato që u ofronte mjedisi. Çfarë e argëtonte djalin në lojën me sternën që e trajtonte si një shoqe?

Interpretojmë tekstin

6 Si e kuptoni bisedën imagjinare të fëmijës me pikat e shiut. A mund të flasin në të vërtetë ato? Ç'tregon kjo për botën e fëmijës?

Tamam në çastin kur bëheshin gati të kërcenin nga çatia në tokë, pikat e shiut gjendeshin befas në qyngjin e ngushtë bashkë me mijëra shoqe të tjera, që pyesnin të frikësuara: "Ku po shkojmë kështu, ku po na çojnë?"

7 A përjetuat ankth gjatë leximit? Nënvizoni fjalët që përcaktojnë shpejtësinë e ndodhjes së ngjarjes dhe tensionin që përjeton autori dhe personazhet e tjera.

8 Përpiquni të kuptoni paralelizmin mes robërisë së njeriut dhe robërisë së pikave të shiut në sternë. Çfarë i bashkon?

Ndërsa po vrisja mendjen se cili e kishte më të vështirë të duronte burgimin, njeriu apo uji, dëgjova hapat e gjyshes […] Tani e merrja me mend se si pikat e panumërta të shiut po bashkonin me njëra-tjetrën zemërimin e tyre atje poshtë, në sternë.

Gjuha e tekstit

9 Kush e rrëfen historinë e pjesës së mësipërme? A është ai dëshmitar i ngjarjes?

10 Përshkruani robërinë e pikave të shiut në sternën e errët, nën tokë:

a. nëpërmjet mbiemrave që tregojnë përjetimet **b.** nëpërmjet foljeve që tregojnë veprimet

_____ _____

_____ _____

Reflektojmë rreth tekstit

11 Diskutoni në lidhje me temën: *Në momente të vështira të gjithë kemi nevojë për ndihmën e dikujt.*

12 Çfarë lloj ndihme mund të japim në familje dhe në shoqëri?

Detyrë

- Shkruani një rrëfim të shkurtër në të cilin të zërë vend një ngjarje e jetuar ose e dëgjuar rreth rrezikimit të jetës së njeriut nga kushtet e përkeqësuara të motit: përmbytje nga shiu, prishja e digës, ortekët e dëborës, tufani, furtuna etj.

Udhëve të fëmijërisë

Para leximit

Kjo pjesë është shkëputur nga romani "Udhëve të fëmijërisë" të autorit Ramadan Pasmaçiu. Personazhet e romanit janë një grup fëmijësh të së njëjtës moshë që mësojnë në të njëjtën shkollë. Ngjarjet që rrëfehen kanë të bëjnë me vështirësitë që hasin në shkollë, lojërat që bëjnë në shkollë e jashtë saj, grindjet mes njëri-tjetrit dhe dashurinë e besimin që kanë te prindërit e mësuesit.
Në fragmentin e mëposhtëm rrëfehet për një ditë pushimi në një kamp veror. Dritani, personazhi kryesor, po vizaton në fletore. Ai vazhdimisht vizatonte natyrën, detin, diellin pemët, rërën, por jo njerëzit. Një incident në det e nxit atë të kuptojë se çfarë u mungonte vizatimeve të tij: gjallëria e jetës që krijohej nga dashuria e njerëzve.

Dita ishte e bukur. Shumë e bukur. Kupa e qiellit e pastër, e pastër. Deti – në ngjyrë vjollce të thellë. Valët rrëshqitnin të qeta, duke shpalosur drejt bregut fustanellat e bardha palë-palë.
U ula në rërë pranë Yllit, që po lexonte një libër. Bardhi me Luton po loznin buzë detit. Hapa fletoren e vizatimit dhe nisa të vizatoja, po s'më bënte dora. Mendjen e kisha te ngjarja e ditës së kaluar. Më dilte përpara syve Eshrefi. Që ta largoja e lashë lapsin mënjanë dhe fillova të shfletoja ç'pata bërë ato ditë. Fletët e para ishin nga natyra e Vlorës. Deti zinte vendin kryesor, pastaj shkëmbinjtë mbi det, Uji i Ftohtë, kodrat me ullinj... Po seç mungonte në to. E kjo më mundonte në shpirt. I shfletova edhe një herë një nga një. Pamjet qenë të ftohta, si të ngrira. Çfarë s'kishin vallë?! U ndala mbi një fletë, tek ishte deti i qetë dhe rëra e kokërrzuar. Më tej, mbi sipërfaqen e detit – ca vaporë të vegjël me shtëllunga tymi përsipër. Fillova të punoja mbi të. Detin e bëra të dallgëzuar, rërën të shprishur, vaporët i fshiva fare... Lëvizja sikur hyri brenda dhe çdo gjë u gjallërua. Dukej se ndihej e prekej edhe era e detit. Ajo u fut edhe midis pemëve, që dukeshin se lëkundnin degët. Megjithatë, s'isha i kënaqur. Nxora një ofshamë dhe po vritja mendjen.
– Ç'ke? – më pyeti Ylli. La hapur librin "Zemra" të De Amiçisit dhe m'u afrua. E vështroi vizatimin tim për një kohë të gjatë me sy të picërruar dhe tha:
– Mirë e ke bërë. Gjithçka që të shikon syri këtu në plazh, ti e ke hedhur bukur në letër. Vetëm njerëz nuk paske fare te vizatimi yt! Pa njerëzit, deti dhe rëra duken të shkretë. Mundohu të vizatosh dhe ca nga ne dhe do të shohësh sa i kënaqur do të jesh! Hë, keq e kam? Ç'thua?
– Për këtë po vritja mendjen e s'po e gjeja dot! – ia ktheva. – Po do ta jap si duhet lëvizjen e njerëzve?

Ramadan Pasmaçiu

Ramadan Pasmaçiu lindi në Berat në vitin 1938. Ka punuar si gazetar në gazetën "Mësuesi" dhe në revistën letraro-artistike për fëmijë "Yllka". Ai ka botuar shumë libra për fëmijë të moshës së ulët e të mesme shkollore. Ka shkruar të gjitha llojet letrare: poezi, novela, tregime, romane etj. Në vitin 1987 ai meritoi çmimin e madh shtetëror "Migjeni" për romanin në katër vëllime "Udhëve të fëmijërisë".

– Qysh jo! Bëj disa skica të veçanta! Ja, për shembull, Bardhin kur hidhet nga shkëmbi e duke notuar... Si të stërvitesh mirë, vendose në vizatim! Atëherë ky do të dalë krejt ndryshe.

– Çuditem me ty, Ylli! – i thashë. – Me vizatime nuk merresh, po gjërat i kap dhe i mendon kaq mirë!

– Unë të fola siç ma pret mua, po ti do ta gjesh vetë si duhet bërë, po të punosh.

Ai u shtri mbi rërë dhe u zhyt në faqet e hapura të librit. Sa shumë që lexonte! Edhe unë e Bardhi lexonim, po jo sa ai.

Mora lapsin dhe fillova të skicoja disa çuna që loznin afër nesh. Nuk e di se sa punova ashtu, kur dëgjova së largu ca thirrje:

– Po mbytet njëri, po mbytet!

U ngrita rrëmbimthi dhe vrapova drejt bregut. Pashë Bardhin e Luton që po jepnin e merrnin me nja dy të tjerë për të nxjerrë një djalë trupmadh, që herë dilte e herë humbiste nën ujë. U zhyta me kokë. Pas meje – Ylli. Po kur arritëm, ata e kishin kapur dhe po e tërhiqnin. Megjithëse kishte dallgë, nuk na u desh shumë që ta nxirrnim në breg. Aty s'e lëvizëm dot më. Ishte bërë plëndës i rëndë. Dukej që s'kishte pasur haber nga noti. E shtrinë të tjerët përmbys e ai filloi të lëshonte ujë nga goja e të merrte frymë pa pengesë. Ndjeva gëzim që kishte shpëtuar, e u ula në rërë. Mora fletoren e

vizatimit dhe nisa prapë të vizatoja. Diçka e brendshme më shtynte, më ngacmonte... Punova me ngulm. Dorën e ndieja të sigurt. Përdora edhe lapsat me ngjyrë. S'kisha shqetësimin se mos dy fëmijët që po hidhja në letër do t'u ngjanin apo jo Bardhit e Lutos. Mjaftonte që të jepja skenën e atë guxim të tyre për të shpëtuar një njeri.
Rreth e rrotull u mblodhën shumë vajza e djem dhe më shikonin në heshtje. Më erdhi zor kur i pashë dhe desha ta mbyllja fletoren, por s'më la Ylli.
– Vazhdo, vazhdo, – më tha me zë të ngrohtë, – e ke mirë fort!

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Përgjigjuni pyetjeve:

a) Ku zhvillohen ngjarjet e këtij fragmenti? Çfarë po bënin fëmijët në breg?
b) Cilin libër po lexonte Ylli? A lexoni dhe ju gjatë pushimeve?
c) Cilat ishin disa nga sugjerimet e Yllit për vizatimet e shokut të tij?
ç) Cila ishte ngjarja që tronditi fëmijët?
d) Çfarë e frymëzoi djalin të vizatonte ndryshe?

Analizojmë tekstin

2 Shënoni në tabelë veprimet që kryente djali që vizaton, si dhe dy gjendjet e përjetimit të tij para dhe pas ngjarjes.

Para ngjarjes		Pas ngjarjes	
veprime	gjendje shpirtërore	veprime	gjendje shpirtërore

3 Krahasoni fillimin dhe fundin e ngjarjes. Ku ngjajnë dhe ku ndryshojnë?

Ngjashmëritë	Ndryshimet

Studim teksti

Interpretojmë tekstin

4 Pse autori ka vendosur pranë njëri-tjetrit dy fëmijë që pëlqejnë pikturën dhe librat?

5 Çfarë mendoni për sugjerimet e Yllit? A ishin të drejta ato?

6 Çfarë paraqiste vizatimi i fundit që bëri Dritani atë ditë? Pse mendoni se e pëlqyen kaq shumë fëmijët kureshtarë që e rrethuan?

Gjuha e tekstit

7 Gjeni në tekst pjesët ku personazhi mediton, ku personazhet dialogojnë dhe ku personazhi rrëfen.

8 Duke u nisur nga sugjerimet që i bën Ylli shokut të tij Dritanit në dialogun e mëposhtëm, shkruani disa fjalë kyçe që portretizojnë karakterin e tij. Mbështetuni në fjalët e zeza më të theksuara për të zbuluar cilësitë e Yllit.

– ***Mirë e ke bërë. Gjithçka që të shikon syri*** këtu në plazh, ti e ke hedhur bukur në letër. Vetëm ***njerëz nuk paske fare te vizatimi yt***! *Pa njerëzit, deti dhe rëra duken të shkretë. Mundohu të vizatosh dhe ca nga ne dhe do të shohësh sa i kënaqur do të jesh! Hë, keq e kam? Ç'thua?*
– Për këtë po vritja mendjen e s'po e gjeja dot! – ia ktheva. – Po do ta jap si duhet lëvizjen e njerëzve?
– *Qysh jo!* ***Bëj disa skica të veçanta****! Ja, për shembull, Bardhin kur hidhet nga shkëmbi e duke notuar... Si të stërvitesh mirë, vendose në vizatim! Atëherë ky do të dalë krejt ndryshe.*
– *Çuditem me ty, Ylli! – i thashë. – Me vizatime nuk merresh,* ***gjërat i kap dhe i mendon kaq mirë!***
– *Unë* ***të fola siç ma pret mua****, po ti do ta gjesh vetë si duhet bërë, po të punosh.*

a) mirë e ke bërë – ***natyrë mbështetëse***

b) gjithçka që të shikon syri – _____

c) njerëz nuk paske fare te vizatimi yt – _____

ç) bëj disa skica të veçanta – _____

d) gjërat i kap dhe i mendon kaq mirë – _____

dh) të fola siç ma pret mua – _____

Reflektojmë rreth tekstit

9 Veprat artistike kanë vlera të mëdha, kur frymëzohen nga jeta e gjallë njerëzore. Flisni dhe vlerësoni këtë mesazh të rëndësishëm të tekstit, duke u mbështetur në filmat dhe librat që keni lexuar.

10 A mendoni se librat na ndihmojnë ta kuptojmë jetën më mirë? Ç'lloj librash ju pëlqen të lexoni më shumë?

Shkruajmë

- Shkruani nga një ese me temë: "A është e lehtë të pranosh këshilla a sugjerime?". Lexojini në klasë dhe diskutoni rreth tyre.

Sarajet e bardha

Para leximit

Kjo pjesë është shkëputur nga romani "Sarajet e bardha" të autorit Vehbi Kikaj.
Mirushen dhe Fatosin, dy fëmijë nga Prishtina, prindërit i kanë dërguar për pushime në bregdetin e Ulqinit. Atje, në breg të detit, ata do të takojnë një turist, i cili çuditërisht e kupton gjuhën e tyre. Ai e ka mësuar këtë gjuhë nga arbëreshët në jug të Italisë, gjatë kohës kur jetonte dhe punonte në Sicili. Fjalët e tij i nxitin kureshtjen e fëmijëve për arbëreshët që, ndonëse jetojnë përtej detit, flasin të njëjtën gjuhë si ata.

Plazha gumzhonte prej njerëzve dhe fëmijëve. Çadrat çileshin si lule dielli. Mbi ranë të nxehtë nuk kishte mbetë vend as për nji pulëbardhë. Mirushja e ndjente disi erën e gjelbërt. Në të vërtetë vetëm i dukej sikur e ndjente, sepse kur dilte prej ujit dhe terej, nëpër trup i shihej nji push i hollë krype. Ajo mëshihej gjithnji prej diellit të fortë që të mos e djegë që në fillim. Mbas lamjes bashkë me Fatosin shkonte në hije të nji fiku dhe vetëm nga pak ia tregonte trupin diellit.

Me ta u shoqnue nji ulqinak i vogël, gaztor dhe simpatik. Nganjiherë i shoqnonte edhe studenti, i cili rëndom e mbante ndonji libër me vete. Edhe Mirushja filloi të lexojë librin "Robinson Kruzo", të cilin e kishte fitue dhuratë në fund të vitit shkollor.

Kah mesdita shkojshin në shtëpi dhe nana e studentit u shtronte drekën. Mbas dite përsëri zbritshin në plazhë dhe vazhdojshin me u la.

Aty kishte njerëz nga të gjitha viset e vendit. Kishte edhe prishtinas, të cilët Mirushja i njifte mirë. Mirëpo, nji pjesë të madhe të plazhës e zejshin turistët, të cilët mbaheshin të urtë dhe të sjellshëm.

Nji ditë ndër ato ditë Mirushja me vllanë dhe Ulqinakun e vogël duelën në Ranë. Prej së largu vërejtën se po vinte nji anije e madhe. Afrohej si anija e Robinsonit, kur ky niset për të dytën herë me vizitue ujdhesën. Kur iu qas bregut të murosun me gurë, lëshoi spirancën, e pastaj u lëshue edhe ura. Filluen të dalin disa njerëz të panjoftun, të cilët u pa mirë se ishin të huej. Në mesin e tyne ishte nji burrë i zeshkët me syza dielli në sy. Ai shikoi qytetin tue u ndalë për nji ças në shkallë, e pastaj u kthye dhe shikoi anijen. Në kuvertë doli nji djalë i vogël, po ashtu i zeshkët, i cili e thirri të jatin tue i tregue me dorë klyshin e vogël. Sigurisht e pyette a ta merrte me vete klyshin, e ky, duket se i tha po. Djali u hodh sakaq nëpër shkallë dhe zbriti shumë shpejt në tokë.

– Këta janë tregtarë, – tha ulqinaku i vogël. – Anija qenka franceze.

– Po ai njeri qenka arab, – vërejti Mirushja.

– Ashtu asht, shihja flokët si i ka të zez dhe kaçurrel.

Arabi kaloi pranë fëmijëve dhe i përshëndeti në frëngjishte:

Fjalor

ujdhes – ishull.
qas – afroj.

Vehbi Kikaj

Vehbi Kikaj (1942-1986) ka qenë një nga shkrimtarët më të njohur të letërsisë shqipe për fëmijë në Kosovë. Ai është autor i këtyre librave: "Gurrat", "Zogu i argjendtë", "Shtëpia ime ka sy". Në prozë ka shkruar romanin për fëmijë "Sarajet e bardha". Vehbi Kikaj për dy dekada ka qenë redaktor i botimeve më të rëndësishme për fëmijë në Kosovë; njëherë i gazetës "Rilindja" për fëmijë e mandej i revistës "Pionieri".

– *Bonjour, mes enfants.*
Ulqinaku ia ktheu përshëndetjen, ndërsa Mirushja e shikoi këtë me habi.
– Ç'ka po thotë. Mirë? – pyeti Fatosi.
– Na përshëndeti, sigurisht.
– O, – u çudit i hueji, – ju flitkeni arbënisht?
– Na flasim shqip, axhë. E kemi gjuhën amnore, – tha Mirushja.
– Gjuha juej? Po unë di të flas si ju… Si jeni?
– Mirë, – i thanë gati përnjiherë Mirushja dhe ulqinaku i vogël.
– Prej nga jeni? – pyeti ulqinaku.
– Unë? I lindun jam n'Arabi, por tash… si po më shihni… Domethanë, ju këtu e flitni arbënishten? Mirushja çuditej pse i hueji thoshte arbënishten dhe jo shqipen. Sigurisht do ta ketë mësue gabimisht këtë fjalë, tha në vete.
– E si e keni mësue shqipen? – e pyetën fëmijët.
– O, më ka mësue jeta. Disa gjuhë m'i ka mësue jeta. Kam jetue n'Sicili, zotnij… Atje ka shumë arbneshë. Kam pasë miq të mirë…
Ecshin ngadalë ullishtes, prandaj mbetën bukur larg atyne të huejve të tjerë.
– E tash keni ardhë si turist?
– Jo, tash jam tregtar. Punoj me nji kompani tregtare franceze, – nuk pritoi të tregojë i hueji. Në dhe të huej, ku njeriu e ndien veten si të humbun dhe shumë ma të vogël se sa asht, asht miqsi e madhe kur të flet dikush dhe të kupton.

Qoftë ai edhe fëmijë siç janë Mirushja dhe Ulqinaku.
– E ju, të gjithë jeni t'Ulqinit? – pyeti i hueji.
– Vetëm unë, – tha ulqinaku i vogël. – Këta janë nga Prishtina.
Duket se i hueji nuk kishte ndëgjue për këtë vend.
– Tash në verime, a?
– Ashtu asht.
I hueji e kapi djalin e vet për dore dhe deshti të ecte ma shpejt për t'i zanë të tjerët.
– Më falni, duhet të ngutem. – Mirë, edhe na po shkojmë në plazhë.
– A mund të ju shoh ma? – tha i hueji.
– Na gjithnji rrijmë kah ullishta.
– Pra, mirë u pafshim! – uroi i hueji dhe buzëqeshi miqsisht.

Fjalor

verim – kaloj verën diku, shkoj për pushime.

Fëmijët u kthyen të kënaqun dhe mendojshin: a thue çfarë arbneshësh ka atje në Sicili?
Mirushja e dinte prej gjeografije se Sicilia asht ujdhesë e madhe në jug të Siujdhesës Apenine…
A thue kush janë ata arbneshë? Do ta pyesim studentin, u ra në mend ma vonë dhe kështu e lanë. Muzgu ishte i qetë, i bukur. Hëna ngadalë e qiti kambën mbi kodë, e mandej si princeshë që del prej malit, zbriti me i la flokët. Vala u prarue n'argjend.
– Edhe na kemi diçka të re të ju tregojmë, – i tha Mirushja studentit.
– Hajt, më tregoni.
– Sot e kemi gjetë nji mik të ri.
– Të vogël? Asht i bukur? – u mahnit studenti.
– Jo, asht i madh. Asht nji tregtar, por i fisit arab.
Studenti vetëm rrëmonte.
– Ai din të flasi shqip! – vazhdoi vogëlushja.
– S'asht gja e re. Shqipen tani po e mësojnë njerëz anë e mbanë botës, – tha studenti, e mandej sikur u kujtue, e shikoi vogëlushen me shikim pyetës: – A din të flasi mirë?
– Flet ma ndryshe se na, por kuptohet.
– Unë s'e kuptoj, lalë, – tha Fatosi.
– Ai tha se gjuhën e ka mësue në Sicili! A asht e mundun?
– Fare lehtë.
– Tha se ka jetue atje pak vjetë dhe i ka pasë disa miq arbneshë. Unë nuk e di kush janë ata.
– Do të mësosh, – tha studenti. – Ata janë shqiptarë. Tanët janë, kanë edhe gjuhën edhe doket që i kemi na. – Vetëm jetojnë atje?
– Dikur kanë qenë në këtë anë të detit, por janë shpërngulë. A dini kur?
– Jo, nuk dimë.
– Janë shpërngulë fill mbas vdekjes së Skënderbeut. Mijëra shqiptarë atëherë kanë kalue në viset jugore t'Italisë. Atje e kanë kurdisë trollin e tyre dhe aty jetojnë. Unë do të shkoj t'i vizitoj. Ata kanë ruejtë shumë kujtime për Skënderbeun. Poetët e tyne i kanë thurë lavde. I kanë mbledhë edhe kangët e lahutës për trimin legjendar, – shpjegoi studenti.

Fjalor

siujdhes – *gadishull.*
troll – *vendosja diku për të banuar e për të jetuar, truall ku është ngulur një popullsi e vogël, e ardhur nga një vend tjetër.*

Mirushja tash e kuptoi mirë kush janë arbneshët, ata që flasin gjuhën shqipe edhe përtej detit. Veturat nxitojshin rrugës së bukur stomit të detit. Disa vijshin n'Ulqin e të tjerat shkojshin në veri, kah Shën Stefani. Filloi të fryjë nji erë e freskët, e cila e heponte lundrën.
Mbas dite shkuen përsëri kah ullishta, e cila gjindej në buzë të detit. Andej kalojshin qindra vetura. Turistët kishin vërshue brigjeve t'Adriatikut si me dashtë me e zanë verën për të mos e lëshue ma. Mirëpo, ajo ditë-ditë kalonte. Secili e ndjente këtë, prandaj përpiqej me u la sa ma shumë dhe me u rrezitë sa ma shumë. Vera asht e mrekullueshme në bregdetin tonë të kaltër, me plot qytete, plot kamp shtëpiza të mëshehuna ndër ullij. Gjinkallat ishin çue në grevë, sepse dojshin me plasë prej zhegut.
– Ndoshta ka shkue arabi? – tha Fatosi. – Unë s'e kuptoj aq mirë, ndonëse flet shqip. Ai nuk po flet si prindët e mi, as si edukatorët në qerthull.
– Po, sigurisht, s'ka mundë të mësojë gjuhën tonë aq mirë. E mandej, ata arbneshë ndoshta vetë flasin pak ma ndryshe? – tha Mirushja.
– Unë, megjithatë, e kuptoj dhe do të dëshirojsha të rrij pak me të.

Fjalor

hepon – përkul.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve:

a) Ku po i kalojnë pushimet verore Mirushja dhe Fatosi?
b) Kush i shoqëronte shpesh ata gjatë kohës së plazhit?
c) Çfarë mbante shpesh në duar studenti në plazh?
d) Çfarë libri filloi të lexonte Mirushja në plazh ndërsa merrte rreze dielli?
dh) Çfarë u bëri përshtypje te njerëzit që dolën nga anija që lëshoi spirancën në breg?
e) Me cilët bisedoi Mirushja dhe Fatosi në plazh?

Interpretojmë tekstin

2 Çfarë e habiti të huajin nga gjuha që përdornin Mirushja dhe Fatosi? Ku e kishte dëgjuar këtë gjuhë ai më parë?

3 Mirushja habitet kur i huaji e quan gjuhën që ajo flet arbërisht dhe jo shqip. Shpjegoni pse i huaji përdor këtë emërtim.

4 Interpretoni fjalët e arabit: *Në dhe të huaj ku njeriu e ndien veten si të humbun dhe shumë ma të vogël se sa asht*. Flisni për mërgimin dhe rolin që luan ai në jetën e njerëzve.

5 Arbëreshët janë larguar për në Itali pesë shekuj më parë. Mirushja shprehet: *ata arbneshë ndoshta vetë flasin pak ma ndryshe*. Cila është arsyeja që arbërishtja është pak më ndryshe se gjuha shqipe?

Studim teksti

Analizojmë tekstin

6. Përshkruani paraqitjen e jashtme të turistit që takojnë fëmijët në plazh. Përshkruani edhe sjelljen e tij dhe të djalit të vogël.
7. Cilat janë arsyet që i detyruan arbëreshët të largohen nga vendi i tyre?
8. Të gjitha personazhet e pjesës dinë të flasin shqip. Kush prej personazheve e ka shqipen "gjuhë amnore"?
9. Plotësoni tabelën:

Emri i personazhit	Vendlindja	Kombësia	Gjuha që mund të flasin në tekst

Gjuha e tekstit

10. Pse fjala "Ranë" është shkruar me shkronjë të madhe?
11. Si mund të thuhet sintagma "gjuhë amnore" në një formë tjetër?
12. Kur flet për vendlindjen e tij dhe për kohën në mërgim larg vendlindjes, arabi ndalon shpesh. Në tekst këto ndalesa reflektohen nëpërmjet pikave, retiçencave. Çfarë tregon kjo gjë?

Reflektojmë rreth tekstit

13. Në Prishtinë flitet shqip, në Ulqin flitet shqip, në disa zona të Sicilisë flitet shqip. Çfarë tregon ky fakt për historinë dhe fatin e shqiptarëve?
14. Shqiptarëve ndër shekuj u është dashur të emigrojnë jashtë vendit të tyre. Cilat janë arsyet kryesore të largimit të tyre?
15. Shqiptarët e Kosovës u detyruan të largohen nga vendi i tyre në vitin 1999. Kujtoni arsyet dhe rrethanat e këtij eksodi.

Detyrë

- Me ndihmën e prindërve mblidhni informacion rreth mënyrës se si arbëreshët e Italisë kanë ruajtur gjuhën dhe kulturën e tyre të origjinës edhe pas shumë shekujsh. Diskutoni në klasë rreth tyre.

Fshati i pesë kodrave

Para leximit

Pjesa e mëposhtme është shkëputur nga romani "Malësorja", ngjarjet e të cilit zhvillohen në një fshat të Kosovës në periudhën mes dy luftërave botërore. Shkrimtari përshkruan një mjedis real, mjedisin e fshatit të Gollokut (mes Prishtinës dhe Podujevës), që ngjason shumë me fshatrat e tjerë. Në roman rrëfehet historia e një malësoreje, Hajries, e cila përfaqëson vuajtjen e femrës së nënshtruar dhe të shtypur shqiptare në Kosovë e më gjerë. Vuajtjet e saj janë të shumta, por si më të madhen autori ka spikatur dhimbjen e nënës për djalin që ia kanë marrë me forcë dhe është i rritur larg prehrit të saj.

Nazmi Rrahmani

Nazmi Rrahmani (1941, Ballofc, Podujevë) u shkollua në Podujevë dhe Prishtinë. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Prishtinë. Pas studimeve punoi si gazetar. Ai aktualisht jeton në Prishtinë dhe është shkrimtari që ka pasur dhe vazhdon të ketë një numër të madh lexuesish, sidomos në Kosovë. Rrahmani lexohet nga të gjitha shtresat shoqërore dhe nga të gjitha moshat.
Ka shkruar romanet: "Malësorja", "Tymi i votrës së fikun", "Toka e përgjakun", "Pas vdekjes", "Rruga e shtëpisë sime" etj.

Fundi i të pesë kodrave lëshohet pjerrtas dhe humbet në fushën e vogël me formë trekëndëshi, e cila tërë verën e ruante blerimin, edhe atëherë kur dielli piqte gjithçka. Pesë përrenjtë që i ndanin ato kodra të vjetra, të cilat kushedi sa lisa kishin rritur dhe ushqyer dhe, më në fund i kishin kalbur e tretur, sajonin një lumë të vogël, i cili ia shtonte bukurinë edhe më tepër asaj lugine që dukej si një qilim i madh. Lumi dredharak e përshkonte nëpër qendër, e ndante katundin në dy pjesë dhe gjatë tërë verës rridhte, ashtu i qetë, me atë pak ujë të kthjellët e të vakët.
Vetëm në vjeshtë, e herë-herë në dimër e pranverë, uji i tërbuar i palonte buzët e gërryera të shtratit të vet, mbyste ara e livadhe dhe linte pas vetes lym. Njerëzit me fuqinë e krahut të tyre e mbanin këtë lym dhe përsëri e hidhnin në lumë, thuaj se ashtu vepronin për inat të fuqisë së tij që për atë vit ua kishte shkatërruar frutat e punës së tyre. Por në verë uji ishte më i çmueshëm se çdo gjë që kishte katundi dhe banorët e tij. Ai ua mbante kopshtet, arat me misër dhe kafshët. U ndihmonte katundarëve sa herë që qiellit nuk i vinte keq për tërë atë nxehtësi që derdhte mbi ta. Ishte ushqim i çmueshëm për tokën e tyre, për trembëdhjetë familjet e atij katundi të vogël malor.
Trembëdhjetë oborret, të thurura me gur ose thupra, ishin strukur nën hijen e kodrave, duke u munduar të zënë sa më pak vend në arat pjellore, sepse në atë mënyrë ruhej më mirë kafshata edhe ashtu e vogël e katundit, që rritej përvjet ngadalë dhe disi pa u rënë në sy njerëzve. Lumi gjarpëronte duke u ngjeshur me rrënjët e shelgjeve përreth dhe thuase gurgullimën e vet të qetë ua kushtonte atyre trembëdhjetë shtëpive, me oxhaqe të larta e të vjetruara, me pullaze të mbuluara me kashtë ose me dërrasa, që vjetët ua kishin falur ngjyrën e plumbit.
Dita në atë katund malor, ku gati kurrë nuk shkelte këmbë e huaj, përpos ndonjë miku, që rrallë herë shihej atypari, ishte shumë e qetë. Njerëzit shpërndaheshin në punë së bashku me agimin e çdo dite.
Kur dielli depërtonte me rrezet e veta nëpër kurorat e mëdha të lisave

përballë katundit, një njeri i ndodhur rastësisht në lindje mund të vërente katundin me të gjitha karakteristikat e tij: aty-këtu ndonjë fëmijë duke lozur në oborr ose në rrugë, përroskat e vogla të ujit që hynin e dilnin nga oborri në oborr dhe më në fund drejtoheshin si gjarpërinj dredha-dredha e të gjerë pa fund kah arat e gjelbëruara nga misri, që nuk dinte për nxehtësinë e madhe edhe kur dielli digjte gjithçka nëpër ato kodra, sepse gjithmonë ujin e kishte pranë. Ditëve të verës mund të dëgjohej prej së largu, vetëm herë pas here, ndonjë zile kafshe ose blegërimë e ndonjë deleje e ndarë nga tufa, e që herë-herë përzihej me zërin e barinjve, me jehonat që kumbonin thekshëm përrua pas përroi, duke e përcjellë zërin derisa humbte në lartësi.

Kah mesdita, kur dielli i afrohej kupës së përhimtë të qiellit, katundi bëhej edhe më i qetë. Ngjante me një vend të shkretë, pa kund njeri të gjallë në të. Edhe nga pamja e jashtme ai nuk jepte shumë shenja gjallërie. Vetëm gjelat, tërë ditën, pa marrë parasysh vapën apo të ftohtit, nuk menin këngën dhe, po të dinin njerëzit më tepër për këngën e tyre, do ta quanin: katund i gjelave. Edhe çdokush nga banorët e tij dëshironte që shtëpia e tij të kishte sa më shumë gjela. Shpeshherë shtyheshin ndërmjet tyre se gjeli i kujt këndonte më

Fjalor

përroskë – përrua i vogël, rrëke.
shoke – brez.
dimi – çitjane, veshje e kohëve të shkuara për gra.

mirë, e zgjaste zërin më tepër dhe kush kishte më shumë gjela në shtëpi. Mëngjeset ishin të mbushur plot me këngën e tyre, e cila përcillej përrua pas përroi e këthehej si jehonë, duke u përzierë me zërin e kësaj orkestre të çuditshme por, kur dielli lëshohej kah kodrat e perëndimit, që ishin vetëm pak më të ulëta se ato të lindjes dhe qielli dukej më i gjerë, e hijet e shtëpive e mbulonin me pjesë të oborreve, katundi ngjallej përsëri. Njeriu që kalonte për herë të parë andej habitej sa shpejt ndryshonte çdo gjë. Mbrëmja ishte edhe më e gjallë. Njerëzit këtheheshin nga puna, ndaheshin në mes të katundit dhe bisedonin deri vonë. Tufat e mëdha të deleve që shiheshin në fillim në rrëzat e kodrave, zvogëloheshin ngadalë, sepse çdonjëra dinte të ndalej para dyerve të veta. Tingëllimat e zileve të tyre pushonin dhe çdo gjë binte në heshtje.

* * *

Në oborrin e mbuluar gati krejt me bar, përpos një shoke kah ecnin zakonisht njerëzit, ku bari nuk mbinte kurrë, gjendej një shtëpi e lyer me baltë, qysh para disa vjetësh dhe e mbuluar me dërrasa, që shiu dhe dëbora u kishin dhënë ngjyrën e plumbit. Përkundruall, mu afër dyerve të oborrit ishte një shtëpi tjetër, gjithashtu e mbuluar me dërrasa, por me mjeshtëri e me dy dritare të vogla, kthyer kah lindja, thuase ato ishin bërë që më lehtë të shihej e tërë fusha, e cila shtrihej në atë anë deri te rrëzat e kodrave të pyllëzuara. Nëpër muret e saj grethat kishin hapur vrimat e veta dhe posa agonte, fillonin zukamën e mërzitshme e montonte, e cila zgjaste deri kah mesdita, kur vapa i detyronte të struken diku nën hije.

Dielli atë ditë vere ishte ngritur bukur lartë mbi kurorat e rrumbullakta të lisave kah lindja. Një mjegull e hollë, vetëm sa shihej, si vel nuseje e tejdukshme, kishte marrë ngjyrë ari nga rrezet e diellit. Tërë lugina dukej si e praruar nga ajo mjegull e çuditshme.

Në atë katund, atë ditë ndodhte diçka e pazakonshme. Asgjë thuase nuk i ngjante jetës së rëndomtë të atij katundi. Qetësia e përditshme ishte zëvendësuar me endjen e njerëzve dhe me një zhurmë që vinte nga çdo anë.

Oxhaku i asaj shtëpie që shtrihej në të majtë të krahut të rrugës, e cila shkonte kah jugu, villte tym të zi e të dendur tërë atë mëngjes. Tymi nganjëherë turrej shllunga-shllunga edhe nëpër derë e dritare, sepse gryka e nxirë e oxhakut, e cila kishte vjellë aqë shumë tym, tash sa vjet nuk e zinte.

Një grua që nga pamja nuk dukej aq e moçme, megjithëse mund të vërehej lehtë se gjatë jetës kishte mbledhur mbi kurrizin e vet një barrë të rëndë vuajtjesh, me dimi të arnuara në disa vende, një mbështjellësi të zi e me dy-tre arna të bardha, që e bënin edhe më të shëmtuar, doli e hyri disa herë atë ditë prej mëngjesit. Atypari silleshin herë pas here edhe gratë e tjera me shami lidhur nën fyt dhe pa shikuar as djathtas as majtas, por duke u ngutur që të mos takoheshin me kënd rrugës.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Përgjigjuni pyetjeve rreth tekstit:

a) Çfarë marrëdhënieje kishte lumi me njerëzit e fshatit?
b) Sa familje jetonin në fshatin e përshkruar në këtë pjesë?
c) Për çfarë konkurronin mes tyre shtëpitë e këtij fshati?

Analizojmë tekstin

2 Pse fshati i përshkruar në tekst mund të quhej "katund i gjelave"?

3 Çfarë përshkruhet në pjesën e parë të tekstit dhe çfarë përshkruhet në pjesën e dytë?

4 Shkrimtari realizon përshkrime të hollësishme. Për cilën stinë të vitit realizohen këto përshkrime? Për cilin moment të ditës flitet në pjesën e dytë të tekstit?

5 Gjeni fjalët kyçe në pjesën e parë të tekstit dhe fjalët kyçe në pjesën e dytë të tij.

Pjesa I	kodra						
Pjesa II	shtëpi						

6 Në pjesën e dytë të tekstit, përveç përshkrimit të ambientit, realizohet edhe përshkrimi i pamjes dhe i veprimeve të personazheve. Gjejini dhe shënojini ato.

Pamja fizike	
Veprimet e personazheve	

Interpretojmë tekstin

7 Fshati që përshkruhet nga autori mund të konsiderohet një fshat i gjallërishëm apo një fshat i heshtur?

Gjuha e tekstit

8 Një nga figurat e përdorura më së shumti në tekst, është epiteti. Gjeni 10 epitete të cilat ju mbeten në mendje.

9 Që krijimi të jetë sa më i ndjeshëm dhe artistikisht më i realizuar, shkrimtari përdor gjuhën e figurshme. Shpjegoni shprehjet e figurshme:

- *fundi i të pesë kodrave lëshohet pjerrtas*
- *edhe atëherë kur dielli piqte gjithçka*
- *Trembëdhjetë oborret, të thurura me gur ose thupra, ishin strukur nën hijen e kodrave...*
- *katundi ngjallej përsëri*
- *tymi turrej nganjëherë*

Reflektojmë rreth tekstit

10 A mendoni se vendi ku jetojnë personazhet ndikon në karakterin dhe jetën e tyre?

Detyrë

- Përshkruani natyrën dhe relievin e fshatit tuaj ose të një fshati që ju ka bërë përshtypje të veçantë.

Droja

Para leximit

Kjo pjesë letrare është shkëputur nga romani "Droja", i shkrimtarit Rifat Kukaj. Në këtë pjesë rrëfehet rreth një gare skish që zhvillohet në mal mes dy skuadrash fëmijësh. Artani dallohet për aftësitë shumë të mira, por diçka e çuditshme ndodh në atë garë. Ai dhe shokët e tij zbulojnë se Shkëlzeni ka bërë me hile, prandaj planifikojnë të hakmerren. Ndërkohë, gjërat ndryshojnë. Shkëlzenin e vret ndërgjegjja, ndaj i kërkon falje Artanit. Shokët nuk kanë dijeni për bisedën e tyre dhe vazhdojnë me planin e tyre të hakmarrjes. Ata mendojnë të prishin "Vidren", anijen me të cilën Shkëlzeni konkurron në garën me anije.

Rifat Kukaj

Rifat Kukaj (1939-2005) lindi në Drenicë. Ai ka qenë prozator, poet, dramaturg, përkthyes dhe skenarist i letërsisë për fëmijë dhe të rritur. Gjithashtu ka drejtuar programet për fëmijë të Radio Prishtinës dhe ka redaktuar shumë libra për fëmijë. Emrin e tij e mbajnë rreth 100 vëllime librash dhe 30 radio–drama.

Skiatorët, të tretur në mendime, me nerva të tendosura për garat që do të bënin, i lyen skitë shpejt dhe i vunë të thaheshin. Pastaj u futën në sallë që të hanin mëngjesin. Qirinjtë e akullit ishin lëshuar thikë tatëpjetë anëve të pullazit dhe ende nuk kishin zënë të pikonin. Pak më larg tyre, në skaj të një bredhi plak, ishin mbledhur edhe skiatorët e trajner Gjetos. Edhe në zemrat e tyre rrihte shpresa për fitore. Pas mëngjesit, fëmijët hipën në teleferik dhe arritën rrëzë Kodrës së Veriut. Nga kjo rrëzë do të lëshoheshin poshtë lugjeve. Shpati ishte i stolisur që herët me shkopinj dhe me flamurë, që valëviteshin lehtë. Nëpër ta kalonte shtegu i garave. Poshtë, pak përmbi shtëpinë e pushimit, kishte zënë vend juria, sekondanti dhe shumë dashamirës të garave. Kishin ardhur dhe reporterët e gazetave, të revistave, të radios e të televizionit. Ata po bënin gati pajimet e tyre. Gati do t'i filmonin.

Nuk kishte mbetur shumë kohë nga fillimi i garave. Më parë do të lëshohej një nga ekipi i Shkëlzenit, pastaj një nga ekipi i Artanit. Artani kishte numrin 4. I veshur me rroba të blerta, me numrin në gjoks e në shpinë, i ngjante një pëllumbi. Kështu ngjanin të gjithë. Dielli kishte hipur lart në horizont. Tani qielli nuk e kishte atë kaltërsinë e mëngjesit. Dukej disi më i zvenitur, por gjithsesi ishte i bukur. Bjeshka shkëlqente.

– Gati? – u dëgjua një zë pak i ngjirur.

– Gati! – gumëzhiti përgjigjja e fëmijëve.

U dha shenja. U lëshua skiatori i parë. Ishte një shok i Shkëlzenit. Nuk ishte aq i sigurt dhe i mësuar me ski. Që në portën e dytë, e theu shkopin e shtegut. Nuk vonoi shumë dhe u rrëzua, duke përfunduar në portën e katërt. U ngrit shpejt e shpejt dhe vazhdoi ecjen, por kishte humbur shumë kohë të çmuar. Gazmendi, sa pa se u dha shenja me flamur të vogël, të kuq, u lëshua si vetëtimë. Vogëlushi nuk bëri asnjë gabim dhe arriti në një kohë të shkurtër, që e lakmonin shumë. Në fund mori frymë i skuqur, i hutuar, i lumtur. Çdo gjë vajti në rregull, sa i erdhi radha Artanit. Deri atëherë, të dyja skuadrat pothuajse kishin pika të njëjta. Sytë e të gjithëve u mbërthyen tek ai.

Shpresat e të gjithëve ishin tek ai. Ua merrte mendja se medoemos Artani do t'i jepte ekipit përparësi të madhe dhe shumë pika. Por ja se ç'ndodhi: Artani, sa u dha shenja, u lëshua vrap. Që në start u dha shkopinjve me hov, që të fluturonte siç e kishte zakon, të hidhej pakëz lart, pastaj të voziste shtegut si shigjetë, por menjëherë vuri re se diçka e papritur, e panjohur, e jashtëzakonshme po ndodhte me të atë ditë. Skitë e tij nuk e dëgjonin si më parë! Nuk preku asnjë shkop gjatë shtegut, por që të ecte me shpejtësinë që dëshironte, ishte e pamundur! Voziste me zhdërvjelltësi, ishte i saktë, i sigurt, por e gjithë kjo nuk sillte kurrfarë dobie. Ku ishte shpejtësia? U djersit! Shtegu i dukej gjithnjë e më i gjatë. Koha ikte shpejt. Më shumë u lodh nga mllefi se nga rrëshqitja që e donte aq shumë! Dha e mori të shtonte shpejtësinë. U qull në djersë. Zuri t'i dilte tym nga koka.

– Artan! Artan! Artan! – klithnin nga poshtë të befasuar fëmijët.

Artani u jepte shkopinjve me forcë, por ç'e do. Mbërriti me vonesë. Në një kohë më të madhe se shumë skiatorë që ishin ku e ku më të ngathët se ai!

– Ç'është kjo? – pyeti i tronditur Blerimi. – Mos ke qenë i sëmurë mbrëmë?

– Jo. Është shëndoshë e mirë, – u gjegjën fëmijët të habitur. Kishin harkuar vetullat. Qenë të shqetësuar. Gati sa nuk qanin nga zhgënjimi.

Artani, sa arriti në finish, menjëherë uli kokën. Dukej si i mjerë e i pafuqishëm. I tronditur. I hutuar. I hoqi skitë, i hodhi diku dhe vrapoi e hyri në dhomë. U dëgjuan shkallët duke rënkuar me ankim nën këpucët e tij të rënda. Derën e dhomës e hapi dhe e mbylli me rrëmbim. U hodh në shtrat. Nisi të qante me ngashërim. Pas tij vrapuan shokët. U munduan ta pajtonin, por nuk ia dolën deri vonë në mbrëmje…

Atë ditë, për çudi, Shkëlzeni fitoi shumë pikë. Eci me shpejtësi më të madhe se Artani. Ekipi i trajner Gjetos fitoi me ndryshim shumë të madh pikësh. Këtë nuk e priste askush. Shokët e Artanit mbështeteshin në zhdërvjelltësinë, shpejtësinë dhe sigurinë e tij të pashoqe. Pritnin që të kishin epërsi, dhe gjithsesi fitore në saje të zotësisë së tij. Asgjë prej gjëje! U bënë pikë e vrer. Edhe bjeshka u duk sikur e humbi bukurinë. Shokët e Shkëlzenit jo vetëm që ishin të gëzuar, por filluan edhe ta tallnin ekipin e Artanit.

* * *

Afër një bredhi po pushonte Artani. Papritur, afër tij erdhi e u ndal me ski Gazmendi. Ishte i lodhur, mezi merrte frymë. – E di ç'ka ndodhur?! – e pyeti Artanin, sikur të donte të hiqte një barrë të rëndë nga supet e pakta.

– Ç'ka?! – Pyetja donte të thoshte: "Më lër të qetë!"

– E di pse nuk dole dje më i miri në gara?

– Këtë e dinë të gjithë. Vozita ngadalë…

– Jo!

– Më tradhtuan skitë.

– Jo, jo!

– …E pra, i pata lyer me kujdes të madh…

– I pate lyer vetëm me "Univesal".

– Vetëm me të…

– Me asgjë tjetër?

– Me asgjë tjetër!

– Nuk vure re pastaj, pas garave, se mbi atë shtresë ishte vënë edhe një shtresë e hollë me vaj për borë të thatë?

– Nuk i shikova mirë…

– Unë i pashë më nge!

– Pse? Ç't'u desh t'i shikoje.

– Si s'm'u desh? Shkëlzeni, kur ishim duke ngrënë mëngjesin, u largua fshehtas dhe sipër "Universalit" t'i leu skitë me…

– Me gjithë mend? – dhe u ngrys. Ca rrudha iu panë rreth buzëve dhe në ballë, nën balluken e verdhë, që i kishte rënë sipër syve. Çakërriti sytë.

– Po, po. Ta punoi. Na e punoi!

– Kush ta tha këtë?

– Ajo kuzhinierja e trashë. Por m'u lut të mos i them askujt. Kishte drojë se do të zihemi…

– Hej, ç'po bisedoni tinëz shokëve? – i pyeti Migjeni, duke dalë me ski në krahun e tyre të djathtë. I kishte përgjuar si një vëzhgues i rritur.

– Asgjë! – tha Artani i zënë në befasi.

– Asgjë? Ç'fshehtësi ruani prej nesh? – pyeti Liraku. Pas tij dolën edhe Dukagjini e Fatosi… Të gjithë qenë fshehur pas trungut të trashë të bredhit shumëvjeçar.
– Puna qëndron siç e dëgjuat!
– Gazmendi u zu ngushtë. Ua tha edhe pse nuk kishte dëshirë të tregonte. Fshehtësia që e dinë të gjithë nuk është fshehtësi…
– Ejani pas meje! – bërtiti Dukagjini dhe e çoi shkopin lart, në shenjë triumfi.
– Pritni, ç'doni ?! Për ku niseni?
– T'i hidhemi në shpinë Shkëlzenit! – tha Migjeni. Shokët u nisën shpejt pas tij, por, pa i bërë nja dhjetë hapa, i ndali zëri i ashpër, por gjithë dridhje i Artanit. – Heeej, ndaluni! Ata mezi i ndaluan skitë. Orë e çast ishin të gatshëm të lëviznin, të vazhdonin drejt Lugut të Ariut, ku ekipi i trajner Gjetos po rrëshqiste… Skitë e tyre lëviznin sipër borës që shkëlqente.
– Në më keni shok, ndaluni! – i luti prapë.
– Mirë, por garat duhen anuluar! – u kërcënua Liraku. Sytë i shkrepnin.
– Është vonë! – tha Artani. Tani rezultatet i kanë botuar gazetat dhe i kanë dhënë radioja e televizioni.

* * *

Një ditë shkoi të blinte një komplet me vegla për gjeometrinë. Papritur takoi Shkëlzenin. Fytyra e tij nuk ishte më aq e vrenjtur dhe e largët, si gjatë skijimit në Sharr. Ishte më e ëmbël. Ku e ku më e afërt. Buzëqeshi. Artani, megjithatë, nuk ia ktheu përshëndetjen. Përkundrazi, e pa vëngër e me përbuzje. Shkëlzeni e preku lehtë në sup.
– Artan! – I thirri duke i shtrirë dorën. Sytë e tij kërkonin miqësi dhe shprehnin pendim.
– Më lër rehat! – ia ktheu Artani duke e shtyrë.
– Ka kohë që po të kërkoj! – Zëri sa vinte e bëhej më vëllazëror, më i ngrohtë, gati lutës.
Kurrfarë pune nuk kam me ty, – tha dhe u përpoq të ikte, por e penguan disa burra.
– Kam unë! – Shkëlzeni deshi t'i thoshte se diçka shqetësuese e brente në zemër.
– Ç'ke? – e pyeti Artani pa e kthyer kokën.
– Dua të të kërkoj falje!
– Nuk dua të bisedoj me ty!
– Të lutem të më falësh… – Fjalët i ngatërroheshin. Ishte skuqur nga turpi. Për një çast, sa tha këto, ndjeu se hoqi një barrë të rëndë nga shpina.

– Të thashë, mos më bezdis! – thirri Artani.

– Të lutem si shokut… – Sytë nuk ia ndante.

– Qëkur u kthyem nga bjeshka, nuk jam i qetë. Ti je skiatori më i mirë në qytet. Këtë e dinë të gjithë, i madh e i vogël. Je më i miri ndër fëmijët e Kosovës.

Artani e pa vëngër.

– Artan, as gjumin nuk e bëj të qetë… – ia nisi.

– Aq më bën! – Artani nuk po ia varte fare.

– Pse ikën prej meje?

– Mos ma zër në fyt këtë limonadë! – e qortoi pa e ngritur kokën.

– Po të lut kaq shumë, kurse ti s'i dëgjon fare lutjet e mia. Pse nuk ndalon në rrugë?... – dhe mori frymë më lirisht.

– Pse ikën prej meje?

– Mos të kam faj?! – që nga ky çast ndjeu se zemra nuk i thoshte më ashtu siç i përgjigjej Shkëlzenit. Kështjella, pra, kishte zënë të pushtohej nga brenda…

– T'i lëmë fjalët. Unë kam bërë faj, ndaj të kërkoj falje…

– S'ka nevojë të më kërkosh asgjë…

– Nuk kam qetësi, të betohem: për kokë të… – Shkëlzeni nisi të betohej në kokën e nënës, të babait, të motrës.

– Mirë, po ta fal gabimin, por, ama, të më lësh të qetë. U morëm vesh?!

– Artan, më duket se ma fale gabimin sa për të kaluar radhën që të më heqësh qafe. Nuk po më fal nga zemra… – nguli këmbë.

– Toke! – dhe i shtriu dorën.

– Të qoftë falur! Dy duar të njoma u shtrënguan miqësisht. Fort, gjatë. Ngrohtë. Gati u dolën lot nga ngazëllimi.

* * *

Gazmendi tashmë kishte hapur derën me kujdes që të mos i binte në sy askujt. Mes shumë anijesh njohu atë të Shkëlzenit. Me gjithë mend ishte e bukur dhe e stolisur për merak. Ia merrte mendja se edhe nëpër parket sikur ta niste, ajo do të lundronte me shpejtësi, le pastaj nëpër ujë. "Hë, moj bukuroshe, edhe pak jetë ke!" – e kërcënoi Gazmendi duke folur me vete. E kapi me dorë. E çoi. Kishte ndër mend ta përplaste, ta shtypte me këmbë, ta bënte copë e çikë. Në atë kohë, një dorë e fuqishme ia kapi anijen dhe ia mori. Ktheu kokën. Ishte Artani i ngrysur, i lodhur që kishte bërë vrap.

– Ç'deshe të bësh? – e pyeti duke u mbushur me frymë.

– Më lësho! Do ta bëj copë e grimë!

– Kurrë!

– E di ç'na bëri në Sharr Shkëlzeni?

– Ta punoi ty apo mua? – zëri i Artanit ishte tepër serioz dhe i vendosur. Gazmendit iu duk shumë i fuqishëm.
– Na e punoi të gjithëve! – tha Gazmendi.
– Punë e madhe! Për hakmarrje deshe ta prishësh këtë anije kaq të bukur?
– Kemi dhënë besën!
– Ç'besë? Besë për punë të liga?! Shkëlzeni më ka kërkuar falje…
– E fale?
– Po!
– Pse nuk na kërkoi neve falje? – pyeti i mllefosur.
– Ju nuk e latë! – ia ktheu Artani duke e vendosur anijen në vendin e mëparshëm. Bile nxori edhe shaminë dhe e fshiu, nga frika se mos i kishte ngelur ndonjë gjurmë nga duart e djersitura.

Pasdreke, shokët vajtën në stadiumin e qytezës për të lëshuar raketat. Kishin edhe nja njëzet minuta kohë, prandaj ndaluan të shihnin garat me anije në basenin e vogël.
– T'i shohim anijet? – tha Migjeni.
– Shkojmë!
Ata shpejtuan hapat. Sa zunë vend në rreshtin e parë, Shkëlzeni e lëshoi anijen në syprinën e lëmuar të ujit. Priste shenjën të ndizte motorin me bateri.
– Fillo! – u dha shenja.
Motori i vogël, prej katër voltësh e gjysmë, u ndez. Zhurmoi lehtë. "Vidra" e bukur, duke shkëlqyer, po çante ujin me siguri, duke sajuar ca rrathë që zhdukeshin në skaj të basenit.
"Vidra!" "Vidra!" "Vidra!" – brohoritnin fëmijët të kënaqur. Shikimet e të gjithëve ishin qepur në fund të basenit, ku do të arrinte anija. Pas tetëmbëdhjetë sekondash, kiçi i saj preku skajin e basenit. Domethënë, dy sekonda më shpejt nga ç'pritej. Kjo ishte shpejtësia më e mirë që ishte arritur ndonjëherë në gara. Të gjithë hovën të mahnitur. Sytë u shkëlqenin. Faqet u ishin skuqur. Përqafonin Shkëlzenin. E uronin. Ai heshtte.
Duke i shtyrë fëmijët me bërryla, para tij doli Artani:
– Urime! – i tha dhe i shtriu dorën.
Shkëlzeni e pa me turp. I dha dorën. Ia shtrëngoi dhe ktheu kokën anash. Ishte skuqur në fytyrë. S'dinte ç'të bënte me duar. Nisi t'i fuste gishtat nëpër flokë. Pas Artanit e uruan me radhë edhe Migjeni, Fatosi, Dukagjini e shumë fëmijë të tjerë.
Shkëlzeni e mbante kokën të ulur. Një vajzë zeshkane, me një kordele të mëndafshtë në flokë, tha:
– I çuditshëm qenka ky djalë! Arriti këtë sukses kaq të madh dhe kokën e mban ulur.
Ajo nuk dinte ç'kishte ndodhur në Sharr.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve:

a) Kush janë trajnerët e ekipeve kundërshtare që zhvillonin garën në mal?
b) Kush ishin skiatorët më të mirë të dy ekipeve?
c) Si ishte gara që zhvilloi Artani? A dha ai maksimumin në garë?
ç) A e plotësoi Artani pritshmërinë e tij dhe të skuadrës?
d) Cila skuadër e fitoi garën? Në ç'mënyrë e fitoi garën ekipi që u shpall fitues?
dh) Pse i kërkoi falje Shkëlzeni Artanit? A iu pranua falja?
e) A vazhdoi grindja mes Artanit dhe Shkëlzenit edhe më vonë?
ë) Çfarë plani kishin shokët e Artanit për t'u hakmarrë? A e realizuan këtë plan? Kush i pengoi në realizimin e hakmarrjes?

Analizojmë tekstin

2 Cilët janë anëtarët e skuadrës së Artanit? Si reagojnë ata pas garës së Artanit?

3 Përshkruani pamjen dhe ndjesitë e Artanit kur përfundoi garën në mal.

4 Për sa gara dhe për çfarë lloj garash flitet në tekst? Dallojini ato dhe dalloni cili është pjesëmarrësi vërtet më i mirë.

5 Teksti ka tri momente kryesore. Dallojini këto momente duke e ndarë tekstin në tri pjesë dhe vërini një titull secilës prej tyre.

1_____ 2_____ 3_____

Interpretojmë tekstin

6 Artani dhe shokët e tij i kishin dhënë fjalën njëri-tjetrit se do të hakmerreshin ndaj atij që kishte bërë hile në garën në mal. Por në fund Artani thotë: *Ç'besë? Besë për punë të liga?! Shkëlzeni më ka kërkuar falje. Interpretoni fjalët e tij.*

Gjuha e tekstit

7 Shkruani kuptimin e drejtpërdrejtë të shprehjeve të figurshme të mëposhtme.

- *të tretur në mendime –*
- *nuk po ia varte fare –*
- *zuri t'i dilte tym nga koka –*
- *sytë e të gjithëve u mbërthyen tek ai –*
- *të më heqësh qafe –*
- *kishin harkuar vetullat –*

Reflektojmë rreth tekstit

8 Si do të vepronit ju po të ishit në vend të Artanit? A do ta falnit Shkëlzenin?

9 Pse mendoni se e vlerësojnë kaq shumë shokët Artanin? Cilat janë cilësitë që e karakterizojnë dhe e dallojnë nga të tjerët?

Detyrë

- Tregoni me gojë ose me shkrim një rast kur ju ose dikush që njihni ka kërkuar falje për një gabim të kryer.

Gjyshja ime

Para leximit

"Gjyshja ime" është një nga tregimet e përmbledhjes "Të fala nga fshati", të shkrimtarit Sterjo Spasse. Libri është ndërtuar në bazë të letrave. Secili prej tregimeve është një letër që Ylli, një djalosh që ndjek shkollën, i dërgon Sokolit shokut të tij bashkëmoshatar. Ylli jeton në fshat, ndërsa Sokoli jeton në kryeqytet. Në letërkëmbimin e tyre ata i tregojnë njëri-tjetrit për familjet, vendin ku jetojnë, por edhe për shokët e shoqet e shkollës dhe të afërmit.
"Gjyshja ime", është një prej letrave të Yllit, në të cilën ai përshkruan një nga njerëzit më të dashur të tij. Në këtë letër përshkruan pamjen, sjelljen dhe në mënyrë të veçantë dashurinë e madhe që i jep ajo.

Sokol, kam harruar të të njoh me gjyshen time, me gjyshe Marën, nënën e nënës. Sa e dashur që është, sa e mirkëz! Merre me mend sikur po shkojmë në shtëpi të saj, te vujçja: kalojmë deriçkën e oborrit; një qen i murrmë do të na kërcënohet, por ja, te dera duket gjyshja:
– U, kush më paska ardhur. Hajde, hajde xhan i gjyshes, shpirt i gjyshes, t'u bëfsha kurban, ditët e mia në të tuat! – më bekon një mijë herë duke më përqafuar e duke më puthur në faqe, në fytyrë, në sy, në ballë, në flokë. E unë prehem me ato ledhatime, me ato të puthura të gjyshes: ia marr doçkën, një doçkë të vockël, të nxirë e të rreshkët, ia shtrëngoj e ia puth me gjithë zemër, pa i thënë asnjë fjalë.
Ulemi me gjyshen në buxhak, pranë zjarrit. Por ajo kujtohet për diçka: më ngre nga vendi, më shtron rrogozin, më vë jastëkun e vogël mbushur me misërishte e ulemi pranë njëri-tjetrit.
– Po nënën si ma ke? Po babagjyshi a ta heq veshin nga ndonjëherë? Po me shkollën si ia ke shpënë? Po lopës a i jep ujë në rregull? Po qeve a u shtie sanë? – e pyetjet e gjyshes janë aq të shumta, sa edhe të puthurat e saj, sa edhe ledhatimet e saj. –
Eja më afër, akoma më afër meje, – më thotë.
Unë jam aq afër saj, veçse të ngjitem me të, por ajo s'kënaqet. Më së fundi më merr në prehër mua një goxha burrë. Unë nuk ia prish qejfin fare.
– Hë kështu, kështu bir i gjyshes, tani më kënaqe pa masë! Pa dale të të puth. Uu, sa të ëmbla i paske faqet, llokum fare; ububu, sysheqer! – më thotë e bot e puth. Unë buzëqesh. Gjyshja e gjorë

Fjalor

vujçja – daja.

Fjalor

manar – fëmijë i urtë e i përkëdhelur, që nuk u ndahet prindërve.
kunadhe – dhelpër.
arme – lakër turshi.
pëqi – prehër.

Sterjo Spasse

Sterjo Spasse (1914-1989) e filloi veprimtarinë letrare në vitet tridhjetë të shekullit të kaluar dhe shkroi në prozë. Ai është autor edhe në studime pedagogjike, tekste shkollore etj. Ai ka botuar katër përmbledhje tregimesh: "Kuror rinie", "Në krahët e një femre", "Nusja pa duvak" dhe "Të fala nga fshati", si dhe dhjetë romane, ndër të cilat përmendim: "Pse?", "Afërdita", "Ata nuk ishin vetëm", "Afërdita përsëri në fshat" etj.

akoma më quan bebe e më ndjell po me ato të përkëdhelura, e po me ato të puthura, siç bënte kur unë isha fëmijë dy-trevjeçar. Po me atë gazin fëminor më merr për dore e më shpie në qymezin e pulave, zgjedhim vezën më të madhe e më të bardhë, pastaj marrim xhezven, e duke luajtur e mbushim me ujë dhe e vëmë vezën në zjarr që të ziejë! Pastaj e qërojmë bashkë dhe e… hamë bashkë!

Kjo historia e gjyshes s'ka të mbaruar dhe unë jam i lidhur aq shumë pas saj, tamam si manar. Më pëlqejnë fjalët e saj, të puthurat e përkëdhelitë e saj. Shpesh edhe në ëndërr më shtiret sikur më flasin ata dy sy të vegjël, që u ngjajnë syve të kunadhes, që zuri vujçja sivjet me çark në pyllin e Malizonjës; më duket se më përkëdhelin ato dy duar të vogla e të rreshkëta; më duket sikur më puthin ato buzë të holla e të vyshkura. Gjyshja! Gjyshja ime, Sokol, sa e dashur, sa e mirkë! Nuk i rrihet ditë pa ardhur në shtëpinë tonë, pa e parë e pa folur me nënën time, pa i ndihmuar asaj në punët e shtëpisë, pa i sjellë arme, gjizë, vezë nga të sajat. Edhe me nënën time, që është tani grua afër të dyzetave, ajo sillet si me një foshnjë; ia shtrëngon kokën në gji të saj, e përkëdhel, e puth. Bile disa herë e kam parë kokën e nënës në pëqi të gjyshes, e cila ia përkëdhelte flokët dhe faqet

tamam si të ishte nëna ime fëmijë, fare kalama, bebe! Gjyshja më ka thënë sa herë: "Për nënën, or bir, fëmijët e saj janë gjithnjë të vegjël sado plakë qoftë ajo, sado të mëdhenj qofshin bijtë e bijat e saj!"
Mua më duket sikur kam dy nëna: nënën dhe gjyshen time. Kur isha i vogël e kur më qortonte nëna për ndonjë gabim a për ndonjë grindje me shokët, unë duke qarë shkoja i ankohesha gjyshes. Ajo më priste krahëhapur, dëgjonte me kujdes ankimet e mia, pastaj me buzë më thithte lotët në faqet, më merrte kalipiç dhe më shpinte përsëri te nëna:
– Ti, moj, Lenkë, pse ma shave Yllkë-xhanin? Ai s'e ka bërë atë gabim. Hajde puthe tani, se ndryshe nuk ta jap. Do ta mbaj për vete! Ta dish, ky është xhani im, e ti… vetëm ta puthësh! A more vesh? – i thërriste gjyshja nënës që nga oborri. Nëna, sa dëgjonte zërin e saj, dilte në oborr e qeshur, hapte krahët dhe na përqafonte të dyve.
– Jo, unë , jo, s'e dua mamin, jo! – ia bëja duke e larguar me doçkat e mia i zemëruar, ndërsa ajo – nëna ime – m'i rrëmbente të dy doçkat e m'i shtrëngonte fort e fort në gjirin e saj. Pastaj, që të tre të përqafuar, që të tre të pajtuar, hynim në shtëpi.
Kushedi sa herë, Sokol, është përsëritur kjo historizë! Prandaj gjyshen time – këtë plakë të kërrusur dhe me fytyrën tërë zhubra, me ata flokë si të kripur me miell gruri – e kam një nga njerëzit e mi më të dashur.
Kam harruar të të pyes, Sokol, ti a ke ndonjë gjyshe të tillë? Të përqafoj së largu me ngrohtësinë e gjyshes sime!

Ylli

Fjalor

kalipiç – kaliqafë, këmbët rreth qafës.
doçka – dora e fëmijëve të vegjël.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Në tekst flitet me dashuri për një gjyshe.

a) Ajo është nëna e nënës apo nëna e babait të atij që tregon?
b) Si është sjellja e gjyshes ndaj nipit të saj?
c) A shkon ai ta takojë atë? Po gjyshja a vjen shpesh në shtëpinë e tij?
d) Si ndihet nipi gjatë kohës kur viziton gjyshen?
dh) Me çfarë e gostit gjyshja nipin e saj?
e) A e kritikon ndonjëherë gjyshja djaloshin e vogël?

Analizojmë tekstin

2 Çfarë lloj pyetjesh i bën gjyshja djalit të vogël të tekstit?

3 Si sillet gjyshja me djalin e vogël? Si me një bebe apo si me një të rritur?

Studim teksti

4. Çfarë bënte gjyshja kur në vegjëli, shpesh djali shkonte dhe i ankohej se e ëma e kishte qortuar? A mendonte gjyshja se nëna kishte bërë gabim?
5. Cilët janë pjesët e trupit dhe të fytyrës së gjyshes që përshkruhen më së shumti në tekst?

   a) _____
   b) _____
   c) _____

Interpretojmë tekstin

6. Gjyshja i bën shumë pyetje nipit të saj. Çfarë tregojnë pyetjet e shumta që bën ajo?
7. Interpretoni fjalët e gjyshes: *"Për nënën or bir, fëmijët e saj janë gjithnjë të vegjël sado plakë qoftë ajo, sado të mëdhenj qofshin bijtë e bijat e saj!"*

Gjuha e tekstit

8. Gjeni figurën e enumeracionit në tekstin e mësipërm.
9. Zbërtheni kuptimin e shprehjeve të mëposhtme sipas situatave në të cilat përdoren.

   nuk ia prish qefin _____
   prehem në ato ledhatime _____
   nuk i rrihet ditë pa ardhur_____
10. Zëvendësoni me një fjalë këtë shprehje:

    me ata flokë si të kripur me miell gruri _____

Reflektojmë rreth tekstit

11. Zgjidhni dhe shkruani në fletore pjesën që ju pëlqen më shumë nga ky tregim. Shpjegoni pse ju pëlqen.

Shkruajmë

Përshkruani portretin fizik të gjyshit ose të gjyshes suaj, si dhe marrëdhënien që keni me të.

Ndaluni te paraqitja e jashtme:

- tregoni se kujt gjinie i përket;
- jepni moshën e saktë ose të përafërt;
- përshkruani trupin: gjatësinë, zhdërvjelltësinë, ngathtësinë etj.
- përshkruani fytyrën: formën dhe ngjyrën e syve, ngjyrën e flokëve, ngjyrën e lëkurës, ndonjë shenjë dalluese, si nishan etj.;
- përshkruani veshjen që përdor më së shumti.

Ndaluni te bota e brendshme dhe te marrëdhënia qe ju keni me të:

- përshkruani si sillet zakonisht;
- tregoni se çfarë i pëlqen të bëjë dhe çfarë jo;
- ndaluni te mendimi që ju keni për të.

Kur përshkruani një person, kujdesuni që të përdorni sa më shumë mbiemra nëpërmjet të cilëve të shprehni cilësi, gjykim dhe vlerësim për të.

Mësuesi ynë i dashur

Para leximit

Pjesa "Mësuesi ynë i dashur" është shkëputur nga romani "Kamoja, ideja e shekullit" i autorit francez Daniel Penak. Në këtë pjesë tregohet për një grup fëmijësh të klasës së pestë fillore, të cilët janë shumë të shqetësuar për atë që do të ndodhë vitin tjetër shkollor, kur do të shkojnë në klasën e gjashtë. Ata kërkojnë informacion për këtë ndryshim nga mësuesi i tyre, zoti Margarel.

– Gjepura! Vetëm gjepura! Të rrinim e t'i dëgjonim gjithë ç'thonë të rriturit, nuk do të bënim dot asgjë, me shkasin e klasës së gjashtë! "Sa vjeç është i vogli juaj?" "Dhjetë vjeç e gjysmë? Oh, po kjo s'është aspak për të qeshur, është çështje serioze, shumë shpejt do të shkojë në klasë të gjashtë!" "Ah! Më vjen keq, por vitin tjetër s'ka më pishinë, do të hysh në klasë të gjashtë!" "Çfarë? Në kinema? Mos e zër fare në gojë! Shiko të përsëritësh tabelën e shumëzimit, në ta ka qejfi të kalosh klasën!"

Britmat e Kamosë kishin krijuar pështjellim mes shokëve tanë të klasës së pestë fillore, ata që shumë shpejt do të përballeshin me klasën e gjashtë të 9-vjeçares.

– Ndër gjithë të rriturit, vetëm njëri nuk e përmend kurrë klasën e gjashtë, vetëm njëri! – tha Lantier trashaluqi, një nga djemtë e klasës.

– E kush na qenka ky?

– Zoti Margarel! – u përgjigj Lantieri, që gjithnjë kishte frikë se mos lëshonte ndonjë budallallëk.

Pas pak, të gjithë nxënësit u futën në klasë. Mësuesi, zoti Margarel, po fotokopjonte mësimet e historisë.

– Djema, ç'bëni të gjithë këtu brenda? Pushimi i madh s'ka mbaruar ende…

Këto fjalë i tha pa u kthyer nga ne, pa na qortuar, me zërin e tij përherë të gëzuar. Zoti Margarel ishte mësuesi ynë që s'e humbiste kurrë qetësinë, kurrë, "mësuesi ynë i nderuar", siç e quante Kamoja sa herë duhej t'i kërkonte leje për të thënë apo për të bërë diçka.

Sidoqoftë, në atë çast, zoti Margarel i ra më të që bëhej fjalë për diçka serioze, sepse ai drejtoi trupin dhe na vështroi gjatë në sy.

– Çfarë keni, djema?

Kamoja uli sytë tek atletet e veta.

– Mund t'ju pyesim për diçka, zotëri? Ju nuk flisni kurrë për klasën e gjashtë, përse vallë?

– Më falni, s'ju kuptova.

– Po, vërtet, – ndërhyri Lantieri, – ju jeni i vetmi i rritur që s'e zini kurrë në gojë.

– Epo… më thoni, ç'doni të dini për klasën e gjashtë të 9-vjeçares?

Kamoja u përgjigj:

Daniel Penak

Daniel Penak (1 dhjetor 1944, Marok) është një shkrimtar francez. Babai i tij ishte oficer, ndaj ai e kaloi fëmijërinë e tij në Afrikë, në Azinë Juglindore dhe në Francë. Pas studimeve në Nisë, Daniel Penak u bë mësues. Ai ka shkruar një sërë librash për fëmijë, me të cilët ka marrë edhe disa çmime letrare. Stili i tij karakterizohet nga humori dhe imagjinata, por ai gjithashtu shkrin në të edhe elementin edukativ. Është vlerësuar për stilin e tij, por edhe për vlerat pedagogjike të letërsisë që shkruan.

– Gjithçka.
Zoti Margarel u ul në katedër, këmbë përmbi këmbë, siç bënte sa herë na tregonte ndonjë histori. (E kishte zakon të na rrëfente ndonjë histori të shtunave paradite. Po, me atë, të shtunat u ngjanin të dielave).
– Gjithçka? Do të mbeteni të zhgënjyer.
Vështroi Kamonë, pastaj ne të tjerët.
– Sepse, s'ka ndonjë gjë të veçantë. Klasa e gjashtë është njësoj si klasa e pestë, pikë për pikë. Të njëjtat lëndë, të njëjtat detyra, të njëjtat orare… kuptohet, duke përparuar ca më shumë, njësoj siç përparon njeriu, kur futet në të njëjtin shteg. Kjo është e gjitha.
– E po, kjo klasa e gjashtë duhet të ketë diçka ndryshe, përderisa prindërit po e bëjnë kaq tragjike! – theksoi Kamoja mbiemrin "tragjike" duke parë zotin Margarel drejt e në sy.
– Jo, asgjë ndryshe. Përveç… Margareli kaloi dorën mes flokëve të dendur. Nuk ishin flokë ata që kishte në kokë, por një pyll amazone.
– Përveç…
– I vetmi ndryshim i vërtetë do të jetë që, në vend të një mësuesi të vetëm, do të keni pesë ose gjashtë: një për matematikën, një për gjuhën… pra, një mësues për çdo lëndë. Kjo është e gjitha.
– Kjo do të thotë që do të jenë pesë a gjashtë herë më pak të përgatitur se ju? – thirri Lantieri.
Mësuesi zuri të qeshte.
– Po ç'janë këto që thua, mor djalë! Ata janë si puna e specialistëve, siç janë mjekët: një doktor për zemrën, një tjetër për mëlçinë, një tjetër për veshkat etj. Gjithë problemi qëndron te përshtatja. Deri tani keni pasur vetëm një mësues gjatë gjithë vitit, që e njihnit mirë; i mirë apo i keq, me atë kishit të bënit. Kur të kaloni në 9-vjeçare, duhet të mësoheni me pesë a gjashtë karaktere të ndryshme në të njëjtin vit shkollor dhe ata mund të jenë të ndryshëm nga njëri-tjetri, po aq sa edhe ju.

Fjalor

gjepura – *fjalë boshe, pa vlerë.*
shkas – *këtu: pretekst.*
pështjellim – *këtu: ngatërresë, rrëmujë.*
i ra më të – *këtu: e kuptoi.*
katedër – *vend i ngritur në një klasë prej nga flet mësuesi, profesori.*
tragjike – *këtu: tronditëse, shqetësuese.*
specialist – *dikush që ka njohuri të posaçme dhe të thelluara në një degë të shkencës.*

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve:

a) Në cilën klasë janë fëmijët të cilët janë pjesë e tekstit të mësipërm?
b) Pse janë kaq të shqetësuar fëmijët?
c) Kush është zoti Margarel?
ç) Për çfarë e pyesin zotin Margarel fëmijët?
d) Cili është ndryshimi i vërtetë që do të ndodhë nga kalimi i fëmijëve një klasë më lart?

Analizojmë tekstin

2 Cilët janë personazhet që flasin në këtë rrëfim. Kush është më i shqetësuari prej tyre? Kush është personazhi më i qetë?

3 Me çfarë i krahason zoti Margarel mësuesit e ndryshëm që do t'u japin lëndë të ndryshme fëmijëve?

Gjuha e tekstit

4 Përcaktoni se çfarë figurash letrare janë përdorur në shprehjet e mëposhtme.

Ata janë si puna e specialistëve _____
Siç janë mjekët _____
Flokëve të dendur _____
Nuk ishin flokë... por një pyll amazone _____

Interpretojmë tekstin

5 Zoti Margarel:

☐ u shkakton fëmijëve edhe më tepër shqetësim;
☐ i qetëson duke u thënë që pothuajse çdo gjë është njësoj.

Argumentoni zgjedhjen tuaj.

6 Interpretoni fjalët: *E kishte zakon të na rrëfente ndonjë histori të shtunave paradite. Po me atë, të shtunat u ngjanin të dielave.* Pse të shtunat u ngjanin të dielave?

Reflektojmë rreth tekstit

7 Në tekst thuhet: *Zoti Margarel ishte mësuesi ynë që s'e humbiste kurrë qetësinë, kurrë.* Cilat mendoni se janë karakteristikat kryesore që duhet të ketë një mësues i mirë? Radhitini ato në fletore.

Bashkëbisedojmë

- Si ndikojnë prindërit në sjelljen e fëmijëve? Çfarë mendoni se duhet të bëjnë prindërit kur fëmijët pësojnë ndryshime gjatë procesit të rritjes?
- Shpesh thuhet: *Rritja është e vështirë, por e bukur*. Diskutoni në lidhje me këtë shprehje.

Provimi

Para leximit

Tregimi "Provimi" është shkëputur nga përmbledhja "Korrieri i vogël i familjeve" e shkrimtarit italian Xhovanino Guareski. Në të përshkruhet marrëdhënia e ndërlikuar prindër-fëmijë. I nxitur nga një detyrë që duhet ta realizojë për në shkollë, Albertinoja i bën disa pyetje të drejtpërdrejta babait të tij, të cilat e vënë në siklet atë. Si do të reagojë babai i Albertinos?

Isha ulur e po lexoja përpara dritares së hapur, kur Albertinoja m'u afrua dhe më pyeti:
– Baba, je i ndershëm ti?
Kjo nuk është pyetje e thjeshtë dhe, megjithëse njeriu mund të jetë mësuar duke rrëmuar në ndërgjegjen e vet, mbeta ngushtë.
– Po ty pse të intereson? – mërmërita.
– Më duhet për esenë ku duhet të përshkruajmë prindërit, por jo siç e bëra vitin e kaluar, me gjatësinë, gjerësinë, perimetrin e të tjera. Kësaj radhe duhet të shkruaj për ndershmërinë, zellin, punën, dashurinë për atdheun e gjëra si këto.
Margarita, ime shoqe, ndërhyri:
– Domethënë, të kërkohet portretizimi moral i prindërve, – tha ajo. – Ne kujtojmë se brenda mureve të shtëpisë nuk na kontrollon njeri, mirëpo në të vërtetë fëmijët na shohin.
– Shohin edhe djemtë, edhe vajzat e vogla, – theksoi vajza ime e vogël, që ne e thërrasim "Rebelja", me një fije qesëndie.
– S'janë punë për ty këto, – ia ktheu e ëma prerazi. – Kur të shkosh në klasë të katërt, si yt vëlla, atëherë, po.
"Rebelja" ia priti se ajo shikonte dhe i dinte ca gjëra, pa qenë nevoja të ishte në shkollë, por Margarita nuk iu përgjigj provokimit të saj.
– Baba, je i ndershëm ti? – pyeti sërish Albertinoja.

Fjalor

rrëmoj – këtu: kërkoj me kujdes diçka që më nevojitet.
mërmërij – flas me vete me zë të ulët.
zell – këtu: përpjekje dhe këmbëngulje e pareshtur për të kryer një punë.
theksoj – këtu: shqiptoj më fort një pjesë fjalie për të vënë në dukje rëndësinë kuptimore të saj, peshën emocionale që ka etj.
qesëndi – këtu: fjalë për të vënë në lojë dikë, tallje e lehtë.
prerazi – këtu: shkurt.
provokim – këtu: nxitje e qëllimshme.

– Nuk është nevoja as të ngresh pyetje, – thirra. – Ti më njeh, e di çfarë bëj e si sillem, ndaj të takon ty të gjykosh a jam i ndershëm apo jo.
Albertinoja u kthye në tryezën e punës.
– Por, kur unë jam në shkollë dhe ti s'je në shtëpi, unë nuk e di se çfarë bën ti, – vërejti ai me shqetësim.
Patjetër që u pezmatova.
– Pra, kështu paske besim te babai yt?! Vërtet mendon se unë sillem si njeri i drejtë në shtëpi, kurse jashtë sillem si i keq?
Bëra një gjest padurimi.
Albertinoja pohoi me kokë, pastaj, pasi e kafshoi mirë e mirë bishtin e penës, shkoi te Margarita e i pëshpëriti diçka në vesh.
– Xhovanino, – tha Margarita pas pak, – të lutem, jepi një përgjigje të saktë.
– Unë jam njeri i drejtë! – thirra. – Habitem si mund të lindin dyshime për këtë.
Albertinoja pohoi përsëri me kokë e shkoi t'i çuçuriste në vesh Margaritës.
– Po, po, njeri i drejtë dhe njeri i ndershëm janë e njëjta gjë, – e siguroi ajo dhe Albertinoja iu kthye fletores.
Kaluan pesë minuta, pastaj Albertinoja, me shumë kujdes, filloi prapë nga pyetjet:
– Je edhe i zellshëm, baba?
– Po, Albertino, – iu përgjigja ngrohtë. – Jam punëtor i zellshëm, më pëlqen puna që bëj, përballoj edhe sakrifica për të mirën e familjes, të atdheut, të qytetërimit.
Albertinoja shënoi me kujdes çdo gjë në fletore dhe ngriti kokën sërish:
– Po si baba, si je?
Nuk pranova të përgjigjesha.
– Të takon ty të më gjykosh, ti je fëmija im, – pohova.
– Edhe unë jam fëmija yt, – tha "Rebelja" me kryeneçësi.
– Patjetër! Prandaj, ju të dyve ju takon të më gjykoni si jam si baba.
Albertinoja dhe "Rebelja" shkuan në dhomën tjetër për të biseduar e për të marrë një vendim të përbashkët për cilësitë e mia si baba. Diskutimi qe i gjatë dhe i gjallë. Më së fundi, u kthyen të dy dhe Albertinoja u ul menjëherë në tavolinë e filloi të shkruante. E vështrova mirë e mirë, por nga fytyra e Albertinos nuk kuptohej asgjë. "Rebelja" më vështroi drejt e në sy, pastaj më shkeli syrin dhe bëri një gjest si për të më thënë: "Mos ki merak, janë të gjitha për bukuri: i rregullova unë punët".
Mora frymë i lehtësuar: më kishte shkuar mirë edhe kësaj radhe. E kisha kaluar me sukses provimin e babait. "Rebelja" më kishte ndihmuar shumë, ndaj i isha mirënjohës.

Fjalor

pezmatohem – *këtu: fyhem prej një padrejtësie.*
gjest – *këtu: shenja e duarve a e kokës që shoqëron të folurit e njeriut.*
çuçuris – *flas me zë shumë të ulët me dikë.*
kryeneçësi – *kokëfortësi, të mos pranosh mendimin e të tjerëve.*

Xhovanino Guareski

Xhovanino Guareski (1908-1968) është gazetar, shkrimtar, karikaturist dhe humorist. Guareski ndoqi në Parmë Liceun Klasik dhe universitetin, por më vonë i la studimet për t'iu kushtuar gazetarisë e karikaturës. Shkrimet dhe karikaturat e tij ranë shpejt në sy dhe synuan një kthesë historike të traditës italiane të epokës. U bë shumë i famshëm me përmbledhjen me tregime "Bota e vogël e Don Kamilos", tregime që e bënë të njohur në nivel ndërkombëtar. Më pas botoi edhe shumë libra të tjerë, në bazë të të cilëve janë krijuar një sërë filmash dhe programesh televizive.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve:

a) Çfarë po përpiqet të bëjë Albertinoja? Ndihmën e kujt kërkon?
b) A e ndihmon apo pengon dikush atë në realizimin e saj?
c) Cilat janë personazhet që marrin pjesë në këtë tekst?
ç) Çfarë pozicioni mban nëna gjatë diskutimit të Albertinos me babain?
d) Çfarë roli luan "Rebelja" në diskutimin mes babait dhe Albertinos?

Analizojmë tekstin

2 Për çfarë e pyet babain Albertino?

- _____
- _____
- _____
- _____

3 Në cilin mjedis zhvillohet ngjarja e treguar? Përpiquni ta përshkruani këtë mjedis, duke përdorur edhe imagjinatën tuaj.

4 Duke u nisur nga sjellja e vajzës në tekst, analizoni karakterin e saj dhe shpjegoni pse e thërrasin "Rebelja" prindërit e saj.

Interpretojmë tekstin

5 Babai nuk i përgjigjet menjëherë fëmijës së tij, por e lë atë të mendohet dhe të japë mendimin e tij. A tregon kjo se babai ka shumë besim në vlerësimin e fëmijës për të? Argumentoni përgjigjen.

6 Interpretoni faktin që për ta gjykuar si baba, *diskutimi qe i gjatë dhe i gjallë*, mes fëmijëve.

Gjuha e tekstit

7 Shprehni me fjalët tuaja kuptimin e këtyre shprehjeve:

- duke rrëmuar në ndërgjegje – _____
- mbeta ngushtë – _____
- e kisha kaluar me sukses provimin – _____

Reflektojmë rreth tekstit

8 Në një çast pyetjet e Albertinos e bëjnë nervoz babain. *Unë jam njeri i drejtë! – thirra. – Habitem si mund të lindin dyshime për këtë.* Mos ndoshta kjo ka të bëjë me faktin që ndryshe e shohim veten, ndryshe na shohin të tjerët?

Bashkëbisedojmë

- Si do t'i cilësonit marrëdhëniet që keni me shokët dhe mësuesit? A përputhet mendimi juaj gjithmonë me atë të shokëve të tjerë? A ndikon përputhja ose mospërputhja e mendimeve në marrëdhëniet që ju keni me ta?
- Bashkëbisedoni për temën: "Prindërit janë njerëzit më të ndershëm që ne njohim".

Ishulli i thesarit

Para leximit

Kjo pjesë është shkëputur nga romani "Ishulli i thesarit" i R. L. Stivenson. Në qendër të romanit janë aventurat e një djaloshi, Xhim Houkinsit, i cili gjen një hartë të çuditshme në baulen e vjetër të "kapitenit" që qëndronte në hanin e prindërve të tij. Së bashku me disa të tjerë, ata formojnë ekuipazhin, ngrenë velat dhe nisen në kërkim të ishullit të thesarit. Një grup piratësh, ku bënte pjesë edhe Xhon Silveri, bëjnë plane se si të rrëmbejnë thesarin.

Të gjithë sa ishin në kuvertën e anijes, u emocionuan. I gjithë ekuipazhi vrapoi në pjesën e përparme të anijes për të parë tokën. Atëherë unë dola fshehurazi nga fuçia. Asnjeri nuk më pa të dilja andej.

Në atë çast, hëna kishte dalë dhe mjegulla ishte larguar. Edhe unë u afrova menjëherë pa bërë zë pranë atyre që vështronin me kureshtje ishullin. Të gjitha vështrimet binin te dy kodrat e vogla të ishullit. Këto kodra në drejtim të juglindjes kishin formën e një koni.

Në të vërtetë, frika ende nuk më ishte larguar. Më dukej se po shihja një ëndërr. Ndërkohë që anija lundronte drejt ishullit, kapiten Smolleti i jepte urdhër ekuipazhit.

– A e ka parë ndokush nga ju më parë këtë ishull? – pyeti ai.

Xhon Silveri i tha se e kishte parë ishullin kur kishte qenë kuzhinier në një anije tjetër.

– Mund të hedhim spirancën diku në jug, apo jo? – pyeti sërish kapiteni.

– Po, zotëri. Atë ishull e quajnë "Ishulli i thesarit". Njëherë e një kohë këtu ka qenë vendi i piratëve.

Pastaj kapiteni iu drejtua Xhon Silverit:

– Në dorë kam një hartë. Pa shikoje njëherë!

Xhon Silveri zgurdulloi sytë nga gëzimi. Kjo ishte një kopje e hartës që kishte qenë në sëndukun e Bill Bonsit. Vetëm se nuk kishte shenjat e kuqe X dhe shënimet përkatëse.

Sapo Xhon Silveri e vuri re, u bë keq, por nuk e dha veten.

– Po, zotëri, – tha ai. – Kjo pikë duhet të jetë. Po kush vallë ta ketë bërë? Mendoj se ata piratë kanë qenë pa mend. Paskan gjetur vendin më të përshtatshëm për të hedhur spirancën.

Kapiteni e falënderoi Xhon Silverin. Ai i tha se do ta thërriste përsëri kur të kishte nevojë për të. Në atë çast, Xhon Silveri më kishte vënë dorën mbi sup. Isha shumë i emocionuar, por nuk bëra zë.

– Ky është një vend i bukur për të rinjtë. Shëtit, bridh, noto, gjuaj, kacavirru nëpër kodra... Kur i sjell nëpër mend këto, më duket vetja i ri, – tha. Pastaj m'u kthye mua. – Në qoftë se del në pyll për të

Fjalor

kuvertë – sheshi i sipërm i anijes.
ekuipazh – të gjithë ata që drejtojnë anijen dhe kujdesen për të.
kon – trup si hinkë e përmbytur.
spirancë – hekur i rëndë me ganxhë që lëshohet në det.
zgurdulloi – iu hapën sytë fort.
sënduk – arkë prej druri me kapak.
pretekst – të gjesh një arsye.



Robert Luis Stivenson

Robert Luis Stivenson (1850-1894) ka qenë romancier, poet, skenarist, eseist etj. Ndër romanet më të njohura të tij, përmendim: "Shigjeta e zezë", "Djaloshi i grabitur" dhe "Ishulli i thesarit". Ky i fundit u botua për herë të parë në vitin 1883 dhe pati një sukses të jashtëzakonshëm, duke u përkthyer edhe në shumë gjuhë të botës.

zbuluar diçka, do të të jap gjëra të mira për të ngrënë, – më tha dhe shkoi drejt kuzhinës.

Kapiten Smolleti, Sër Trillani dhe doktor Livsi po flisnin në kuvertën e anijes.

...Unë iu afrova pa bërë zë dhe nuk prita më.

– Doktor, më dëgjoni! Dërgojini Sër Trillanin dhe kapitenin në dhomë! Pastaj gjeni një pretekst dhe më thërrisni. Kam lajme shumë të këqija për t'ju thënë.

Doktori ndryshoi paksa në fytyrë, por e përmblodhi shpejt veten. Më pas të tre u ulën poshtë në dhomë. Nuk vonoi shumë dhe dërguan fjalë se më thërrisnin në dhomën e tyre. I gjeta të ulur rreth tavolinës.

– Hajde Xhim Hokins! – tha Sër Trillani. – Paske për të na thënë diçka.

Doktori më tha të ulesha. Unë u tregova se disa nga detarët ishin piratë, se ata e dinin se ishim nisur për të gjetur thesarin e Flintit, se tani dukeshin si miq, por pasi ta gjenim thesarin, do të na vrisnin.

– Nga i di ti këto? – m'u drejtua doktori.

– Isha brenda në fuçinë e mollëve. E dëgjova bisedën dhe planet e tyre. Xhon Silveri është kryetari i tyre dhe të tjerët janë nën urdhrat e tij. Disa nga piratët nuk e pëlqyen planin e tij, por gjithsesi ia kanë frikën Xhon Silverit. Çfarë do të bëjmë tani?! – u thashë.

Kapiteni më falënderoi për këto që u tregova.

– Kapiten! – tha doktor Livsi. – Unë mendoj se shkaku i kësaj është Xhon Silveri. Ai është një burrë që tërheq vëmendjen e të tjerëve.

– Ai, edhe i varur në litar, do të tërheqë vëmendjen e të tjerëve, – tha kapiteni i nevrikosur. – Por këto janë fjalë të kota. Unë shoh tri a katër mundësi. Nëse Sër Trillani më lejon, do t'jua numëroj.

– Ju jeni kapiteni dhe juve ju takon të flisni, – tha me shumë mirësjellje Sër Trillani.

Zoti Smollet nisi të fliste:

– Së pari, ne duhet të vazhdojmë rrugën, sepse tashmë është e pamundur të kthehemi pas. Nëse atyre u them se po kthehemi, më kundërvihen

menjëherë. Së dyti, kemi ende kohë, të paktën derisa të gjejmë thesarin. Së treti, mes tyre ka edhe burra që janë në anën tonë. Në fund të fundit, do të luftojmë. Unë ju këshilloj t'i kapim në befasi duke i sulmuar në një ditë që ata nuk e presin. Mund të kem besim te burrat që sollët nga shtëpia juaj, Sër Trillani, apo jo?

– Aq sa keni besim tek unë, mund të keni besim edhe tek ata.

– Ata janë tre, – llogariti kapiteni. – Ne bashkë me Hokinsin bëhemi shtatë vetë. Tani, cilët nga ata janë të ndershëm?!

– Duhet të jenë burrat e Trillanit, – ndërhyri doktori. – Ata që zgjodhi para se të takohej me Xhon Silverin.

– Jo, – tha Sër Trillani. – Hendsi ishte njëri prej tyre.

– Mendoja se mund të besoja te Hendsi, – shtoi kapiteni. Dhe vazhdoi:

– Unë nuk kam gjë tjetër për të thënë. Të gjithë duhet të sillemi sikur jemi të gëzuar. E di që kjo është e lodhshme dhe se të përleshesh me ta do të ishte më qetësuese, por derisa të marrim vesh se kush është në anën tonë, nuk mund të bëjmë dot asgjë. Do t'i vëzhgojmë me kujdes. Unë kështu mendoj.

– Unë mendoj, se për këtë, Xhimi është ai që mund të na ndihmojë shumë, – tha doktori. – Detarët flasin lirshëm pranë tij, kështu që Xhimi mund të dallojë çdo gjë.

– Hokins! Kam besim te ti, – tha edhe Sër Trillani.

Kur po më thoshin këto fjalë, më zuri një pesimizëm i madh, sepse isha i pafuqishëm në kuptimin e plotë të fjalës. Vetëm se ja, pra, sërish nëpërmjet meje, në saje të disa rastësive, Zoti nxori gjithçka në pah.

Ne le të flisnim sa të donim, ishim vetëm shtatë vetë ndër njëzet e gjashtë burra që kishte anija. Dhe unë isha një fëmijë.

Fjalor

mendjeshkurtër – dikush që nuk mendon thellë.
vëzhgoj – ndjek me vëmendje.
pesimizëm – njeri i trishtuar, që është i pakënaqur nga jeta.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Përgjigjuni pyetjeve rreth tekstit:

a) Ku zhvillohen ngjarjet e treguara në këtë pjesë?

- ☐ Në anijen me emrin "Spanjollja".
- ☐ Në breg të ishullit.
- ☐ Në brendësi të ishullit.

b) Shënoni emrat e personazheve në këtë pjesë, rolin e tyre dhe grupin ku bëjnë pjesë.

_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

c) Pse ishin të emocionuar marinarët? Po Xhimi, pse ishte i tensionuar?

ç) Çfarë dinin marinarët për ishullin në të cilin do të ndalonte anija?

Studim teksti

2 Pse Xhon Silveri mbeti pa fjalë kur kapiteni i përmendi hartën? Kujt i përkiste ajo hartë?

☐ Xhon Silverit. ☐ Bill Bonsit. ☐ Xhim Hokinsit.

3 Çfarë dëgjoi Xhimi ndërsa rrinte i fshehur në fuçinë me mollë? Pse ndihma e Xhimit ishte e rëndësishme?

4 Çfarë vendosin të bëjnë Xhimi, kapiteni Smollet, Sër Trillani dhe doktor Livsi?

☐ Të bëhen miq me Xhon Silverin.
☐ Të shtiren sikur nuk dinë asgjë.
☐ Ta vrasin atë natën, në gjumë.

Analizojmë tekstin

5 Cila pjesë ju duket se mbart më shumë tension? Nënvizoni në tekst fjalitë që e tregojnë këtë.

6 Edhe doktori, edhe Xhon Silveri mendojnë se Xhimi është një zbulues i mirë. Çfarë karakteristikash të tjera të një heroi aventurash ka ai?

Interpretojmë tekstin

7 Ç'tipar i Xhon Silverit vihet në dukje në fjalinë e mëposhtme?

Ai, edhe i varur në litar, do të tërheqë vëmendjen e të tjerëve.

Gjuha e tekstit

8 Si e përjeton Xhimi të gjithë ngjarjen? Nënvizoni në tekst fjalët që tregojnë gjendjen e tij shpirtërore, si: frikë, gëzim, mosbesim, dyshim etj.

9 Gjeni në tekst, tri foljet që përshkruajnë planin e zotit Smollet.

a. *duhet të vazhdojmë* **b.** _____

c. _____ **ç.** _____

Reflektojmë rreth tekstit

10 Sipas mendimit tuaj, çfarë do të thotë Xhimi me fjalinë e fundit të fragmentit? *(Dhe unë isha një fëmijë?)* Sa herë keni marrë përsipër detyra dhe përgjegjësi, a keni dyshuar se mund t'ia dilni mbanë? Çfarë keni bërë për të rritur vetëbesimin në të tilla raste?

11 Xhimit do t'i duhet të përballet me piratët, gjë që është një sfidë e fortë për të. A duhet të përballemi me sfidat apo duhet t'i shmangim ato?

Detyrë

- Xhim Hopkinsi zbulon se piratët kanë thurur një plan, i cili, për të shtuar kureshtjen tonë nuk tregohet në këtë fragment. Shkruani një plan imagjinar të piratëve. Lexojeni në klasë atë.
- Kërkoni në internet për të parë filmin "Ishulli i thesarit" dhe diskutoni në klasë për fragmentet që ju bënë më shumë përshtypje.

Ishulli i delfinëve të kaltër

Para leximit

Në një ishull të vogël, në mes të detit, "dy lega i gjatë dhe një i gjerë", që nga lart duket "si një delfin truplakuar", jetonte një popullsi e vogël indiane. Në këtë ishull jetonte edhe Karina bashkë me të atin, motrën Ulapja dhe vëllanë e vogël Ramo. Banorët e ishullit patën një përleshje të egër me aleutët, të cilët vinin me anijet e tyre dhe kërkonin të vrisnin lundërzat, që notonin pranë brigjeve të këtij ishulli. Meqenëse shumë burra humbën jetën, ndërmjet të cilëve edhe babai i Karinës, ata që mbetën u larguan me një anije për të mos u kthyer më. Kur anija ishte larg bregut, duke u përplasur me dallgët dhe erën e madhe që kishte nisur, Karina u hodh prej saj pasi pa se vëllai i vogël kishte mbetur në breg. Stuhia nuk e la anijen të kthehej pas për t'i marrë.

Romani përshkruan përpjekjet për mbijetesë të kësaj vajze të vogël, e cila mbetet e vetme në ishull. Ajo arrin të mbijetojë me inteligjencën dhe aftësinë për t'u përshtatur me natyrën.

Pranvera erdhi përsëri plot me lule dhe ujërat rridhnin nëpër rrëpira dhe derdheshin në det. Shumë zogj u kthyen përsëri në ishull.

Tainori dhe Lurai ndërtuan një fole në pemën ku kishin lindur. E bënë me barishte të thata deti e me gjethe, si dhe me qime nga kurrizi i Rontusë. Sa herë që ai ndodhej në oborr, kur ata merreshin me folenë, i vërsuleshin kur ai nuk i shihte, ia shkulnin një tufë qimesh dhe iknin fluturim. Doemos, atij s'i pëlqente aspak kjo gjë dhe, bëri ç'bëri, u fsheh derisa u mbarua foleja.

Kisha pasur të drejtë që i vura emër femre, Lurai, njërit prej zogjve, sepse pikërisht ajo bëri dy vezë pikaloshe dhe me ndihmën e shokut të saj nxori dy zogj të vegjël shëmtaraqë, të cilët, brenda pak kohësh, u bënë zogj të bukur. U vura emra e ua preva krahët dhe pas pak kohësh u bënë po aq të butë sa edhe prindërit e tyre.

Gjeta edhe një zog të vogël pulëbardhe, që ishte rrëzuar nga foleja poshtë në plazh. Pulëbardhat i ngrenë foletë lart në majat e shkëmbinjve, nëpër boshllëqe. Zakonisht këto boshllëqe janë të cekëta dhe shpesh kam parë zogj të vegjël gati duke rënë nga foleja dhe kam vrarë mendjen se si mbahen. Por në të vërtetë nuk para bien poshtë. Zogu për të cilin po ju tregoj ishte pendëbardhë, me sqep të verdhë dhe nuk ishte vrarë shumë, por kishte thyer njërën këmbë. E çova në shtëpi dhe ia lidha eshtrat me dy shkopinj të vegjël dhe fije tendine. Një kohë nuk bëri përpjekje të ecte. Pastaj, meqë ishte ende i vogël për të fluturuar, filloi të kërcente nëpër oborr.

Me zogjtë e vegjël dhe me të rriturit, me pulëbardhën e me Rontunë, që më vinte pas ngado që shkoja, oborri dukej një vend i këndshëm.

[...] Një ditë, kur po mblidhja abalone në breg e po i fusja në kanoe, pashë një kope lundërzash aty pranë. Ndiqnin njëra-tjetrën duke nxjerrë kokën midis leshterikëve dhe duke u zhytur përsëri për të dalë prapë në një vend tjetër. Dukej sikur luanin lojën tonë, kur ishim

Skot O'Dell

Skot O'Dell (1898-1989) ka qenë një shkrimtar i njohur amerikan. Ai e adhuronte detin, sepse në fëmijëri familja e tij jetoi për disa vite në një ishull. Kjo dashuri e shkrimtarit për detin vihet re edhe në librat e tij. Disa nga librat e tij më të njohur janë: "Ishulli i delfinëve të kaltër", "Këndo që nga hëna", "Nuk më quajnë Anxhelika", "Zia", "Rrënja e stuhisë në mal" etj. Ai është fitues i medaljes Hans Kristian Andersen, çmimi më i lartë ndërkombëtar për një grup veprash që merr një autor i librave për fëmijë.

ende fëmijë, në kaçubet e ishullit. Kërkova me sy Mon-a-ni-në, por të gjitha më dukeshin njëlloj.

E mbusha kanoen me abalone dhe po vozisja drejt bregut, kur më zunë sytë një lundërz që më vinte pas. Kur ndalova, ajo u zhyt e më doli përpara. Ishte ende larg, por e njoha menjëherë se cila ishte. Nuk do ta besoja kurrë se mund të isha në gjendje ta dalloja nga të tjerat, por tani isha kaq e sigurt se ishte Mon-a-ni-a, saqë mora një peshk në dorë dhe e ngrita lart.

Lundërzat notojnë shumë shpejt dhe para se të mblidhja veten nga befasia, ajo ma rrëmbeu peshkun nga dora.

Dy muaj me radhë nuk e pashë më, por një mëngjes, ndërsa peshkoja, m'u fanit befas para syve. E ndiqnin dy lundërza të vogla. Ishin si dy kukulla dhe notonin aq ngadalë sa Mon-a-ni-a ndalej herë pas here dhe i shtynte përpara. Lundërzat e detit nuk dinë të notojnë kur janë të porsalindura, kështu që mbahen pas nënës. Pak nga pak ajo i mëson duke i shtyrë me krahët e saj dhe duke notuar rreth tyre në formë rrethi, derisa ato mësohen ta ndjekin.

Mon-a-ni-a u afrua pranë bregut dhe i vërvita një peshk. Ajo nuk e kapi, siç bënte zakonisht, por priti të shihte çfarë do të bënin të vegjlit. Kurse ata dukej se ishin më të interesuar të më shihnin mua e jo peshkun që po e merrte uji, ndaj ajo e kapi me dhëmbët e saj të mprehtë dhe ua hodhi përpara fytyrës.

Fjalor

rrëpirë – faqe mali a kodre shumë e thepisur.
abalone – molusk që rritet nëpër shkëmbinj buzë detit.
kanoe – një lloj varke e ngushtë dhe e ngritur në pjesën e fillimit dhe të fundit.
kope – tufë.
lundërz – kafshë e vogël me lëkurë të butë dhe të çmueshme, që ushqehet me peshq.
leshterik – barishte deti.
kaçube – një grumbull bari, gëmushë, një tufë bari.
vozitje – lundroj me barkë.
fanit – shfaqet.

Bashkëbisedim

- Mblidhni nga interneti të dhëna mbi shkaqet dhe pasojat e zhdukjes së specieve të rralla bimore e shtazore në ditët e sotme. Diskutoni në klasë rreth tyre.
- Diskutoni rreth filmave që flasin për marrëdhëniet e kafshëve me njeriun dhe bashkekzistencën e tyre.



I hodha Mon-a-ni-së një peshk tjetër, por edhe me këtë veproi si me të parin. Me gjithë përpjekjet e saj, të vegjlit nuk po e merrnin ushqimin dhe, së fundi, pasi u lodhën duke luajtur me të, i shkuan pranë e filluan t'i lëpiheshin.

Vetëm atëherë e kuptova se Mon-a-ni-a ishte nëna e tyre. Lundërzat çiftëzohen përjetë dhe, kur ngordh nëna, për të vegjlit kujdeset babai, i cili mundohet t'i rritë ata sa më mirë. Kështu mund të kishte ndodhur ndoshta edhe me Mon-a-ni-në.

Ndërkaq po vështroja familjen e vogël që notonte pranë bregut.

– Mon-a-ni, – i thashë, – do të të vë një emër tjetër. Ky emër është *Uon-a-ni*, i cili të përshtatet shumë, sepse do të thotë "Vajza me Sy të Mëdhenj".

Lundërzat e vogla u rritën shpejt dhe s'kaloi shumë e zunë të m'i merrnin peshqit nga dora, kurse Mon-a-ni-së i pëlqenin më tepër abalonet. Abalonen që ia hidhja, e linte të binte në fund dhe pastaj zhytej dhe dilte duke e mbajtur atë afër vetes, kurse në gojë mbante një copë guri shkëmbor. Pastaj kthehej në kurriz, e vinte abalonen në gjoks dhe fillonte ta godiste pareshtur me copën e gurit, derisa t'ia thyente guaskën.

I mësoi edhe të vegjlit të bënin si ajo, kështu që unë herë pas here rrija në breg e shihja të tria lundërzat tek i godisnin me gurë guaskat që mbanin në gjoks. Po të mos e dija se të gjitha lundërzat kështu i hanë abalonet, do të mendoja se Uon-a-ni-a e bënte këtë enkas për të më kënaqur mua. Por në të vërtetë kështu veprojnë të gjitha dhe shpesh kam vrarë mendjen për këtë, madje edhe sot.

Pas asaj vere, pasi u miqësova me Uon-a-ni-në dhe të vegjlit e saj, nuk vrava kurrë më lundërza. Kisha një llabane prej lëkure lundërze, që e hidhja shpatullave dhe e mbajta derisa u gris, por nuk bëra më tjetër. As kormoranë nuk vrava më për t'ua marrë pendët e bukura, megjithëse ata kanë qafë të gjatë aspak të hijshme dhe lëshojnë ca tinguj të shëmtuar kur merren vesh me njëri-tjetrin. Nuk vrava më as foka për t'ua marrë tendinat dhe fillova të përdorja leshterikë për të lidhur gjëra që më duheshin. As qen të egër nuk u përpoqa të vrisja më, madje as elefantë deti.

Ulapja do të kishte qeshur me mua, edhe të tjerët do të ishin tallur, sidomos babai s'do linte gjë pa më thënë. Gjithsesi, kështu mendoja atëherë, sepse nuk më bënte zemra të vrisja kafshë që ishin bërë miqtë e mi apo edhe të tjera që me kohë do të më qëndronin pranë. Edhe sikur të kthehej Ulapja e babai dhe të më vinin në lojë, edhe sikur gjithë të tjerët të ishin aty e të gajaseshin me mua, prapë kështu do të veproja, sepse kafshët e zogjtë ndiejnë si njerëzit, edhe pse nuk kanë gojë të flasin dhe nuk bëjnë të njëjtat gjëra. Pa to, globi do të ishte një vend i trishtuar.

Fjalor

çiftëzohen – bashkohen femra me mashkullin, bëhen dyshe.
llabane – tip gune prej lëkure.
kormoran – një lloj shpendi ujor me këmbë si lopatë, zakonisht me pendë të errëta e të bukura, që ushqehet me peshq.
foka – gjitar i deteve polare, me trup të madh e të dhjamosur.
elefant deti – lloj foke me feçkë si të elefantit.
gajasem – ia plas gazit, mekem se qeshuri.

Shënim

Për shkrimin e këtij romani, Skot O'Dell është nxitur nga historia e vërtetë e një vajze të mbetur vetëm në një ishull nga viti 1835 në vitin 1853. Ajo njihet si Gruaja e Humbur e Shën Nikollës. Ishulli që në libër quhet "Ishulli i delfinëve të kaltër", në të vërtetë njihet si ishulli i Shën Nikollës. Ai u banua për herë të parë nga indianët në vitin 2000 p.K., por vetëm në vitin 1602 u zbulua edhe për të tjerët. Gruaja u gjet aty 18 vjet pasi njerëzit e saj ishin larguar.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Përgjigjuni pyetjeve:

a) Në ç'vend ndodhin ngjarjet? Kush jeton aty?
b) Çfarë bën vajza, me zogun e vogël të pulëbardhës që gjen në breg? Pse vajza u pret krahët zogjve të vegjël?
c) Si kujdeset vajza për lundërzat? Çfarë bën Mon-a-ni-na për të vegjlit e saj?
ç) Si sillet vajza me kafshët dhe shpendët e ishullit? A ndryshon ajo nga fillimi në fund të pjesës?

Analizojmë tekstin

2 Pse u zhduk Mo-a-ni-a për dy muaj me radhë? Gjeni në tekst të gjitha tiparet që e bëjnë Mo-a-ni-në dhe dy lundërzat e vogla një familje të vërtetë.

3 Shënoni emërtimet e kafshëve dhe të shpendëve që e rrethojnë vajzën e vogël në ishull. Kërkoni në internet apo në një enciklopedi të shihni pamjet e tyre.

_____, _____, _____, _____,
_____, _____, _____, _____,

Interpretojmë tekstin

4 Vajza u ka vënë emra kafshëve, edhe pse ato nuk janë kafshë shtëpiake apo kafshë shoqërimi. Pse e ka bërë ajo këtë?

5 Si silleshin njerëzit e rritur me kafshët dhe shpendët e ishullit? Po vajza? Pse ajo është e vendosur t'i mbrojë e të kujdeset për ta?

6 Vajzës, për të mbijetuar, i duheshin veshje dhe ushqime. Pse ajo nuk zgjedh që të përdorë kafshët për këto nevoja jetësore?

Reflektojmë rreth tekstit

7 Si i kuptoni fjalitë e mëposhtme?

"... nuk më bënte zemra të vrisja kafshët që ishin bërë miqtë e mi apo edhe të tjera që me kohë do të më qëndronin pranë... Pa to globi do të ishte një vend i trishtuar."

8 Në ditët e sotme shumë lloje kafshësh a bimësh janë në rrezik zhdukjeje dhe shkak për këtë janë njerëzit. Diskutoni se ç'masa mund të merren që ato të shpëtojnë.

Gjuha e tekstit

9 Në një pjesë të tekstit përmendet shpesh vendimi për të mos vrarë më kafshë. Renditini këto raste.

a) nuk vrava më kurrë lundërza b) _____ c) _____
ç) _____ d) _____ dh) _____

10 Vajza thotë se kafshët ndiejnë si njerëzit. Rrethoni fjalët në tekst që e tregojnë këtë.

Detyrë

- Të gjithëve na pëlqen të mbajmë kafshë shtëpiake. Shkruani një tekst të shkurtër me temë: "Kam një mik të veçantë në shtëpi".

Princi dhe i varfri

Para leximit

Kjo pjesë letrare është shkëputur nga romani "Princi dhe i varfri", me nëntitull "Një përrallë për të rinjtë e të gjitha moshave". Në qendër të tij janë dy fëmijë që kanë lindur në të njëjtën ditë. Ata kanë çuditërisht pamje shumë të ngjashme, por kanë fate krejtësisht të ndryshme. Njëri është princ dhe jeton në një pallat, ndërsa tjetri jeton në një shtëpizë të vogël, në një lagje të ndotur. Në një takim të rastësishëm, të dy djemtë do të këmbejnë jo vetëm rrobat, por edhe fatin. Princin Eduard që kishte veshur rrobat e Tomit të varfër e hedhin në rrugë, ndërsa Tomit të varfër që kishte veshur rrobat e princit fillojnë t'i përulen me plot nderime.

Kur mbaroi parada, populli hyri brenda në pallatin Uestminster për të marrë pjesë në ceremoninë e kurorëzimit. Tom Kenti, i veshur me një mantel të gjatë, u duk te dera. E vunë të ulet në fron dhe ja, ceremonia filloi.

Kryepeshkopi i Kanterberrit mori kurorën e Anglisë dhe ia vuri Tom Kentit në kokë. Djali u zverdh, ndërsa zemra iu mbush plot trishtim. Mbas pak aty ndodhi diçka e çuditshme.

Një djalosh i veshur zhele-zhele, hyri në sallë. Ngriti dorën dhe tha me zë të fortë:

– Mos ia vini kurorën e Anglisë këtij djali. Jam unë mbreti!

Në çast, shumë njerëz që ishin aty e shtynë atë për ta nxjerrë jashtë, por menjëherë ndërhyri Tomi, me zë të prerë:

– Mos e prekni! Ai është mbreti!

Të habitur dhe të hutuar, njerëzit u ngritën në këmbë dhe i panë me vëmendje të dy djemtë. Për çudi, të gjithë vunë re se ata ngjanin shumë.

Pastaj lordi protektor tha:

– Mos ua vini veshin fjalëve të madhërisë së tij. Ai vazhdon të jetë i sëmurë. Nxirreni jashtë atë lypës.

... Sytë e lordit protektor, pa dashur, shikuan atë, fytyrën e çuditshme, dhe ai vuri re të njëjtën gjë që kishin parë edhe të tjerët: të dy djemtë ngjanin në një mënyrë të çuditshme.

U mendua për disa çaste, pastaj tha:

– Në qoftë se do të më lejoni zotëri, dua t'ju bëj disa pyetje.

– Me gjithë qejf, lordi im!

Lordi protektor i bëri atij shumë pyetje, p.sh., mbi pallatin, mbi mbretin Henrikun VII, princin dhe princeshat. Djaloshi iu përgjigj të gjithave.

Ai vazhdonte ta thërriste mbret ende Tom Kentin, ndërsa vetë Tomi ishte shumë i dëshpëruar. Ai po humbte çdo shpresë për t'u kthyer në shtëpinë e tij.

Fjalor

paradë – parakalim.
ceremoni – veprimtari të përcaktuara deri në imtësitë më të vogla, që realizohen për ngjarje të veçanta dhe të rëndësishme.
kurorëzim – këtu: shpall mbret.
lord – titull aristokratik që trashëgohet.
fron – këtu: ndenjëse ku ulet mbreti.



Mark Tuejn

Mark Tuejn (1835-1910) ka qenë një shkrimtar shumë i njohur amerikan. Ditën kur lindi Tuejni, u shfaq kometa Hallei. Ai parashikoi se do të vdiste kur kometa të kthehej dhe ashtu ndodhi vërtet. Ai ka shkruar romanet: "Aventurat e Tom Sojerit", "Aventurat e Hakëlberi Finit", "Princi dhe i varfri" etj.

Eduardi mbret

Lordi protektor u mendua edhe një herë pastaj iu drejtua me këtë pyetje:

– Ku është Vula e Madhe? Në qoftë se do t'i përgjigjesh kësaj pyetjeje, atëherë çdo gjë do të sqarohet, mbasi vetëm princi i Uellsit e di se ku ndodhet ajo.

– Oh, po kësaj s'e kam të zorshme t'i përgjigjem, – thirri djaloshi, pastaj u kthye nga ana tjetër dhe urdhëroi: – Ju, lordi Xhon, shkoni në kabinetin tim në pallat dhe, në murin nga ana e majtë, do të shikoni një sustë. Shtypeni sustën dhe do të shikoni që muri do të hapet pak. Të parën gjë që do të gjeni atje është Vula e Madhe. Merreni dhe silleni këtu.

Tom Kenti e pa njëherë lordin Xhon që ngurronte të shkonte, pastaj i tha:

– Pse nuk shkoni? Nuk e dëgjuat urdhrin e mbretit? Nisuni!

Lordi Xhon u përul një herë në shenjë nderimi dhe doli. Pas disa minutash u kthye përsëri. Iu afrua Tomit dhe i tha:

– Madhëri! Vula nuk është atje!

– Nxirreni jashtë këtë lypës, – u inatos Lordi protektor, – dhe veç kësaj jepini një mësim të mirë!

Oficerë dhe roje shkuan ta kapin Eduardin, por Tom Kenti urdhëroi:

– Mbrapsht! Kush prek atë, e pret vdekja!

Lordi protektor iu afrua lordit Xhon dhe i tha me zë të ulët:

– Po si mund të zhduket Vula e Madhe e Anglisë? Një gjë e florinjtë si ajo?

Tom Kenti bëri një hap përpara dhe thirri:

– Një minutë! Mos ishte një gjë e rrumbullakët dhe e hollë, me disa shkronja të gdhendura në të? Tani e di unë ku është ajo, por nuk isha unë i pari që e vura atje.

– Po kush atëherë? – pyeti Lordi protektor.

– Ai që qëndron atje, mbreti i vërtetë i Anglisë.

– Nuk e mbaj mend ku e kam vënë.

– Oh, mbreti im, – u mundua ta ngushëllonte Tomi. – Mendohuni, mendohuni mos e kujtoni. Në fillim ne ecëm bashkë, unë ju tregova për motrat e mia, Nanin dhe Betin, sigurisht ju e mbani mend këtë, pastaj ju fola për lodrat e djemve në Ofal Kort. Ju e mbani mend edhe këtë. Më dëgjoni mua dhe do t'ju kujtohet çdo gjë. Pastaj ju veshët

rrobat e mia dhe unë tuajat, prej këtej ne shkuam para një pasqyre të madhe dhe atje çuditeshim sa shumë i ngjanim njëri-tjetrit. Jam i kënaqur që e mbani mend këtë. Pastaj ju vutë re se si rojat më kishin plagosur në krah. Duke e parë këtë plagë, madhëri, ju u nxehët shumë dhe ikët për të dënuar rojat. Kaluat para një tavoline. Ajo që ju quani vulë ishte mbi këtë tavolinë; ju e morët prej andej, patë njëherë rreth e rrotull, si për të gjetur një vend ku ta vinit, pastaj ...

– Mjaft! – thirri mbreti. – Tani më kujtohet. Lordi Xhon, shkoni në kasafortën që ndodhet në mur dhe atje do të gjeni vulën.

– Pikërisht, mbreti im, pikërisht, – foli Tom Kenti. – Tani froni i Anglisë ju takon juve. Vraponi, lordi Xhon, vraponi!

Kur lordi Xhon u kthye me Vulën e Madhe në dorë, të gjithë thirrën:

– Rroftë mbreti i vërtetë!

Mbasi u bë qetësi, lordi protektor tha:

– Urdhëroj që ky lypës të futet menjëherë në burg!

Por mbreti ia priti:

– Jo, ai nuk do të shkojë në burg!

Pastaj iu drejtua Tomit:

– Po ju, miku im, si mundët ta mbani mend ku e kisha fshehur vulën? Mua për veten time s'më kujtohej fare.

– Oh, mbreti im, ajo ishte fare kollaj, sepse unë e kisha përdorur disa herë.

– E keni përdorur? Po atëherë pse nuk e shpjegonit dot ku ishte?

– Sepse kur më pyesnin për të, unë nuk e dija çfarë kërkonin. Unë nuk e dija se kjo gjë ishte vula. Ata nuk më tregonin se ç'ishte, madhëri.

– Po ku e keni përdorur, miku im?

Tomi u skuq në fytyrë dhe heshti.

– Fol, miku im, dhe mos ki frikë për asgjë, – i tha mbreti. – Për çfarë e keni përdorur Vulën e Madhe të Anglisë?

– Kam thyer arra me të!

Fjalor

kurorë – këtu: rreth i stolisur me ar dhe gurë të çmuar.
protektor – këtu: person i caktuar për të mbrojtur dhe drejtuar dikë.
vulë – mjet i vogël zyre, ku gdhenden simbole të ndryshme, që ngjyhet me bojë dhe vendoset mbi shkresa si shenjë dalluese e vërtetësisë së tyre.
e zorshme – e vështirë.
kabinet – dhomë pune e dikujt që ka një pozicion të lartë.
ngurronte – ishte në mëdyshje, nuk ishte i sigurt.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Përgjigjuni pyetjeve rreth tekstit:

a) Ku zhvillohen ngjarjet e rrëfyera në tekst?
- ☐ Në Ofal Kort.
- ☐ Në pallatin Uestminster.
- ☐ Në Uindsor.

b) Në cilin moment u ritakuan sërish Eduardi dhe Tom Kenti?

c) A përfiton Tomi nga rasti për t'u shpallur mbret?

ç) Kush e vuri në provë Eduardin nëpërmjet pyetjeve që i bëri?

d) Cila është prova që vërtetoi se kush ishte mbreti i vërtetë?

Studim teksti

Analizojmë tekstin

2 Nëpërmjet diagramit të Venit, gjeni të përbashkëtat dhe dallimet mes Tom Kentit dhe Eduardit.



3 Përshkruani me nga një fjali si dukej princi dhe si dukej Tomi në ditën e kurorëzimit.

_ _

_ _

Interpretojmë tekstin

4 Me Vulën e Madhe vuloseshin vendimet me të rëndësishme për mbretërinë. Çfarë simbolizon vula për një mbret?

5 Argumentoni dëshpërimin e Tom Kentit:

Ai vazhdonte ta thërriste ende Tom Kentin "mbret", ndërsa vetë Tomi ishte shumë i dëshpëruar. Ai po humbte çdo shpresë për t'u kthyer në shtëpinë e tij.

Gjuha e tekstit

6 Nënvizoni fjalitë të cilat tregojnë se Tom Kenti nuk donte të shpallej mbret.

7 Çfarë kuptoni nga përgjigjja e Tom Kentit në fund të tekstit? Cilën veçanti të të shkrurit të autorit zbuloni me këtë fjali?

Reflektojmë rreth tekstit

8 Si e thërret mbreti Eduard Tom Kentin në fund të tekstit? Çfarë kuptoni nga kjo mënyrë komunikimi?

9 A mendoni se Eduardi do të tregohet mirënjohës për miqtë që ka njohur në këtë aventurë të çuditshme?

10 A duhet gjykuar njeriu nga pamja apo nga veprimet që bën?

Po	Pse?	Jo

Detyrë

- Përshkruani me disa fjali si e imagjinoni marrëdhënien e mëvonshme ndërmjet Eduardit dhe Tom Kentit.

Klorela

Para leximit

Në këtë pjesë letrare tregohet për udhëtimin që ndërmerr anija kozmike "Flumina". Në ekuipazhin e saj ka edhe dy fëmijë, të cilët kishin muaj të tërë që përgatiteshin të udhëtonin në këtë distancë shumë të madhe, nga toka. Ata ishin shumë të emocionuar, si dhe prindërit dhe moshatarët që i shoqëronin. Në anijen kozmike shkencëtarët kishin vendosur edhe një bimë uji, një algë, e cila kishte aftësi të shumohej shumë dhe shpejt. Udhëtimi ishte i gjatë, por dhe shumë i bukur.

Rruga për në pistodrom gjallonte nga qindra njerëz të moshave të ndryshme. Anija kozmike "Flumina" pas një ore do të niste udhëtimin e saj drejt hapësirës. Në vorbullën e njerëzve, së bashku me prindërit, nxitonin edhe Jona dhe Dori. Ndiheshin të gëzuar dhe të emocionuar. Së bashku me inxhinier Ninin do të niseshin për në Mars me anije kozmike. Një udhëtim i këndshëm dhe i vështirë. Një rast i jashtëzakonshëm, ndaj qyteti po i përcillte me zemër të ngrohtë, me besim në fitore. Kalimtarët i shikonin me kërshëri, prindërit edhe me njëfarë shqetësimi, ndërsa moshatarët ndiheshin krenarë. Nuk ishte shaka. Do të udhëtonin 112 milionë km vajtje-ardhje. Për muaj të tërë ishin përgatitur me kujdesin më të madh për të përballuar vështirësitë, për të përdorur aparaturën e ndërlikuar shkencore, për të eksperimentuar Klorelën në kushte të reja. "Planeti i kuq", siç i thonë Marsit, gjashtë herë më i vogël se Toka, nuk ishte i panjohur për ta.

Shkencëtarët tanë, që kishin fluturuar disa herë në Mars, kishin sjellë sa e sa të dhëna interesante për të, sa e sa fotografi, filma me ngjyra, mostra dheu dhe analiza. Po kurrsesi nuk mund të krijosh atë përfytyrim të plotë që të jep një fluturim drejt Marsit, një shëtitje në tokën e tij disi të shkretë.

Në hyrje të pistodromit kozmik u ndanë me njerëzit e afërm dhe së bashku me inxhinier Ninin, u nisën drejt anijes kozmike. U futën brenda. Një shpërthim i zakonshëm dhe anija kozmike "Flumina" u nis me vërtik drejt hapësirës së pafund…

Turma e njerëzve po kthehej nga pistodromi kozmik. Babai i Jonës, inxhinier i fluturimeve kozmike, u rrethua nga të rritur dhe fëmijë të njohur e të panjohur. Pyesnin për gjithçka, e ai, i qetë, i matur jepte përgjigje.

– Xhaxhi, – iu drejtua një fëmijë, – me se do të ushqehen kozmonautët?

– Ku do ta mbajnë gjithë atë ushqim?

– Kam lexuar në një revistë se, gjatë një fluturimi për në Mars, ekuipazhit të anijes kozmike, po të përdorte ushqim të zakonshëm, do t'i duheshin 25 tonë.

– Po, kështu është? Por kohët e fundit ka filluar të zbatohet një metodë e re.

Bardhyl Xhama

Bardhyl Xhama ka lindur në vitin 1933. Ai ka punuar si mësues, redaktor, studiues i çështjeve pedagogjike e metodike. Si shkrimtar, ka botuar shumë libra për fëmijë, ndër të cilët përmendim: "Zjarrfikësi i pyllit", "Lejleku me akullore", "Tre vëllezërit", "Ekspedita e kaltër", "Arratisje nga kafazi" etj.

Tetë nga veprat e tij janë nderuar me çmime në konkurset kombëtare të letërsisë për fëmijë e të rinj. Ka shkruar pjesë për teatrot e kukullave, radiotregime e teletregime, radionovela, skenarë dokumentarësh televizivë etj.

Kozmonautët do të ushqehen me një bimë uji, me një algë që quhet Klorela. Kemi hartuar një projekt të ri për përdorimin e saj në fluturimet kozmike.

– Po ku do ta mbajnë Klorelën?

– A nuk është njësoj?

– A nuk ka edhe ajo peshë?

– Pastaj, si mund të ushqehen udhëtarët me një bimë mikroskopike?

Pyetjet bëheshin njëra pas tjetrës dhe inxhinieri e kishte të vështirë të përgjigjej menjëherë. Pasi dëgjoi pjesën më të madhe të pyetjeve, inxhinieri nisi të shpjegojë:

– Klorela njihet si bimë uji. Ka vlera të mëdha ushqyese. Trupi i saj përmban 50% albumina, 20% yndyrë, 20% karbohidrate dhe vetëm 10% mbeturina të ndryshme. Kur i krijohen kushte të mira, shtohet 8 herë në 24 orë. Në prodhimtari nuk mund të krahasohet me asnjë bimë tjetër. Nga një bimë, me shpejtësi të çuditshme rriten dy të tjera, nga këto rriten katër, tetë e kështu me radhë. E kemi provuar rritjen e saj në kushte laboratorike dhe e dini sa prodhim ka dhënë? 1200 kv për ha. Kështu lindi ideja që në anijen kozmike "Flumina", për kultivimin e saj të ndërtojmë një kabinë speciale, një sistem prej lëndësh sintetike të tejdukshme, me peshë 100 kg. Kjo e lehtëson në mënyrë të ndjeshme peshën e anijes kozmike dhe në të njëjtën kohë, siguron ushqimin për kozmonautët dhe frymëmarrjen e rregullt të tyre. Dhe gjithçka ndodh se ajo e shfrytëzon shumë mirë energjinë e dritës së diellit.

* * *

Anija kozmike "Flumina" fluturonte me shpejtësi fantastike. Të tre banorët e saj e ndienin veten të qetë. I vetmi shqetësim ishte përballimi i vështirësive për mungesën e peshës. Këtë e ndienin sidomos Jona dhe Dori. Çdo lëvizje e tyre përfundonte me një flurim në kabinë, shpeshherë merrnin poza qesharake. Inxhinier Nini i ndihmonte dhe i këshillonte. Brenda javës ata fituan më shumë besim në lëvizjet e tyre.

Fjalor

pistodrom – *vendi nga ku nisen anijet kozmike.*
anije kozmike – *mjet fluturues në hapësirë.*
mostra – *copë a pjesë e vogël e shkëputur nga diçka për të mësuar cilësitë e saj.*
kozmonaut – *ai që fluturon me anije kozmike.*
albumina – *lëndë organike shumë e rëndësishme për trupin e qenieve të gjalla.*
karbohidrate – *bashkim lëndësh organike të përbëra nga karboni, hidrogjeni dhe oksigjeni.*



Klorela po rritej për bukuri aty, në kabinën e saj, në kushte shumë të mira që i ishin krijuar. Një robot elektronik i telekomanduar nga inxhinier Nini merrej vetëm me Klorelën, kryente të gjitha shërbimet e nevojshme. E mbillte, e plehëronte, e prashiste, e korrte, e thante. Një aparat tjetër po elektronik, përpunonte Klorelën dhe e kthente në miell, yndyrë, karbohidrate dhe i pasuronte këto me vitaminat e nevojshme, duke u dhënë shije të mirë, të ngjashme me të ushqimeve të tokës.

– Sot do të na përgatisësh drekën, – i tha një ditë Jonës inxhinier Nini. – Duam gjellë të shijshme.

– Patjetër inxhinier, – tha Jona. – Do të mundohem! Të shohim se si do të na bindet kuzhina elektronike. Iu afrua një tabele sinjalesh dhe shkeli disa butonë. Lënda e parë nuk i mungonte. Nuk kaluan veç disa minuta dhe dreka ishte gati. Dy duar metalike u zgjatën dhe tavolina e ngrënies u shtrua me të gjitha të mirat.

– Urdhëroni, – u tha Jona inxhinier Ninit dhe Dorit. – Dreka është gati. Besoj se do të mbeteni të kënaqur. Supa me Klorela të freskëta u përla e para. Buka ishte e shijshme dhe e pjekur mirë. Disa feta të skuqura si patate, madje me dhjetë herë më shumë albumina, u pëlqyen shumë. Ëmbëlsira ishte gatuar për bukuri, e shkrifët, me shurup sheqeri, me shije si të tortave. Në fund, një pije freskuese që ngjasonte me lëngun e pjeshkës.

–Mrekulli, – tha inxhinieri. Kjo Klorela po na kënaq.

Fluturimi po shkonte mirë. Po i afroheshin Marsit. Sa ngjasonte sipërfaqja e tij me atë të Tokës!

– Po të zbresim në Mars me trup të lirë, pa asnjë mjet, – tha Nini, – nuk do të jetonim veç disa minuta. Në atmosferën e Marsit ka vetëm 0,4 për qind oksigjen.

Në Mars zbritën në ditën dhe orën e caktuar. Në Tokë erdhi njoftimi: "Anija kozmike "Flumina" u ul me sukses në Mars. Ekuipazhi në gjendje shumë të mirë. Eksperimentimi me Klorelën i suksesshëm."

Fjalor

pasuroj – shtoj diçka për t'i rritur vlerat, për ta përmirësuar.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve:

a) Sa është distanca vajtje-ardhje që do të përshkojë anija kozmike "Flumina"?

b) Cilat janë përmasat e Marsit, planetit ku do të shkojë anija kozmike, krahasuar me Tokën?

c) Cilët janë anëtarët e ekuipazhit të anijes kozmike?

Studim teksti

ç) Cila ishte vështirësia më e madhe me të cilën u përballën udhëtarët? Kush prej tyre ndjeu më shumë vështirësi?
d) Me çfarë do të ushqeheshin anëtarët e ekuipazhit?
dh) Kush e përgatiti drekën për kozmonautët? Në ç'mënyrë u përgatit ajo?
e) A ka oksigjen në planetin Mars?

Analizojmë tekstin

2 Si i shikojnë udhëtarët e anijes kozmike:
a) kalimtarët? _____
b) prindërit? _____
c) moshatarët e tyre? _____

3 Çfarë është Klorela? Cilat karakteristika të saj shfrytëzonin njerëzit?

4 Kush kujdesej për Klorelën? Çfarë shërbimesh i bëheshin asaj?

Interpretojmë tekstin

5 Cili ishte qëllimi i këtij udhëtimi? A u realizua ai?

6 Do të donit të ishit pjesë e një udhëtimi të tillë në një planet tjetër?

Reflektojmë rreth tekstit

7 A mund ta ndryshojnë dhe përmirësojnë jetesën tonë zbulimet shkencore? Në ç'mënyrë?

Gjuha e tekstit

8 Cilat janë dy epitetet që përdoren në tekst për të karakterizuar udhëtimin që do të realizohet?

9 Gjeni në këtë tekst fjalë të cilat lidhen me fushën e teknologjisë dhe zbërtheni kuptimin e tyre.

Shkruajmë

- Shkruani një tregim të shkurtër fantastiko-shkencor me temë: *Udhëtimi im në Hënë*.

Mbani parasysh këto këshilla:

- Krijoni një hyrje sa më interesante që të fitoni interesin e lexuesve tuaj.
- Shprehni bukur mendimet tuaja.
- Përgjatë zhvillimit, lidhini ngjarjet, duke i vendosur ato në hapësirën dhe kohën e përzgjedhur.
- Përcillni nëpërmjet personazheve mesazhe që lidhen me kurajën, guximin, vullnetin etj.
- Në paragrafin përmbyllës, zgjidheni situatën në mënyrën tuaj.
- Çdo ilustrim, fotografi apo pikturë që shoqëron shkrimin, duhet të lidhet me ngjarjen.

Momoja dhe lodrat e reja të miqve të saj

Para leximit

Momo është heroina e librit të shkrimtarit Mikel Ende, që mban në titull emrin e saj. Ajo është një vajzë e vogël me flokët si kaçube që jeton në një amfiteatër të lashtë. Aftësia e saj dhe e miqve të saj, Bepo Fshesari dhe Gigi Turist-shoqëruesi, është që t'i mbledhin njerëzit së bashku. Gjëra të çuditshme ndodhin kur në këtë qytet, nga hiçi shfaqet shoqëria-fantazmë e "zotërinjve gri". Ata i shtyjnë vazhdimisht njerëzit të kursejnë kohë. Sa më shumë kohë të kursejnë njerëzit, aq më të ftohtë dhe aq më të huaj bëhen me njëri-tjetrin. Ata që e ndiejnë më fort këtë mungesë dashurie janë fëmijët.

Kohët e fundit po ndodhte gjithnjë e më shpesh që fëmijët sillnin me vete gjithfarëlloj lodrash, me të cilat nuk mund të luaje tamam, si për shembull, një tank me telekomandë, që s'hynte në punë për gjë tjetër veçse për ta komanduar të ecte vërdallë. Apo raketat kozmike, me të cilat s'bëje dot gjë tjetër veçse t'i vije të fluturonin rreth një boshti. Ose ndonjë robot të vogël, që me sytë e ndezur lëvizte duke u lëkundur dhe duke rrotulluar kokën, por edhe ky nuk të hynte në punë për gjë tjetër.

Sigurisht që ato ishin lodra shumë të shtrenjta që as miqtë e Momosë, le pastaj ajo vetë, nuk i kishin pasur ndonjëherë. Mbi të gjitha, këto lodra ishin të përsosura deri në detajin më të vogël, saqë nuk kishte nevojë ta zhvilloje vetë fantazinë. Kështu, fëmijët shpesh rrinin orë të tëra duke parë si të magjepsur, por të mërzitur, ndonjërën prej këtyre lodrave që vinte vërdallë me zhurmë, lëvizte duke u lëkundur apo duke fluturuar rreth e rrotull – po nuk u vinte asnjë *ide* në kokë. Ndaj fëmijët u ktheheshin përsëri lojërave të tyre të vjetra, për të cilat mjaftonin disa kuti, ndonjë copë e grisur pëlhure, ndonjë pirg

Mikel Ende

Mikel Ende (1929-1995) është një shkrimtar gjerman i shumë veprave për fëmijë. Ai është i njohur për veprat "Xhim Kopsa dhe Lukas makinisti", "Shkolla e magjisë dhe histori të tjera", "Histori pa mbarim" etj. Veprat e tij janë përkthyer në shumë gjuhë dhe janë përshtatur si filma, opera muzikore etj.

dheu apo ndonjë grusht me guralecë. Me këto mund ta fantazoje çdo gjë vetë.
Po dhe atë mbrëmje loja sikur nuk po ecte mirë. Fëmijët lanë lojën njëri pas tjetrit, derisa më në fund u mblodhën e zunë vend rreth Gigit, Bepos dhe Momosë, me shpresën se Gigi do të fillonte t'u tregonte ndonjë gjë. Çuni i vogël që kishte ardhur për herë të parë, kishte marrë me vete një radio dore. Kishte zënë vend mënjanë nga të tjerët dhe ia kishte ngritur zërin radios në qiell. Po jepej një reklamë.
– Nuk mund t'ia ulësh pak zërin asaj radios tënde?! – i tha me zë kërcënues djali i lënë pas dore, që quhej Franko.
Djali i huaj u zbeh pak në fytyrë dhe, duke e sfiduar, iu përgjigj:
– Nuk më urdhëron dot mua as ti dhe askush tjetër. Do t'ia ngre zërin radios sa të më dojë qejfi!
– Ka të drejtë, djali, – tha Bepoja i vjetër, – ne nuk mund ta ndalojmë, e shumta mund t'i lutemi.
Frankoja u ul përsëri.
– Le të shkojë në ndonjë vend tjetër, – tha ai me ashpërsi, – po na e prish të gjithëve këtë pasdite.
– Do të ketë ndonjë arsye, – iu përgjigj Bepoja, duke i hedhur djalit të huaj një shikim miqësor dhe të vëmendshëm përmes syzeve të tij të vogla. – Me siguri e ka një arsye.
Djali i huaj s'bëri zë. Pas një copë here uli zërin e radios dhe vështronte nga ana tjetër.
Momoja iu afrua dhe, e heshtur, zuri vend pranë tij. Ai e mbylli fare radion.
Një copë herë u bë qetësi.
– Gigi, do të na tregosh ndonjë gjë? – iu lut njëri prej fëmijëve të ardhur rishtazi.
– Hë, të lutemi, – thirrën të tjerët, – ndonjë histori gazmore!
– Jo, ndonjë emocionuese! – Jo, ndonjë përrallë!
– Ndonjë aventurë!
Por Gigi nuk donte. Ishte hera e parë që ndodhte kjo.
– Do të kisha më shumë qejf, – tha në fund ai, – që ju të më tregonit ndonjë gjë për veten dhe shtëpitë tuaja, çfarë bëni dhe pse keni ardhur këtu.
Fëmijët nuk bëzajtën. Papritur, fytyrat e tyre morën një shprehje të mërzitur dhe të pikëlluar.
– Tani ne kemi një makinë shumë të bukur, – u dëgjua të thoshte njëri. – Të shtunave, kur babi dhe mami kanë kohë, lajnë makinën. Po të jem sjellë mirë, më lënë t'i ndihmoj. Dua të kem edhe unë një si ajo kur të rritem.
– Kurse mua, – tha një vajzë e vogël, – tani më lënë të shkoj çdo ditë në kinema. Këtë e bëjnë që të jem e sigurt, ngaqë ata, fatkeqësisht,

Fjalor

nuk bëzajtën – nuk bënë zë, nuk thanë asnjë fjalë.
të pikëlluar – të mërzitur shumë.

nuk kanë kohë për mua. – Dhe, pas një pushimi të shkurtër, shtoi: – Po unë nuk dua të jem e sigurt, ndaj vij fshehurazi këtu dhe kursej paratë. Kur të kem kursyer mjaft para sa të blej një biletë udhëtimi, do të shkoj te shtatë xhuxhët.

– Ti je budallaqe! – thirri një fëmijë tjetër. – E ku ka xhuxhë?

– Ka, si s'ka! – tha vajza e vogël me kryeneçësi. – Madje i kam parë në një nga ato prospektet e udhëtimeve.

– Unë kam njëmbëdhjetë pllaka gramafoni me përralla, – tha një djalë i vogël, – që mund t'i dëgjoj sa herë të dua. Më parë, kur babai kthehej nga puna, gjithnjë më tregonte ndonjë gjë. Sa bukur që ishte! Por tani ai s'është më kurrë në shtëpi. Ose është i lodhur dhe nuk ka qejf të më tregojë.

– Po nëna? – e pyeti Maria.

– Edhe ajo tani është gjithnjë e ikur tërë ditën.

– Po, – ia bëri Maria, – kështu është edhe te ne. Por, për fat, kam Dedenë. – Dhe, duke i dhënë një të puthur motrës më të vogël që e kishte marrë në prehër, vazhdoi: – Kur kthehem nga shkolla, ngroh drekën në fillim e pastaj bëj detyrat e shtëpisë. Dhe pastaj... – ngriti supet dhe vazhdoi: – Po ja, vijmë kështu vërdallë, sa të erret. Në shumicën e rasteve, ja, vijmë këtu.

Të gjithë e miratuan duke tundur kokën, se pak a shumë të gjithë ishin në të njëjtën situatë.

Fjalor

prospekte – *përmbledhje shënimesh e fotografish.*
pllakë gramafoni – *fletë e hollë prej materiali të veçantë në të cilën regjistrohen këngët, muzika etj.*

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Përgjigjuni pyetjeve rreth tekstit:

a) Çfarë po bënin fëmijët e përshkruar në këtë fragment?
b) Pse në një moment ata lanë lodrat dhe u mblodhën të gjithë bashkë?
c) Çfarë i tregojnë fëmijët njëri-tjetrit? Pse janë të shqetësuar ata?

Analizojmë tekstin

2 Plotësoni tabelën që përshkruan gjendjet shpirtërore të fëmijëve.

Personazhi	Si sillet	Çfarë bën	Si flet	Si ndihet
Franko	i egërsuar	vjen vërdallë	me zë kërcënues	i lënë pas dore

Interpretojmë tekstin

3 Me çfarë po luanin fëmijët? Lodra e blerë shtrenjtë, a është e shtrenjtë (e dashur) për fëmijët? Pse?!

Studim teksti

4. Cila është arsyeja që prindërit nuk u kushtojnë fëmijëve vëmendjen e duhur? Po prindërit tuaj, a kanë kohë të lirë? Si e shpenzojnë ata kohën e tyre të lirë?
5. Komentoni fjalët e Momosë: *Mbi të gjitha këto lodra ishin të përsosura deri në detajin më të vogël, saqë nuk kishte nevojë ta zhvilloje vetë fantazinë*. Sa e rëndësishme është nxitja e fantazisë te fëmijët?

Reflektojmë rreth tekstit

6. A ju duken të sinqerta rrëfimet e fëmijëve? Pse flasin ata me njëri-tjetrin për këto gjëra dhe jo me prindërit? Po juve, a jeni ndodhur në të njëjtën situatë?
7. Pse prindërit e lënë vajzën e vogël të shkojë përditë në kinema? Po juve, a ju pëlqen të bëni çdo ditë të njëjtën gjë?

Gjuha e tekstit

8. Gjeni dallimet mes fjalëve *lodër* dhe *lojë* (send dhe veprimtari). Diskutoni se cila sjell më shumë gëzim: loja e luajtur mes shokësh me lëndë nga natyra që i bën ata aktivë apo një lodër që i kryen të gjitha vetë dhe fëmija është vetëm soditës pasiv?
9. Gjeni në tekst dhe shënoni në fletore fjalët dhe shprehjet që lidhen kryesisht me teknologjinë dhe tregojnë se kemi të bëjmë me ngjarje të vendosura në kohët e sotme.

Detyrë

- Përshkruani një fundjavë me prindërit tuaj. Si e kaloni kohën me ta? Çfarë veprimtarish bëni së bashku? Çfarë ndjesish ju jep koha që kaloni bashkë?
- Provoni të luani pa sende, për shembull, luani me mimikën tuaj para pasqyrës, këndoni një këngë vetëm me një zanore, bëni muzikë me përplasje buzësh etj. Gjithashtu provoni të krijoni lodra me sende të panevojshme, si shuka letrash a aeroplanë me palosje nga ambalazhet etj. A ju duket argëtuese?

Tregimi fantastik

Projekt në grup: Bëni një libër me tregime fantastike, të krijuara nga nxënësit e klasës suaj. Ftoni edhe nxënësit e klasave të tjera, duke përzgjedhur tregimet më të mira për librin. Kërkoni ndihmë për të botuar librin tuaj. Dhurojuni kopje të tij bashkëmoshatarëve tuaj në komunitet, shkollave të tjera fqinje apo qendrave të ndryshme për fëmijë.

Momo takon zotërinë gri

Para leximit

Në këtë pjesë letrare tregohet se si papritmas, nga hiçi, shfaqet një "zotëri gri", që e nxit Momonë të luajë me një kukull të përkryer, madje të kërkojë lodra të tjera shtesë. Ai i thotë se Momoja tani nuk ka nevojë për shokët e saj, duke nënkuptuar që miqtë mund të zëvendësohen me lojëra materiale të teknologjisë moderne. Ai ishte gri dhe i ngjallte frikën çdokujt që e kishte pranë, pasi i nxiste njerëzit që vetëm të punonin dhe të mos qëndronin me familjen dhe miqtë e tyre.

Kjo ndodhi një pasdite veçanërisht të nxehtë:
– Momoja gjeti një kukull në shkallaret e gërmadhave. Kishte ndodhur shpesh që fëmijët të harronin dhe të linin aty ndonjë nga lodrat e tyre të shtrenjta me të cilat nuk mund të luaje tamam. Po Momosë nuk i kujtohej t'ia kishte parë atë kukull ndonjërit prej fëmijëve. Momoja i nguli sytë e mahnitur. Pas pak e preku me dorë, kukulla i hapi e mbylli sytë disa herë...
– Mirëdita, unë quhem Bibigërl, kukulla e përkryer.
Momoja u tërhoq pas e tmerruar, por pastaj, pa dashje i shpëtoi:
– Mirëdita, unë quhem Momo.
Kukulla lëvizi përsëri buzët dhe tha:
– Unë të përkas ty. Të gjithë të kanë zili prej meje.
Momoja nuk dinte nga t'ia mbante. Donte ta linte kukullën e përkryer aty ku ishte dhe të luante me ndonjë gjë tjetër, po kush e di se për çfarë arsyeje nuk shkëputej dot prej saj.
Kështu, përfundimisht Momoja vazhdonte të rrinte aty duke vështruar kukullën, e cila gjithashtu ia kishte ngulur sytë e saj blu të qelqtë Momosë, sikur ta kishin hipnotizuar njëra-tjetrën. Më në fund Momoja e detyroi veten t'i shkulte sytë nga kukulla – dhe u tremb pak kur vuri re fare pranë një makinë elegante me ngjyrë gri të hirtë, që nuk e kishte dëgjuar të vinte. Në makinë ishte një zotëri i veshur me kostum gri, kapele ngjyrë gri. Edhe fytyrën e kishte si hi, ngjyrë gri. Zotëria kishte kohë që po e vëzhgonte, sepse ia bëri Momosë me kokë dhe buzëqeshi. Dhe megjithëse atë mesditë ishte aq nxehtë sa

ajri vezullonte në afshin e diellit, Momoja papritur filloj të dridhej nga i ftohti.
Ndërkaq burri hapi derën e makinës, zbriti dhe u drejtua nga Momoja. Në duar mbante një çantë ngjyrë gri plumbi.

– Kam një copë herë që të vëzhgoj, – vazhdoi zotëria gri, – dhe ti më duket se nuk di fare të luash me një kukull të tillë të mahnitshme. Të ta tregoj unë?

Ndërsa po fliste, nxirrte kukulla njëra pas tjetrës nga bagazhi makinës e dukej se ato s'kishin të mbaruar, pastaj i vendoste përreth Momosë, e cila e shihte burrin gjithnjë pa reaguar, përherë dhe më e tmerruar.
Zotëria gri i buzëqeshi Momosë gjithë shpresë, por meqenëse ajo nuk tha gjë, por iu përgjigj me seriozitet shikimit të tij, nxitoi të vazhdonte:
– Në këtë rast ti nuk ke më fare nevojë për miqtë e tu e kuptove? Se tani, po të kesh gjithë këto gjëra të bukura dhe po të marrësh edhe më shumë, ke me çfarë të zbavitesh, apo jo dhe ti i do këto. E do këtë kukullën e mahnitshme? E do patjetër, kështu?
... Momoja tundi kokën
– Çfarë, çfarë? – ia bëri zotëria gri duke ngritur vetullat lart. – Ende nuk je e kënaqur. Ju fëmijët e sotëm jeni me të vërtetë me pretendime! A mund të më thuash çfarë i mungon asaj kukulle të përkryer?
Momoja vështroi duke u menduar:
– Besoj, – tha ajo me zë të ulët, – nuk arrin ta kesh shumë xhan.
Zotëria gri nuk reagoi një copë herë dhe ia nguli vështrimin e tij të qelqtë si të kukullës derisa më në fund e mblodhi veten.
– As që bëhet fare fjalë për këtë, – ia bëri ai fare ftohtë.
Momoja e pa në sy, të kallte datën, sidomos ftohtësia që kishte shikimi i tij. Çuditërisht i vinte edhe keq për të, pa e ditur edhe vetë pse.
– Kurse miqtë e mi i kam xhan, – tha ajo. – I kam xhan.
Zotëria gri shtrembëroi fytyrën sikur papritmas t'i dhembte ndonjë dhëmb, por e përmbajti menjëherë veten dhe buzëqeshi pak.

* * *

– Po ty të ka xhan njeri? – e pyeti duke pëshpëritur.
Zotëria gri u kërrus dhe papritur sikur hyri në ujë. Zotëria gri kërceu në këmbë, vështroi rreth e rrotull sikur ta ndiqnin nga pas, rrëmbeu çantën e përhimtë dhe u vërsul drejt makinës. Në atë çast ndodhi diçka shumë e çuditshme: si në një shpërthim me veprim të anasjelltë, të gjitha kukullat dhe të gjitha gjërat e tjera të shpërndara përreth fluturuan mbrapsht nga të gjitha anët në bagazhin e makinës që u mbyll me zhurmë. Pastaj makina u largua me nxitim.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Përgjigjuni pyetjeve rreth tekstit:

a)	Çfarë gjen Momo në shkallaret e gërmadhave?	
b)	Kush vjen ta takojë Momonë atë pasdite të nxehtë?	
c)	Çfarë i ofron ai? Nga çfarë i kërkon Momosë që të heqë dorë?	

Analizojmë tekstin

2 Përshkruani si e imagjinoni ju njeriun gri, me rroba gri.

3 Duke u nisur nga fragmenti, shpjegoni pse "njeriu gri" largohet menjëherë kur Momoja e pyet nëse e do ndokush? A duhet pasur frikë nga dashuria?

4 A janë fjalët e fundit që i thotë Momoja "zotërisë gri" mesazhi i pjesës?

Reflektojmë rreth tekstit

5 A mund të zëvendësohet koha që kalojmë me shokët dhe miqtë me ndonjë gjë tjetër?

6 Si mendoni ju, a shprehet gjithmonë dashuria nëpërmjet dhuratave të shtrenjta?

Gjuha e tekstit

7 Shpjegoni kuptimin e shprehjeve të figurshme të mëposhtme.

- e detyroi veten t'i shkulte sytë nga kukulla _____
- e mblodhi veten _____
- të kallte datën _____

8 Cilat nga elementet e tregimit fantastik shfaqen në tekst? Gjejini dhe shënojini ato në tabelë.

Elemente magjike	Elemente të mrekullisë	Dukuri të mbinatyrshme
		Është ditë e nxehtë, por kur vijnë ata bëhet ftohtë.

9 Nënvizoni në tekst fjalën gri (dhe fjalë të tjera që e përcaktojnë këtë ngjyrë, si e përhimët etj.). Tregoni për ç'efekt e ka dhënë autori.

10 Gjeni në tekst elementet e letërsisë fantastike: personazhet reale dhe imagjinare, ngjarjet reale apo të fantazuara, vendet reale apo misterioze.

Detyrë

- Shkruani një mbyllje tjetër për këtë pjesë letrare.

STINËT NË PLANETIN E KUQ

Para leximit

Kjo pjesë është shkëputur nga romani "Presidenti i planetit të Kuq", që është një vepër letrare fantastike. Ngjarjet zhvillohen në planetin Mars, ku asgjë nuk ndodh siç jemi mësuar ne në planetin tonë. Në këtë planet mjafton të bësh kërkesë që të ndryshojë moti apo stina dhe dëshira jote mund të bëhet realitet. Veçanërisht fëmijët, që njihen për dëshirat e tyre të shpeshta për t'u larë në det në mes të dimrit dhe për të bërë ski në mes të verës, bënin kërkesa që brenda ditës t'i ndryshonin stinët, gjë e cila krijoi probleme të mëdha.

Bedri Dedja

Bedri Dedja (1930-2004) ka qenë një akademik dhe profesor i njohur në fushën e pedagogjisë dhe të psikologjisë. Ai është i njohur për krijimtarinë letrare për fëmijë: poet e prozator, përrallëtar e dramaturg. Ndër librat për fëmijë që ai ka shkruar, përmendim: "Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit", "Një udhëtim i rrezikshëm", "Qyteti me tri kështjella", "Presidenti i Planetit të Kuq", vëllime me "Përralla njëmbëdhjetëkatëshe", "Përralla të zgjedhura". Ka fituar çmime letrare, si: Çmimi i Republikës, Urdhri Naim Frashëri dhe mban titullin "Mjeshtër i Madh".

Në mëngjes, në kryeqytet zbardhte një agim artificial. Në lindje niste të ngrihej dalëngadalë një diell elektrik, gjithashtu artificial, i cili edhe ndriçonte, edhe të ngrohte me rrezet e tij. Dita dhe nata, të ftohtit dhe të ngrohtit, moti i mirë dhe moti i vrenjtur, shiu dhe bora, flladi dhe era në kryeqytetin dhe në gjithë krahinat e nëndheshme të Planetit të Kuq, ashtu si edhe stinët, drejtoheshin me susta dhe me marshe nga Qendra Planetare e Motit, ku punonin tre robotë, që merrnin urdhra nga Presidenca.

Ta zëmë se marsianëve të vegjël, në mes të verës së nxehtë u tekej për të rrëshqitur me patina në akull. Presidenti i vogël i kalamajve i telefononte Presidentit të madh dhe i shprehte dëshirën e shokëve të tij. Ky, po nuk ua bënte dysh fjalën të vegjëlve. U jepte udhëzime robotëve në kokat e tyre elektronike, me anë të mesazhit që transmetonte nga kozmocelulari i Presidencës në Qendrën Planetare të Motit.

Në çast ndodhte çudia.

Dielli elektrik artificial zhdukej. Qielli vranësohej. Fushat e blerta ktheheshin në fusha të akullta. Frutat e pemëve, mollë, dardhë, qershi, ftonj, mana toke fluturonin në fabrikat e reçelrave, gjethet në fabrikat e plehut bimor dhe drurët zhvisheshin sa hap e mbyll sytë. Kalamajtë me patina, me qindra e me mijëra derdheshin në fushat e akullta.

Si mbaronte kjo histori dhe ata ngopeshin duke rrëshqitur, kërkonin vapë korriku që të laheshin në liqen, pasi ishin të djersitur nga rrëshqitja në akull. Kjo punë kishte vazhduar për një kohë të gjatë. Marsianët e vegjël kishin nisur të llastoheshin. Ca thërrisnin: "Sot duam pranverë, që të mbledhim lule për festën e mësuesve!", ca të tjerë thërrisnin: "Duam vjeshtë, që të vjelim rrush, se na ka marrë uria për rrush!"

Kalamajtë, si kalamaj që janë, filluan ta teprojnë. Kokat elektronike të robotëve të Qendrës Planetare të Motit kishin nisur të digjeshin nga stërmundimi dhe puna e lodhshme, për të plotësuar tekat e kapriçozëve të vegjël. Sikur ta them me ca fjalë popullore, kosi në planetin Mars kishte nisur të thartohej…

Presidenti dha urdhër që të mblidhej të nesërmen Asambleja e Madhe e planetit Mars për t'u vendosur njëherë e përgjithmonë radha e ndërrimit të stinëve.

* * *

Sapo Presidenti hapi sytë pas gjumit, përballë krevatit të tij u ndez një tabelë e madhe elektronike, si ato të stadiumeve të mëdha, që tregojnë rezultatet e ndeshjeve të futbollit. Në tabelën e Presidentit tregohej plani i punës për atë ditë, që, ai, si plak që ishte, të mos harronte dhe të organizohej që në mëngjes për ato që duhej të bënte. Në tabelë kishte aq shumë pika, sa mund të dyshoje nëse arrinte të merrte frymë ky njeri, apo jo?! A kishte kohë të pushonte gjatë ditës sa për të ngrënë një sanduiç apo për të pirë një kafe?!

Dy pikat e para të planit në tabelën e asaj dite ishin:

1. Mbledhja e Asamblesë së kalamajve për të vendosur radhën e stinëve.

Presidenti duhej të përgatiste një fjalim me titull: "Tekat e fëmijëve, sëmundje ngjitëse e rrezikshme për planetët e sistemit diellor."

2. Takimi i Presidentit me kalamajtë e Tokës, të ardhur në Mars me autobus kozmik…

Filloi dita artificiale në kryeqytet. Pastaj nisi Asambleja e kalamajve nën drejtimin e Presidentit. U mbajtën njëqind e dy fjalime. Në fund u votua rezoluta për tekat e kalamajve. Me pesëqind vota pro, tekat u dënuan rëndë dhe u vendos që të futeshin në një thes. Pastaj, thesi i mbyllur mirë, të hidhej me një sondë kozmike në planetin e fundit të sistemit diellor, në akullin e Plutonit. Dyzet kalamaj, tekanjozët më të tërbuar të Galaktikës, që donin çdo ditë të kishte katër stinë, votuan kundër. Sipas mendimit të kalamajve të Tokës, këta s'mund t'i quaje vetëm tekanjozë, por stërtekanjozë, mbasi donin që gjithë ditën të hanin vetëm çokollata, të pinin lëng frutash, të rrëshqisnin në akull, të loznin futboll e tenis, të shikonin nga katër a pesë orë në ditë filma me kafshë të mbinatyrshme e të frikshme, të vizatuara ose prej kartoni, dhe të mos hapnin asnjë libër, as në shkollë e as në shtëpi. Asambleja e kalamajve vendosi në fillim, që dyzet stërtekanjozët të mos thërriteshin për disa kohë me emrat e tyre të vërtetë. Ata duhej të niseshin, së bashku me ekspeditën e parë të kalamajve

Fjalor

fllad – erë e lehtë.
marsh – këtu: mekanizmi i ndërrimit të shpejtësisë.
rezolutë – vendim me shkrim që merret në fund të mbledhjes.
sondë – pajisje e posaçme që lëshohet në ajër për distanca shumë të largëta.
ekspeditë – udhëtim i një grupi njerëzish në një vend për një qëllim a për një detyrë të caktuar.

marsianë, për në Jupiter. Kështu, do të kishin mundësi t'i harronin pak e nga pak tekat e tyre, duke menduar se si të zbulonin të fshehtat dhe mrekullitë e planetit gjigant.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1. Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve:
   - a) Si është dielli në Planetin e Kuq?
   - b) Kush i drejtonte stinët, ditën dhe natën, të ftohtët dhe të ngrohtët, shiun dhe borën?
   - c) Në ç'mënyrë drejtoheshin?
   - ç) Kush i jepte urdhrat në këtë planet? Sa presidentë kishte në Planetin e Kuq?
   - d) Cilat ishin kërkesat e marsianëve të vegjël? A realizoheshin ato?
   - dh) A kishte shumë punë Presidenti ditën që do të vendosej radha e ndërrimit të stinëve?
   - e) Çfarë vendimi mori Asambleja për tekanjozët?

Analizojmë tekstin

2. Pse mbledhja për të vendosur radhën e stinëve, ishte numri një në planin e punës së Presidentit?
3. Çfarë do t'u ndodhte tekave pas miratimit të rezolutës? A mund ta realizojmë këtë në jetën e përditshme?
4. Përshkruani me fjalët tuaja si i mendoni ju tekanjozët e Planetit të Kuq.

Interpretojmë tekstin

5. Interpretoni fjalët e tekstit: *Kalamajtë si kalamaj që janë, filluan ta teprojnë.*
6. Si ju duken kërkesat e 40 fëmijëve tekanjozë? A keni ju ndonjë shok të tillë?

Reflektojmë rreth tekstit

7. A do të donit të jetonit në një planet ku të ishit ju ai që vendoste, pa marrë parasysh mendimin e të tjerëve, për të ndryshuar stinën?
8. Në rast se do të ishit për një vizitë në planetin e kësaj pjese, cila është dëshira që do të donit t'ju realizohej? Pse?

Gjuha e tekstit

9. Zbërtheni kuptimin e shprehjeve të mëposhtme.
   - Kosi në planetin Mars kishte nisur të thartohej
   - Nuk ua bënte dysh fjalën të vegjëlve

Detyrë

- Ndahuni në grupe dhe realizoni një punim në të cilin të paraqitni situata të ndryshme (me shkrim ose me vizatime apo fotografi) që përcjellin mesazhin: "Tekat duhet t'i shmangim, sepse krijojnë shumë probleme për të gjithë". Paraqiteni atë në klasë.

Shelgu goditës

Para leximit

"Shelgu goditës" është pjesë e shkëputur nga romani "Harri Poteri dhe dhoma e të fshehtave". Në ditëlindjen e njëmbëdhjetë djalit me aftësi të jashtëzakonshme dhe me shenjën e vetëtimës në ballë, iu bënë të ditura aftësitë e tij magjike dhe origjina nga prindër magjistarë. Më pas ai ndoqi shkollën e Hoguortsit, ku mësonin fëmijët magjistarë nga e gjithë bota. Në këtë fragment tregohet për udhëtimin e çuditshëm që bën bashkë me shokun e tij Ronin, për t'u kthyer në shkollë pas pushimeve verore.

– Shiko mos po na sheh ndokush, – tha Roni, duke ndezur motorin me një lëvizje tjetër të shkopit magjik. Harri nxori kokën nga dritareza. Në rrugën kryesore kishte trafik të dendur, por rruga ku ndodheshin ata ishte e shkretë.
– Jepi! – i tha.
– Po nisemi! – tha Roni dhe shkeli një sustë të argjendtë. Makina u bë e padukshme, po ashtu edhe ata vetë. Harri ndiente ndenjësen që dridhej, ndiente motorin, ndiente duart e mbështetura përmbi gjunjë dhe syzet përmbi hundë, por ai ishte shndërruar vetëm në një palë sy që po lundronin pak metra sipër kokës, në një rrugë të shpëlarë, plot me makina të parkuara anash nga e djathta e tij.
Toka dhe ndërtesat e nxira në të dyja anët po largoheshin, ndërsa makina ngrihej lart; pas pak sekondash tërë Londra po ndehej poshtë tyre, plot mjegull dhe drita. Pastaj u dëgjua një përplasje dhe Harri me Ronin u bënë përsëri të dukshëm.
– Dreq! – thirri Roni, duke i dhënë ca goditje Turbinës së Padukshme.
– Nuk punon...
Nisën ta goditnin të dy bashkë me grushte. Makina u zhduk. Pastaj u bë përsëri e dukshme.
– Mbahu fort! – thirri Roni dhe shkeli pedalin e gazit; u futën me vërtik mes reve të ulëta dhe të dendura si shtëllunga leshi dhe gjithçka u bë e murrme dhe si e veshur.
– Po tashti? – pyeti Harri, duke picërruar sytë. Mes atij grumbulli resh të ngjeshura që po i mbështilleshin nga të katra anët.
– Duhet të gjejmë trenin, që të marrim vesh në ç'drejtim duhet të shkojmë, – tha Roni.
– Shpejt, lëshohu poshtë...
Zbritëm përsëri nën retë dhe vështruam përqark, duke vëzhguar tërë tokën.
– Ja ku është! – thirri Harri. – Aty përpara, djathtas!
Ekspresi i Hoguortsit po shkiste nën të si një gjarpër flakë i kuq.

J. K. Rouling

J. K. Rouling (1965) është një shkrimtare angleze bashkëkohore, e cila u bë e njohur pas librit të saj "Harri Poter dhe guri filozofal", i cili ishte edhe libri i parë i serisë së librave që kanë në qendër personazhin e Harri Poterit. Seria e librave për Harri Poterin është përkthyer në shumë gjuhë të botës dhe mbi këta libra janë bazuar edhe shumë filma.

– Drejt veriut,– tha Roni, duke i hedhur një sy busullës së makinës.

* * *

U dëgjua një zhaurimë hekurishtesh, pastaj një krismë dhe motori u fik krejt.

– Mos! – thirri Roni kur ra heshtja.

Makina nisi të zbriste me shpejtësi me turi poshtë. Ishin duke rënë gjithnjë e më shpejt, drejt e fill mbi murin e madh e të trashë të kështjellës.

– Mooooos! – bërtiti Roni duke kthyer timonin me sa fuqi që pat. Për një qime iu shmangën murit me gur të zinj dhe makina përshkoi një hark të gjerë, duke u vërtitur sipër serrave, pastaj sipër kopshtit të punuar dhe pastaj edhe më tej, mbi livadhet e errëta, gjithnjë duke zbritur.

– NDALU! NDALU! – thirri duke goditur kroskotin dhe xhamin e përparmë, por rënia

kryengulthi nuk u ndal dhe toka poshtë po afrohej me vërtik.

– KUJDES ATË PEMË! – thirri Harri, duke u përpjekur të kapte timonin, por qe shumë vonë...

BUM!

Me një rrapëllimë shurdhuese hekurishtesh që përplaseshin mbi dru, makina goditi trungun e trashë dhe ata të dy u flakën jashtë saj. Nga motori i palosur vijonin të dilnin fjolla avulli; Hedvigu çirrej nga llahtari; aty ku Harri kishte përplasur kokën, qe bërë një bërdungull e madhe sa një top tenisi dhe, djathtas tij, Roni nxori një rënkim të mbytur dhe të përvajshëm.

– A je mirë? – e pyeti Harri.

– Shkopi im magjik! – tha Roni me zë të dredhur. – Shih si është bërë shkopi im magjik!

Shkopi ishte ndarë më dysh: maja varej e pajetë dhe lidhej me pjesën tjetër vetëm nga një cifël druri.

Harri hapi gojën për të thënë se në shkollë dikush do t'ia ndreqte doemos, por s'nxori dot asnjë fjalë. Pikërisht atë çast, nga ana ku ishte ai, makinën e goditi diçka me aq forcë, sa ç'mund të bënte një dem i tërbuar dhe ai ra përmbi Ronin, ndërsa një goditje e dytë, po aq e fortë, bëri të dridhej çatia e makinës.

– Ç'po bën vaki?

Roni u hodh përpjetë duke parë matanë xhamit të përparmë dhe Harri sapo u kthye, pa një degë të trashë sa një piton, që po binte mbi makinë. Pema mbas të cilës qenë përplasur, kishte nisur sulmin. E kishte përthyer trungun më dysh dhe degët e saj nejçe po qëllonin ku të mundnin çdo pëllëmbë të makinës.

– Ooooh! – thirri Roni, ndërsa një degë tjetër e përdredhur goditi sportelin e makinës; tashti xhami i përparmë po shkundej e përshkundej nga goditjet e njëpasnjëshme dhe një degë ë dytë e trashë sa një dash po godiste vazhdimisht mbi çatinë e makinës, sa dukej se do të çahej.

– Mbathja! – thirri Roni, duke peshuar me tërë trupin në derën e anës së tij; por aty për aty një "grusht" i fuqishëm i një dege tjetër e flaku ndër krahët e Harrit.

– Mbaruam! – rënkoi, teksa po shembej çatia e makinës; por befas makina nisi të dridhej: motori ishte ndezur përsëri.

– *Fut marshin mbrapa!* – thirri Harri dhe makina bëri mbrapsht si shigjetë. Pema po gatitej të godiste përsëri; dëgjoheshin rrënjët e saj që kërkëllinin sikur të donin të shkuleshin nga dheu dhe vazhdonte të qëllonte, ndërsa dy djemtë përpiqeshin t'i përvidheshin.

– Për një grimë! – tha Roni duke dihatur. – Të lumtë, makinë e dashur!

Por makina nuk mbante më. Dyert u shpërthyen njëherazi dhe Harri ndjeu se ndenjësja e tij u shty përpjetë. Pastaj nuk mori vesh më gjë, derisa e pa veten të shtrirë në tokën e lagësht. Disa zhurma të mbytura i dhanë të kuptonte se makina sikur po "i pështynte" sendet e tyre nga e ndara e plaçkave; kafazi i Hedvigut fluturoi në hava dhe

Fjalor

ekspres (tren) – që ecën shpejt e nuk ndalon në shumë stacione.
bërdungull – gungë, xhungë e madhe.
kërkëllinin – lëshonin një zhurmë si kërcitje.
nejçe – me shumë nyje.

u bë copash: shpendi doli duke nxjerrë një piskamë, fort i zemëruar, dhe fluturoi drejt kështjellës pa kthyer kokën. Pastaj tërë gunga, e rrjepur dhe duke nxjerrë tym, makina, mes gumëzhimave, u krodh në errësirë me dritat e pasme që vetëtinin tërë inat.

– Kthehu mbrapsht! – thirri Roni, duke shkundur shkopin e tij të këputur. – Do të më mbysë babai!

Por ajo u zhduk duke nxjerrë me zhurmë një shtëllungë tjetër tymi nga skapamentoja.

– Patëm goxha fat, s'ke ç'i thua! – tha Roni tërë trishtim, duke u zgjatur që të merrte Koren, miun e tij të përhimët. – Nga të gjitha pemët ku mund të përplaseshim, na qëlloi pikërisht ajo që ta këput me dacka!

U kthye për të parë pemën nejçe që po shkundte ende degët e saj gjithë kërcënim.

– Eja, është më mirë sikur të shkojmë në shkollë... – tha Harri me një zë të lodhur.

Fjalor

skapamento – pjesë makine, prej së cilës dalin gazrat që çlirohen nga djegia e karburantit.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Përgjigjuni pyetjeve rreth tekstit:

a) Cilët janë personazhet e kësaj pjese? Çfarë duan të bëjnë ata?
b) Mbi cilin qytet fluturuan personazhet e kësaj pjese? Në çfarë mënyre fluturuan?
c) Në ç'mënyrë e ndezën makinën?
ç) Si e gjetën rrugën për në Shkollën e Magjisë në Hoguorts?
d) Me çfarë përplaset makina? Çfarë dëmesh pësuan djemtë? Po makina?

Analizojmë tekstin

2 A e humbet ndjeshmërinë Harri kur bëhet i padukshëm? Përshkruani me fjalët e tekstit çfarë ndodh në ato momente.

3 Cilat janë karakteristikat dalluese të makinës me të cilën udhëtojnë Harri dhe Roni?

1.
2.
3.
4.

Studim teksti

4 Duke u nisur nga fragmenti, cilat janë elementet që e bëjnë fantastike këtë vepër letrare?

Personazhet ndërmarrin udhëtime të rrezikshme .	Po.
Personazheve u duhet të kapërcejnë pengesa të shumta, të jashtëzakonshme.	
Personazhet përballen me rreziqe të mëdha për jetën.	
Personazhet luftojnë me forca të panjohura, përtej përmasave dhe moshës së tyre, si: magjistarë, forca të mbinatyrshme etj.	
Konflikti merr përmasat e një përballjeje mes së mirës dhe së keqes.	

5 A janë reale ngjarjet që zhvillohen në tekst? Po makina, është si makinat që shihni në rrugë?

Të interpretojmë tekstin

6 Në këtë tekst makinat fluturojnë, njerëzit bëhen të padukshëm, pemët sulmojnë njerëzit, kafshët mërziten. A ka ndonjë gjë të pamundur në veprat fantastike?

7 A ishte e mjaftueshme magjia për t'i zgjidhur gjërat e për të dalë nga situata?

8 A duhet që edhe në botën magjike personazhi kryesor të karakterizohet nga disa tipare të veçanta? Cilat mund të jenë ato?

Reflektojmë rreth tekstit

9 Çfarë përjetuat gjatë leximit të këtij teksti? Cila ishte pjesa më tërheqëse për ju?

10 Si e parafytyroni shkollën e magjisë? A bëhen edhe atje detyrat apo testet me magji? Për çfarë mund të vlerësohen nxënësit në këtë shkollë?

Gjuha e tekstit

11 Gjeni në tekst foljet që janë karakteristike vetëm për veprimet e njerëzve, por që përdoren edhe për pemët, kafshët, sendet etj.

Makina	Pema	Hedvigu
Pështyn		

12 Autori përdor një gjuhë të pasur e të figurshme për të shtuar përjetimin emocional të ngjarjes. Shënoni dhe shpjegoni shprehje të tilla, si:

- toka dhe ndërtesat e nxira në të dyja anët po largoheshin _____
- një palë sy që po lundronin pak metra sipër kokës _____
- e tërë Londra po ndehej poshtë tyre _____
- makina sikur po i pështynte sendet e tyre nga e ndara e plaçkave _____

Bashkëbisedojmë

- Diskutoni rreth ngjashmërisë së romaneve që përshkruajnë aventurat e Harri Poterit me filmat e realizuar duke u bazuar në ta. Cilët parapëlqeni prej tyre: librat apo filmat? Pse?

Vargje kushtuar gjuhës shqipe

Para leximit

Në letërsinë shqipe ka shumë poezi kushtuar gjuhës shqipe, bukurisë dhe vlerave të saj. Vargjet e mëposhtme janë shkëputur nga poezi të zgjedhura, të poetëve më të njohur shqiptarë, të cilat kanë të njëjtin motiv: dashurinë për gjuhën amtare. Gjuha është frymë dhe ndërgjegje kombëtare, është informacioni më i rëndësishëm shpirtëror i mbërritur prej të parëve, është shenja e parë e identitetit të të qenit shqiptar.

Korça

Gjuha jonë sa e mirë!
Sa e ëmbël, sa e gjerë!
Sa e lehtë, sa e lirë!
Sa e bukur, sa e vlerë!
Kjo 'shtë mëm' e mirësisë,
Që bije qytetërinë,
Gasthin e vëllazërisë,
Njerëzin' e miqësinë.

Naim Frashëri

Fjalor

gasthin – gazin, humorin.

Apostrofi

Apostrofi është ndërhyrja emocionuese me anën e së cilës thërresim pranë gjërat e largëta ose të afërta, të gjalla a të vdekura, që t'i bëjmë të pranishme, konkrete dhe që të ndikojnë kështu në ndjenjat e emocionet e të tjerëve.
Shembuj: *Lamtumirë, o mori Shkodër!/ Lamtumirë, o ti Cukal*
O malet e Shqipërisë dhe ju, o lisat e gjatë

Gjuha shqipe

Përmbi za që lshon bylbyli,
gjuha shqipe m'shungullon
përmbi er' që jep zymbyli,
pa da zemrën ma ngushllon.

Ndre Mjeda

Fjalor

shungullon – dridhet me zhurmë të madhe, ushton thellë, gjëmon.



Gjuha shqipe

Të falem ty, O gjuhë shkrepëtim,
që shkrep në qiej e vrungullon,
me bujë pyjesh bubullon
me gjëmë detesh uturon,
dhe je, siç ishe:
...vetëtim.

Mitrush Kuteli

Fjalor

vrungullon – buçet, shungullon.

Gjuha e zjarrtë

O gjuhë-e shenjtëruar, o mall me shpirt plot.
O vetëtim' e qiellit që fërfëllon me flakë,
O djellë-i llaftaruar që ndrin si pikë lot...
Si pikë lot e ndritur po ndrij në rreze t'uaj,
Po ndrij e papandehur po qaj pak e nga pakë
Sepse prej botës s'uaj kam mbetur kaq i huaj...

Lasgush Poradeci

Gjuha shqype

Porsi kanga e zogut t'verës,
qi vallzon n'blerim të prillit;
porsi i ambli flladi i erës,
qi lmon gjit e drandofillit;
porsi vala e bregut t'detit,
porsi gjâma e rrfès zhgjetare,
porsi ushtima e nji tërmetit,
ngjashtu â' gjuha e jonë shqyptare.

Gjergj Fishta

Fjalor

hordhi – fise endacake mongole ose osmane që shkatërronin.
dëlir – dalldi, shastisje, kllapi.
jerm – kllapi, përçartje.
martire – këtu: është përndjekur, goditur, dhunuar.
lehonë – një grua që sapo ka lindur fëmijë.

Gjuha shqipe

Kur në sulm hodhën turqit
Hordhitë e pambaruara,
Kështjellat e sintaksës
S'i muar, që s'i muar.

Në përçartje ta kthenin
Në dëlir në jerm,
Ishin vite të rënda,
Ishin shekuj plot helm.

Kjo gjuhë martire,
Lehonë e përjetshme,
Që lindi mes dhembjesh,
Art i të pavdekshmëve.

Ismail Kadare

Studim teksti

Kuptojmë vargjet kushtuar gjuhës

1. Gjuha është një nga elementet kryesore dalluese të një kombi. Përmendni elemente të tjera dalluese.
2. Cilën kohë të historisë ka dalluar Kadare si më shumë të rrezikshme për zhdukjen e gjuhës shqipe?
3. Si ka arritur të mbijetojë gjuha shqipe ndër shekuj?

Studim teksti

4 Cili është qëllimi i këtyre poezive?

a) T'i thurin himn gjuhës shqipe. b) _____

c) _____ ç) _____

5 Cili nga poetët e mësipërm është shkrimtar i bashkëkohësisë (që jeton në kohën tonë)?

Analizojmë vargjet kushtuar gjuhës

6 Si e sjell qytetërimin gjuha shqipe? Në ç'mënyrë?

7 Gjuha është pjesë e identitetit të njeriut. Si e ruan ajo lidhjen me të kaluarën dhe si e krijon atë me të ardhmen?

8 Në poezinë e Kadaresë thuhet: *Që lindi mes dhembjesh/Art i të pavdekshmeve.*

Ku qëndrojnë aftësitë e gjuhës për të krijuar art të pavdekshëm? Ç'lidhje ka gjuha dhe arti?

Interpretojmë vargjet kushtuar gjuhës

9 Gjatë leximit me zë të lartë përqendrohuni në zbulimin e ndjesive që ju përcjellin këto vargje. Diskutoni me njëri-tjetrin.

10 Interpretoni vargun e Poradecit: *O vetëtim' e qiellit që fërfëllon me flakë.* Pse poeti shprehet që gjuha shqipe ka forcën e një vetëtime?

Gjuha e vargjeve kushtuar gjuhës

11 Poetët kanë përdorur në një sërë figurash letrare. Gjejini ato dhe shënojini në tabelë.

Figura letrare	Shembuj
Krahasime	
Metafora	
Apostrofë	

12 Gjeni dhjetë epitete të përdorura për të karakterizuar gjuhën shqipe.

13 Zbërtheni kuptimin e figurshëm në togfjalëshat e mëposhtëm.

- Gjuhë shkrepëtim _____
- gjuhë-e shenjtëruar_____
- vetëtim' e qiellit_____
- Gjuhë martire_____
- Lehonë e përjetshme_____

Reflektojmë rreth vargjeve kushtuar gjuhës

14 Të gjitha gjuhët pasurohen me fjalë të reja që nuk kanë ekzistuar më parë. Ndodh që pavarësisht se gjuha i ka fjalët e saj, në të ndërfuten edhe fjalë të huaja, të panevojshme. Diskutoni në klasë rreth dëmit që i shkaktojnë fjalët e huaja gjuhës sonë dhe rreth mënyrave se si mund t'i shmangim ato, duke sjellë shembuj dhe raste të ndryshme.

Detyrë

- Lexojini disa herë vargjet e mësipërme dhe më pas recitojini me zë të lartë. Kujdesuni të përdorni intonacion shprehës.

Lulëkuqja

Para leximit

Në poezinë "Lulëkuqja", Asdreni ka përshkruar në mënyrë simbolike atdheun tonë. Në lulëkuqen e bukur, por për të cilën askush nuk kujdeset, poeti sheh fatin e vendit të tij. Ashtu si lulëkuqja, vendi i tij është shumë i bukur, por është nëpërkëmbur vazhdimisht. Nëpërmjet poetizimit të fatit të vendit të tij, Asdreni ka krijuar një poezi e cila mbetet gjithmonë bashkëkohore.

Lulëkuqja e mjera
Asgjëkundi s'ka shtëpi,
E shkon jetën n'arrati,
Ajo s'është si të tjera
S'ka stoli!

Fushës, kodrës, del vetiu
Verës ngrohet, dimrit ngrin
Vetë shkundet, vetë mbin
Dhe, kur skuqet, vjen veriu
dhe e përfshin.

Nëpër këmbë gjith' e shkelin,
Vend në kopshtet ajo s'ka
Dorë ndihme kurrë s'pa;
As e mbjellin, as e vjelin
shkoi u tha…

Po veç ngjyra e saj si zjarri,
Si një yll që xixëllon
Tërë bota e imiton
Është shenjë për së mbari
nga shikon.

Ajo ngjyrë kur zë shfaqet
Mbreti frone shkon e le
Njerëz robër fare s'sheh
Vjen e drejta del në faqet,
si Zot je.

Ajo ngjyrë në ato fletë
Është shpresa që tregon
Një të ardhme q'ëndërron
Është flamuri ynë vetë
që valon!

Fjalor

del vetiu – këtu: mbin vetë.
vetë shkundet – i bien vetë fletëzat.
e drejta del në faqet – e drejta del në shesh.
valon – valëvitet.

Aleksandër Stavre Drenova

Aleksandër Stavre Drenova (1872-1947) është i njohur në letërsinë shqipe me pseudonimin Asdreni. Ai është personalitet shumë i njohur i Rilindjes Kombëtare, në të cilën u dallua jo vetëm për veprimtarinë e tij si atdhetar i zjarrtë për çlirimin dhe bashkimin e Shqipërisë, por edhe si poet i madh. Në krijimet e tij, poeti demaskoi ashpër pushtuesit e huaj, i këndoi heroizmit të popullit në kryengritjet e armatosura ndaj tyre, fshikulloi parinë frikacake dhe oportuniste, e cila nuk bëri detyrën ndaj atdheut. Disa nga veprat e Asdrenit janë: "Rreze dielli", "Himni i flamurit", "Ëndrra e lotë", "Burri i dheut" etj.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Lexoni vargjet dhe përgjigjuni pyetjeve:

a) Kujt i kushtohet kjo poezi e Asdrenit?
b) Si ndihet poeti kur flet për "fatin e lulëkuqes"?
c) Çfarë simbolizon ngjyra e lulëkuqes?

Analizojmë poezinë

2 Ritmi i shqiptimit poetik në këtë poezi është ngritës. Në fillim poeti vetëm ankohet, më pas kjo gjendje ndryshon. Çfarë shprehet në tri strofat e fundit?
Shënoni me ✓ alternativat e sakta.

- ☐ Revolta.
- ☐ Krenaria.
- ☐ Turpi.
- ☐ Besimi.
- ☐ Shpresa.
- ☐ Mosbesimi.

Interpretojmë poezinë

3 Gjeni elementet e ngjashmërisë në paralelizmin që krijon autori mes lulëkuqes dhe atdheut.

Gjuha e poezisë

4 Cila është figura letrare në bazë të së cilës është ndërtuar e tërë poezia?

5 Gjeni figurat letrare në këtë poezi.

Metaforë	
Krahasim	
Epitet	
Antitezë	

6 Nënvizoni foljet në formën mohore që tregojnë imazhin e nëpërkëmbur dhe rrethanat e këqija në të cilat rritet lulëkuqja.

Reflektojmë rreth poezisë

7 Zbuloni idetë dhe mesazhin që përcjell kjo poezi.

Detyrë

- Përshkruani imazhin e një lulëkuqeje që kur fryn erë ngjan me një flamur.

Prandvera

Para leximit

"Prandvera" është një nga poezitë e poetit Ndre Mjeda. Ai përshkruan ardhjen e pranverës dhe ndryshimet e mëdha që ndodhin në natyrë. Ndryshimet vihen re në fillim tek ardhja e shpendëve, te sythat e çelur nëpër pemë, te lulet që çelin, por edhe te njerëzit që shfaqin më shumë gjallëri dhe dëshirë për të punuar tokën. Plogështia nuk është e pëlqyeshme as për kafshët, jo më për njerëzit.

Jeni lodhe, dallëndysha t'shkreta,
Je molis' i ziu bylbyl;
Ah! pushoni n'streh' ku u gjeta,
Pusho n'kopshte te njaj' zymyl.

Mbi krahë t'uej prej dhenash tjera
Ju prendverën na pruet këtej;
Shlodhn' ju pra, dallëndysha t'mjera,
Rri, bylbyl, n'lulzim qi kthej.

Se qe'j prrue prei malit ulet
E t'tanë fushës ushqim i nep;
E nën borë po shpërthejn' lulet
Porsi fëmi qe zblohen n'djep.

Fllad i let me vapë dashtnijet
Puthi pemën gemb për gemb;
U zgjue pema, e qe prei shijet
Buloj mbarë nëpër kopshte tem.

Ndej' bri votrës nieri myket:
Vrapo, bulk, ku puna t'thrret;
Tui vrue fushën kau bërlyket,
Lyp'm'u vue për lavër t'vet.



Ndre Mjeda

Ndre Mjeda është poet i shquar, veprimtar dhe patriot. Lindi në Shkodër në vitin 1866. Ai punoi si famullitar i thjeshtë në fshatin e vogël Kukël, ndërsa në vitet e fundit të jetës së tij punoi si mësues i shqipes në gjimnazin e Shkodrës. Gjatë gjithë jetës së tij, ai punoi me një dashuri të veçantë për gjuhën e për kulturën shqiptare. Ai shkroi poemën "Vaji i Bylbylit", përmbledhjen me vjersha "Juvenilja", poemat "Liria", "Lissus", "Scodra", "Andrra e jetës" etj.

Fjalor

molisur – këtu: shumë i lodhur.
streh – mbulesë, zgjatim që të mbron nga shiu.
njaj – ai.
zymyl – lloj luleje.
dhenash – këtu: vende.
qe – ja.
gemb për gemb – bisk për bisk.
buloj mbarë – shpërtheu e tëra.
vrue – duke parë.
bërlyket –përkëdhelet.
lavër – kular.

Studim teksti

Kuptojmë poezinë

1. Çfarë nënkupton ardhja e dallëndysheve për njerëzit?
2. Poeti i paraqet dallëndyshet si shumë të lodhura dhe i këshillon që të çlodhen. Pse janë kaq të lodhura dallëndyshet?
3. Me çfarë "ushqehet" përroi në pranverë?
4. Përveç natyrës, a nxit ardhja e pranverës ndonjë lloj gjallërie të dukshme edhe te njerëzit?

Analizojmë poezinë

5. Renditni njëra pas tjetrës, shenjat e ardhjes së pranverës, të përshkruara në poezi.

_____

Kanë çelur zymbylat_____

_____

6. Çfarë të rejash sjell në jetën e bujkut në fshat, ardhja e pranverës?
7. Çfarë ngjyrash do të zgjidhnit për të realizuar një pikturë të natyrës që përshkruan poeti nëpërmjet vargjeve të tij?

Gjuha e poezisë

8. Si janë ndërtuar figura letrare në këta shembuj? Shpjegoni ngjashmërinë dhe transferimin e kuptimit nga diçka në diçka tjetër.
   - Porsi fëmi, qi zblohet në djep
   - Fllad i lehtë...., puthi pemën gemb për gemb
   - U zgjue pema...
   - E t'tanë fushës ushqim i nep
9. Kjo poezi e Ndre Mjedës është shkruar në dialektin gegë. Shkruajini fjalët në tabelë në gjuhën standarde.

prandvera	pranvera
bylbyl	
zymyl	
dashtnije	
zblohen	
gemb	
bulk	

10. Cili është lloji i strofës në këtë poezi? Po lloji i rimës?

Reflektojmë rreth poezisë

11. A ju nxit kjo poezi një përfytyrim të saktë për natyrën në pranverë? Çfarë ndjesish ju krijon të lexuarit e poezisë?

Detyrë

- Përshkruani ardhjen e pranverës në qytetin apo fshatin në të cilin jetoni.

Nana

Para leximit

Në këtë poezi lirike, poeti i thur vargje plot ndjenjë nënës së tij. Në vargjet e para duket sikur poeti do t'ia kushtojë këto vargje bukurisë së natyrës. Në vijim kuptojmë se objekti i këtyre ndjenjave dhe emocioneve është krejt tjetër, derisa në strofën e fundit kuptojmë se vargjet i janë kushtuar dashurisë për nënën. Adhurimin për të poeti nuk e përshkruan me shumë fjalë dhe mjaftohet duke u shprehur se vetëm shikimi i saj e bën të lumtur.

Mi kande hyjt, qi ndrisin
Aq bukur atje n'qiell;
I due lulet e kandshme,
Kur njomshëm çilin n'Priell.

Knaqem sa herë m'bjen zogun
Me e ndie pyllës tuj vallzue.
A i ve un veshin prronit,
Kah rrshet, tuj gurgullue.

Por lulet aq s'i due
S'i due aq hyjt vizluesa,
As m'knaqë blerimi i tokeve,
Me sa janë zogj kënduesa,

Sa m'knaqë perherë mue nana:
Virtytesh nji pasqyrë,
Nuk ka nevojë me m'folun,
Kam mjaft kur ajo më kqyrë.

Vinçens Prenushi

Vinçens Prenushi (1885-1945) ka qenë ka qenë folklorist, poet, publicist, përkthyes etj. Ai është autor i përmbledhjes së njohur poetike "Gjeth' e lule", përmbledhje të cilën kritika e gjeti të bukur e delikate. Si folklorist, shquhet për botimin e vëllimit të parë të përmbledhjes "Visaret e kombit", me titull "Kangë popullore gegnishte" (Veri, Kosovë, Shqipni e Mesme). Prenushi është edhe përkthyesi i disa veprave të shkrimtarëve të njohur të letërsisë botërore.

Studim teksti

Kuptojmë poezinë

1. Kujt i kushtohet kjo poezi?
2. Çfarë i pëlqen më shumë poetit nga natyra?
   a) Në dy vargjet e para të strofës I - *hyjt*,_____
   b) Në dy vargjet e dyta të strofës I _____
   c) Në dy vargjet e para të strofës II _____
   ç) Në dy vargjet e dyta të strofës II _____

Analizojmë poezinë

3. Në cilat prej strofave poeti vendos gjithë bukuritë e natyrës përballë kënaqësisë që i jep të kundruarit e nënës?
4. A ndalet poeti te përshkrimi i pamjes fizike të nënës? Çfarë vë në dukje ai prej saj?

Gjuha e poezisë

5. Kjo poezi është shkruar në gegërishte. Kthejini disa fjalë të saj në gjuhën standarde.

   Kande – _____ Hyjt – _____
   E kandshme – _____ Ndie – _____
   Prroni – _____ Nana – _____

6. Në strofën e fundit janë dy raste kur është ndryshuar rendi i gjymtyrëve për të krijuar rimë. Gjejini dhe shënojini në fletore duke shënuar edhe rendin e tyre të zakonshëm.

Reflektojmë rreth poezisë

7. Si mendoni, çfarë gjen poeti në vështrimin e nënës? Si arrin të komunikojë ai me të?

Shkruajmë

- Përshkruani marrëdhënien që keni me nënën tuaj. Në fund korrigjoni shkrimin tuaj, duke ndjekur hapat e mëposhtëm.

Hapat	Problemi	Lloji i ndërhyrjes
Hapi i parë Kuptimi	Lexoni tekstin. Është i qartë dhe i kuptueshëm? Ka dalë ideja që keni pasur në mend?	Shtoni ide. Zgjeroni ose shkurtoni fjali. Ndani paragrafët. Shmangni përsëritjet.
Hapi i dytë Struktura	Lexoni shkrimin për të parë nëse dalin të qarta: hyrja, zhvillimi, mbyllja.	Rishkruani hyrjen ose mbylljen, nëse nuk ju pëlqen.
Hapi i tretë Morfologjia dhe sintaksa	Kontrolloni përshtatjen në gjini, në numër dhe në rasë të emrave dhe të mbiemrave, rendin e fjalëve në fjali, përshtatjen e kallëzuesit me kryefjalën, përdorimin e lidhëzave.	Përmirësoni shkrimin tuaj duke bërë korrigjime sipas rastit.
Hapi i katërt Leksiku dhe kuptimet e fjalëve	Kontrolloni fjalët nëse janë përdorur me kuptimin e duhur, shmangni fjalët e huaja.	Bëni korrigjime dhe zëvendësime sipas rastit.
Hapi i pestë Drejtshkrimi dhe pikësimi	Kërkoni gabime drejtshkrimore dhe pikësimi.	Korrigjoni gabimet drejtshkrimore dhe ato të pikësimit. Për të qenë të sigurt, kështillohuni me fjalorin drejtshkrimor.

Më tha një plak dikur

Para leximit

Kjo poezi është ndërtuar në formën e një bashkëbisedimi mes dy brezash me diferencë të madhe në moshë. Thelbi i gjithë këtij bashkëbisedimi është nxjerrja në pah e gjërave që vlejnë në jetë nga pozicioni i dikujt që e ka jetuar jetën dhe është përplasur me dallgët e saj. Vështirësitë të bëjnë të kuptosh çfarë vlen vërtet dhe çfarë duket sikur vlen.

Nëse e humb pasurinë, djalo,
Asgjë s'ke humbur,
Asgjë, ta dish, –
Më tha një plak dikur,
Një plak i urtë,
Kokë e përhirtë.

Nëse e humb shëndetin, djalo,
Shumëgjë ke humbur,
Shumëgjë, ta dish, –
Më tha një plak dikur,
Një plak i urtë,
Kokë e përhirtë.

Po ndodhi e humbe guximin, djalo,
Çdogjë ke humbur,
Çdogjë, ta dish. –
Më tha një plak dikur,
Një plak i urtë,
Kokë e përhirtë.

E unë i gjori mendova ç'mendova,
Axhami qëllova, pakgjë kuptova,
Por dalëngadalë nga jeta me sprova
Pohimet e plakut krejt i pranova.

(nga vëllimi "Poezi-drama")

Fjalor

axhami – fëmijë i vogël e pa përvojë nga jeta
qëllova – u ndodha.

Hivzi Sulejmani

Hivzi Sulejmani (1910-1975) është një ndër shkrimtarët më të frytshëm të letërsisë shqipe të pasluftës. Ai ka marrë pjesë aktive në Luftën Nacionalçlirimtare, prandaj edhe veprat e tij janë kryesisht me tematikë nga lufta për çlirimin e atdheut nga pushtuesit fashistë. Gati tërë jetën pas çlirimit e kaloi në Prishtinë. Përmbledhja e tij me tregime "Era dhe kolona" (1959) u ndoq nga romani "Njerëzit" (1966), si dhe nga romani "Fëmijët e lumit tim" (1969). Për shkak të censurës shtetërore, shumë prej veprave të Sulejmanit u botuan shumë vite pasi u shkruan. Ai është gjithashtu edhe autor i mjaft dramave dhe poezive.

Studim teksti

Kuptojmë poezinë

1. Ndërmjet kujt realizohet bashkëbisedimi në poezi?
2. A i kuptoi djali fjalët e plakut në momentin kur i dëgjoi?
3. Kur i kuptoi? A iu desh kohë?

Analizojmë poezinë

4. Gjeni në tekst fjalët të cilat janë të lidhura me përgjigjet përshkallëzuese.

   Asgjë _____
   Shumëgjë _____
   Çdogjë _____

5. Çfarë ngjyre i ka flokët plaku i poezisë? Çfarë treguesi është kjo ngjyrë?

Interpretoni poezinë

6. Interpretoni përgjigjen e plakut për pasurinë: "Asgjë s'ke humbur". Si mendoni, pse sipas tij pasuria nuk është asgjë?
7. Si e shpjegoni përgjigjen e plakut se guximi ishte gjëja më e rëndësishme?
8. Si e shpjegoni që guximi sipas tij ishte më i rëndësishëm edhe se shëndeti?

Gjuha e poezisë

9. Në të gjitha përgjigjet e plakut kemi përsëritje të fjalëve. Për çfarë shërben dhe çfarë efekti të jep kjo lloj përsëritje?

Reflektojmë rreth poezisë

10. Duke u nisur nga poezia e mësipërme, si i vlerësoni këshillat e më të moshuarve?

Shkruajmë

- Provoni të shkruani një poezi kushtuar gjyshit ose gjyshes suaj, duke ndjekur këshillat e mëposhtme.

Këshilla për të shkruar poezi

- Përmbajuni idesë që doni të shprehni.
- Lidheni idenë me përjetimet tuaja.
- Lexoni më parë poezi të ngjashme, ndiqni modele.
- Krijoni strukturën: shkruani në strofa, vargje të shkurtra dhe me rimë.
- Përdorni figura letrare: epitete, krahasime etj.
- Ndryshoni shpesh vendin e fjalëve në vargje.
- Përsëritni fjalët që japin mesazhe.
- Lexojeni vetë pasi ta keni shkruar, që të kuptoni nëse ka ritëm.
- Shikojeni të shkruar, poezia duhet të duket bukur.

Mbarim vjeshte

Para leximit

Në këtë poezi, Poradeci përshkruan fundin e vjeshtës. Poezia të përcjell ndjesinë sikur gjithçka është në lëvizje, ashtu si zogjtë që fluturojnë dhe po largohen, ashtu si gjethet e pemëve që fëshfërijnë e që bien. Vjeshta po ikën dhe po ia lë vendin dimrit me erën e fortë, me brymën dhe malet me dëborë.

Fluturoj dhe shtërg' i fundit, madhështor, me shpirt të gjorë
Duke shkuar që me-natë sipër malesh me dëborë…
Iku rend' e i përmallshmë, dhe me sqep të ti të fortë
Zotriut q'i la folezën i trokiti mun në portë…

Pra më s'duket shpes' i fatit prapa bujqësh dhe plorësh,
Prapa brazdës së rrëxuar hap-me-hap prej që malorësh;
Më s'dëgjohet nër ugare të kërcasë miu i hirtë,
Vdiq nepërka pikëlore ndaj blatisht' e shkretëtirë.

Dheri-i mardhur prej thëllimi dirgjet heshtur nënë brymë,
Fryn veriu në pyll të thatë me zemrim e me fërtymë
E si shtohet cingërima… ja! se ku dinak dh'i voçërr…
Nëpër gardhe-e nëpër ferra dërdëllet gazmor një çoçërr!…

O! sa hir që kishte shtërgu, aq fisnik me shtat të gjorë,
Kur bariste dal-nga-dalë – posi dhëndër me kurorë!…
E kur pranë-i vinte krilla, që shëndrij në kraharuar,
Me sy lart, me hap të matur – posi vash' e nusëruar!..

(*nga Vepra 1, "Poezia"*)

Fjalor

shtërg – lejlek.
plorësh – pjesa e hekurt që vihet në majë të parmendës.
brazdë – vijë e gjatë, që hapim në arë me plug ose me një vegël tjetër bujqësore.
të rrëxuar – të punuar.
ugar – tokë e punuar, e bërë gati për t'u mbjellë.
blatishtë – moçalishte.
çoçërr – zog shumë i vogël, i ngjashëm me trumcakun, që ka ngjyrë të murrme dhe që rri nëpër ferra.
krilla – zog i madh shtegtar si pelikani, i përhimë e me sqep të shkurtër.

Lasgush Poradeci

Lasgush Poradeci është pseudonim i emrit Llazar Sotir Gusho (1899-1987). Ai është një nga poetët më të spikatur shqiptarë. Në vitin 1933 u botua vëllimi i tij i parë, "Vallja e yjeve", kurse në vitin 1937 u botua vëllimi i dytë dytë, "Ylli i zemrës". Ai ka përkthyer edhe disa nga shkrimtarët më të mëdhenj të letërsisë botërore, si: Pushkinin, Hajnen, Gëten, Hygoin, Bajronin, Shellin, Bërnsin etj.

Studim teksti

Kuptojmë poezinë

1 Lexoni poezinë dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

a) Për cilën periudhë të vitit flitet në poezi?

b) Për ku është nisur shtërgu i fundit?

c) Pse është i përmallshëm udhëtimi i shtërgut në largim? Shënoni me ✓ alternativën e saktë.

- ☐ Ka lënë pas folezën.
- ☐ Nuk di se çfarë e pret.
- ☐ Ka frikë nga udhëtimi i gjatë.
- ☐ Ndihet i braktisur.

Aliteracioni

Aliteracioni është përsëritje e bashkëtingëlloreve të njëjta ose e togjeve të tingujve të njëjtë. Kjo figurë letrare vërehet veçanërisht në vargje dhe rrit fuqinë shprehëse të tyre.
P.sh., në poezinë "Shpell'e Dragobisë" të Fan Nolit:
Dif drangoj i Dragobisë,
Trim bun i Vegjëlisë
O Bajram, bajrak i gjallë
More nam me gjak në ballë.

Analizojmë poezinë

2 Përshkruani me disa fjali ndjesinë e keqardhjes për ikjen e kohës që s'kthehet pas. Në cilën prej strofave të poezisë shfaqet nostalgjia për kohën e shkuar?

3 Edhe poezia e Mjedës ka si temë ndërrimin e stinëve. Shënoni ndryshimet e të përbashkëtat mes këtyre dy poezive.

Interpretojmë poezinë

4 Natyrën në këtë fillim dimri poeti e karakterizon si "e shkretëtirtë". Nga çfarë ndryshimesh niset kur përdor këtë karakterizim?

Gjuha e poezisë

5 Dalloni figurën e aliteracionit në poezinë e Poradecit.

6 Gjeni dy krahasimet në vargjet e strofës së fundit të poezisë.

7 Përcaktoni llojin e strofës. Përcaktoni llojin e rimës së përdorur në poezi.

8 Nënvizoni fjalët që tregojnë zëra, tinguj e zhurma. Si mendoni, çfarë efekti shkaktojnë ato te lexuesi?

Reflektojmë rreth poezisë

9 Po ju, a ndieni mall për kohët që kanë kaluar? Për shembull, kur keni qenë nxënës ose nxënëse në ciklin fillor? Çfarë kujtoni me mall nga ajo kohë?

Detyrë

- Përshkruani përjetimet tuaja në fund të stinës së verës dhe në prag të stinës së vjeshtës.

Horizonti

Para leximit

"Horizonti" është një poezi e Dritëro Agollit, e shkruar në vitin 1984 në përmbledhjen me poezi "Udhëtoj i menduar". Qëkur jemi të vegjël na pëlqen të shohim larg, deri aty sa na kap syri. Pyesim vazhdimisht se çfarë ka përtej asaj vijës ndarëse, mes tokës dhe qiellit. Rritemi me dëshirën për të njohur atë që nuk na rrok syri: fshatra, qytete të panjohura, peizazhe të pashkelura, njerëz të rinj.

Desha të dija se ç'kish përtej horizontit pa fund,
Desha male, lumenj, njerëz e dete të tjerë
E thosha me vete: horizont, horizont, më mund a të mund
Dhe vrapimin merrja në kodra e maja me erë...

Dhe ky vrapim më mbeti dhe sot:
Të zbuloj se ç'ka përtej horizontesh.
Horizont, horizont, horizont,
O ëndrra ime prej motesh.

Dritëro Agolli

Dritëro Agolli (1931-2017) është i njohur si shkrimtar, por dhe si publicist. Ai ka shkruar poezi, poema, tregime, romane, drama, skenarë filmash etj. Veprat e tij më të njohura janë: poemat "Nënë Shqipëri", "Devoll, Devoll"; përmbledhja me poezi "Fjala gdhend gurin"; romanet "Komisari Memo", "Njeriu me top", " Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo", "Arka e djallit" etj.

Studim teksti

Kuptojmë poezinë

1. Cili është motivi i kësaj poezie?
2. Çfarë nënkupton "vrapimi" në këtë poezi?
3. Analizoni vargun: *O ëndrra ime prej motesh.* Pse poeti përdor metaforën *ëndërr* në poezi?
4. Si mendoni, në cilën moshë njeriu zbulon më shumë gjëra të reja? Zgjidhni një alternativë dhe argumentojeni.
   - ☐ Kur është fëmijë.
   - ☐ Kur është i rritur.
   - ☐ Kur është i moshuar.
6. Poeti e përsërit fjalën "horizont" disa herë në të njëjtin varg. Si mendoni, përse e bën këtë?

Bashkëbisedojmë

- Si mendoni, horizonti nënkupton vetëm vijën imagjinare që krijojmë me sy në largësi, apo edhe dëshirën e njeriut për zbuluar diçka të re?
- Pse autori e quan ëndërr zbulimin e së panjohurës? A ia ka dalë njeriu të zbulojë të panjohurën gjatë gjithë zhvillimit të tij?

Në natyrë

Para leximit

Objekti i kësaj poezie është dëshira e poetit për të qenë në natyrë. Atje, ai mendon se mund të gjejë prehjen, qetësinë e shpirtit. Në mes të gjelbërimit, aromave të luleve, zërave që lëshojnë kafshët dhe shpendët, gurgullimës së ujit që rrjedh dhe fluturimit të zogjve, ai beson se shpirti i tij u largohet mërive dhe inateve të së përditshmes dhe nis të ëndërrojë.

Esad Mekuli

Esad Mekuli (1916-1993) ka qenë poet dhe përkthyes i njohur. Ai ishte nismëtar, themelues dhe kryetar i parë i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Në vitin 1949 themeloi revistën letrare "Jeta e re", kryeredaktor i së cilës ishte për shumë vite. Disa nga veprat që ka botuar, janë: "Për ty", "Dita e re", "Vjersha", "Brigje", "Drita që nuk shuhet" etj.

Diku larg gjelat janë ndi
Dhe gurgullimë e lumit n'amtësi...

Sa këndshëm asht n'këtë kështjelltësi t'agimit
lugjeve me aromë
me iu falë kangës e gjelbërimit -
zaneve që kudo jehojnë...

Me shkue, e mbas me lanë rrugët
e pluhnueme, plot shëmti;
me përshëndetë ngrohtas zogjt
me mirësi t'zemrës së pamëni.

Me u shtri vesës mbi tokë
ndër fije bari që kundërmojnë
dhe me andrrue se si, ndër flokë,
naltësitë e kaltra të bulojnë...

Studim teksti

1. Duke lexuar me vëmendje dy vargjet e para, përcaktoni se në çfarë gjendjeje është natyra e përshkruar.
   a) Në gjendje qetësie të plotë.
   b) Në gjendje amullie.
2. Cila është dëshira e poetit e shprehur në poezi?
3. Ku dëshiron të shtrihet poeti? Çfarë dëshiron të ketë si shtrojë?
4. Me çfarë dëshiron të mbulohet?
5. Lexoni me kujdes poezinë dhe gjeni në cilin moment të ditës, i lind poetit dëshira për të qenë në mes të natyrës.
6. Çfarë ndjesie ju ngjall poezia? Shënoni me ✓.
   - ☐ Qetësi.
   - ☐ Ankth.
   - ☐ Ëndërrim.
   - ☐ Frymëzim.
   - ☐ Frikë.
   - ☐ Gëzim.
7. Si mendoni, a do të kishte të njëjtën vlerë artistike poezia nëse fjalët në dialekt do të zëvendësoheshin me gjegjëset e tyre në gjuhën standarde?

Secili udhëtar përshëndet në mënyrë të vet

Para leximit

Shpesh thuhet se secili prej nesh është udhëtar në këtë botë. Njerëzit janë në një udhëtim të përhershëm, nga fëmijëria drejt pleqërisë, nga një vend në një tjetër, nga një gjendje shpirtërore në një tjetër. Njerëzit flasin gjuhë të ndryshme dhe përshëndetin me fjalë të ndryshme, por gjithashtu edhe me mimikën e tyre që transmeton mendime dhe ndjesi emocionale.

Secili udhëtar në botë
Përshëndet në mënyrë të vet
- Secili prej nesh.

Kurse unë gjithmonë kam menduar
njerinë ta përshëndes
me buzëqeshje më të nxehtë

në minutat e ndarjeve të zakonshme
që të mallëngjejnë,
që të gëzojnë.

E ju - si të dëshironi:
sytë e udhëtarëve n'kalim përherë i keni
dhe shamiat e përshëndetjeve në duar.

Ali Podrimja

Ali Podrimja (1942-2012) lindi në Gjakovë dhe pati një fëmijëri mjaft të vështirë. Ai është autor i më shumë se dhjetë vëllimeve me poezi dhe mbahet sot nga kritika si një nga përfaqësuesit më të denjë të poezisë moderne shqipe. Në vitin 1961, botoi përmbledhjen e parë me poezi "Thirrje". Pas saj, botoi përmbledhjet: "Shamijat e përshëndetjeve", "Dhimbë e bukur", "Torzo" etj., deri në veprën e tij mjeshtërore "Lum Lumi" (1982). Dy librat e tij në prozë janë: "Burgu i hapur" dhe "Harakiri".

Studim teksti

Kuptojmë poezinë

1 Pse udhëtarë të ndryshëm përshëndetin në mënyra të ndryshme?
Shënoni me ✓ alternativat e sakta.

- ☐ Kanë gjuhë të ndryshme.
- ☐ Kanë gjendje shpirtërore të ndryshme.
- ☐ Janë të frikësuar, sepse janë në një vend të panjohur.
- ☐ Nuk njohin atë që përshëndetin.
- ☐ Kanë gjendje ekonomike të ndryshme.
- ☐ Kanë karaktere të ndryshme.

2 Cila është mënyra me të cilën poeti ka vendosur të përshëndetë?

Analizojmë poezinë

3 Radhitni disa forma dhe mënyra përshëndetjeje që përmenden në poezi:

a) me fjalë
b) _____
c) _____

4 Udhëtarë janë vetëm ata që udhëtojnë? Interpretoni vargun "secili prej nesh" në lidhje me këtë pyetje.

Gjuha e poezisë

5 Me çfarë lloj strofe dhe vargu është shkruar poezia?

6 Poeti i drejtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë lexuesit. Çfarë krijon kjo mënyrë komunikimi?

Reflektojmë rreth tekstit

7 Keni vënë re se shpesh turistët, ndonëse janë të panjohur, përshëndetin ose u pëlqen t'i përshëndetni. Si mendoni, çfarë i shtyn ata dhe juve për të përshëndetur të panjohur?

Detyrë

- Vështroni ilustrimin. Identifikoni se çfarë paraqet ai dhe shkruani se çfarë përjetimesh ju shkakton.

Ne ishim, ne jemi, ne do të jemi këtu...

Para leximit

Në këtë poezi kushtuar Kosovës, atdheut të tij, poeti thekson se është bir i kësaj toke dhe pasardhës i atyre që kanë qenë përjetësisht në të. Ai ndihet i fyer nga ata që e quajnë ardhacak dhe, për këtë arsye, thekson se Kosova ka qenë dhe do të jetë vendi i shqiptarëve, vendi i tij për të cilin është gati të bëjë gjithçka, të japë edhe jetën, ashtu siç bënë paraardhësit e tij.

Se kush erdhi tek ti, Kosovë,
Kosova ime e dashur,
të quajti tokë të vet.
E mua, birin tënd, që të ledhaton
me mall dhe dashuri, dorën ta shkon,
më quajti ardhacak, i pashtëpi,
njeri pa tokë dhe qiell të vet mbi kokë,
mysafir i përkohshëm dhe farë e ligë,
hije drithëritëse në ajër,
as në tokë, as në qiell.
Por në rrugën e gjakut kafkën la kujtim,
se ti s'je e atij shkel,
lavrën tënde me vdekje ai mbjell.
S'je tokë e gjithkujt dhe e askujt,
as tokë pa popull e një populli pa tokë.
Ti je dhe kreshnik i bijve besnikë,
që të duam dhe të mbrojmë,

Fjalor

ardhacak – ai që ka ardhur nga një vend tjetër dhe është ngulur në një vend të ri, jovendas, i ardhur.
drithëritës – që të fut dridhmat, që të bën të dridhesh.
lavër – arë e punuar dhe e mbjellë.

Qerim Ujkani

Qerim Ujkani (1937-2015) ka qenë një nga redaktorët më të spikatur të emisioneve letrare në Radio Prishtina. Ai ka botuar mbi 20 libra me poezi dhe prozë, si dhe është marrë me përkthime letrare nga serbokroatishtja në gjuhën shqipe. Poezitë e tij janë prezantuar në shumë antologji.

me dashuri t'i mbjellim ugaret,
me flamuj lirie ndër festa
t'i mbulojmë varret.
Lule dhe gjyle në dorën e trimit
je vatër e ngrohtë
e atyre që kurrë s'të lanë vetëm,
me ty qëndruan si shkëmb në erë,
me ty,
në jetë dhe vdekje,
në liri dhe dashuri.
Dhe në qoftë se dikush na thotë prapë:
"Ikni që këtej, se kjo s'është toka juaj!"
ne e dimë se ç'do t'u themi:
"Shkuar për të shkuar ka kush të shkojë,
Ne ishim, ne jemi, ne do të jemi këtu!"

Fjalor

ugar – tokë e punuar, e bërë gati për t'u mbjellë.

Studim teksti

Kuptojmë poezinë

1. Strofa e parë e poezisë i ngjan një bashkëbisedimi. Mes kujt duket se zhvillohet ai?
2. Çfarë ndjenjash shfaq poeti kur flet për vendin e tij?

Analizojmë poezinë

3. Ç'luftëra kanë bërë shqiptarët për të mbrojtur trojet e tyre amtare?
   Gjeni vargjet në të cilat tregohen vuajtjet e paraardhësve të poetit.
4. Nënvizoni fjalët që shprehin dashurinë e madhe të poetit për atdheun.
5. Ç'kuptoni me vargjet e mëposhtme?

   "S'je tokë e gjithkujt dhe e askujt,
   as tokë pa popull e një populli pa tokë."

   Ç'ndjenja ju ngjallin ato?
6. Interpretoni vargjet:

   "Shkuar për të shkuar ka kush të shkojë,
   ne ishim, ne jemi, ne do të jemi këtu!"

   Kujt i drejtohen këto fjalë të poetit?
7. Gjeni pesë metafora që përdor poeti për vendin e tij.

Detyrë

- Gjeni dy poezi të tjera kushtuar Kosovës dhe lexojini në klasë.

Trashëgimi

Para leximit

Ne të gjithë jemi fryt i kryqëzimit e i trashëgimit të gjeneve, modeleve të të sjellit dhe të vlerave e dashurisë që na falin prindërit. Ne trashëgojmë shumë elemente nga brezat para nesh, si: atdheun (shtëpinë), gjuhën, kulturën, historinë, që duhet t'i ruajmë dhe t'i lëmë pas për brezat që vijnë pas nesh. Ne jemi ata që ikën dhe ata që vijnë. Poezia e mëposhtme sjell reflektime rreth këtij fakti.

Stërgjyshi i stërgjyshërve
më ka lënë trashëgim
truallin,
babai –
shtëpinë,
nëna –
mirësinë,
vëllai –
trimërinë,
motra –
durimin,
shokët –
besnikërinë,
të huajt –
stuhinë,
armiqtë –
mërgimin,
gjaku ynë –
dashurinë.

(*nga vëllimi "Zemra ime"*)

Muhamed Kërveshi

Muhamed Kërveshi (1935, Mitrovicë) është një poet i afirmuar, krijimtaria e të cilit është prezantuar në shumë antologji të poezisë shqipe dhe është përkthyer në disa gjuhë të tjera. Ai është shqipërues i shumë veprave të shkrimtarëve të njohur francezë, si dhe përpilues i tri antologjive: "Kurrizi i engjëllit" (antologji e poetëve francezë të shekullit XX), "Antologji e poetëve të Pejës" dhe "Antologji e lirikës frënge" (shek. XIII-XXI).
Ka botuar 29 përmbledhje me poezi, disa vepra me tregime, drama, monodrama, romane, si dhe një vëllim me ese e kritika dhe përrallëza.

Studim teksti

Kuptojmë poezinë

1 Lexoni poezinë dhe lidhni me shigjetë fjalët njëra me tjetrën, në mënyrë që të krijojnë grupe fjalësh me kuptim.

stërgjyshi i stërgjyshërve
të huajt
armiqtë
motra
shokët
babai
vëllai
gjaku ynë

dashurinë
besnikërinë
mërgimin
truallin
durimin
trimërinë
shtëpinë
stuhinë

Analizojmë poezinë

2 Sipas vargjeve të kësaj poezie, mund të trashëgojmë elemente objektive dhe jo-objektive (ndjesore). Plotësoni tabelën.

Elemente objektive	Elemente joobjektive (ndjesore)
trualli	mirësia

3 Çfarë nënkupton "stuhia" si një trashëgimi që e kemi marrë nga të huajt?

4 Duke iu referuar vargjeve, interpretoni si kanë ndikuar armiqtë te ne dhe në ç'mënyrë.

Gjuha e poezisë

5 Vargu i dytë i poezisë (*më ka lënë trashëgim*) nuk ka funksion të lidhë vetëm vargun e parë dhe të tretë, por ai lidh pothuaj të gjitha vargjet e poezisë njëra me tjetrën. Ky varg është zëvendësuar në poezi me shenjën (–). Rishkruajeni poezinë duke shtuar këtë varg në vend të shenjës. Çfarë vini re?

Shkruajmë

- Vëreni figurën që shoqëron këtë poezi dhe shkruani një ese letrare, pasi të keni lexuar edhe këshillat e mëposhtme.

Këshilla për të shkruar një ese letrare

- Shihni figurën dhe shkruani variante të ndryshme titujsh, të cilët do t'ju ndihmojnë për të zgjedhur titullin përfundimtar.
- Mendoni se çfarë doni të shprehni. Përpiquni ta shprehni me gjuhë të figurshme.
- Përdorni folje që shoqërohen me ndajfolje, si p.sh.: ndriçonte tej mase, dhe mos harroni t'i përdorni mbiemrat në shkallë të ndryshme.
- Ndajeni esenë në paragrafë. Mirë janë tre, shumë mirë pesë.

Detyrë klase

Para leximit

Fëmijët e duan lojën dhe bëjnë gjithçka për t'u argëtuar në çdo moment dhe kurdoherë. Ndodh që ata e gjejnë mënyrën të luajnë edhe në çastet më të papërshtatshme, siç është edhe gjatë një ore mësimi. Djaloshi i poezisë së mëposhtme luan me një zog, i cili me këngën e tij i nxit fantazinë për t'u zbavitur. Ai ëndërron të ishte një vend krejt tjetër, në natyrë, në breg të detit, duke luajtur me zogun në rërë.

Dy dhe dy katër,
katër dhe katër tetë,
tetë dhe tetë gjashtëmbëdhjetë.
Përsëriteni! - mësuesi thotë.
Dy dhe dy katër,
katër dhe katër tetë,
tetë dhe tetë gjashtëmbëdhjetë
Po ja, zogu-lirë
që në qiell kalon:
fëmija e shikon
fëmija i thërret:
shpëtomë,
luaj me mua,
zog!
Ahere zogu zbret,
me fëmijën lot.
Dy dhe dy katër,
Përsëriteni! - mësuesi thotë.
Dhe fëmija lot
e zogu lot me të...
Tetë dhe tetë gjashtëmbëdhjetë,
po gjashtëmbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë,
sa bëjnë?
S'bëjnë fare
gjashtëmbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë
Sidomos s'bëjnë tridhjetë e dy.

Zhak Prever

Zhak Prever (4 shkurt 1900-11 prill 1977) ka qenë poet dhe skenarist francez. Suksesi dhe popullariteti i shfaqet në moshën 46-vjeçare, me rastin e botimit të përmbledhjes me vjersha "Paroles" ("Fjalë"). Poet popullor, falë gjuhës së thjeshtë dhe lojës së guximshme të fjalëve, ai vazhdon të lexohet me ëndje nga të mëdhenjtë dhe të vegjlit. Vargjet e tij kanë shumë ritëm e tingëllim, duke marrë nota shumë origjinale.



Dhe fëmija zogun nën bankë e fsheh
dhe fëmijët gjithë
këngën ia ndiejnë,
ia dëgjojnë muzikën
fëmijët të gjithë.
Dhe tetë dhe tetë ikin fluturim,
dhe katër dhe katër,
dhe dy dhe dy zhduken fare,
dhe një dhe një s'bëjnë as një as dy,
një dhe një ikin gjithashtu.
Dhe zogu-lirë lot,
fëmija këngës ia thotë
dhe mësuesi thërret:
kur do t'i lësh qyfyret!
Po gjithë fëmijët e tjerë
Ia dëgjojnë muzikën
dhe muret e klasës
shemben pa zhurmë:
xhamat prapë bëhen rërë,
boja bëhet ujë,
bankat bëhen pemë,
shkumësi bëhet gur,
pena bëhet zog.

Studim teksti

Kuptojmë poezinë

1. Pasi të lexoni poezinë, përgjigjuni pyetjeve:
   - a) Çfarë po bën mësuesi? Po fëmijët?
   - b) A janë të gjithë të vëmendshëm në shpjegimin e mësimit?
   - c) Çfarë ia tërheq vëmendjen mësuesit?
   - ç) Ndërsa mësuesi vazhdon të shpjegojë, çfarë bën fëmija?
   - d) Si sillet fëmija me zogun? Si e trajton atë?
   - dh) Pse shqetësohet mësuesi?

Analizojmë poezinë

2. Duke u nisur nga ajo që po shpjegon mësuesi, në çfarë lloj ore mësimi janë fëmijët?
3. Pse mësuesi kërkon vazhdimisht të përsëritin atë që thotë ai?
4. Interpretoni vargjet: *shpëtomë, / luaj me mua, zog*. Pse fëmija kërkon shpëtim nga zogu?
5. Cilat janë vargjet që përsëriten më shpesh? Çfarë efekti krijojnë ato?

Reflektojmë rreth poezisë

6. A e keni dëgjuar shprehjen: "Përsëritja është mëma e dijes"? Çfarë mendoni për të?
7. Diskutoni rreth frazës: "Lojërat janë çelësi i një fëmijërie të lumtur".

Detyrë

- Prezantoni lojëra nëpërmjet të cilave mësoni edhe gjëra të reja.

Mbreti Lir

Para leximit

Fragmenti i mëposhtëm është shkëputur nga tragjedia "Mbreti Lir" e Uilliam Shekspirit. Mbret Lir, i cili është mbreti i Anglisë, ka vendosur të lërë fronin e tij dhe ta ndajë atë mes tri vajzave të tij: Gonerilës, Reganës dhe Kordeljas. Në fillim, ai i vendos ato para një prove, nëpërmjet së cilës do të shohë se cila nga vajzat e donte më shumë. Gonerila dhe Regana, dy vajzat e mëdha, fillojnë të shprehin me fjalë një dashuri të pamat për atin, ndërsa Kordelja, vajza e vogël, thotë se ajo e do atin e saj ashtu si çdo fëmijë. Mbretit, të mësuar me lajka, kjo përgjigje i duket si fyerje, ndaj zemërohet dhe vendos ta largojë nga shtëpia. Mbreti Lir e kupton se ç'gabim të rëndë ka bërë pasi dy vajzat e mëdha e dëbojnë nga shtëpia dhe e lënë në shi.

Trumpetë. Hyjnë mbreti Lir, Kornuolli, Albani, Gonerila, Regana, Kordelja dhe Shpura.

Uilliam Shekspir

Uilliam Shekspiri është një nga shkrimtarët më të mëdhenj të të gjitha kohërave. Ai ka qenë komediograf, dramaturg, por edhe aktor. Shekspiri ka shkruar tragjeditë e njohura "Hamleti", "Mbreti Lir", "Makbethi", "Otello" etj., të cilat kanë hyrë në historinë e letërsisë botërore. Ai ka shkruar edhe një numër të madh komedish, si: "Shumë zhurmë për asgjë", "Nata e dymbëdhjetë". Krijimtaria e tij përfshin edhe 154 sonete, që janë vlerësuar për vlerat poetike.

LIRI

Ndërkaq e çpallim botërisht vendimin
fshehtë: pa më jepni atë kartë.
Ta dini, trish e ndamë mbretërinë.
I kemi dhënë fund një herë e mirë
T'i shkundim gjithë andrallat e kujdeset
Prej pleqërisë sonë, t'ua ngarkojmë
* * *
Cila nga ju na do më shumë vallë?
Që ashtu darovën tonë më të pasur
ta japim pas meritës. Gonerilë,
ke lindur më përpara, fol' e para.

GONERILA

Imzot, ju dua më fort se shprehin fjalët,
Më fort se syt, hapsirën e lirinë,
Më shumë se çdo gjë që mund të çmohet
Për pasurinë dhe rrallësinë e saj;
Dhe jo më pakë nga sa dua jetën
me hir, shëndet, e bukuri dhe nder;
ju dua aqë fort sa asnjë fëmi
nuk i ka dashur prindët gjer tani,
me dashuri q'as fryma s'është e mjaftë
As gjuha s'është e zonja ta tregonjë –
Ju dua ca më shumë nga sa thashë.

KORDELJA *(mënjanë)*

Po ti Kordelja? Duaj duke heshtur.

LIRI

Mbi gjithë viset nga ky skaj ay –
Të pasura me pyje hijeplotë
E fusha fort pëllore rreth e rrotull,
Me plot lumenj për të vaditur arat –
Të bëjmë zonjë ty: I trashëgofshin
Për jetë bijt e tu, t'Albanit. Ç'thotë
E dyta bijë, e dashura Reganë,
E shoqja e Kornuollit? Folë!

REGANA

Im atë,
Jam mbrujtur prej një brumi si ime motër,
Dhe kam të njëjtën vlerë. Zemrën e dlirë
Ma thonë, se ime motër ju ka shprehur
Të gjithë dashurinë që ndjej unë;
Po mbeti tepër prapa, sepse vetë
Armike jam për gjith'ato gëzime
Që rrjedhin si pasoja t'epshevet,
Dhe ndjenj se s'jam e lumtur veç se vetëm
Në dashurinë e Madhërisë suaj

KORDELJA *(mënjanë)*

Kordelja e varfër, pra. Po gjene jo;
Se dashuria ime, jam e sigurt,
Është më e pasur se sa fjala ime.

LIRI

Ty dhe trashëgimtarëve të tu
Ju jap këtë të tretën pjesë tjetër
Nga, mbretëria jonë e madhe e bukur.
M'e vogël jo nga pjesa e Gonerilës
Me gjerësi, në vlerë e në bukuri
Tani, gëzimi i zemrës sonë, ti
Që, ndonëse më e vogla, s'je më e pakë
e dashurin' vajzërore ta lakmojnë
Hardhitë e Francës, qumësht i Burgundit,
Ç'na thua ti që të fitosh të tretën
akoma më të pasur nga tët motra?

KORDELJA

Asgjë, i ndertë imzot.

LIRI

Asgjë?

KORDELJA

Asgjë.

Tragjedia

Tragjedia është një lloj dramatik i shkruar kryesisht në vargje. Në antikitet, tema e tragjedisë u mor nga mitet, kurse kori luante një rol të rëndësishëm. Aktorët visheshin në mënyrë të posaçme dhe mbanin maska. Më vonë, tematika mitike u zëvendësua nga tematika historike ose nga tematika e konflikteve aktuale shoqërore.

LIRI

Nga asgjëja s'del asgjë. Pa fol më qartë.

KORDELJA

E mjera, s'jam e zonja të ngroh zemrën.
Në cep të gjuhës. Madhëri, ju dua
Ashtu si e ka detyrë çdo fëmijë
Ndaj t'et, dhe as më shumë as më pakë.

LIRI

Si the? Kordelja! Ndreqe pakë gjuhën
Se mos i biesh fatit tënd me shqelm.

* * *

LIRI

Dhe e thua me gjithë zemër.

KORDELJA

Po, imzot.

LIRI

Sa e re dhe sa e vrazhdë!

KORDELJA

Sa e re dhe sa e drejtë, i dashur atë.

LIRI

Po mirë pra, të Drejtën marrsh për prikë!

* * *

Që sot e tutje përgjithmonë e huaj.

("Mbreti Lir", U. Shekspir, e përktheu S. Luarasi)

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Pasi të lexoni fragmentin, përgjigjuni pyetjeve:

a) Ku zhvillohen ngjarjet?
b) Çfarë ka vendosur të bëjë mbreti Lir?
c) Çfarë bën mbreti Lir para se të ndajë mbretërinë?
ç) Ç'pyetje i bën mbreti Lir vajzës së madhe, Gonerilës? Si i përgjigjet ajo?
d) Ç'pyetje i bën mbreti Lir vajzës së dytë, Reganës? Si i përgjigjet ajo?
dh) Si i përgjigjet Kordelja së njëjtës pyetje?

Analizojmë tekstin

2 Gjeni në tekst fjalët me të cilat i drejtohet mbreti Lir vajzës së vogël.

3 Dalloni në përgjigjen e Reganës fjalët që tregojnë xhelozinë e saj ndaj motrës së madhe.

4 Zbërtheni karakteret kryesore të pjesës së shkëputur nga tragjedia, duke i vënë përballë njëri-tjetrit.

Mbreti Lir	Gonerila	Regana	Kordelja
krenar			
	dinake	dinake	
	e përciptë		
			e ndershme
			e virtytshme
			e drejtë
		ambicioze	
	pa shpirt		

Interpretojmë tekstin

5 A e vlerëson babai përgjigjen e sinqertë të vajzës së vogël?

6 A ka ndonjë justifikim për vendimin e babait ndaj Kordeljas?

7 A mendoni se është fajtor edhe mbreti Lir për sjelljen e dy vajzave të mëdha?

Reflektojmë rreth tekstit

8 Cilat vese njerëzore dënon Shekspiri në këtë pjesë? Si duhet të jenë marrëdhëniet familjare?

Detyrë

- Luani në role fragmentin. Kujdesuni për shqiptimin e fjalëve, gjestet dhe lëvizjet në skenën e improvizuar.

Shqyptarja e qytetrueme

Para leximit

Kjo pjesë është shkëputur nga melodrama "Shqyptarja e qytetrueme" e Gjergj Fishtës. Në këtë fragment ndërthuren mitologjia me realitetin, duke himnizuar botën shqiptare, dijen, qytetërimin. Në njërën anë kemi figura mitologjike, si Ora e Shqypnisë, Zana e Madhe e në anën tjetër është Silja, vajza shkodrane, bijë njeriu. Ajo shkel pa dashje në sofrën e zanave, veprim që zakonisht dënohet prej tyre, por ato nuk mërziten, madje e pëlqejnë fort. Silja është simbol i mirësisë dhe i dashurisë për dijen.

ZANA E MADHE

Po se n'vend shitue s'e kini?
Kushto shklet mbi tryezës të zanavet,
Pa ndërshkim aj nuk don lanë,
Sikur urdhnin qi u kam dhanë.

BJESHKA

Besa, po, moj Zona e Madhe:
Njashtu asht krejt si ti po thue.
Edhe un deshta m'e shitue;
M'e ba deshta karravaxh

* * *

SILJA

(vedi me vedi)
Zojë!... Ku gjindem?... Këto gra.
Kush do të jenë?

ZANA E MADHE

(Silja)
Pse s'ke fishkëlleu,
Kahë ke ra atij bregu t'shehut?...
Kur të bijsh vetmisë s'ndo 'i vendi
E mos t'dijsh ti vetë me kndue,
Fishkllo atëhera rrugës, mos tjetër,
Per t'vumë n'beh, po, shtozovallet,
Qi aty t'Mirat mund të ndodhin
A t'u la, ase m'tryezë tue ngranun.

SILJA

Me fishkllue m'thue?... - un nuk jam djalë.
N'Shqipni varzat nuk fishkëllojn.

Fjalor

shitue – mallkoj.
shklet – rrëshqet.
karravaxh – dru, shkop druri.
n'beh – të bërit be.
ngranun – ngrënë.
varza – vajza.

Gjergj Fishta

Gjergj Fishta (1871-1940) ka qenë poet e prozator, dramaturg, publicist, estet, anëtar i parlamentit dhe mbrojtës i Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Ai është autori i veprës së mirënjohur epike "Lahuta e Malësisë", i përmbledhjes satirike "Anzat e Parnasit", i përmbledhjes lirike "Pika voëset" etj. Për veprimtarinë poetike, arsimore, atdhetare e fetare, Gjergj Fishta mori nderime të ndryshme.

ZANA E MADHE

Mirë: po ti, moj bijë, kah je?

SILJA

Prej Shqypnijet.

ZANA E MADHE

Pra, shqyptare?

SILJA

Po, shqyptare e bijë shqyptarit,
Fis e besë e fe t'të Parit
Qi der m'sot kurr s'ka mohue.

* * *

Fjalor

avitë – afrohem.

ORA E SHQYPNISË

(Tue iu avitë Siles e me njanën dorë tue e lmue krejet).
Po a shqiptare je moj bijë?

SILJA

Po, shqyptare.

ORA E SHQYPNISË

Ku ke le?

SILJA

N'at mollë Shkodre në krye t'Gegnis'
Prej kahë s'parit Shqyptaris'
Zu me i shndritë hylli i liris'!

ORA E SHQYPNISË

Vajzë shkodrane?
... Sa mirë
Asht tue m'ardhë, qi edhe unë po ndodhi
Këtu me ty.

Fjalor

n'at mollë Shkodre – këtu: më e bukura, më e mira në Shkodër.
ndollë – ndodh.

SILJA

Po ti kush je?

ORA E SHQYPNISË

Unë jam ora e Shqyptarisë.

Melodrama

Melodrama është një lloj drame, në të cilën muzika e ndjek fjalën e artistit vazhdimisht, ose aty ku është më e rëndësishme. Tematika e saj është sentimentale.

SILJA

Po këto varza kush, thue, janë?

ORA E SHQYPNISË

Njana Orë e tjetra Zanë
Këto janë, moj, shtozovallet;
Njato t'Bukrat e Dheut.

(Silja tmerrohet e struket nën sjetull t'Orës së Shqypnisë)

Jam unë ktu, s'të bajnë gja
Mos druaj.
Veç, si ti ke ndollë ktu, m'thuaj.

SILJA

Un? S'e di.

* * *

Jo, po, e dij: por disa shoqe
U bamë bashkë e duelëm n'Bardhaj,
për të mbledhun atje lule.

(nga vëllimi "Dramatika")

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Pasi të lexoni fragmentin, përgjigjuni pyetjeve:

a) Në cilin ambient zhvillohen ngjarjet?
b) Çfarë veprimi të gabuar ka bërë Silja? Pse Zana e Madhe kërkon ndëshkim për të?
c) A e di Silja se ku e kanë çuar këmbët pa kuptuar?
ç) Ç' pyetje i bën Zana e Madhe, vajzës që gjendet papritmas mes tyre?
d) Si reagon Ora e Shqypnisë kur dëgjon se Silja është vajzë shqiptare?
dh) Si ka përfunduar Silja në vendin e orëve, bjeshkëve e shtojzovalleve?

Analizojmë tekstin

2 Pse kërkojnë zanat që Silja të fishkëllejë kur të kalojë në bjeshkë? Ç'ndjesi marrim nga përgjigjja e saj?

3 Dalloni personazhet mitologjike nga personazhet e ndërtuara sipas imazheve reale. Shënoni me ✓.

Personazh	Ora e Shqypnisë	Bjeshka	Zana e Madhe	Silja	Shtojzovallet	Të bukurat e dheut
mitologjik						
real						

Interpretojmë tekstin

4 Interpretoni përgjigjen e Siljës për origjinën e saj: *Qi der m'sot kurr s'ka mohue*.

5 Cilat janë tiparet që e karakterizojnë sjelljen dhe përgjigjet që jep Silja?

6 Përshkruani ndjenjat dhe emocionet që përcjellin fjalët e Siljës, kur tregon se është nga qyteti i Shkodrës.

Gjuha e tekstit

7 Gjeni në tekst dhjetë fjalë dialektore dhe shënojini në fletore, duke vënë përkrah tyre fjalën në gjuhën standarde.

8 Çfarë është mbizotërues në këtë tekst: monologu apo dialogu?

Reflektojmë rreth tekstit

9 Silja është krenare për origjinën e saj. A është e hijshme të mohojmë prejardhjen, vendin ku kemi lindur? Pse?

Detyrë

- Si e imagjinoni Orën e Shqypnisë? Përshkruajeni atë.

Vdekja e një mbretëreshe

Para leximit

Fragmenti i mëposhtëm është shkëputur nga monodrama "Vdekja e një mbretëreshe", e cila ka në qendër figurën e njohur të mbretëreshës Teutë në çastet e fundit të sundimit të saj. Para se të dorëzojë fronin, ajo risjell në mendje jetën e saj dhe periudhën e sundimit.
Mbretëresha Teutë u vu në krye të shtetit ilir pas vdekjes së të shoqit, mbretit Agron. Në këtë monodramë Teuta shfaqet si një grua, si një nënë dhe si një mbretëreshë. Ajo rrëfen në mënyrën më të sinqertë dramën e saj të brendshme.

Dëgjohet zëri i brirtë, më i buçitshëm, që paralajmëron sulmin e menjëhershëm në kështjellën e mbretëreshës. Kthehet e çmeritur, e vendos kamxhikun e artë, parzmoren e çunit, thikën dhe gotën e helmit në dollap. I afrohet dritares, vendos duart në skajet e saj dhe u drejtohet pushtuesve, që nuk shihen, me zë të vendosur dhe të lartë.
Keni kaluar shtrëngatat, detet dhe shkëmbinjtë që të pushtoni tokat e mia. Mendoni se këtu do të gjeni qetësinë? Keni harruar se qetësia juaj do të varet prej nesh, ashtu siç varet gjithmonë paqja e pushtuesit prej durimit të të pushtuarit. Jo. Nuk na njihni mirë. Ju keni marrë guxim prej fatkeqësisë sime dhe prej urrejtjes suaj. Guximi juaj do të jetë edhe fatkeqësia juaj. Ju do t'i shihni kufijtë e vetes kur t'i kaloni kufijtë. Nuk e dini se prej luleve këtu bëhen shpesh ujqit, prej kaprojve lindin shpesh arinjtë; prej dafinave farkohen shpesh shigjetat, kurse prej medosit bëhet shpesh helmi. Ju nuk e njihni këtë popull. Nuk e duron ai shpatën e të vetit e aq më pak e duron shpatën e të huajit. Ky popull e vë krenarinë mbi lumturinë.
Përmbi malet tona fluturojnë shqiponjat dhe prej tyre jemi mësuar të çmojmë mbi çdo gjë tjetër lirinë. Edhe buka na duket e ëmbël, edhe gruri na duket i butë; edhe malet na duken fusha; edhe dimri na duket pranverë vetëm kur jemi të lirë.
Ne i kemi këputur gjithmonë prangat dhe do t'i këpusim aq më shpejt prangat tuaja. Si nuk keni mësuar prej ushtarëve të mi? A ka ngjarë ndonjëherë të zini ndonjë rob dhe ta bëni skllav? Jo. Tani mendoni se do ta shtini në duart bazileshën e tyre!
Jo. Nuk do ta shtini në duar as të gjallë, as të vdekur. Kufomën e saj do ta lëshojë dheu dhe s'do ta shihni kurrë me sytë tuaj. Do të bindeni se edhe pushtimi juaj do të dëshmojë namin tim. Namin e bazileshës, që s'ju ka lënë kurrë të qetë.
(I largohet fronit dhe i afrohet bustit të perëndisë Medaurus para të cilit gjunjëzohet dhe fillon të lutet).
Perëndi? Pse hesht? Fol, së paku sot, mos të shkoj pa ta njohur zërin. Kurrë nuk ta kam dëgjuar fjalën edhe pse kurrë vullnetin tim s'e



Rexhep Qosja

Rexhep Qosja ka lindur më 25 qershor 1936 në Vuthaj të Kelmendit, Malit të Zi. Në vitin 1964 u diplomua në degën Gjuhë-Letërsi të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1971 mori titullin "Doktor i Shkencave Filologjike", me temën "Asdreni - jeta dhe veprat". Ai është autor i antologjive të ndryshme dhe monografive shkencore, duke përfshirë një histori me tri vëllime të letërsisë shqiptare në periudhën romantike. Ai është gjithashtu autor i veprave "Vdekja më vjen prej syve të tillë", "Një dashuri dhe shumë faje", "Vdekja e një mbretëreshe" etj.

kam vënë mbi vullnetin tënd. Ti me heshtje e ke drejtuar fatin tim dhe fatin e popullit tim: të keqen dhe të mirën t'i kemi pranuar njësoj. Kurrë s'të kam lutur si sot, sepse kurrë s'kam dashur ta shqetësoj heshtjen tënde. E, sot? Jam pajtuar me vdekjen time, por mos u pajto ti me pushtimin e popullit tim. Perëndi! Bëj që nami i tij të mos shuhet!

Bëj që nami im të ruhet! Unë do të vdes ashtu si më ka hije: pa më prekur dora e armikut dhe e tradhtarit. Kujdesu që të mos ketë uri dhe etje, që të lulëzojnë pemët dhe të shtohen të korrat, të pjellin bagëtia dhe të shumëzohen bletët, të kenë gjinj nënat dhe të rriten foshnjat. Perëndi! Vetëm Ty të bie në gjunjë dhe vetëm Ty të lutem: mallkoje armikun, dënoje tradhtarin. Dhe mos e harro Laidin tim të vogël, të humbur. Perëndi! Më jep ndjesë herën e fundit, se unë të jap veten.

(Ia ndërpret lutjen zëri i bririt, që bie shtatë herë, duke paralajmëruar dorëzimin e përgjithshëm edhe të rojtarëve të kështjellës. Mbas zërit të bririt shikon dritare më dritare. Heshtje e plotë. Kur kthehet sheh se valltaret dalin njëra pas tjetrës. Pastaj fillon marshi triumfues.)



Të gjithë janë dorëzuar. Tani edhe ato më lanë. Edhe Fari është bërë me ta. Kam mbetur vetëm. Mes luleve më kanë çelur gjarpërinjtë. Kam parë dashurinë edhe atje ku ka qenë urrejtja – si gjithnjë; besnikërinë edhe atje ku ka qenë tradhtia – si gjithnjë. Kam zgjatur dorën që të më nxirret krahu – si gjithnjë; më është dhuruar buzëqeshja e është shikuar froni – si gjithnjë. Unë e vdekur, derisa të tjerët do të jetojnë. Vetëm…

(Qesh duke qarë)

Fjalor

e çmeritur - e mahnitur, e mbetur pa mend.
parzmoren e çunit – veshje prej metali, e gjatë deri në brez, që mbronte luftëtarët në kohët e vjetra gjatë ndeshjeve me armë të ftohta.
medos – këtu: pije e ëmbël.
bazileshë – këtu: mbretëreshë.
Medaurus – zoti i luftës. Ilirët e përfytyronin këtë zot si një kryetrim gjigant, majë një kali zjarrmor, e me një shigjetë në dorën e djathtë.
Fari (Dimitër Fari) – një nga komandantët kryesorë të Teutës, i cili e tradhtoi atë duke ia dorëzuar flotën ilire armikut.

Monologu i brendshëm

Monologu i brendshëm është pjesë e një vepre letrare, që përmban bisedën e personazhit me vetveten, duke shprehur në këtë mënyrë mendimet e ndjenjat e tij, jetën e brendshme dhe gjendjen shpirtërore. Monologu i brendshëm rrit shkallën e dramacitetit.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Përgjigjuni pyetjeve:

a) Cila është fatkeqësia e Teutës?
b) Çfarë çmon Teuta dhe populli i saj më shumë se çdo gjë në botë?
c) Kujt i lutet mbretëresha Teutë? Për çfarë lutet ajo si mbretëreshë dhe si nënë?
ç) Cila është arsyeja që mbretëresha Teutë ndihet shumë e zhgënjyer në fund të tekstit?

Monodrama

Monodrama është një vepër dramatike që shfaqet si drama e një personazhi. Në këto vepra dramatike zakonisht nuk ka shumë veprime, por teksti shfaqet si monolog ose si një shfaqje e asaj që ndodh në botën e brendshme shpirtërore të protagonistit.

Analizojmë tekstin

2 Cilat janë pyetjet që u drejton mbretëresha Teutë ushtarëve pushtues? Shënojini ato dhe shpjegoni përgjigjet e dhëna ose të nënkuptuara prej tyre.

3 Çfarë ka marrë në shkëmbim të asaj që ka dhënë mbretëresha Teutë?

- Dashurinë _____
- Besnikërinë _____

4 Interpretoni frazën: *Keni harruar se qetësia juaj do të varet prej nesh*. Si mund të varet qetësia e pushtuesit nga popullsia e pushtuar?

5 Çfarë do të thotë fraza e mëposhtme?

Mes luleve më kanë çelur gjarpërinjtë.

Çfarë simbolizojnë gjarpërinjtë?

Gjuha e tekstit

6 Në frazën e fundit të tekstit përsëritet vazhdimisht togfjalëshi *si gjithnjë*. Çfarë emocionesh shkakton përsëritja e këtyre fjalëve në këtë tekst?

7 Shënoni me ✓ alternativat e sakta. Ndërtimi i tekstit në formën e monologut e bën tekstin:

- ☐ më të sinqertë;
- ☐ të pavërtetë;
- ☐ më intim;
- ☐ më të besueshëm;
- ☐ me më shumë imagjinatë;
- ☐ më të ngatërruar.

Reflektojmë rreth tekstit

8 Si e vlerësoni faktin që Teuta nuk mendon për veten, por për fatin e popullit të saj? A mendoni se udhëheqësit e vërtetë e vendosin veten e tyre pas popullit që udhëheqin? A ndodh kjo në realitet?

Detyrë

- Mblidhni informacione të tjera rreth mbretëreshës Teutë. Paraqitini dhe diskutojini ato në klasë.

TEKSTI JOLETRAR

Tekstet joletrare kanë përmbajte reale, pra nuk janë të trilluara, ashtu siç ndodh në të shumtën e rasteve me tekstet letrare. Në to tregohen fakte dhe përshkruhen rrethana apo objekte për qëllime funksionale që lidhen me fushën e dijes për të cilën bën fjalë teksti.

Këto lloj tekstesh kanë si qëllim:

- *të tregojnë* ngjarje reale që kanë në qendër njerëz realë (kronika, shënime udhëtimi, biografi, intervista, ditarë etj.);
- *të paraqesin* të dhëna dhe informacione (njoftime, zëra nga enciklopeditë, raporte, relacione, fjalorë etj.);
- *të udhëzojnë*, këshillojnë, urdhërojnë për të mbajtur qëndrime të caktuara (udhëzime, urdhra, receta, ligje, rregullore etj.);
- *të argumentojnë* duke mbështetur ose kundërshtuar ide, opinione, fakte (ese, artikuj, fjalime me karakter nga jeta sociale, ekonomike, politike etj.);
- *të përshkruajnë* njerëz, vende, kafshë, objekte (guida turistike, enciklopedi, tekste shkencore etj.).

Stivi dhe problemat e matematikës

Para leximit

Pjesa e mëposhtme është shkëputur nga biografia e shkruar rreth jetës dhe veprimtarisë së shpikësit dhe nismëtarit të teknologjisë, Stiv Xhobsit. Në këtë pjesë tregohet se kush arriti të zbulonte dhe të nxiste, atëherë kur të tërë e konsideronin një fëmijë problematik, aftësitë e veçanta dhe inteligjencën që e karakterizonte. Tregohet për mënyrën se si zonja Hill, mësuesja e Xhobsit, kishte arritur të kuptonte veçantinë e tij dhe të ardhmen që e priste, ndaj ajo i kishte dhënë vëmendjen e duhur dhe kishte nxitur tek ai dëshirën për të shpërfaqur talentin e fshehur pas sjelljeve çapkëne.

Teksti rrëfyes

Teksti rrëfyes është një lloj shkrimi, në të cilin autori rrëfen duke u bazuar në një ndodhi të vërtetë. Personazhet janë reale, ashtu sikurse vendet, koha dhe ngjarjet. Në këtë lloj shkrimi përfshihen: intervistat, autobiografitë, biografitë, kujtimet, udhëpërshkrimet, mbresat, reportazhet, ditarët, kronikat etj. Rrëfimi gërshetohet me përshkrimin e hollësishëm, shpjegimin dhe informimin nëpërmjet fakteve. Fjalitë janë të thjeshta dhe të qarta, me përdorim të kursyer të figurave letrare.

Stivi e kalonte mërzinë duke u punuar rrengje të tjerëve. “Kisha një shok të mirë që e quanin Rik Ferrentino dhe, bashkë me të, jam futur në lloj-lloj telashesh”, kujtonte. “Për shembull, bënim postera të vegjël ku shkruhej: *Nesër sillni kafshët në shkollë*. Ishte çmenduri me tërë ata qen që ndiqnin macet, ndërsa mësuesve u ziente koka.” Një herë bindëm disa fëmijë të na tregonin kombinimet e çelësave të biçikletave. “Dolëm jashtë dhe ndërruam kodet, pastaj asnjëri nuk merrte dot biçikletën e vet. Iu desh të rrinin deri në darkë sa t’i gjenin.” Kur ishte në klasë të tretë, rrengjet nisën të bëheshin më të rrezikshme.

Kur erdhi koha të futej në klasën e katërt të fillores, shkolla vendosi që do të ishte më mirë t’i ndanin në klasa të ndryshme, Xhobsin dhe Ferrentinon. Mësuesja e klasës së katërt dhe të pestë quhej Igomen Hill, një zonjë e guximshme që i kishin ngjitur nofkën “Tedi” , e cila, siç na rrëfen Xhobsi, u bë “një nga shenjtoret e jetës sime”. Pasi e vëzhgoi nja dy javë, ajo mendoi se rruga më e mirë që të merrej me të, ishte ta nxiste me ndonjë shpërblim. “Një ditë pas shkolle, më dha një libër ushtrimesh me probleme matematike dhe më tha: “Dua që ta marrësh me vete këtë e t’i zgjidhësh të tëra.” Kurse unë mendova: “Mos ke luajtur mendsh?” Pastaj ajo nxori një nga ato lëpirëset e mëdha që dukej sikur nuk mbaronte kurrë dhe tha: “Kur t’i mbarosh ushtrimet, nëse i ke zgjidhur mirë, do të të jap këtë bashkë me pesë dollarë.” Ia ktheva brenda dy ditësh.” Pas disa muajsh, nuk qe më nevoja të joshej duke u shpërblyer. “Doja vetëm të mësoja, që t’i bëja qejfin.”

Ajo ia shpërbleu duke i dhuruar një komplet me pjesë për lëmimin e lenteve, me të cilat mund të ndërtohej një aparat i vogël fotografik. “Prej saj mësova më shumë se nga çdo mësues tjetër dhe, po të mos qe për të, do të kisha përfunduar në burg.” Kjo i përforcoi idenë se

Fjalor

rreng – dredhi ose diçka tjetër e keqe që i bëhet fshehurazi dikujt.
nofkë – emër i dytë që i vihet dikujt sipas ndonjë tipari dallues.

ishte i veçantë. “Në klasën time, ajo kujdesej vetëm për mua. Shihte diçka tek unë.”

Mësuesja nuk kishte parë vetëm zgjuarsinë. Vite më vonë, asaj i pëlqente të tregonte një fotografi të klasës së atij viti në Ditën e Havait. Xhobsi mbërriti në shkollë pa bluzën tradicionale të Havait, që mësuesja e kishte këshilluar të vishte, por në atë fotografi ku ndodhej në qendër të radhës së parë, dukej se e kishte veshur. Në të vërtetë, i kishte mbushur mendjen një djali tjetër ta hiqte bluzën dhe t’ia jepte atij.

Nga fundi i klasës së katërt, zonja Hill i bëri një provim Xhobsit. “Mori aq pikë sa nxënësit e dy viteve më lart”, kujtonte ajo. Tashmë u bë e qartë jo vetëm për djalin e për prindërit, por edhe për mësuesit, se ishte i veçantë nga ana intelektuale, prandaj shkolla bëri një propozim të pazakontë që të kapërcente menjëherë dy klasa e të futej menjëherë në të shtatën; kjo do të ishte edhe mënyra e vetme për ta nxitur. Prindërit, si më të kujdesshëm, vendosën që të kapërcente vetëm një klasë.

(nga vëllimi “Steve Jobs”, Walter Isaacson)

Biografia

Biografia është përshkrimi i jetës së një njeriu, me të dhënat për jetën dhe për veprimtarinë e tij. Biografia përfshin jo vetëm faktet themelore (lindja, arsimi, familja, puna, karriera, vepra, vlerësimet dhe vdekja), por edhe përvojën e personit rreth këtyre ngjarjeve. Ajo shkruhet nga një person tjetër (biograf), i cili mbledh të dhëna rreth personit për të cilin po shkruan një biografi. Këto të dhëna mund të jenë dokumente të ndryshme, letra, letërkëmbime, fotografi, filmime, intervista me njerëz të afërt ose që e kanë njohur personin për të cilin po hartohet biografia në fjalë.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1. Pasi të lexoni fragmentin e mësipërm, përgjigjuni pyetjeve:
   a) Për cilën periudhë të jetës së Stiv Xhobsit flitet në këtë pjesë?
   b) Si e kalonte Stivi kohën? Me kë shoqërohej ai në atë kohë?
   c) Radhitni prapësitë që bënin dy fëmijët.
   ç) Cila ishte nofka e mësueses që i kishte lënë aq shumë mbresa Xhobsit?
   d) Sa pikë mori Xhobsi në provimin që i bëri mësuesja e e tij, zonja Hill?

Analizoni tekstin

2. Cila është mënyra që ndoqi mësuesja për të tërhequr vëmendjen e Stiv Xhobit?
3. Si e interpretoni ju frazën: "Pas disa muajsh, nuk qe më nevoja të joshej duke u shpërblyer."? Çfarë roli luajti mësuesja në jetën e tij?

Gjuha e tekstit

4. Dalloni fjalët e Xhobsit nga fjalët e autorit të biografisë. Si dallohen ata nga ana formale?
5. Gjatë fragmentit ju vëreni se disa fjali janë shkruar në thonjëza. Ato ndryshojnë nga pjesa tjetër e tekstit edhe për faktin se foljet e përdorura janë në vetë të parë. Brenda këtyre thonjëzave janë mbyllur fjali të shprehura nga Stiv Xhobsi dhe nga mësuesja e tij e dikurshme. Ato quhen ndryshe citime. Në gjithë pjesën tjetër të tekstit, foljet janë në vetën e tretë, sepse kemi të bëjmë me fjalitë e shkruara nga autori i biografisë. Ai ka intervistuar Stiv Xhobsin dhe mësuesen e tij dhe, kur ka rindërtuar këtë pjesë të fëmijërisë së Xhobsit, ka përdorur pjesë të këtyre intervistave. Si mendoni, pse autori citon vazhdimisht fjalët e Stiv Xhobsit? Çfarë efekti kanë ato?

Reflektojmë rreth tekstit

6. Stiv Xhobsi shprehet për mësuesen e tij: "Prej saj mësova më shumë se nga çdo mësues tjetër dhe, po të mos qe për të, do të kisha përfunduar në burg". Cili është roli i mësuesve në jetën tuaj? A ka ndonjë mësues që ka luajtur një rol të rëndësishëm në jetën tuaj?

Detyrë

- Gjeni informacione në lidhje me shpikjet që ka bërë Stiv Xhobsi. Shkruani si e kanë ndryshuar botën këto shpikje të tij.



Një shoqe e re

Para leximit

Kjo pjesë është shkëputur nga autobiografia e Hilari Klintonit, "Historia e jetës sime". Në të tregohet se si babai dhe nëna e saj kanë ndikuar në formimin e karakterit të saj të fortë. Rrëfehen ngjarje të thjeshta dhe të vërteta, por të treguara me emocion dhe me ndjesitë e përjetimit të tyre.

Babai im ishte shumë kokëfortë, që ta them në mënyrë të zbutur. Gjatë diskutimeve të gjalla dhe nganjëherë të zjarrta të familjes sonë rreth tryezës së kuzhinës, zakonisht për politikën ose sportin, mësova se nën të njëjtën çati mund të bashkëjetonin mendime të ndryshme. Kur u bëra dymbëdhjetë vjeçe, unë i kisha përcaktuar qëndrimet e mia për shumë çështje. Kisha mësuar gjithashtu se dikush nuk ishte medoemos i keq vetëm sepse ti nuk ishe dakord me të dhe, nëse kishe besim te diçka, ishte mirë që të ishe i përgatitur për ta mbrojtur atë. Të dy prindërit na kishin vënë kusht që të tregoheshim të paepur, me qëllim që të mbijetonim në çfarëdo situate që mund të na hidhte jeta. Ata prisnin që si unë, ashtu edhe vëllezërit e mi të dinim të mbronim veten. Pak kohë pasi u vendosëm në Park Rixh, nëna vuri re se unë ngurroja të dilja jashtë për të luajtur. Nganjëherë kthehesha në shtëpi me sytë e përlotur, duke u ankuar se vajza përballë rrugës gjithmonë më shtynte.

Suzi O'Kallagani kishte vëllezër më të rritur dhe ishte mësuar të ishte e ashpër në lojë. Unë isha vetëm katër vjeçe dhe nëna kishte frikë se, po të dorëzohesha përpara frikës, kjo do të përcaktonte modelin e gjithë jetës sime. Një ditë hyra me vrap në shtëpi. Ajo më ndaloi:

– Kthehu përsëri jashtë, – më urdhëroi ajo, – dhe nëse Suzi të godet, ke lejen time që ta godasësh edhe ti! Duhet të mbrohesh! Në këtë shtëpi nuk ka vend për frikacakët!

Më pas më tha se më kishte ndjekur me sy nga prapa perdes së dhomës së ndenjjes teksa unë drejtova trupin dhe kalova rrugën me hap të sigurt. U ktheva në shtëpi disa minuta më vonë, duke rrëzëllitur nga fitorja.

– Tani mund të luaj me djemtë, – i thashë. – Dhe Suzi do të jetë shoqja ime!

Ajo ishte dhe ende është shoqja ime.



Hilari Klinton

Hilari Klinton (26 tetor 1947) ka qenë Sekretare Shteti, senatore dhe Zonja e Parë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Gjithashtu, ajo ka qenë kandidatja e parë grua, e zgjedhur nga një parti e madhe (Partia Demokratike), për të mbajtur postin e kreut të shtetit amerikan.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1. Cilat ishin temat të cilat nxitnin më shumë diskutime në tryezën e kuzhinës së familjes së Hilarit?
2. Për çfarë kishin shërbyer bisedat e zjarrta në shtëpi? Çfarë kishte mësuar Hilari prej tyre?
3. Sa vjeç ishte rrëfimtarja kur u përball me fqinjën e saj të ashpër, Suzi O'Kallaganin?
4. A pati ndonjë sherr të dhunshëm mes vajzave të vogla? Si përfundoi marrëdhënia e tyre?

Autobiografia

Autobiografia është jetëshkrimi i një njeriu, i hartuar nga ai vetë. Librat autobiografikë zakonisht shkruhen nga personalitete publike, të cilët kanë dhënë kontribut në shoqëri, politikë, shkencë, sport, arte, letërsi etj. Për ta ka interes nga publiku i gjerë sepse nëpërmjet tyre perceptohet rrugëtimi i jetës së personit që e ka shkruar librin dhe kuptohen zgjedhjet që atij i janë dashur të bëjë në jetë.

Analizojmë tekstin

5. Gjeni në tekst përgjigjen e nënës për vajzën e saj, e cila po kthehej në shtëpi duke qarë.
   Cila ishte frika e nënës për mospërballimin e situatës nga vajza e saj?
6. Në fund të tekstit thuhet: *Dhe Suzi do të jetë shoqja ime! Ajo ishte dhe ende është shoqja ime.* Çfarë tregojnë këto fjalë për karakterin e autores?
7. Diskutoni rreth këtyre fjalëve: *Kisha mësuar gjithashtu se dikush nuk ishte medoemos i keq vetëm sepse ti nuk ishe dakord me të dhe, nëse kishe besim te diçka, ishte mirë që të ishe i përgatitur për ta mbrojtur atë.* Si e kuptoni ju këtë mendim?

Gjuha e tekstit

8. Në çfarë kohe janë në përgjithësi foljet e kësaj pjesë? Pse ndodh kjo? Për çfarë kohe tregohet?
9. Kush është personazhi i këtij teksti? Po autori? Nga e kuptoni këtë?

Dallojmë biografinë nga autobiografia



Studim teksti

Reflektojmë rreth tekstit

10 A mendoni se prindërit duhet t'i mbrojnë apo t'i mësojnë si të mbrohen fëmijët e tyre? Pse?

11 Duke u nisur nga teksti i mësipërm, diskutoni si ndikojnë ngjarjet e së shkuarës në jetën tonë.

Shkruajmë

- Përdorni skemën e mëposhtme për të shkruar autobiografinë tuaj. Përfshini në tekstin tuaj edhe opinione, mendime personale dhe përshkruani emocionet tuaja.

Skemë për shkrimin e autobiografisë		
HYRJA	**Prezantimi:** *të dhëna rreth vitit të lindjes, vendit të lindjes dhe përshkrim i shkurtër i paraqitjes fizike*	- *Kush je?* - *Sa vjeç je?* - *Kur ke lindur?* - *Ku ke lindur?* - *Ç'veçori fizike ke?*
ZHVILLIMI	**Familja ime:** *nga kush përbëhet?*	- *Si quhen prindërit e tu?* - *Çfarë profesioni kanë?* - *Ke motra apo vëllezër?*
	Pasionet e mia	- *Cilat janë sportet që praktikon në kohën e lirë?* - *Cili është pasioni yt?* - *Si e ke kultivuar atë?*
	Miqësitë	- *Cilët janë miqtë e tu më të mirë?* - *Çfarë ndien për ta?* - *Trego një ngjarje në të cilën je përfshirë ti dhe një ose më shumë nga shokët e tu.*
MBYLLJA	**E ardhmja**	- *Si e mendon veten deri në klasë të nëntë?* - *Çfarë do të doje të bëje kur të rriteshe?* - *Cilat janë ëndrrat e tua?* - *Si ndihesh kur e imagjinon veten të rritur? Përse?*

Rrëfimet në vetë të parë: Tirana, Durrësi, Kruja

Para leximit

Teksti i mëposhtëm është një fragment nga libri me mbresa dhe kujtime, "Rrëfimet në vetë të parë", i aktorit të njohur shqiptar, Bekim Fehmiu, gjatë një vizite në Shqipëri.
Bekim Fehmiu tregon përshtypjet e tij për Tiranën dhe për disa qytete të tjera shqiptare. Ai e përqendron vëmendjen tek arkitektura, rrugët, skulpturat, vendet arkeologjike, muzetë, por sidomos te pritja e njerëzve, te mënyra se si e presin me aq shumë dashuri e respekt.

Fjalor

regjisor – drejtues artistik i punës që kryhet për të vënë në skenë një pjesë teatrale ose për të bërë një film.

Bekim Fehmiu

Bekim Fehmiu është një nga artistët më të mëdhenj shqiptarë. Ai ishte një aktor shqiptar nga Kosova. Rrjedh nga një familje e njohur gjakovare. Ai është aktori i parë shqiptar i filmit dhe i teatrit, i cili ka luajtur me sukses në filmat dhe skenat e gjithë hapësirës së ish-Jugosllavisë. Ka qenë një nga personalitetet që ka lënë gjurmë në kinematografinë ballkanike, por mbi të gjitha, çmohet për kontributin artistik në kinematografinë botërore.

Java e filmit shqiptar. I ftuar... Mbahej për herë të parë "Java e filmit shqiptar" në Beograd në Shtëpinë e Rinisë. Mezi arrita të shihja fundin e projektimit të njërit prej filmave. Takoj Abdurrahman Shalën, regjisorin e ri Besim Sahatçiu... Më njohën me dy regjisorë të rinj nga Shqipëria, Piro Milkani dhe Dhimitër Anagnosti.
– A do të kishit ardhur tek ne si i ftuar? – më pyet Dhimitri, ai shtatshkurtri me tipare të zeza, i cili studimet e kamerës dhe të regjisë i kishte kryer në Leningrad dhe në Moskë.
– Me shumë dëshirë, nëse më ftoni!
[...] Erdhi ftesa që të isha i ftuar i "Kinostudios" shqiptare.

TIRANA

Më sistemuan në hotel "Dajti" në qendër të qytetit. Më pëlqeu heshtja, pa atë zhurmën e qarkullimit të automjeteve, vetëm ndonjë biçikletë. Tirana duket e bukur. Bulevarde të gjera, me shumë lule, me pemë anash... Monumenti i Gjergj Kastriotit dominon tërë qendrën. Mikpritësit kishin organizuar shfaqjen e filmit "Odiseja". Salla e kinemasë e mbushur plot e përplot me të ftuar të përzgjedhur.

Duartrokitje dhe pritje njëlloj sikur presin një njeriun e tyre. Me krenari, me gëzim, me ngrohtësi. Filluan vizitat zyrtare. Në Lidhjen e Shkrimtarëve, krahas me të tjerët, njihem me Ismail Kadarenë, Dritëro Agollin […].

DURRËSI

Durrësi. Teatri. Në fuaje, busti i Aleksandër Moisiut. Marr pjesë për herë të parë në një koncert me këngë e valle shqiptare. Zëra madhështorë, të shkolluar. Bukuria e atyre valleve të ngadalta për nga ritmi, por dinjitoze, dhe menjëherë më pas shumë të gjalla. Valltarët e veshur me kostume popullore shumëngjyrëshe. Jam i emocionuar, thuajse më zihet fryma dhe jam shumë krenar që po më jepet rasti të shoh këtë bukuri. Më shpunë të njihem me anëtarët e Ansamblit. I përgëzoj dhe i falënderoj që më bënë të përjetoj këtë ndjesi të paharrueshme. Nuk e kisha ditur se në Durrës kishte një amfiteatër, madje edhe i madh sa ai i Koloseut romak. Është zbuluar vetëm një e treta. Shoqëruesit më takuan me arkeologun amator. Dridhet nga emocioni, duke më treguar një varëse të hollë prej ari, ku ishte varur një figurë në formën e gjethes së duhanit. Dridhet sa herë që e prek. Çfarë thesari! Thesar i vërtetë kulturor, shpirtëror. Me sugjerimin e atyre që më shoqëronin, më dhuroi, si pa qejf, një kopje të Afërditës të shekullit IV-V p.e.s.

KRUJA

Vendlindja e Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Cili është ky gjeni, i cili arriti që për çerek shekulli të ndalë fuqinë e pandalshme të Perandorisë Osmane dhe të mos e lejojë depërtimin e saj drejt Perëndimit? Kalaja e Skënderbeut, e cila dominon në tërë kodrën e qytetit, është e rikonstruktuar nga disa pjesë të saj të shekullit XIV.
– Përse përkrenarja e Skënderbeut ka një kokë dhie? – e pyes ciceronin e muzeut.
– Gjatë një beteje, Skënderbeu lidhi pishtarë pishe në brirët e dhive, të cilat pastaj i lëshoi para ushtrisë së tij. Turqit u frikësuan "nga kjo ushtri e madhe që po vinte drejt tyre" dhe u tërhoqën. Në shenjë përkujtimi për këtë betejë, ai e zbukuroi përkrenaren e tij me kokën e dhisë me brirë. Sapo hymë në kështjellë, e pyes: – Përse keni ndërtuar një muze prej alumini e qelqi në një ambient të rrethuar me gurë qindravjeçarë? Keni futur Amerikën në kështjellë.

(nga vëllimi "Rrëfimet në vetë të parë")

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

a) Çfarë dini rreth aktorit shqiptar Bekim Fehmiu?
b) Kush i bëri ftesë aktorit të madh për të vizituar Shqipërinë? Ku iu bë kjo ftesë?
c) Ku u vendos aktori në Tiranë? Çfarë përshtypje i bënë rrugët e Tiranës?
ç) Jepni detaje të përshtypjeve të aktorit të madh në sallën e kinemasë ku u shfaq filmi "Odiseja".
d) Në çfarë koncerti mori pjesë në qytetin e Durrësit?
dh) Pse i shkaktoi habi vizita në amfiteatrin e Durrësit?
e) Cilat vende vizitoi Bekim Fehmiu gjatë vizitës së tij në Krujë?
ë) Çfarë pyetjesh bëri aktori në lidhje me Gjergj Kastriotin?

Analizojmë tekstin

2 Si e shpjegoni emocionalitetin e dialogut mes aktorit dhe regjisorit shqiptar, Dhimitër Anagnosti?

– *A do të kishit ardhur te ne si i ftuar?*
– *Me shumë dëshirë, nëse më ftoni!*

3 Përse Bekim Fehmiu nuk e kishte vizituar më parë Shqipërinë?

4 A dëshmohet në këto mbresa udhëtimi gjendja e shqiptarëve andej e këndej kufirit?

5 Cilat janë emocionet e aktorit në përshkrimin e përshtypjeve nga Durrësi?

Interpretoni tekstin

6 Shpjegoni kuptimin e shprehjes me të cilën Bekimi përshkruan Durrësin:

Çfarë thesari! Thesar i vërtetë kulturor, shpirtëror.

7 Çfarë kuptoni nga shprehjet e aktorit për muzeun e Krujës:

Keni futur Amerikën në kështjellë.

Gjuha e tekstit

8 Nënvizoni fjalët ku tregohet emocioni i thellë që përjeton aktori nga respekti i madh me të cilin e presin kudo në Shqipëri.

9 Gjeni në tekst fjalët të cilat tregojnë habinë dhe krenarinë që ndien aktori i njohur, kur sheh pasurinë shpirtërore dhe kulturore të shqiptarëve në Shqipëri.

10 Çfarë emocioni ngjall përafrimi i grupit të fjalëve *"një muze prej alumini e qelqi"* me grupin e fjalëve *"të rrethuar me gurë qindravjeçarë?"*

Reflektojmë rreth tekstit

11 Kur lexoni mbresat e udhëtimit të aktorit të madh shqiptar Bekim Fehmiu, ju zgjohet kërshëria për njohjen e të gjitha trojeve shqiptare. Po ju, cilat troje shqiptare jashtë kufijve të Kosovës do të dëshironit të vizitonit?

Dekada e Majlinda Kelmendit

Para leximit

Sportistët janë ata, të cilët me sukseset e arritura, i bëjnë kombet e tyre të ndihen krenare. Majlinda Kelmendi i ka bërë shqiptarët e Kosovës e të Shqipërisë, si dhe ata që jetojnë anembanë botës, kryelartë. Kur arriti të fitonte medaljen e artë olimpike, ajo ngriti lart flamurin e Kosovës duke përfaqësuar një shtet të pavarur. Medalja e Majlindës është medalja e parë olimpike për shtetin e Kosovës.

Fjalor

dekadë – periudhë kohe që zgjat dhjetë vjet rresht; dhjetëvjetësh, dhjetëvjeçar.

Në dekadën e parë të jetës së shtetit të Kosovës, 2008-2018, Majlinda Kelmendi ka bërë rrugëtim të jashtëzakonshëm dhe ka prekur nivelet më të larta të mundshme.

Ajo ka prekur kulmin në sportin e xhudos dhe vlerësohet të jetë figura më e njohur dhe më e suksesshme e Kosovës në dhjetëvjetëshin e parë të funksionimit si shtet.

Majlinda vazhdimisht merret si shembull suksesi për shtetin e Kosovës, si një rrëfim suksesi. Emri i saj është përmendur në nivelet më të larta politike botërore, sa herë që drejtues të vendit, por edhe zyrtarë ndërkombëtarë, kanë argumentuar shpalljen e Pavarësisë dhe njohjen e shtetit të Kosovës. Majlinda ka fituar medalje të shumta gjatë kësaj dekade, por veçohet triumfi në Lojërat Olimpike në Rio de Xhanejro të Brazilit, ku xhudistja nga Kosova fitoi medaljen e artë, duke bërë krenarë shqiptarët në gjithë botën.

Majlinda Kelmendi

Majlinda Kelmendi (9 maj 1991) është xhudiste shqiptare nga Peja. Në vitin 2013, Majlinda qëndronte në vendin e parë në renditjen ndërkombëtare nga Federata Ndërkombëtare e Xhudos për kategorinë 52 kg. Në vitin 2014, Majlinda u shpall xhudistja më e mirë në botë në të gjitha kategoritë nga presidenti i FNXH-së, Marius Vizer. Më 24 dhjetor 2014, ajo u dekorua nga presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga me titullin "Medalja Presidenciale e Meritave".

Kronika

Kronika është një lloj shkrimi që u kushtohet lajmeve të përditshme nga një fushë e veçantë e jetës ose e veprimtarisë së njerëzve. Në të rrëfehen fakte që kanë ndodhur vërtet. Informacioni që ajo jep, u përgjigjet pyetjeve: *Kush? Çfarë? Ku? Kur? Kush? Si?*

Në përgjithësi, kronikat janë shkrime të shkurtra, por të strukturuara mirë, ku dallohen mirë data, fakti, situata, pasojat.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1. Lexoni kronikën dhe përgjigjuni pyetjeve:
   a) A e kishte parashikuar ndokush suksesin e Majlinda Kelmendit, vite më parë?
   b) Cili është kulmi i suksesit në karrierën e Majlindës?
   c) Si i priti publiku shqiptar dhe ai botëror rezultatet e Majlindës?

Analizojmë tekstin

2. Numëroni rezultatet më të rëndësishme të Majlinda Kelmendit.
3. Gjeni në tekst për çfarë merret si shembull Majlinda.
4. Në tekst thuhet se: *Si ajo vlerësoheshin edhe shumë e shumë sportistë të tjerë të vendit. Dhjetë vjet më vonë, asnjë nuk është si ajo...”* Çfarë mendoni se e bëri Majlindën të arrinte rezultatet e pritura, ndërsa sportistët e tjerë jo?

Gjuha e tekstit

5. Nënvizo frazat ku përmendet emri i Majlindës. Shkruani fushën leksikore të kësaj fjale. P.sh.: “Majlinda ka fituar medalje të shumta gjatë kësaj dekade...”
6. Gjeni në tekst frazat në të cilat rrëfimtari bëhet subjektiv.

Reflektojmë rreth tekstit

7. Shpesh thuhet se sportistët prezantojnë veten, por edhe ngjyrat e flamurit të tyre. Diskutoni rreth këtij pohimi.
8. Majlinda ka fituar medalje të artë olimpike. Pse përmendet kaq shumë fitorja e saj? Çfarë ka bërë ajo përtej sportit me fitoren e saj?

Detyrë

- Gjeni disa kronika të llojeve të ndryshme në gazeta, revista dhe internet. Këto materiale, lexojini në klasë dhe diskutoni rreth ngjarjeve të tyre.

Shkruajmë

- Më poshtë jepet modeli gjysmë i gatshëm i një kronike të strukturuar sipas pyetjeve që e karakterizojnë atë. Plotësoni kronikën.

Takohemi për një libër

Jemi në _____ *Ku?*

Është ora _____ *Sa?*

Në sallën e leximit _____ *Ku?*

Të pranishmit kanë ardhur për arsye se _____ *Pse?*

Studim teksti

Me ne ndodhen _____ *Kush?*

Pritet të vijë _____ *Çfarë?*

Para nesh po kalon _____, *autor i mirënjohur* _____ *Kush?*

Dhjetëra _____ *Sa?*

Pjesëmarrësit u shpërndanë _____ *Kur?*

- **Lexoni udhëzimet e mëposhtme dhe shkruani një kronikë rreth ngjarjeve të fundit kulturore në vendbanimin tuaj.**
  - Zgjidhni temën.

    - Një ngjarje kulturore.
  - Përshkruani vendin ku zhvillohet ngjarja.

    - në teatër, kinema, sallë koncertesh etj.
  - Jepni sa më shumë elemente që përcaktojnë kohën dhe vendin.
  - Jepni fakte dhe shifra rreth numrit të spektatorëve dhe të organizatorëve.

Intervista

Nexhmije Pagarusha, me zërin e saj e vulosi shekullin e njëzetë!

Para leximit

Vendoset në sfond kënga "Baresha" e Nexhmije Pagarushës.
Çfarë dini për këngëtaren Nexhmije Pagarusha?
Diskutoni në klasë për rolin që ka muzika në jetët e njerëzve.

Znj. Pagarusha, kur filluat ju të këndoni ishte shumë e vështirë të ishe femër e aq më e vështirë të ishe femër artiste. Çfarë do të kujtoni nga ai fillim?

N. P.: Ka qenë vërtet shumë, shumë vështirë. Tash po e shoh sa më vështirë ka qenë atëherë se sa tash. Mirëpo unë kam pasur një grusht njerëzish të cilët më kanë ndihmuar shumë, më kanë inkurajuar, p.sh., Skënder Gjinali, i cili ka qenë shef i grupit të produksionit, mandej i ndjeri Ismet Mula, drejtor, pastaj Lorenc Antoni etj., të cilët me dashurinë e tyre për artin me të vërtetë na kanë ndihmuar shumë. Na kanë shtyrë përpara. Kështu unë dua që të shfrytëzoj këtë rast dhe t'i falënderoj publikisht sepse kanë bërë shumë për ne.

Po si e kultivuat zërin dhe talentin më pas?

N.P.: Natyra kur të fal diçka, të fal! Ose të fal diçka të mrekullueshme ose të shëmton. Unë nuk e di se si natyra më ka falë këtë zërin tim të impostuar, që unë kurrë nuk ia kam ditë vlerën. Kam kënduar 40 vjet e nuk e kam ditë si po këndoj. Tash po e



Nexhmije Pagarusha

"Kam kënduar 40 vjet e nuk e kam ditë si po këndoj. Tash po e shoh se paskam kënduar mirë"!

Nexhmije Pagarusha, legjenda e gjallë e këngës shqiptare, lind më 7 maj të vitit 1933 në Pagarushë. Babai i Nexhmijes, Veseli, mësues, siç thotë Nexhmija, është më meritori që nuk e la këtë yll të shuhej, por na e dhuroi të gjithëve deri në shkallë krenarie. Dikush e quajti Bilbili i Kosovës, dikush Mbretëresha e Këngës Shqipe, dikush tjetër Primadona e Melosit Popullor, Ema Sumak shqiptare, Fyti i Kristaltë e të tjera, e të tjera. Të gjitha këto epitete janë bërë sinonim për emrin e Nexhmije Pagarushës dhe mbase të gjithë kanë të drejtë, sepse të gjithë gjejnë diçka të veçantë në zërin e saj magjik. Nuk pretendojmë t'i themi të gjitha në një intervistë, me hapësirë të kufizuar, kur bëhet fjalë për një kolos siç është Nexhmija.

shoh se paskam kënduar mirë!

Ne konsiderojmë se "Baresha" është kryevepra e interpretimit tuaj. A pajtoheni ju me këtë?
N. P.: Unë pajtohem me konstatimin se kjo është kryevepër e kompozitorit Rexho Mulliqit dhe poetit Rifat Kukaj!

Për ju janë dhënë vlerësime në superlativ! Ka qenë e vështirë të arrini këtë famë?
N. P: Në vend që unë të përgjigjem në këtë pyetje do të kisha cituar një thënie të Dantes: "*Rruga që shpie drejt ngjadhënjimit asnjëherë nuk është e mbushur me lule*".

Keni qenë ambasadore e vërtetë e këngës shqipe nëpër botë. Çfarë do të veçonit si diçka më karakteristike nga ato udhëtime dhe cila është fuqia e prezantimit para të tjerëve përmes muzikës?
N. P.: Kam udhëtuar shumë dhe kam folur me gjuhën e popullit tim! Kudo ku shkova, me këtë gjuhë fola dhe të gjithë më kuptuan. Kënga popullore shqipe është vërtet e bukur. Populli ynë ka një kulturë të lashtë. Ata kompozitorë që nuk dihen me emër kanë krijuar dhe i kanë dhënë shpirt këngës. Është e veçantë kënga popullore dhe është klasikë që s'e ka kush, që na e lakmojnë shumë. Besoj shumë që këngën popullore kushdo që do ta kish kënduar ashtu edhe do të tingëllonte, plot shpirt.

Shumë këngëtarë, duke folur për ju, thonë se keni qenë shkollë për ta, pra pikë reference. Për çfarë i këshilloni ata kur kërkojnë mendimin tuaj?
N. P.: Kurrë askush nuk e ka kërkuar mendimin tim! Mbasemendojnë se i dinë të gjitha ose kanë ngurruar duke menduar se nuk do t'i këshilloj! Ndoshta edhe kanë bërë mirë. Secili duhet ta gjejë veten në interpretimin e vet.

Çfarë do t'u thoshit sot atyre që kanë ngurruar t'ju pyesin?
N. P.: Le të këndojnë me shpirt. Le ta duan këngën e mirëfilltë popullore se kurrë nuk do të dështojnë dhe le të jenë vetja e tyre!

Jeni shpallur këngëtare e shekullit XX pra, e shekullit të kaluar. Keni marrë edhe shumë çmime të tjera. A do të veçonit ndonjërin prej tyre?
N. P.: Po, çdo shpërblim ka qenë një moment i rëndësishëm për punën që kam bërë. Jam gëzuar shumë, besa, edhe jam befasuar. Ata kanë qenë të mirëseardhur se për ato 40 vjet punë gjithnjë kam dyshuar se po këndoj mirë! Publiku më ka vlerësuar, kritikët, gazetarët. Kjo vërtet është një mrekulli që kam përjetuar, gjithë këto mirënjohje dhe çmime të tjera të ndryshme!

Intervista

Është një komunikim në formë pyetje-përgjigjesh midis dy individësh për çështje të rëndësishme që mbështeten në fakte dhe në opinione të folësve. Intervista synon të njohë mendimet, qëndrimet, perceptimet, përvojat dhe karakteristikat e të intervistuarit. Intervista mund të jetë:

a. e strukturuar;
b. gjysmë e strukturuar;
c. e lirë.

Në fund fare...

N. P.: I dëshiroj popullit tim një ecje më të shpejtë përpara. Të mundohemi të gjithë bashkë t'i shërojmë plagët. Vuajtjet dhe përjetimet e tmerrshme nuk harrohen, por jeta vazhdon. Të gjithë të japim aq sa mundemi, të mos presim vetëm nga të tjerët, se vetëm me angazhim të madh mund të ndërtojmë një shtet që u ka hije shqiptarëve dhe të jetojmë të lumtur!

(Intervistoi: F. Durmishi)

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Pasi të keni lexuar intervistën, përgjigjuni pyetjeve:

a) Çfarë epitetesh i kanë vendosur Nexhmije Pagarushës për zërin e saj?
b) Cila është kënga që konsiderohet si kryevepra e interpretimit të Nexhmije Pagarushës?
c) Si e shfaq mirënjohjen Nexhmija në këtë intervistë?
ç) Cila është rëndësia dhe vlera e veprës së Nexhmijes, dhe pse ajo është çmuar e vlerësuar nga njohësit e artit?
d) Në jetën artistike, Nexhmija mori shumë çmime, të cilat ajo nuk mund t'i veçojë. Ju a mund të veçoni çmimin apo titullin me të cilin Nexhmije Pagarusha vulosi me emrin e saj shekullin XX?

Analizojmë tekstin

2 Cilat janë emocionet e këngëtarës gjatë intervistës? Nënvizoni mbiemrat dhe ndajfoljet që përcaktojnë gjendjen e saj shpirtërore.

3 Gjeni në intervistë si mendon ajo se e ka kryer misionin e ambasadores së këngës shqipe.

4 Ç'dëshiron të thotë Nexhmija me fjalët që citon: *"Rruga që shpie drejt ngadhënjimit asnjëherë nuk është e mbushur me lule".*

5 Diskutoni rreth përgjigjes së fundit të këngëtares në intervistë. Çfarë e këshillon dhe çfarë i dëshiron popullit të saj këngëtarja?

6 Analizoni përgjigjen e Nexhmije Pagarushës për këshillën që do t'u jepte këngëtarëve të rinj. *Le ta duan këngën e mirëfilltë popullore se kurrë nuk do të dështojnë dhe le të jenë vetja e tyre!* Zbërtheni nëntekstin e kësaj përgjigjeje.

Reflektojmë rreth tekstit

7 Si i kuptoni fjalët e Nexhmije Pagarushës:*"Kam kënduar 40 vjet e nuk e kam ditë si po këndoj. Tash po e shoh se paskam kënduar mirë!"*?

8 Formuloni dy pyetje që do të donit t'ia drejtonit Nexhmije Pagarushës.

Detyrë

- Përgatitni pyetjet e një interviste për një personalitet të njohur të vendbanimit tuaj. Përpiquni ta kontaktoni dhe të merrni prej tij përgjigjet e tyre.

Bjeshkët e Rugovës - mirë se vini në mbretërinë e natyrës!

Para leximit

Shikoni fotografi apo video me pamje nga Bjeshkët e Rugovës. Përshkruani emocionet që ju shkaktojnë ato.

Kosova, edhe pse vend i vogël, ka mjaft resurse turistike, që krijojnë mundësitë për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit, trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Bjeshkët e Rugovës janë destinacion i mrekullueshëm në çdo stinë.

Udhëpërshkrimi

Udhëpërshkrimi është një lloj i veçantë i rrëfimit joletrar. Ai është një prej gjinive më të vjetra dhe më me ndikim të shkrimit. Ky lloj publicistik ka lindur nga udhëtimet e njerëzve nëpër vende të ndryshme dhe nga shkrimet që kanë lënë ata. Udhëpërshkrimi është përshkrim dhe rrëfim kronologjik i viseve, njerëzve dhe ngjarjeve, si dhe i temave që lidhen me një rrugëtim. Udhëpërshkrimi sjell të dhëna të plota, fakte, njerëz, kultura, mendime, visore, emra e deri edhe elemente fantastike apo magjike.

Ndër destinacionet turistike, që mund të kryesojnë listën e destinacioneve tërheqëse kosovare, janë Bjeshkët e Rugovës, një nga vendet më të bukura në Kosovë, ku mund të përjetoni përvoja të paharrueshme mes ajrit të pastër e natyrës, që është treguar vërtet bujare me këtë vend.

Ju mund ta vizitoni në çdo stinë këtë krahinë të mrekullueshme, duke qenë të sigurt për argëtimin tuaj, i cili fillon me shëtitjet në natyrë, me gjelbërimin marramendës, me ekspeditat e gjata zbuluese të vendeve më të bukura, me shijimin e ushqimeve natyrale dhe mikpritjes së pashoqe, e përfundon me sportin e skive që ju presin në zemër të dimrit për të rrëshqitur mbi shpatet njëherazi të buta e të ashpra.

Rugova është një lokalitet më vete, që përbëhet prej 13 fshatrave, të cilat shtrihen në perëndim të qytetit të Pejës, nga të dyja anët e këtij qyteti. Rugova fillon aty ku Bistrica e Pejës del nga Gryka e Rugovës dhe vazhdon gjatë këtij lumi deri te burimet e tij në Qafë të Qakorrit në perëndim.

Territori i Rugovës në kohën e sundimit osman ka qenë edhe më i gjerë. Kështu, në perëndim përfshinte malet e Smajlovicës,

Gllogjinë dhe Rekat e Shekullarit, dhe vazhdonte deri në afërsi të Tregovishtes (Rozhajës), ku përfshinte disa katunde. Pastaj vazhdonte bjeshkëve dhe kufizohej me Bjeshkët e Rusolisë, duke përfshirë Lipën dhe përfundonte përsëri në Pejë.

Në kohën e Perandorisë Osmane, por edhe më vonë, Rugova përfshinte në gjirin e vet disa katunde e vende përreth, si: Buxhovin, Husajt, Dacajt, Katundin Peshkaj, Plluncaj e shkonte deri në Ballotiq. Shumica e këtyre banorëve janë Lajç e Nikç. Rugova tani në gjirin e saj përfshin këto katunde: Shtupeqin e vogël, Shtupeqin e Madh, Rekën e Allagës, Malajn, Drelajn, Kuqishtën, Haxhajn, Stankajt, Bogën, Shkrelin, Dugajevën, Koshutanin dhe Pepajn. Pjesën dërrmuese të popullatës e përbëjnë kelmendasit, por ka edhe pjesëtarë të fiseve Shalë Shkrel dhe Kastrat.

Kjo zonë e Kosovës është kthyer sot në qëllimin turistik jo vetëm të shqiptarëve të Shqipërisë, por të shumë turistëve në kërkim të natyrës e aventurës, të cilët pranverës e verës eksplorojnë nëpër magjitë e Bjeshkëve të Rugovës, e dimrit shëtisin me "Mace dëbore" ose bëjnë ski. Nuk është kurrë vonë për të zbuluar të bukurën, sidomos kur ajo është fare pranë!

(*Revista "Travel"*)

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Lexoni udhëpërshkrimin dhe përgjigjuni pyetjeve:

a) Cila është koha më e përshtatshme për të vizituar Bjeshkët e Rugovës?

b) Çfarë ofron ky vend për turistët?
Shënoni me ✓ alternativat e sakta.

- ☐ Ajrin e pastër.
- ☐ Detin e mrekullueshëm.
- ☐ Shëtitjet në natyrë.
- ☐ Rrezet e nxehta të diellit.
- ☐ Gjelbërimin marramendës.
- ☐ Koncertet e shumta që zhvillohen atje.
- ☐ Ushqimin e shijshëm.
- ☐ Ekspeditat zbuluese të vendeve të veçanta.
- ☐ Ushtrimin e sërfit.
- ☐ Ushtrimin e skive.

c) Sa fshatra përfshin zona e Rugovës?

Analizojmë tekstin

2 Përveç bukurisë natyrore, në tekst theksohet edhe një karakteristikë kryesore e vendasve. Gjejeni dhe diskutoni rreth saj.

3 Rogova shtrihet në perëndim të qytetit të Pejës. Ku fillon dhe deri ku vazhdon shtrirja e Rugovës? Çfarë mendoni për shtrirjen gjeografike të saj? Është një vend i gjerë apo i kufizuar?

Interpretojmë tekstin

4 Autori i këtij udhëpërshkrimi shprehet: *Kjo zonë e Kosovës është kthyer sot në qëllimin turistik jo vetëm të shqiptarëve* [...]. Çfarë kërkon të theksojë me këtë fjali?

5 Në tekst thuhet për Bjeshkët e Rugovës: *Ndër destinacionet turistike, që mund të kryesojnë listën e destinacioneve tërheqëse kosovare, janë Bjeshkët e Rugovës [...]*. Pse bën pjesë në destinacionet më të mira? Çfarë ka më shumë se vendet e tjera?

Gjuha e tekstit

6 Pasi ta lexoni tekstin, nënvizoni frazat ku gjuha e udhëpërshkrimit është:

- objektive;
- subjektive.

Reflektojmë rreth tekstit

6 Pasi keni lexuar këtë udhëpërshkrim, a do të donit t'i vizitonit Bjeshkët e Rugovës? Për ç'arsye?

Detyrë

- Sipas modelit të këtij fragmenti, shkruani një udhëpërshkrim të shkurtër për vendbanimin tuaj.

Në Beratin e një mijë e një mrekullive

Para leximit

Në këtë reportazh tregohet për një udhëtim nëpër thesaret kulturore që ofron qyteti i Beratit. Natyra dhe pozicioni gjeografik i Beratit i lënë udhëtarët gojëhapur, sapo shkelin. Qyteti i Beratit ka një kala 2400-vjeçare, që banohet edhe sot e kësaj dite. Lumi Osum kalon mes përmes qytetit, gjë që kushtëzon praninë e urave të vjetra dhe shumë të bukura. Një nga vendet më interesante është Muzeu Kombëtar Ikonografik "Onufri" ku ndodhen Kodikët e Purpurt.

Është mesi i verës dhe Tomori hijerëndë zbardh ende. Nga larg ai është orientuesi kryesor për në Berat. "Berati është ndër të vetmet qytete, mes atyre që kam parë, me "far natyror", shprehej udhëtari anglez Hobhauz.

Për pak minuta gjendemi në Berat dhe prezantimi i parë është me lagjet Mangalem e Goricë, tejet të rëndësishme për këtë qytet. Një qytet si Berati, i ndarë në mes nga një lumë, domosdo që pjesë thelbësore të tij ka urat lidhëse, më e bukura ndër të cila është ajo e Goricës, tashmë e rikonstruktuar.

Sipas dokumenteve osmane, ura e Goricës është ndërtuar fillimisht në vitin 1780. Pavarësisht se themelet e kësaj ure datojnë në shekullin XVIII, mendohet se ura që lidhte dy anët e Osumit ka ekzistuar edhe më herët, kur ka lindur nevoja për komunikim mes dy lagjeve: Goricës dhe Mangalemit. Si çdo gjë tjetër në Berat, edhe ura mistike mbi Osum të bën ta sodisësh gjatë. Një legjendë thotë se në njërën nga këmbët e urës së Goricës ndodhej një zgavër, në të cilën burgosej dhe flijohej një vajzë, që ura të qëndronte e fortë dhe t'i bënte ballë furisë së Osumit të "zemëruar" gjatë dimrit. Legjenda thotë se zgrava ka ekzistuar deri në vitin 1923, kur ura është rikonstruktuar.

Për sa i përket ndërtimit dhe strukturës së saj, vlen të përmendet se kjo urë në fillim ka pasur 9 harqe, ndërsa sot, pas disa rindërtimesh dhe rikonstruksionesh, ka mbetur vetëm me shtatë të tilla.

Në Berat, historitë janë në "konflikt" me njëra-tjetrën, se cila urë është më e bukur. E tillë është dhe historia e urës së Velabishtit me urën e Goricës. Kur Hobhauzi kaloi në krahinën e Beratit, ai u ndal përballë një ure që e surprizoi për nga arkitektura, vendndodhja dhe mjeshtëria e ndërtimit. Nga ato që kishte lexuar, historiani mendoi se ishte në urën e Goricës, por shoqëruesit e sqaruan se qe ura e Velabishitit.

Kalaja e Beratit (ajo që shohim sot) është një ngrehinë mesjetare, e ndërtuar në themelet e një kalaje dhe vendbanimi antik, ku ka pasur qendrën e tij fisi ilir i dasaretëve. Kalaja e Beratit vazhdon

Fjalor

rikonstruksion – rindërtim, ndryshim i ndërtimit për ta përmirësuar ose për ta ruajtur një objekt.
antik – shumë i vjetër, i lashtë, që i përket periudhës së Greqisë e të Romës së Vjetër.
mesjetar – që ka lidhje me mesjetën, e cila është një periudhë historike që shtrihet përafërsisht nga shekulli V deri në shekullin XVIII.

të banohet që prej më shumë se 2400 vjetësh, duke e bërë atë një nga vendbanimet e rralla ku jeta nuk është ndërprerë. Në antikitet, kalaja ishte një vendbanim proto-urban dhe tejet startegjik, për shkak se ndodhet në një kodër 200 metra mbi nivelin e detit dhe pozicion strategjik mbi të gjithë fushën e Myzeqesë, me fushëpamje deri në detin Adriatik.

Kalaja, si ndër të paktat në llojin e saj, ka pasur 24 kulla vrojtimi. Këto të fundit më së shumti janë ndërtuar në periudhën e pushtimit osman. Muri mbrojtës rrethon kodrën, e cila dominon qytetin modern të Beratit, dhe ka formën e një shigjete drejtuar nga veriu, kurse më parë formonte një zinxhir me kodrën përballë Goricës. Vendndodhja strategjike e kalasë lidhet me përballimin e kushteve atmosferike.

Planimetria dhe struktura e kalasë nuk ka ndryshuar, përveç ndryshimeve të vogla. Disa nga ndryshimet që mund të vërehen më lehtë janë muret në pjesën jugore ku dallohet lehtë, se për nga gdhendja gurët i përkasin epokës antike, por se janë përdorur për ndërtesa të periudhës mesjetare. Kjo tregon edhe një herë për vazhdimësinë e pandërprerë të jetës në të.

Pjerrësia dhe rrugicat e ngushta në mes të shtëpive kanë mahnitur dhe besfasuar të gjithë ata që vijnë në Berat, për shkak të vështirësisë inxhnierike për të ndërtuar aty, e sidomos aq mjeshtërisht. Megjithatë, nuk të befason e të lë mbresa vetëm ndërtimi në Mangalem, por edhe sistemi urbanistik i lagjes. Të gjitha kanalizimet janë të ndara dhe të izoluara.

Nëse do të bëjmë një krahasim të objekteve e të ndërtesave më të vizituara në këtë qytet, do të dilte se asnjë pikë tjetër nuk mund të rivalizojë kalanë legjendare. Ndërsa, sa i përket trashëgimisë kulturore, në krye qëndron Muzeu Kombëtar Ikonografik “Onufri”.

Në kishën ku është i vendosur ky muze mendohet se për një kohë të gjatë, në Luftën e Dytë Botërore, është mbajtur fshehur një nga pasuritë më të mëdha që ka Shqipëria: Kodikët e Beratit. Këta kodikë të shkruar me germa të arta në mesjetë, u mbrojtën me fanatizëm nga beratasit duke i mbajtur si një ndër gjërat më të çmuara që ky qytet ka.

Pas vit 2008, kur u shpall trashëgimi historike dhe kulturore nga UNESCO-ja, në qytet ka pasur vërshim turistësh. Sidoqoftë ka pasur edhe faktorë të tjerë të cilët kanë bërë që në Berat të rritej ndjeshëm numri i vizitorëve. Vlen për t'u theksuar se tashmë turizmi për qytetin e Beratit është kthyer në një degë shumë të rëndësishme të ekonomisë, pasi janë të shumta familjet që sigurojnë të ardhurat e tyre vetëm nga ky sektor.

Si përfundim, pasi ke ardhur vërdallë nëpër Berat, do të ishte mirë që të kaloje nga Ura e Varur, ku ke mundësi të shohësh si qendrën historike të Beratit, edhe atë moderne. Kjo urë shfrytëzohet gjatë gjithë kohës, por kënaqësinë më të madhe ta fal në mbrëmje, kur sipër saj mund të shijosh një pamje të magjishme të kalasë, lagjeve dhe gjithë Beratit në tërësi nën dritën e neonëve.

(Ardit Hoxha)

Reportazhi

Reportazhi pasqyron punën a veprimtarinë në një fushë ose ngjarje nga jeta e përditshme, të cilën gazetari e ka parë vetë. Përshkrimi i njerëzve, i ngjarjeve ose i vendeve bëhet sipas përjetimit të rrëfimtarit (reporterit). Krahas fakteve, autori përfshin edhe detajet, që paraqesin gjendje emocionale, fizike apo sociale. Tema e reportazhit nuk është e kufizuar në përmbajtje. Mund të shkruhet për një person të panjohur apo për një figurë publike, po aq sa për një çështje shqetësuese, të njohur apo të panjohur për opinion publik. Gjuha është zakonisht e qartë, me përdorim të kufizuar të figurave letrare. Reportazhi botohet në gazetë, në radio, në televizion ose në mediat elektronike.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1. Përgjigjuni pyetjeve në lidhje me tekstin:
   - a) Në cilën stinë të vitit është realizuar ky reportazh?
   - b) Sa ura përmenden në reportazh? Cilat janë ato?
   - c) Cilat lagje komunikojnë nëpërmjet urës së Goricës?
   - ç) Sa harqe ka pasur dhe sa harqe ka sot ura e Goricës?
   - d) Me cilën prej urave të qytetit të Berat ngjan ura e Goricës?
   - dh) Sa vjeçar konsiderohet qyteti i Beratit?

Analizojmë tekstin

2. Kë konsideron si "far natyror" udhëtari anglez Hobhauz? Analizoni pse përdor këtë etiketim.
3. Cilat janë arsyet që në vitin 2008 u rrit numri i turistëve?
4. Pse Kodikët e Beratit konsiderohen *një nga pasuritë më të mëdha që ka Shqipëria*? Çfarë i bën ata kaq të rëndësishëm?

Gjuha e tekstit

5. Zbërtheni nëntekstin e titullit. Si është ndërtuar ai nga ana gjuhësore?
6. Dalloni shprehjet subjektive dhe objektive të autorit të reportazhit. Nënvizojini ato në tekst.

Reflektojmë rreth tekstit

7. Keni qenë ndonjëherë në qytetin e Beratit? Do të donit ta vizitonit atë?

Po	Pse?	Jo

Punë në grupe

- Vizatoni një hartë dhe shënoni mbi të vendet që keni vizituar, e më pas përshkruajini këto udhëtime.
- Rrëfeni në grupe nga një histori interesante që lidhet me ato që ju kanë ndodhur gjatë udhëtimeve tuaja.
- Hidhuni një vështrim fotografive në librin "Gjuha shqipe 6" dhe tregoni nëse keni vizituar ndonjërin nga ato vende (tregoni çfarë ju kujtojnë ato).
- Diskutoni dhe shprehni ide, opinione, mbresa për ekskursionet që keni zhvilluar së bashku me mësuesit dhe klasën tuaj.

Shtatë mrekullitë e botës antike

Piramida e Keopsit

Piramida e Keopsit është e vetmja mrekulli për të cilën nuk na nevojitet përshkrimi i poetëve apo historianëve të hershëm. E vetmja mrekulli për të cilën nuk biem pre e spekulimeve për sa i përket pamjes, madhështisë dhe formës së saj. Më e vjetra dhe e vetmja ende "gjallë" midis të gjitha mrekullive të antikitetit. Monumenti u ndërtua prej Keopsit, faraon egjiptian i Dinastisë së Katërt, rreth vitit 2560 para Krishtit, për të shërbyer si varri i tij kur ai të vdiste.

Teksti informues-paraqitës

Teksti informues-paraqitës është një tekst që paraqet informacione, data dhe lajme, duke i shpjeguar në mënyrë të qartë dhe korrekte. Çdo paragraf i tij përmban informacione të reja dhe shpesh shoqërohet me ilustrime grafike, si: fotografi, skica, harta, grafikë etj.
Informacioni përcillet te lexuesi në forma të ndryshme komunikimi, si nëpërmjet mediave të shkruara dhe atyre televizive, enciklopedive, artikujve, gazetave etj.
Tekste shpjeguese-informuese janë artikujt, njoftimet, broshurat, fletëpalosjet, vërtetimet, kërkesat, raportet vjetore, procesverbalet, letrat zyrtare, ftesat, shpalljet, telegramet, etiketat etj. Në këtë lloj teksti përdoret gjuha standarde, si dhe fjalë teknike, sipas fushës për të cilën bën fjalë teksti. Nuk përdoret gjuha figurative.

Shtatorja e Zeusit

Në tempullin kushtuar zotave në malin e Olimpit, u realizua në vitin 462 para Krishtit, nga skulptori më i mirë i Greqisë, Fidisi, në fildish dhe ar, skulptura e Zeusit. Shtatorja kishte lartësi prej 14 m. Ajo ka shërbyer për shumë vjet për të kurorëzuar fituesit e olimpiadave greke.

Fjalor

tempull — vend që të ngjall nderim të thellë, që konsiderohet i shenjtë.

Kolosi i Rodit

Vendndodhja gjeografike e Rodit ishte e favorshme për tregti me Greqinë, Azinë dhe Egjiptin, ndaj ai u shndërrua në qendrën tregtare më të madhe të Mesdheut Oriental. Mbreti Demetër Pliorketi i Maqedonisë, i njohur për përvojën ushtarake, vendosi të sulmonte Rodin. Qyteti i rezistoi dhe Demetri u detyrua të tërhiqej. Për të festuar këtë triumf, qyteti vendosi të ndërtonte një monument në kujtim të Helios, Zotit të Diellit, në port. Në fillim, statujën e veshën me hekur dhe sipër me pllaka bronzi. Kur statuja përfundoi, ishte jo më pak se 32 metra e lartë. Fama e saj solli udhëtarë nga e gjithë bota antike për ta parë. 56 vjet pas ndërtimit në vitin 223 para Krishtit, një tërmet e shembi Kolosin.

Tempulli i Artemisës

Qyteti i Efesit në shekullin VI p.K. ka qenë qendra e kultit të perëndeshës Artemisë, për nder të së cilës ishte ndërtuar edhe një tempull. Ajo ishte perëndeshë e natyrës dhe e kafshëve të egra, ndaj paraqitej e shoqëruar nga një sorkadhe e armatosur me hark dhe shigjeta. Tempulli i ndërtuar në nderim të saj u dogj dhe u shkatërrua gjatë një sulmi të qytetit.

Rreth 20 vjet më vonë, Aleksandri i Madh i Maqedonisë pushtoi qytetin e Efesit dhe dëgjoi historinë e tempullit. Ai zbuloi se tempulli ishte shkatërruar në të njëjtën ditë që kishte lindur ai. Për shkak të kësaj koincidence, ai e rindërtoi tempullin gjatë kohës që ishte në Efes, duke u përpjekur të krijonte një qeveri demokratike.

Fjalor

koincidencë – *rastësi.*

Fari i Aleksandrisë

Kryeqyteti i dikurshëm i Egjiptit, Aleksandria, themeluar prej Aleksandrit të Madh, në vitin 332 p.K., ishte vatër e rëndësishme kulturore.
Megjithatë, këtë herë mrekullia nuk do të ishte një tempull, as ndonjë lloj tjetër monumenti a ndërtese, por një kullë. Mbreti vendosi të ndërtonte një kullë që të identifikonte vendin dhe qytetin nga shumë larg.
Kjo kullë do të shërbente për të drejtuar anijet e shumta që mbërrinin në brigjet e Aleksandrisë. Kur përfundoi, kulla ishte mbi 120 metra e lartë. Kjo mrekulli do të rezistonte rreth 1600 vjet, deri në shekullin XIV, kur tërmetet do ta shembnin.

Kopshtet e Varura të Babilonisë

Kopshtet e Varura të Babilonisë janë një nga shtatë mrekullitë e botës antike. Ato ndodhen në qytetin e lashtë të Babilonisë (i quajtur Porta e Zotit), pranë Bagdatit të sotëm (Irak) dhe janë ndërtuar rreth vitit 590 p.K. nga mbreti Nabukodonosor II (edhe pse tradita, atributet të tyre ia jep mbretëreshës Semiramidë). Kopshtet disakatëshe, me lartësi rreth 22 m, me pajime për vaditjen dhe qarkullimin e ujit, i përafroheshin përfytyrimit që kishin njerëzit për parajsën.

Mauzoleu i Mauzolit

Ky mauzole u ndërtua për të kryer funksionin e varrit për mbretin Mauzol të qytetit grek Halikarnas. Arkitektët e projektuan si një podium këndrejtë mbi të cilin ngrihej një piramidë e shkallëzuar dhe në majë një statujë. Të gjitha këto elemente arrinin lartësinë prej 50 metrash.

(Nga shtypi)

Studim teksti

1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve:

a) Cili ishte qëllimi i ndërtimit të Piramidës së Keopsit nga faraoni?
b) Për çfarë shërbente Shtatorja e Zeusit?
c) Pse u shkatërrua Kolosi i Rodit?
ç) Kush e rindërtoi Tempullin e Artemisës?
d) Pse u ndërtua Fari i Aleksandrisë?
dh) Kush i ka ndërtuar Kopshtet e Varura të Babilonisë?
e) Si ishte projektuar Mauzoleu i Mauzolit?

2 Si mendoni, pse janë quajtur "mrekulli" këto ndërtime të botës së lashtë?

3 Cila nga shtatë mrekullitë e botës antike ju pëlqen më shumë? Pse?

Detyrë

- Kërkoni dhe gjeni në internet shtatë mrekullitë e botës moderne. Mblidhni informacione për to dhe diskutoni në klasë rreth tyre.

Shkruajmë

- **Ndiqni udhëzimet e mëposhtme dhe shkruani një njoftim për një dokumentar në lidhje me shtatë mrekullitë e botës antike, që do të shfaqet në ambientet e shkollës suaj.**

	Shembull njoftimi
- Mbani parasysh se njoftimi është një shkrim formal, që komunikon shkurtimisht dhe qartësisht një informacion. - Njoftimet japin informacione të përmbledhura rreth: një ngjarjeje, një përurimi, një programi kulturor, një veprimtarie në fusha të ndryshme. - Nëpërmjet njoftimit, lexuesi/dëgjuesi merr informacion për diçka të re ose të panjohur prej tij. - Njoftimet shkruhen nga një person, grup, organizatë apo institucion për të transmetuar një lajmërim. - Në tekstin e njoftimit gjenden këto elemente: personi/institucioni që e bën njoftimin; qëllimi për të cilin është bërë njoftimi; koha dhe vendi i veprimtarisë për të cilën është shkruar njoftimi. - Njoftimi shpërndahet në mënyra të ndryshme: duke e vendosur në tabelën e njoftimeve të një institucioni apo në mjedise publike, duke përdorur mjetet e telekomunikacionit dhe internetin, apo duke e publikuar në media.	NJOFTIM ***Veprimtari letrare*** *19 mars 2018* *Njoftohen të gjithë nxënësit se çdo të enjte janë të mirëpritur në bibliotekën e shkollës, në orën 16:00, pasi do të ketë veprimtari interesante që lidhen me letërsinë për fëmijë, duke përfshirë takime me shkrimtarë, përkthyes dhe botues.* *Mësuesit e Gjuhës* *Shkolla "Hasan Prishtina"*

Liqeni i Ohrit

Liqeni i Ohrit është një nga liqenet më të mëdha të Gadishullit të Ballkanit. Ai gjendet në një lartësi mbidetare prej 695 metrash. Pika më e thellë është në 289 m thellësi. Pjesa më e madhe ndodhet nën administrimin e Maqedonisë, kurse pjesa tjetër i përket Republikës së Shqipërisë. Në bregun e liqenit shtrihen tri qytete të mëdha: Ohri dhe Struga në Maqedoni dhe Pogradeci në Shqipëri.

Liqeni i Ohrit furnizohet me ujë nga burimet e shumta përreth. Një nga burimet më të mëdha gjendet pranë kufirit Shqipëri-Maqedoni, pranë Manastirit të Shën Naumit (Maqedoni). Në anën e Shqipërisë gjendet gjithashtu një burim i madh në parkun e Drilonit, pranë fshatit Tushemisht. Uji largohet nga liqeni në drejtim të Veriut nëpërmjet lumit Drin i Zi, i cili rrjedh përmes qytetit të Strugës.

Liqeni i Ohrit renditet si një nga liqenet më të vjetra në mbarë botën. Mosha e tij llogaritet të jetë dy deri më pesë milionë vjet. Liqeni u krijua nga një shembje e tokës. Këtë e vërtetojnë aktivitetet e shumta tektonike, si dhe ekzistenca e një mali prej 100 metrash nën nivelin e liqenit. Liqeni i Ohrit është edhe shtëpia e shumë kafshëve endemike, të cilat vijnë vetëm në ujërat e tij. Në liqen rriten 40 specie të rralla, ndër më të njohurat dhe ekonomikisht më të rëndësishmet janë: peshku i pastër i llojit *Salmo letnica* (korani) dhe *Salmothimus ohridanus* (belushka).

Një pjesë e bregut të liqenit, së bashku me qytetin e Ohrit janë shpallur trashëgimi kulturore dhe natyrore e mbrojtur nga UNESCO-ja.

Fjalor

tektonike – lëvizjet dhe ndryshimet në koren e Tokës nën veprimin e forcave të brendshme tokësore.
endemike – kafshë të cilat nuk kanë një vendbanim ose vendqëndrim të përhershëm, që lëvizin.

Qyteti i Pogradecit

Pogradeci është qytet në Shqipërinë juglindore, në bregun jugperëndimor të liqenit të Ohrit. Qyteti numëronte rreth 38 000 banorë në vitin 2009 dhe ka një sipërfaqe prej 13 km². Pogradeci shtrihet 700 metra mbi nivelin e detit, në një luginë e cila rrethohet nga malet në perëndim dhe nga kodra të ulëta në jug dhe në lindje.

Enkelejtë kanë qenë fisi që ka jetuar brenda mureve të kalasë së ndërtuar në majë të kodrës pranë qytetit, në pjesën veriperëndimore të qytetit. Dikur qyteti kishte dimensionet e kalasë, ku momentalisht gjenden vetëm rrënojat. Me rritjen e popullsisë dhe mbarimit të luftërave, lindi nevoja e zgjerimit. Fillimisht u shkua rrëzë kodrës e më vonë deri në atë skaj, saqë kalaja e vjetër nuk përbënte më qendrën e qytetit.

Pogradeci ka një histori të lashtë dhe dokumente të shumta kulturore, gjeologjike dhe natyrore. Gërmimet arkeologjike në kodrën mbi qytet kanë zbuluar një vendbanim ilir të shekullit V para Krishtit, që u përket fiseve të lashta ilire. Gjatë shekujve në vazhdim, njerëzit e fshatit zbritën poshtë në rrëzë të kodrës dhe krijuan qytetin e Pogradecit, përgjatë bregut të Liqenit të Ohrit.

Fjalor

gjeologjike – studimi i ndërtimit, të përbërjes, të formimit e të zhvillimit të kores së tokës.

arkeologjike – studimi i jetës e kulturës së popujve në lashtësi, sipas gjetjeve që zbulohen nëpërmjet gërmimeve.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Përgjigjuni pyetjeve rreth tekstit:

a) Për çfarë ju informon ky tekst?
b) Cila është pika më e thellë e liqenit?
c) Nga vjen uji me të cilin furnizohet liqeni?
ç) Cilat qytete shtrihen në breg të liqenit?
d) Çfarë kanë zbuluar gërmimet arkeologjike në kodrën pranë qytetit të Pogradecit?

Analizoni tekstin

2 Gjeni në tekst sa është lartësia mbidetare e Liqenit të Ohrit?

3 Cilët janë peshqit më të njohur që rriten në Liqenin e Ohrit?

4 Pse konsiderohen ekonomikisht të rëndësishme disa nga speciet që rriten në liqen?

5 Si mendoni, pse një pjesë e bregut të liqenit, bashkë me qytetin e Ohrit janë shpallur trashëgimi kulturore dhe natyrore e mbrojtur nga UNESCO-ja?

6 Çfarë tregon fakti që pranë qytetit të Pogradecit ndodhet një kala?

Gjuha e tekstit

7 Cilat janë karakteristikat e gjuhës së këtyre teksteve? Shënoni me ✓ alternativat e sakta.

- ☐ E hollësishme.
- ☐ Me shifra.
- ☐ E qartë.
- ☐ E thjeshtë.
- ☐ Objektive.
- ☐ E ndërlikuar.
- ☐ E figurshme.
- ☐ Subjektive.

Detyrë

- Mblidhni informacione të tjera rreth liqenit të Ohrit dhe qytetit të Pogradecit. Prezantojini ato në klasë.

Shkruajmë

- Lexoni udhëzimet e mëposhtme dhe shkruani një ftesë për drejtorinë e shkollës, në mënyrë që të jenë të pranishëm në orën e mësimit gjatë së cilës do të prezantoni materialet rreth liqenit të Ohrit.

	Shembull ftese
○ Mbani parasysh që ftesat janë një mënyrë komunikimi për të ftuar një individ apo një grup individësh në një veprimtari të organizuar nga pala dërguese. ○ Ftesat mund të dërgohen për raste nga më të ndryshmet, si p.sh.: takime poetike, aktivitete kulturore, ditëlindje, raste familjare, veprimtari sportive etj. ○ Ftesat përmbajnë **emrin** e të ftuarit, **vendin** ku duhet të paraqitet i ftuari, **orën** dhe **datën** (dita, muaji, viti) kur duhet të paraqitet i ftuari, si dhe **emrin** e personit që bën ftesën. ○ Ftesat shoqërohen me ilustrime figurative.	**Dita e Flamurit** ***Ftesë*** *Me rastin e Ditës së Flamurit, klasa VI/B ka kënaqësinë të ftojë z./znj._____* *të marrë pjesë në shfaqjen e përgatitur për këtë ditë festive, më 28 nëntor 2018, në palestrën e shkollës, në orën 10:00.* *Me respekt,* *Klasa VI/B*

Raport për popullsinë e Kosovës

Para leximit

Çdo vend publikon të dhëna statistikore në lidhje me numrin e popullsisë, numrin e lindjeve, të të papunëve, ndihmëkërkuesve etj. Kosova vazhdon të ketë migrimin të lartë në kërkim të një jete më të mirë.
Teksti i mëposhtëm na informon, duke ofruar të dhëna të sakta për numrin e banorëve në Kosovë, si dhe për numrin e fëmijëve që ndjekin shkollën në komuna të ndryshme të vendit.

Fjalor

agjenci – institucion i posaçëm, që kryen një veprimtari të caktuar.
statistika – tërësia e të dhënave numërore për një fushë të jetës, renditur sipas një kriteri të caktuar.
bilanc – përfundimi që del nga përpunimi i të dhënave statistikore.
migrimi – shkoj nga një vend në një tjetër për arsye ekonomike ose politike .
SNKA – Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit.

Vlerësohet se Kosova vjet kishte 1 798 506 banorë

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Vlerësimin mbi numrin e banorëve për vitin 2017". Sipas këtij vlerësimi, në vitin 2017 popullsia e Kosovës pati një rritje natyrore për 20.406 banorësh ose, e shprehur në përqindje, prej 1,13%. Gjatë vitit 2017 është vlerësuar se 9.376 persona kanë ndërruar vendbanimin (komunën) e tyre. Bilanci i migrimit ndërkombëtar në Kosovë për vitin 2.017 ishte (-5 431 banorë). Popullsia në Kosovë për vitin 2017 vlerësohet të jetë 1.798.506 banorë rezidentë.

Në vitin 2017 pati 23 563 lindje brenda territorit të Kosovës

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Statistikat e Lindjeve në Kosovë për vitin 2017.

Të dhënat në këtë publikim janë paraqitur sipas bazës së grumbullimit të të dhënave administrative për vitin 2017, nga zyrat e gjendjeve civile, ku janë grumbulluar gjithsej 30275 fletë statistikore për lindje.
Këto të dhëna tregojnë se 23563 raste janë lindje brenda territorit të Kosovës, ndërsa 6712 raste janë lindje jashtë territorit të Kosovës.

Nxënësit në arsimin fillor-të mesëm të ulët

Niveli i arsimit fillor-të mesëm të ulët përfshin arsimin e detyruar nëntëvjeçar që korrespondon me nivelin 1 dhe 2 të SNKA-së. Tabela dhe harta e mëposhtme paraqesin numrin e nxënësve në arsimin fillor-të mesëm të ulët sipas komunave.

Numri i nxënësve në arsimin fillor-të mesëm të ulët							
Komuna	Meshkuj	Femra	Totali	Komuna	Meshkuj	Femra	Totali
Deçan	2,146	2,050	4,196	Mitrovicë	5,599	5,397	10,996
Dragash	1,664	1,669	3,333	Novobërdë	256	222	478
Ferizaj	8,331	7,992	16,323	Obiliq	1,585	1,540	3,125
Fushë-Kosovë	3,296	2,974	6,270	Pejë	6,706	6,315	13,021
Gjakovë	6,506	5,826	12,332	Podujevë	6,856	6,407	13,263
Gjilan	5,936	5,719	11,655	Prishtinë	15,405	14,682	30,087
Gllogovc	4,575	4,250	8,825	Prizren	11,495	10,699	22,194
Hani i Elezit	751	662	1,413	Rahovec	3,954	3,552	7,506
Istog	2,838	2,584	5,422	Shtërpcë	227	244	471
Junik	283	267	550	Shtime	2,151	1,978	4,129
Kaçanik	2,388	2,249	4,637	Skënderaj	3,793	3,554	7,347
Kamenicë	1,707	1,644	3,351	Suharekë	4,322	3,972	8,294
Klinë	3,047	2,968	6,015	Viti	3,100	3,006	6,106
Leposaviq	14	10	24	Vushtrri	5,273	4,853	10,126
Lipjan	4,656	4,331	8,987	ZubinPotok	55	50	105
Malishevë	4,776	4,552	9,328	Zveçan	28	34	62
Mamushë	355	338	693	Kllokot	57	61	118

Raporti

Raporti është një tekst që informon për një situatë apo veprimtari në mënyrë të hollësishme, me të dhëna dhe fakte që lidhen me temën. Veçoritë e tij janë:

- organizohet sipas një strukture të përcaktuar: hyrje, zhvillim, mbyllje;
- pasqyron mbledhjen dhe përzgjedhjen e të dhënave;
- është i qartë, lehtësisht i kuptueshëm dhe shoqërohet me diagrame dhe fotografi.

Studim teksti

1 **Lexoni këtë raport informues dhe përgjigjuni pyetjeve:**

a) Sa vlerësohet se ishte popullsia e Kosovës në vitin 2017?

b) Sa ishte numri i lindjeve në Kosovë në vitin 2017?

2 **Interpretoni të dhënat e tabelës që paraqet numrin e nxënësve në arsimin fillor-të mesëm të ulët. Çfarë ju bën më shumë përshtypje?**

3 **Interpretoni hartën që paraqet të dhënat numerike të tabelës. Çfarë vini re?**

Detyrë

- Bazuar në të dhënat e tabelës, llogaritni numrin e vajzave, numrin e djemve dhe numrin e nxënësve në arsimin fillor-të mesëm të ulët në Kosovë në vitin 2017.
- Interpretoni rezultatet e gjetura.

Studim teksti

Shkruajmë

Lexoni udhëzimet e mëposhtme dhe shkruani një letër zyrtare për drejtorinë e shkollës në të cilën të kërkoni të dhëna statistikore për numrin e nxënësve dhe të nxënëseve të shkollës suaj.

- Mbani parasysh që letrat zyrtare janë: letra njohjeje, letra ankese, letra për lidhje dhe bashkëpunim, letra në formë kërkese etj.
- Në hyrje të këtij lloj shkrimi tregohet qëllimi për të cilin po e shkruani këtë letër.
- Gjatë zhvillimit të letrës shpjegohet pozicioni juaj në lidhje me atë që kërkoni dhe faktet kryesore që lidhen me këtë kërkesë.
- Në mbyllje të shkrimit kërkohet informacion dhe propozohen veprime të mëtejshme.

LETRA ZYRTARE	
Vendi dhe data →	Prizren, më 14.09.2018
Marrësi i letrës →	Lura Shala, drejtoreshë e shkollës
Tema e letrës →	**Lënda:** Kërkesë për rregullimin e ambientit të shkollës
Formula e hyrjes me emrin e marrësit →	E nderuar drejtoreshë Lura,
Përmbajtja →	Unë jam Zgjim Goleshi, nxënës i klasës së gjashtë, me mësuese kujdestare Bardha Korabin. Po ju shkruaj këtë letër për t'ju kërkuar zyrtarisht që të shqyrtoni mundësitë financiare të shkollës sonë për sistemimin e gjelbërimit të oborrit të shkollës, që përbën shqetësim edhe për bashkëmoshatarët e mi. Këtë problem e kemi diskutuar edhe me shokët e shoqet e klasës, si dhe me nxënës të klasave të tjera prandaj ju shkruaj që ta merrni në konsideratë kërkesën tonë dhe të ndërmerrni nismën për të sistemuar ambientet e jashtme të shkollës. Të jeni e bindur se ne do t'ju mbështesim dhe ndihmojmë në drejtim të gjelbërimit e sistemimit të ambienteve tona shkollore.
Formula e mbylljes →	Duke ju falënderuar paraprakisht për vëmendjen tuaj ndaj problemit tonë, mbetemi në pritje, me shpresën se kërkesa jonë do të merret parasysh.
Përshëndetja dhe kontaktet tuaja →	Me respekt, Zgjim Goleshi + 3777 45 49 3137/ z.goleshi@gmail.com
Nënshkrimi i dërguesit/es →	Zgjim Goleshi

Familja shqiptare dikur dhe sot

Para leximit

Familja është vendi më i shtrenjtë për gjithsecilin prej nesh. Ajo duhet të jetë vendi ku gjithsecili prej anëtarëve të saj të gjejë dashurinë e vërtetë dhe përkujdesjen pa interes. Mënyra se si është ndërtuar dhe se si funksionon një familje, përcakton mënyrën se si zhvillohet një shoqëri. Nëse familja është në krizë, edhe shoqëria është në krizë. Familja ka ndikim parësor në krijimin e karakterit të secilit prej nesh dhe, nëse familja është e shëndoshë, individi do të bëhet një qytetar i zoti dhe me vlera.

Familja patriarkale dhe nukleare

Familja shqiptare historikisht ka qenë patriarkale dhe mbështetej në këto tri parime themelore traditore dhe kanunore:

- anëtarët e saj jetonin nën një kulm dhe kishin zotin dhe zonjën e shtëpisë;
- si qëllim jete kishin shtimin e anëtarëve të shtëpisë dhe të familjes nëpërmjet martesës, lindjes së fëmijëve;
- zhvillimi i tyre trupor dhe mendor ishte pika e tretë e këtij synimi.

Familja patriarkale është bashkësi e gjerë njerëzish, në ndryshim nga ajo nuklearja apo bërthamorja, me marrëdhënie ndërpersonale burrë-grua-fëmijë, një lloj "kolektivizmi" burimor, ku personi "shkrihet" në logjikën e familjes, pa pasur mundësi për krijimin e personalitetit vetjak dhe të identitetit personal.

Kështu doemos krijohet mentaliteti turmor, grumbullor, masiv, që si parim bazë ka traditën: si të tjerët, si të parët e mi, si të gjithë!

Ana tjetër e këtij organizimi familjar është individualizmi i tepruar ose "bajraktarizmi", që shprehet nëpërmjet nevojës dhe dëshirës për të sunduar të tjerët me parime: vetëm si të them unë, sepse tjetri nënçmohet, nënshtrohet, objektivizohet, nëpërkëmbet dhe keqtrajtohet, te ne sidomos bota femërore dhe fëmijët.

Fjalor

patriarkale – që lidhet me sundimin e plotë të burrit në familje dhe në marrëdhëniet shoqërore.
nukleare – si bërthamë.
Mentalitet – mendësi.
turmor – turmë.
Bajraktarizmi – mënyrë e egër drejtimi; qëndrim e sjellje e rreptë jotolerante.
Kultivohen – kujdesem për të rritur ose zhvilluar një ide të caktuar.

Çfarë i mungon sot familjes shqiptare?

Edukimi për liri dhe për përgjegjësi, për vlera dhe virtyte, me orientime dhe përcaktime të qarta, sepse pa këtë njeriu është "lojë rasti" apo rrethanash, një lloj "malli" në duart e fatit dhe të të tjerëve.

Edukimi për komunikim, për takime, afrime, bashkime, bisedime, dialog, gjithnjë në kërkim dhe në zbatim të së mirës së përbashkët.

Me mentalitetin turmor njeriu shkrihet në masë anonime, ndërsa me individualizmin e tepruar njeriu shndërrohet në sundimtar; ka rrezik të bëhet gati edhe diktator.

Faza kalimtare mes familjes patriarkale dhe asaj nukleare është mjaft e vështirë dhe me plot sfida dhe rreziqe, sidomos kur rrëzimi i sistemit politik, ekonomik, kulturor dhe shoqëror ndodh edhe me luftë, si ishte fatkeqësisht rasti ynë.

Këtë e ka pësuar dhe ende e pëson familja shqiptare, sepse ajo e vjetra, tradicionalja, tashmë është dëmtuar dukshëm, gati edhe është shkatërruar në tërësi, kurse e reja, bërthamorja, ende nuk është formuar.

Kohët e fundit, familja gjithnjë e më tepër ngushtohet, sepse pjesa dërmuese e jetës kalohet jashtë familjes, shtëpisë, në punë, në udhëtime, në lidhje dhe marrëdhënie me të tjerët, aq sa shtëpia gati është bërë "bujtore".

Në këtë situatë, femrat shqiptare janë vetëdijesuar nëpërmjet shkollimit dhe punësimit se janë pikësëpari qenie njerëzore, pastaj femra, qenie familjare dhe shoqërore, dhe si të tilla janë pjesë aktive e familjes dhe e shoqërisë. Ato përfaqësojnë vlerat e mirëfillta të traditës që duhet të ruhen dhe të kultivohen, duke i begatuar edhe me vlera bashkëkohore, si edukimi personal dhe ndërpersonal, bashkëpunimi, bashkëjetesa, toleranca ndërfetare dhe ndëretnike, kultura e punës, e përgjegjësisë dhe e komunikimit.

(Don Lush Gjergji)

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1. Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve:
   - a) Për çfarë na informon ky tekst?
   - b) Si ka qenë e organizuar historikisht familja në Kosovë?
   - c) Cilat janë tri parimet themelore në bazë të të cilave funksionon ajo?
   - ç) Si është e ndërtuar familja e ditëve të sotme?
   - d) Për çfarë janë vetëdijesuar femrat?
   - dh) Çfarë i mungon familjes shqiptare?

Analizojmë tekstin

2. Në cilin tip familjeje gjejmë pluralizmin e mendimeve, qëndrimeve, botëkuptimeve...?
3. Nxirrni informacionet që merrni nga teksti dhe përqasini ato me informacionet që keni për:
   - familjen tuaj;
   - farefisin tuaj;
   - fshatin apo qytetin në të cilin banoni.

Interpretojmë tekstin

4. Interpretoni ndërtimin e marrëdhënieve afektive apo martesore, si dhe krijimin e familjes mbi parime: "Punë për mua, di unë çfarë bëj, mos u përziej ti, askush nuk ndërhyn në jetën time private, nuk jam më fëmijë, mendoj si dua dhe si më pëlqen…".
5. Interpretoni frazën:
   - *[Duhet kultivuar] edukimi për liri dhe për përgjegjësi, për vlera dhe virtyte, me orientime dhe përcaktime të qarta, sepse pa këtë njeriu është "lojë rasti" apo rrethanash, një lloj "malli" në duart e fatit dhe të të tjerëve.*

Reflektojmë rreth tekstit

6. Duke u nisur nga teksti, por edhe nga vëzhgimet tuaja, krahasoni doket dhe zakonet tradicionale me ato bashkëkohore.
7. Çfarë pasojash ka sjellë mungesa komunikimit, që është shumë e dukshme në familjen dhe shoqërinë shqiptare në përgjithësi?A mund të ndryshohet kjo? Si?

Bashkëbisedojmë

- Diskutoni rreth ndryshimeve që ka pësuar familja shqiptare ndër vite. Çfarë vihet re vitet e fundit? Çfarë dini për për të ashtuquajturën "përplasje brezash"? Ku e vini re këtë? Si mendoni, pse ndodh kjo dukuri?

Teksti udhëzues

Teksti udhëzues ka si qëllim të udhëzojë lexuesin hap pas hapi në lidhje me një veprimtari të caktuar. Në funksion të qartësisë së shpjegimit, ato shoqërohen me ilustrime ndihmëse. Në këto lloj tekstesh përfshihen: nenet e ligjeve, manualet mësimore, recetat e gatimit, rregulloret e ndryshme etj. Gjuha e përdorur në to është formale, me fjalë dhe terma teknikë. Për të dhënë udhëzimet dhe shpjegimet rreth tyre, përdoren fraza të tilla, si: *së pari, pastaj, ndërkohë, derisa, si rezultat, për rrjedhojë, nga ana tjetër, duke e krahasuar me* etj.

Rregullorja e bibliotekës së shkollës

Para leximit

Si mendoni, cili është qëllimi i hartimit të një rregulloreje? Diskutoni rreth karakteristikave të përgjithshme të rregulloreve.

RREGULLORJA
MBI FUNKSIONIMIN E BIBLIOTEKËS SË SHKOLLËS SË MESME TË ULËT "HASAN PRISHTINA" NË TERPEZË

miratuar më 1 shtator 2018

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka si qëllim të përcaktojë rregullat bazë për funksionimin e bibliotekës, për shfrytëzimin e fondit të bibliotekës nga përdoruesit, përpunimin dhe mbrojtjen e fondit të bibliotekës dhe masat në rast moszbatimi të tyre.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë rregullore:

- **shkolla:** shkolla e mesme e ulët "Hasan Prishtina" në Terpezë;
- **biblioteka:** biblioteka e shkollës;
- **nxënës:** nxënësit e regjistruar në shkollën e mesme-të ulët"Hasan Prishtina" në Terpezë;
- **stafi:** stafi arsimor administrativ, që punon në shkollën e mesme e ulët "Hasan Prishtina" në Terpezë me kohë të plotë ose të pjesshme;
- **përdorues:** nxënësit, stafi arsimor dhe administrativ;
- **fond:** librat ekzistues në bibliotekë, revistat, gazetat periodike, materialet audio-vizive dhe materialet e ngjashme, që publikohen nga administratori i bibliotekës, si edhe veprat e rralla dhe me vlerë të veçantë.

Neni 3
Objekti i udhëzimit

Rregullorja e bibliotekës së shkollës së mesme-të ulët "Hasan Prishtina" në Terpezë vendos rregullat normative të subjekteve të ndryshme, në lidhje me bibliotekën e shkollës, rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe përcakton përgjegjësitë e stafit përgjegjës, për mbarëvajtjen e punës

së bibliotekës. Mbështet arritjen e objektivave që përfshihen në misionin dhe programin e shkollës. Siguron burime të shumta informative, si: hyrje në katalogët e bibliotekave të tjera.

Neni 4

Funksionet e detyrat e bibliotekës shkollore

1) Siguron materiale, informacione e shërbime bibliotekare në funksion të edukimit që ofron shkolla.
2) Organizon aktivitete me tematika të ndryshme duke aktivizuar anëtare të saj.

Neni 5

Lejueshmëria, frekuentimi

1) Biblioteka e shkollës është e hapur për nxënës, mësues, prindër.
2) Frekuentimi i saj bëhet duke iu përmbajtur dispozitave normative për arsimin parauniversitar.
3) Kohët e hapjes përcaktohen në mënyrë të veçantë dhe bëhen publike.
4) Frekuentimi i bibliotekës është falas.
5) Çdo anëtar i bibliotekës ka të drejtë të pajiset me një numër të veçantë të kartelës.

Neni 6

Rregulli e siguria

Ndalohet në bibliotekë:

a) Përdorimi i objekteve të cilat dëmtojnë ecurinë e punës.
b) Sjellja e palejueshme në mjedisin e saj.
c) Përdorimi i ushqimeve të ndryshme (të ngrënit).
ç) Dëmtimi, grisja e librave.
d) Mungesa e etikës.

Neni 7

Afatet e huazimit

1) Afati i leximit të librit është 15 ditë.
2) Lejohet zgjatja deri në tri herë e afatit, për sa kohë që shtyrja bëhet brenda afatit të kthimit dhe për sa kohë nuk ka kërkesa për këta libra.
3) Në rastet e moskthimit në afat të librave e materialeve nuk huazohet libër tjetër dhe në të njëjtën kohë bëhet dëmshpërblimi.

Neni 8

Dorëzimi me vonesë dhe pagesa për vonesën

Në qoftë se botimi i marrë nuk kthehet brenda afatit të caktuar, atëherë:

a) Në muajin e parë për çdo ditë vonese përdoruesi paguan 20 centë dhe, pas muajit të parë, ai është i detyruar të paguajë për çdo ditë vonese 50 centë për kthimin me vonesë të materialit.

Fjalor

rregullore – përmbledhje rregullash, sipas të cilave duhet bërë një punë a një veprimtari.
audio-vizive – materiale që dëgjohen në kufje dhe shihen pamje filmike.
mision – detyrë e rëndësishme.
katalogë – këtu: regjistrat që përmbajnë titujt e materialeve që zotëron një bibliotekë.
kartelë – këtu: një fletë letre a dy fletë të trasha të lidhura bashkë, ku shënohen të dhëna të ndryshme për përdoruesin e bibliotekës.
kategorike – këtu: e prerë.

b) Për stafin akademik dhe administrativ, 60 ditë pas tejkalimit të afatit të dorëzimit, parashikohet prerja nga rroga e 3-fishit të çmimit të materialit të huazuar.

c) Pagesa për kthimin me vonesë të materialit llogaritet duke shumëzuar pagesën për çdo ditë vonese me numrin e ditëve të vonuara. Pagesa për çdo ditë vonese caktohet nga personeli përgjegjës i bibliotekës dhe publikohet.

ç) Përdoruesve që nuk e kanë kthyer materialin në afatin e dorëzimit dhe atyre që e kanë dorëzuar materialin, por nuk kanë shlyer pagesën për vonesën, në mënyrë kategorike nuk u jepet material tjetër hua.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të tij në Këshillin e shkollës.

Neni 10

Zbatimi

Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga drejtori i shkollës.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1. Çfarë qëllimi ka rregullorja që lexuat?
2. Sa nene ka ajo dhe kur është miratuar?
3. Kush është personi përgjegjës për zbatimin e saj?
4. Sa është pagesa për kthimin me vonesë të materialit të huazuar?
5. Çfarë parashikon kjo rregullore për afatet e huazimit?

Analizojmë tekstin

6. Si është i organizuar ky tekst? Shënoni me ✓.
   - ☐ Ai është i ndarë në paragrafë të veçantë që quhen nene.
   - ☐ Secili prej neneve ka një titull.
   - ☐ Titulli i nenit të sugjeron se për çfarë do të udhëzohesh.
   - ☐ Nenet ndahen më tej në pika (1, 2, 3 etj.) ose në shkronja (a, b, c, ç etj.).
7. Përse janë përdorur përkufizimet e nenit 2?
8. Çfarë ndalon dhe çfarë lejon kjo rregullore.

Reflektojmë rreth tekstit

9. E keni lexuar rregulloren e bibliotekës së shkollës suaj? Ku ngjason dhe ku ndryshon ajo me këtë rregullore.

Punë në grupe

- Ndahuni në grupe dhe hartoni rregulloren e klasës suaj.

Shtegu më i bukur i Shqipërisë

Nëse do të ecësh nga Thethi në Valbonë, duhet të shkosh gjatë muajve të verës. Ne shkuam në shtator, por kishim ndjesinë e verës. Nuk kërkuam udhërrëfyes, pasi shtegu ishte i lehtë për t'u ndjekur dhe çdo ekskursionist mund të ecte përpara. Nëse je vetëm, duhet të gjesh, që në bujtinë, bashkudhëtarë të interesuar për udhëtimin për në Theth.

Mirë është të shohësh parashikimin e motit pasi ky marshim është shumë i rrezikshëm në stuhi. Mbaj parasysh që je duke u ngjitur në malet më të larta në Shqipëri. Mirë është të harxhosh edhe një ditë në rast se moti është i keq. Nuk ke pse ta bësh vajtje-ardhje, prandaj është më mirë të planifikosh udhëtimin tënd duke u nisur nga Thethi dhe duke ecur drejt Valbonës përpara se të vazhdosh më tutje. Itinerari më i zakonshëm është të shkosh në Fierzë me makinë, ku të marrësh tragetin përgjatë liqenit të Komanit përpara se të nisesh për në Shkodër, megjithëse në verë ka edhe autobusë për në Valbonë. Mund të marrësh autobusin për në Gjakovë, Kosovë.

(*Nga shtypi*)

Çfarë duhet të marrësh me vete për udhëtimin nga Thethi në Valbonë?

E mira është të bësh një listë dhe të përgatitesh për udhëtim duke iu referuar asaj. Në këtë mënyrë do të kursesh shumë kohë e mund. Ja lista ime:

Aparati fotografik

Një palë atlete

Krem dielli (duket i parëndësishëm, por do të jesh në kontakt me diellin për një pjesë të mirë të udhëtimit)

Veshje për marshim dhe rroba për t'u ndërruar

Një shishe me ujë

Bukë

Lekë për katër ditë qëndrimi në hotel, ushqim dhe transport

Një çantë e vogël

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Plotësoni tabelën.

Çfarë dinim më parë rreth realizimit të një udhëtimi nga Thethi në Valbonë?	Çfarë mësuam nga teksti që lexuam rreth realizimit të një udhëtimi nga Thethi në Valbonë?	Cilat janë këshillat që morët nga teksti i mësipërm?

Analizojmë tekstin

2 Si është i organizuar ky tekst? Shënoni me ✓.

- ☐ Në të tregohet se si dhe pse ndodh një dukuri.
- ☐ Ndërtohet me paragrafë të veçantë, që paraqesin hapa të ndryshëm të dukurisë.
- ☐ Udhëzon hap pas hapi lexuesin rreth një teme.
- ☐ Jep këshilla hap pas hapi rreth funksionimit të një pajisjeje.

3 Plotësoni:

Në hyrje, autori u sugjeron lexuesve të përqendrohen në tri elemente thelbësore të udhëtimit që po planifikojnë: stinën kur do të udhëtojnë, praninë ose jo të një udhërrëfyesi, si dhe praninë ose jo të një shoqëruesi.

Gjatë zhvillimit _____

Në mbyllje _____

Gjuha e tekstit

4 Në cilën vetë është shkruar teksti i mësipërm? Provoni ta ktheni atë në numrin shumës. Çfarë efekti do t'i sillte ky ndryshim rrëfimit?

5 Zëvendësoni fjalët me shkronja të zeza, pa ndryshuar kuptimin e fjalive të mëposhtme.

*Nuk kërkuam **udhërrëfyes**, pasi shtegu ishte i lehtë për t'u ndjekur dhe çdo **ekskursionist** mund të ecte përpara.*
***Itinerari** më i zakonshëm është të shkosh në Fierzë me makinë [...].*
E mira është të bësh një listë dhe të përgatitesh për udhëtim duke iu referuar asaj.

Reflektojmë rreth tekstit

6 Shtoni dy sende të tjera te lista e përgatitjeve për udhëtim.

7 Cili mendoni se do të ishte një shoqëruesi ideal për ju në këtë udhëtim: nëna, babai, mësuesja/i apo një person jashtë rrethit tuaj familjar? Argumentoni përgjigjen.

Detyrë

- Shkruani një tekst të thjeshtë në të cilin të jepni këshilla se si të bëni gati për të nesërmen çantën e shkollës.

Fjalimi i Adem Demaçit pas marrjes së çmimit “Sakharov”

Para leximit

Kush është Adem Demaçi? Çfarë dini për jetën dhe veprimtarinë e tij?

Duke falënderuar për këtë çmim të lartë para Parlamentit Evropian në Strasburg, Adem Demaçi tha:

Zoti kryetar, zonja e zotërinj deputetë të Parlamentit Evropian. Në këto momente historike për Evropën dhe Ballkanin, duke më nderuar me çmimin “Sakharov”, keni nderuar popullin tim të shumëvuajtur, por prore liridashës, paqedashës e krenar. Duke nderuar popullin tim, para historisë, keni nderuar edhe këtë institucion të lartë, sepse të mbrosh një popull të pafajshëm nga pushtuesit e shtypësit, gjithmonë ka qenë e është lavdi e nder i madh. Në Librin e shenjtë thuhet: “E para ishte fjala”. Në kohën tonë mund të thuhet: “E para është fjala e lirë” si hapi i

Teksti argumentues

Teksti argumentues ka si qëllim të bindë lexuesin për një çështje të caktuar nëpërmjet argumenteve apo arsyetimeve, të cilat janë fakte, shembuj, prova apo gjykime praktike të autorit. Autori i një teksti argumentues formulon një çështje, e cila shfaqet e gatshme për lexuesin ose është e nënkuptuar. Çështja është një pohim, një ide kyçe, mbi të cilën ndërtohet i gjithë teksti. Vërtetësia e kësaj çështjeje dhe argumentimi rreth saj varen nga opinionet e autorit, argumentet që ai sjell për ta mbështetur atë dhe për të bindur lexuesin. Llojet e teksteve argumentuese janë të shumta. Ato më të përdorshmet janë: fjalime, letra të hapura, artikuj gazete, ese argumentuese, reklama promocionale etj.

parë dhe i domosdoshëm drejt demokracisë. Pa fjalë të lirë s'ka dialog, pa dialog nuk mund të zbulohet e vërteta, kurse pa të vërtetën nuk ka progres.

Por, zoti Kryetar dhe ju, zonja e zotërinj deputetë të Parlamentit Evropian, do të guxoj të them se edhe ju të gjithë e doni fjalën e Lirë dhe prandaj më keni ftuar që në këtë sallë të mrekullueshme ta dëgjoni tingullin e fjalës së Lirë shqiptare. Mirëpo, më vjen keq që nuk kam fatin t'ju them asnjë fjalë të gëzuar e të ëmbël nga hapësirat e asaj që ende i thonë Jugosllavi. Në Kosovë pushtuesit serbomëdhenj, hegjemonistë e militaristë, përmes dhunës më të egër, po i presin një nga një arteriet jetëdhënëse të popullit shqiptar duke rrënuar pa mëshirë e plotësisht sistemin informativ, arsimor, shëndetësor, kulturor, sistemin bankar-financiar, sistemin ekonomik, juridik dhe përfundimisht u gjet i rrënuar e i shkallmuar i tërë sistemi politik. E tërë Kosova është shndërruar në një megaburg ku shqiptarët nuk gëzojnë as sigurinë më të vogël fizike, as juridike.

Fjalimi

Fjalimi është një ligjëratë që mbahet në një mbledhje të gjerë. Fjalimi mund të ketë tematika të ndryshme dhe mund të jetë i organizuar në formë të gjatë apo të shkurtër.

Zoti Kryetar, zonja e zotërinj, siç shihet, në Jugosllavi ka probleme të mprehta e fort komplekse, mirëpo unë kam besim të plotë se Bashkësia Evropiane ka potenciale kolosale njerëzore e materiale, për t'i zgjidhur të gjitha problemet që shtrohen para Evropës së sotme.

Prandaj, zoti Kryetar dhe ju, zonja e zotërinj të këtij forumi të lartë, në emër të të gjithë djelmoshave të të gjitha kombeve që masakrohen në këto luftëra absurde e anakronike, në emër të nënave e baballarëve jo vetëm shqiptarë, por edhe atyre serbë e malazezë, kroatë e boshnjakë, hungarezë e maqedonas, në emër të të gjithë prindërve që humbin krijesat e tyre më të dashura nëpër luftërat shkatërruese, ju lutem shumë që ta vini në lëvizje tërë energjinë tuaj që ta ndalim së bashku gjakderdhjen e panevojshme dhe ta largojmë njëherë e përgjithmonë nga skena politike bastionin e fundit të diktaturës ushtarako-policore, të regjimit shovinist e hegjemonist serbomadh, ta tejkalojmë përgjithmonë rrezikun e një lufte shfarosëse ballkanike e evropiane.

Zoti Kryetar, zonja e zotërinj, më lejoni që ta përfundoj fjalën time me një mendim të thellë të një miku tim të sinqertë që thotë: "Logjika e blloqeve bllokon logjikën". Prandaj ju thërras juve dhe gjithë botën: le t'i flakim tej të gjitha blloqet, ato raciale, fetare, kombëtare e ideologjike dhe midis popujve e njerëzve të ndërtojmë rrugë të bashkëpunimit, të respektimit të interesave të ndërsjella, të hapim shtigjet e dashurisë e të harmonisë gjithënjerëzore, që ta krijojmë një botë në të cilën të gjithë njerëzit do të jetojnë pa frikë, pa privime dhe me të drejta të barabarta njerëzore e kombëtare.

Faleminderit për mirësinë dhe vëmendjen tuaj.

4 dhjetor 1991

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1. Lexoni fjalimin e Adem Demaçit dhe përgjigjuni pyetjeve:
   a) Kujt i drejtohet simboli i rezistencës në fjalimin e tij?
   b) Si e përshkruan popullin dhe vendin e tij në kohën kur ka mbajtur këtë fjalim?
   c) Si i përshkruan shqiptarët e Kosovës ai?
   ç) Cilat janë thirrjet që i drejton bashkësisë ndërkombëtare?
   d) Cila pjesë e fjalimit të Demaçit në Parlamentin Evropian iu bëri më shumë përshtypje?

Analizojmë tekstin

2. Sa vjeç ishte Adem Demaçi kur mori çmimin "Sakharov" nga Parlamenti Evropian?
3. Nënvizoni pasazhet në të cilat Demaçi flet për gjendjen e popullit të tij. Çfarë kuptoni prej tyre?
4. Ku tregohet forca dhe vendosmëria për të vazhduar në mbrojtje të të drejtave të popullit shqiptar?
5. Si e kuptoni fjalinë e fundit të këtij fjalimi?

Gjuha e tekstit

6. Nënvizoni në tekst fjalët me të cilat autori cilëson popullin shqiptar. Vendosini ato përballë fjalëve me të cilat cilëson pushtuesit. Çfarë vini re?
7. Nënvizoni momentet e përsëritjeve në fjalim dhe tregoni efektin e përdorimit të tyre.
8. Dalloni pjesët e figurshme të tekstit dhe nënvizojini ato.

Reflektojmë rreth tekstit

9. Për cilat "arsye", ikona e mendimit shqip në Jugosllavinë shtypëse i kaloi 28 vjet në burgjet e regjimit serb?
10. Si i kuptoni fjalët e opinionistëve për vdekjen e Adem Demaçit: "[…] Sot humbëm atdhetarin e flaktë, njeriun që mbajti gjallë shpresën e së ardhmes dhe idealin e pavarësisë së Kosovës."
11. Jepni vlerësimin tuaj për qëndresën e A. Demaçit përballë dhunës, represionit e burgosjeve?

Detyrë

- Kërkoni informacione në libra historikë apo në internet rreth figurës madhështore të heroit kombëtar Adem Demaçi. Diskutoni në klasë rreth vlerave të tij njerëzore dhe patriotike.

Celulari: mik apo armik?

Para leximit

Si i keni marrëdhëniet me teknologjinë? Në cilat raste e përdorni atë?

Disa vjet më parë telefonat e lëvizshëm ose celularët, vështirë se mund të konsideroheshin si aparate vërtet "të lëvizshme". Këta telefona ishin të tillë vetëm nëse ju ishit shumë të fortë ose nëse i kishit të instaluar në makinën tuaj, meqë bateritë e tyre ishin jashtëzakonisht të rënda. Telefonat ishin më të mëdhenj sesa kutitë e këpucëve dhe kushtonin mijëra dollarë.

Sot ka rreth 1,35 miliardë telefona celularë. Në disa vende, më shumë se gjysma e popullsisë ka një të tillë. Shumica prej tyre janë aq të vegjël sa fshihen në pëllëmbën e dorës dhe madje disa herë mund të marrësh një telefon edhe pa para. Revista australiane *The Bulletin* raporton: "Afërsisht, numri i këtyre pajisjeve që janë në përdorim, është sa numri i televizorëve dhe i kompjuterëve personalë të marrë së bashku." Sipas një inxhinieri aktiv në industri, celularët nuk janë vetëm një mrekulli e teknologjisë, por edhe "një dukuri shoqërore".

Nga bumi i shitjeve të celularëve, përfitojnë shumë biznese. Një firmë e madhe pohon: "Tregu i celularëve deri tani është segmenti më i madh i pajisjeve elektronike për konsumatorët." Me fjalë të tjera, paratë që shpenzohen sot për celularët janë shumë më tepër sesa ato që shpenzoheshin në të kaluarën për çdo pajisje tjetër elektronike.

Kudo përreth botës, celularët u sigurojnë kompanive të telekomunikacionit miliarda dollarë në vit. Ja përse për bizneset e mëdha celulari është një mik.

Shumica e informacioneve që shkëmbehen nga këto pajisje të teknologjisë së lartë, nuk janë në formë bisede, por me shkrim. Në vend që të flasin me telefon, një numër gjithnjë e në rritje përdoruesish të celularëve, veçanërisht të rinjtë, po përdorin mesazhet e shkruara. Ky shërbim u lejon atyre të shkruajnë dhe t'i dërgojnë mesazhe të shkurtra njëri-tjetrit, duke shpenzuar pak ose aspak. Por për këtë mënyrë komunikimi, ata përdorin një formë të shkurtuar të gjuhës që kombinon shkronjat dhe numrat për të formuar tingullin e fjalës. Edhe pse të shkruarit e mesazheve është i bezdisshëm po të krahasohet me

të folurit në telefon, përsëri, një numër shumë i madh mesazhesh shkëmbehet në të gjithë botën.

Disa aktivistë për çështjet shoqërore shqetësohen pasi shqiptimi i copëzuar dhe sintaksa e përdorur në mesazhe po dëmtojnë aftësitë e të shkruarit dhe të të lexuarit te të rinjtë. Disa të tjerë nuk janë dakord, duke pohuar se dukuria e mesazheve "po shkakton te brezi i ri një rilindje të dëshirës për të shkruar". Megjithëse është bërë objekt debatesh, celulari ka pasur dhe vazhdon të ketë një ndikim të madh si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë shoqëror. Ngjashëm "kushërinjve" të tij elektronikë, televizorit dhe kompjuterit personal, celulari ka fuqinë që, njëkohësisht, të jetë edhe skllav i dobishëm, edhe pronar i ashpër. Faktikisht, është në dorën tuaj të përcaktoni nëse celulari po ju kthehet në një mik apo në një armik.

Nga shtypi

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Shënoni me ✓ kur pohimet përputhen me përmbajtjen e tekstit dhe me ✗ në rastin e kundërt.

	✓	✗
Teknologjia është një risi globale me dobi të mëdha.	☐	☐
Numri i celularëve në përdorim është më i vogël se numri i televizorëve në përdorim.	☐	☐
Kompanitë që i tregtojnë, përfitojnë miliarda dollarë nga shitja e celularëve.	☐	☐
Të rinjtë zhvillojnë shumë biseda telefonike.	☐	☐

Studim teksti

- Gjuha e mesazheve kombinon numrat me shkronjat për të komunikuar me shkurtime. ☐ ☐
- Celulari është mik. ☐ ☐
- Celulari është armik. ☐ ☐

Analizojmë tekstin

2 Si e kuptoni frazën e mëposhtme?

[…] celularët nuk janë vetëm një mrekulli e teknologjisë, por edhe "një dukuri shoqërore".

3 Pse celulari është një "mik" për bizneset e mëdha?

4 Pse konsiderohet "armik" i gjuhës dhe i komunikimit celulari?

5 Interpretoni frazën:

Ngjashëm "kushërinjve" të tij elektronikë, televizorit dhe kompjuterit personal, celulari ka fuqinë që, njëkohësisht, të jetë edhe skllav i dobishëm, edhe pronar i ashpër.

Reflektojmë rreth tekstit

6 Po ju përdorni telefon celular? Për ç'qëllim?

7 Po ju si e konsideroni celularin: mik apo armik? Pse?

Detyrë

- Shtoni dy këshilla për përdorimin e celularit në listën e mëposhtme.

1. Mos e ngrini zërin kur flisni në një vend ku ka njerëz. Mikrofoni i celularit është shumë i ndjeshëm, kështu që zëri juaj mund të dëgjohet edhe kur flisni me zë të ulët. Veç kësaj, me siguri atyre që janë përreth, nuk u interesojnë bisedat tuaja private.
2. Fikeni telefonin ose lëreni pa zë dhe me dridhje, nëse jeni në mësim, në një festë, në një mbledhje në kinema ose në ngjarje të tjera publike.
3. Mos i përdorni celularët që duhen mbajtur në dorë për të folur, kur ngisni makinën.
4. _____
5. _____

Bashkëbisedojmë

Ndahuni në dy grupe dhe diskutoni lidhur me temën: "Përdorimi i teknologjisë në familjet tona dhe rreziqet e mundshme prej saj". Gjatë diskutimit ndaluni edhe në çështjet e mëposhtme.

- A po bien fëmijët në grackën e teknologjisë?
- Ç'dini për dëmet që sjellin lojërat elektronike?
- Sipas jush, cila është grupmosha që është më tepër e dhënë ndaj lojërave elektronike?
- Cilat janë disa nga arsyet që i shtyjnë fëmijët të jenë të dhënë ndaj lojërave elektronike?
- Disa studiues pretendojnë se lojërat elektronike ndikojnë në rritjen e inteligjencës te fëmijët. Sa e vërtetë është kjo sipas jush?

Biblioteka Kombëtare e Kosovës, thesar i diturisë

Biblioteka Kombëtare "Pjetër Bogdani", në Prishtinë, me 99 kupola të bardha të cilat e karakterizojnë pamjen e jashtme të saj, për më shumë se tri dekada paraqet një nga simbolet kryesore të kryeqytetit të Kosovës. Ajo gjendet në qendër të Prishtinës, pranë Universitetit.

Ndërtesa është vepër e arkitektit të njohur kroat me prejardhje shqiptare, Andrija Mutnjakoviq, ndërsa ndërtimi i takon periudhës jugosllave të arkitekturës në Kosovë. E frymëzuar nga hojet e bletëve dhe e ndërtuar me kube dhe gjysmë sfera, është shenjë arkitektonike e arkitekturës rajonale.

Në brendësi të bibliotekës gjenden punimet e artistëve të famshëm kosovarë, sikurse janë mozaikët dhe muralet e Muslima Muliqit, punimet nga druri i lisit, punimet nga drunj të

Teksti përshkrues

Teksti përshkrues ka si qëllim të përshkruajë, duke informuar dhe duke treguar si është ndërtuar një objekt, cilat janë tiparet e një personi, të një kafshe, të një mjedisi, apo të një dukurie.

Përshkrimi mund të jetë objektiv (në enciklopedi, në tekste shkencore, dokumente zyrtare etj.) ose subjektiv (në ditarët, në letrat personale dhe në tekstet letrare). Përshkrimi mbështetet në perceptimin shqisor: të shikuarit, të dëgjuarit, të nuhaturit, të shijuarit, të prekurit. Në të jepen detaje dhe informacione të hollësishme të objekteve që përshkruhen.

Në tekstin përshkrues mbizotëron përdorimi i mbiemrave dhe fjalëve përshkruese.

Në funksion të përshkrimit përdoren edhe ndajfolje, parafjalë, fraza që tregojnë pozicionin në hapësirë të objektit që përshkruhet. Foljet e përdorura janë në kohën e tashme dhe të pakryer.

tjerë dhe mozaikët me të cilët është e shtruar dyshemeja e ndërtesës. Këta janë filigran i punuar me dorë. I ka punuar i ndjeri Simon Shiroka dhe ia ka falur bibliotekës kur është vënë në përdorim, në tetor 1981.

Biblioteka Kombëtare është më e pasura në Kosovë, me rreth 2 milionë libra, dorëshkrime, revista e doracakë në gjuhën shqipe dhe në shumë gjuhë tjera.

Biblioteka ka gjithsej 400 vende për lexues. Ajo është e hapur nga ora 7:00 deri në orën 20:00 dhe librat nuk mund të nxirren jashtë bibliotekës.

Brenda Bibliotekës Kombëtare të Kosovës gjenden edhe shumë biblioteka të veçanta, në mesin e të cilave është biblioteka evropiane, ajo e NATO-s, biblioteka e artit bashkëkohor, biblioteka e artit muzikor, biblioteka për personat e verbër, ndërsa ka edhe biblioteka personale sikurse është ajo e profesorit të ndjerë, Fehmi Aganit, me mbi dy mijë tituj, të cilët i ka dhuruar familja e tij. Është rezervuar vend i posaçëm dhe aty janë librat e tij, tavolina, lapsat, gjithçka ka pasur profesori. Po ashtu edhe për bibliotekën e profesorit Hasan Mekuli. Biblioteka zotëron edhe laboratorin e vet për restaurimin e librave të vjetër.

Fjalor

kupolë – ka formën e një kupe, dhe pjesa e bazës është e rrumbullakët dhe e thellë si një kupë.
murale – art i krijuar mbi mur, p.sh.: piktura murale.
filigran – punim argjendarie si dantellë, i thurur me fije të holla e të dredhura ari, argjendi.
dorëshkrim – tekst i shkruar me dorë ose i daktilografuar, teksti origjinal i veprës.

Në hapësirat e Bibliotekës Kombëtare organizohen edhe ngjarje të ndryshme kulturore, sikurse prezantimi i librave të rinj, diskutime dhe debate, si dhe ekspozita.

Nga shtypi

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

1 Përgjigjuni pyetjeve në lidhje me tekstin:

a) Ku ndodhet Biblioteka Kombëtare dhe sa kupola ka ajo?
b) Kush e ka dizajnuar arkitekturën e Bibliotekës Kombëtare?
c) Nga sa kupola është e përbërë ajo?
ç) Cilat janë veprat e artit që zbukurojnë Bibliotekën Kombëtare?
d) Në ç'orar funksionon ajo?
dh) A mund të nxirren jashtë materialet që ajo zotëron?

Analizojmë tekstin

2 Çfarë përfaqësojnë hojet e bletëve prej të cilave është frymëzuar dizajnuesi i Bibliotekës Kombëtare.

3 Në tekst thuhet: thuhet *Brenda Bibliotekës Kombëtare të Kosovës gjenden edhe shumë biblioteka të veçanta.* Radhitni bibliotekat e tjera, të cilat janë përfshihen brenda saj.

4 Si e interpretoni faktin që në Bibliotekën Kombëtare gjenden edhe dy biblioteka personale? Pse mendoni se ato janë aty? Cili ka qenë qëllimi për të cilin i kanë dhuruar ata që i kanë pasur?

Gjuha e tekstit

5 Në tekst thuhet: *Biblioteka Kombëtare është më* ***e pasura*** në Kosovë. Gjeni lidhjen kuptimore mes të qenit e pasur (me para, metale të shtrenjta, pasuri etj.) dhe të qenit e pasur (me libra).

6 Analizoni figurën e krijuar nga togfjalëshi *"thesar i diturisë",* të përdorur në titull të tekstit.

7 Cilat janë detajet përshkruese më interesante që ju nxitën dëshirën për të vizituar Bibliotekën Kombëtare?

Reflektojmë rreth tekstit

8 Cili është mendimi juaj për librin fizik dhe librin elektronik? Cili është dallimi mes tyre?

Detyrë

- Kërkoni informacione në libra historikë apo në internet rreth historisë së librit. Si lindi libri dhe si u zhvillua teknologjia e shtypshkrimit?
- Përshkruani bibliotekën e shkollës ose të qytetit tuaj.

Foto:
Faruk Krasniqi

Prizreni: qyteti me trashëgimi kulturore

Kalaja e qytetit

Në kalanë e qytetit të Prizrenit, të dhënat e ndryshme nga arkeologët dëshmojnë praninë e ndonjë fortese të ngritur mbi kodrinë që në periudhën dardane e romake, ku objektet e mesjetës vazhdonin të ndërtoheshin mbi objektet antike.

Kalaja, për shkak të pozicionit topografik, bën që të shijosh plotësisht peizazhin tërheqës natyror. Për të shijuar pamjen magjepsëse duhen 20 minuta ecje në këmbë. Një rrugicë e ngushtë lidh qendrën e qytetit kulturor me monumentin që konsiderohet atraksioni kryesor në Prizren. Shkallët e vendosura në rrugicën prej kalldrëmi e bëjnë edhe më sfiduese ngjitjen deri lart. Vizitorët shpeshherë ndalen për të pushuar dhe, kur arrin në kalanë e ndërtuar mbi kodrën e lartë të vendosur në juglindje të qytetit, harrohet lodhja. Ambienti i jashtëzakonshëm piktoresk është një përjetim i paharrueshëm. Prej lart, shihet i gjithë qyteti. Shihen xhamitë, shtëpi dhe objektet tjera që përbëjnë identitetin kulturor të Prizrenit.

Nga "Telegrafi"

Fjalor

topografik – përshkrimi e paraqitja grafike e një vendi me relievin e me shtrirjen e tij.
piktoresk – këtu: i gjallë, me plot ngjyra, mbresëlënës, shumë tërheqës.
Bistrica – (lumë) ndryshe e quajmë Lumbardhë.
përroska – përrua i vogël, rrëke.
dudë – pemë më trung të madh dhe me shtat të lartë, frutat e së cilës piqen ndër të parat, në të njëjtën kohë me qershitë.

Qyteti im

Prizreni sërishmi shtrihet para meje me gjithë bukurinë magjepsëse. Shoh Bistricën time, që ndan qytetin në dy pjesë dhe degëzohet në vija uji që rrjedhin përskaj saj dhe që sjellin gurët e rëndë të mullinjve. Vijat e ujit kalojnë përskaj mureve të shtëpive, nën punëtori, pronarët e të cilave ftohin në to shalqinjtë dhe shishet e birrave, ato kalojnë përtej rrugëve të kalldrëmta me urëza dhe, duke kaluar përskaj plepave, përskaj shkurreve, përskaj shelgjeve, shpërndahen në përrenj e në

përroska. E, këto vrapojnë nën shportat e gjelbra dhe tjegullat e kuqe, me bar veshi mbi to, hyjnë në çdo oborr me lule, shpejtojnë përskaj dudave, pjeshkave, kajsive, mushmollave, dhe, duke ecur nga oborri në oborr, lidhin fqinjët njërin me tjetrin, me qëllim që të derdhen sërishmi në vija uji, e këto në amzën e tyre.

(Fragment nga "E shkëlqyeshmja dhe e tmerrshmja", B. Fehmiu*)*

Studim teksti

Kuptojmë tekstet

1 Përgjigjuni pyetjeve:

a) Çfarë përshkruhet në tekstin e parë? Po në tekstin e dytë?
b) Cili është objekti rreth të cilit përqendrohet më shumë vëmendja në pjesën e parë?
c) Po në pjesën e dytë, rreth kujt përqendrohet më shumë vëmendja?
ç) Në ç'periudhë mendohet se janë fillesat e ndërtimit të vendbanimeve të para në qytetin e Prizrenit?
d) Cili mendohet se është atraksioni kryesor i Prizrenit?
dh) Ku shtrihet lumi i Bistricës? Çfarë roli luan ky lumë për qytetin?

Analizojmë tekstet

2 Si i shikoni tekstet në krahasim njëri me tjetrin?

- ☐ Janë pjesë nga i njëjti tekst.
- ☐ Mund të shihen edhe si vazhdim i njëri-tjetrit.
- ☐ Janë dy pjesë të cilat flasin për objekte pa lidhje me njëri-tjetrin.

3 Gjeni në secilin prej teksteve:

- një fjali ku shprehen fakte;
- një fjali ku shprehen opinione;
- një fjali ku autori bëhet subjektiv;
- një fjali ku jepen detaje përshkruese.

4 Interpretoni këtë frazë: *[…] objektet e mesjetës vazhdonin të ndërtoheshin mbi objektet antike.*

Çfarë do të thotë ky fakt për qytetin?

Gjuha e teksteve

5 Gjeni në tekst pjesët ku rrëfimi nuk është më objektiv dhe ndihet fort emocioni i përjetimeve të atij që përshkruan.

6 Gjeni dy figura letrare në këtë fjali: *Bistrica më duket si një dud i madh, i shtrirë, i thurur nga argjendi i lëngët… Dud i argjendtë.*

Reflektojmë rreth teksteve

7 Çfarë i shton përshkrimit të një qyteti, dhënia e përjetimeve e këndvështrimit tonë rreth atij?

Detyrë

- Përshkruani qytetin ose fshatin tuaj, duke përfshirë në të edhe emocionet dhe kujtimet tuaja.

Njohuri për gjuhën

Fonetikë


FONETIKA
Fonetika studion veçoritë e shqiptimit të tingujve të gjuhës, si dhe rrokjen, theksin, intonacionin etj.
Fjalët përbëhen nga:
Zanoret:
a, e, ë, i, o, u, y
Bashkëtingëlloret:
b, c, ç, d, dh, f, g, gj, h, j, k, l, ll, m, n, nj, p, q, r, rr, s, sh, t, th, v, x, xh, z, zh
Rrokjet:
Fjalët ndahen në rrokje. Rrokjet janë të hapura dhe të mbyllura.
Theksi i fjalës:
Tregon rrokjen e fjalës që shqiptohet më fort. Theksin e fjalës zakonisht nuk e shkruajmë, por e shqiptojmë.

1 Theksi i fjalës

Kujtojmë

Rrokja *është një tingull zanor ose një grup tingujsh* të bashkuar me një zanore, që shqiptohen me një të nxjerrë të frymës. Në të shkruar rrokja përbëhet nga një ose disa shkronja, njëra prej të cilave është gjithmonë zanore. Një ose më shumë bashkëtingëllore nuk formojnë rrokje.
Rrokja mund të përbëhet vetëm nga një zanore ose nga bashkimi i një a më shumë bashkëtingëlloreve me një zanore.
Kur rrokja mbaron me zanore, quhet *e hapur*. Kur rrokja mbaron me bashkëtingëllore, quhet *e mbyllur*.

Marrim në shqyrtim fjalinë: *Sot kemi një veprimtari dobiprurëse.*
Fjalia e mësipërme përbëhet nga pesë fjalë. Secila nga fjalët e saj përbëhet nga rrokje:

sot *ke-mi* *një* *ve-prim-ta-ri* *do-bi-pru-rë-se*

Fjalët e kësaj fjalie mund t'i ndajmë më tej në tinguj (kur i shqiptojmë) dhe në shkronja (kur i shkruajmë):

s-o-t *k-e-m-i* *nj-ë* *v-e-p-r-i-m-t-a-r-i* *d-o-b-i-p-r-u-r-ë-s-e*

Vëreni figurën. Lexoni dhe shqiptoni saktë fjalët. Lidhni fjalët me objektet përkatëse. Dalloni rrokjen e fjalës që shqiptohet më fort.

Shqiptimi me zë më të fortë ose me ton më të ngritur i një rrokjeje në fjalë, quhet **theks**.

Çdo fjalë përbëhet nga një ose më shumë rrokje. Në fjalët me më shumë se një rrokje, dëgjohet më shumë vetëm njëra prej tyre. Ajo quhet **rrokje e theksuar**. Rrokjet e tjera brenda trupit të fjalës, quhen **rrokje të patheksuara**.

Shumica e fjalëve të gjuhës shqipe e kanë theksin në rrokjen e parafundit:
sipërfáqe, fletóre, dritáre, merméri, pakéta etj.

Fjalë me theks fundor

Një numër i paktë fjalësh janë me theks fundor:
çatí, shtëpí, riní, lirí, lumturí, bukurí, dashurí, diturí, egërsí, trimërí, babá, kalá, bakllavá, bé, rrufé.

Disa fjalë të tjera të shqipes e kanë theksin në rrokjen e tretë para fundit të fjalës, si: *pétulla, vétulla, shpátulla, kúmbulla, fshéhurazi, ríshtazi.*

Për t'i dalluar disa fjalë nga njëra-tjetra, mund të përdoret edhe shenja e theksit (ˊ), si p.sh.: *fole* dhe *folé, para* dhe *pará, bari* dhe *barí, drejtori* dhe *drejtorí, ministri* dhe *ministrí, stoli* dhe *stolí.*

Mbani mend

Në gjuhën shqipe, kemi fjalë me:

- theks parafundor: *darë, borë, përpara, përziej etj.* (kur theksi bie në rrokjen e dytë para fundit të fjalës);
- theks tejfundor: *petulla, kumbulla, populli, flutura etj.* (kur theksi bie në rrokjen e tretë para fundit të fjalës);
- theks fundor: *atdhé, lirí, barí, babá, drejtorí, rrobaqepësí etj.* (kur theksi bie në rrokjen e parë para fundit të fjalës).

Theksi i fjalëve na shërben për t'i dalluar disa fjalë nga njëra-tjetra, prandaj te këto fjalë mund ta përdorim në të shkruar atë.

Për shembull: *fole* dhe *folé, para* dhe *pará, bari* dhe *barí, drejtori* dhe *drejtorí, ministri* dhe *ministrí, stoli* dhe *stolí.*

USHTRIME

1 **Lexoni tekstin dhe vendosni theksin mbi çdo fjalë.**

Gjatë Nilit, në Sudan, tregojnë që Jouku (Zoti) krijoi njeriun prej argjilës. Në veri të vendit gjeti argjilë të bardhë, me të cilën ai bëri evropianët; me argjilë kafe ai bëri arabët, ndërsa me dhé të zi afrikanët. Pastaj Jouku tha: "Do t'i bëj njeriut këmbë të gjata për të vrapuar në pellgje; do t'i jap krahë të gjatë, një gojë të madhe për të ngrënë grurë afrikan dhe një gjuhë për të kënduar; sy për të parë ato çka ha dhe veshë për të dëgjuar këngët e tij." ... dhe gjithçka u bë gati.

2 **Vendos fjalët e ushtrimit 1 në tabelën e mëposhtme.**

Theks parafundor	Theks fundor	Theks tejfundor

USHTRIME

3 Emërtoni çdo figurë dhe vendosni theksin në çdo fjalë që do të përdorni.

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

4 Lexoni me intonacionin e duhur tekstin. Shënoni theksin në çdo fjalë.

Herën tjetër, kur të luani një lojë të thjeshtë, apo të merrni pjesë në një ndeshje sportive, mendoni pak se përse ju pëlqen ajo. Çfarë aftësish ju duhen për të spikatur e për të qenë më të mirët në sportin tuaj të parapëlqyer? A mendoni se këto aftësi do t'ju ndihmojnë në jetën tuaj të përditshme? Mbi të gjitha, herën tjetër, kur të luani, argëtohuni, sepse dita juaj do të bëhet edhe më e bukur!

5 Në fjalët e mëposhtme, shënoni theksin me F për fundor dhe me P për parafundor.

gjë ___, pakujdesi ___, këmbë ___, dhomë ___, shok ___, mbështetje ___, sup ___, ndihmë___, përkujdesje ___, kujdes ___, vend ___, kompjuter ___, këngë ___, mëngjes ___, ndeshje ___, ballkon ___ hap ___.

6 Gjeni dhe shkruani pesë fjalë me theks fundor, pesë fjalë me theks parafundor dhe pesë fjalë me theks tejfundor.

_____ _____ _____

_____ _____

7 A ndryshon kuptimi i fjalëve të mëposhtme në rast se u ndryshon edhe theksi?

para, drejtori, polici, stoli, infermieri

_____

- Formoni nga dy fjali me secilën prej fjalëve, në të cilat të dalë i qartë kuptimi i tyre.

_____

_____

_____

_____

_____

Intonacioni dhe theksi i fjalisë

Lexoni fjalitë me intonacionin e duhur. Çfarë vutë re?
Cila është fjala e theksuar në çdo fjali?

Intonacioni është forca e zërit me ulje-ngritje gjatë shqiptimit të fjalëve nga fillimi deri në fund të fjalisë.

Kur flasim ose lexojmë, nuk i shqiptojmë të gjitha fjalitë me të njëjtin intonacion.

Sipas llojit të fjalisë (dëftore, pyetëse, dëshirore, nxitëse etj.), përcaktohet edhe intonacioni i saj. Intonacionin në fjali e kemi ngjitës ose zbritës.

Fjalitë me intonacion zbritës	Fjalitë me intonacion ngjitës
Fjali dëftore: *Avioni u vonua dy orë.* Fjali dëshirore: *U gëzofsh me një djalë!* Fjali nxitëse: *Ulu në vend!*	Fjali pyetëse: *Pse u vonua kaq shumë?*

Në çdo fjali dallojmë edhe intonacionin, edhe theksin e saj. Theksi i fjalisë zakonisht bie mbi fjalën e fundit të saj.

Mos u mërzit! Edhe pak! Ja, erdhëm! Shikoje shtëpinë! Pse kështu janë burrat?!

Përveç theksit të fjalisë, kemi edhe theksin logjik. Këtë theks e përdorim kur duam të vëmë në dukje një nga fjalët e fjalisë.

Nxënësit *shkuan në festë me mësuesit.*
Nxënësit ***shkuan*** *në festë me mësuesit.*
Nxënësit shkuan ***në festë*** *me mësuesit.*
Nxënësit shkuan në festë ***me mësuesit****.*

Theksi logjik mund të bjerë në një fjalë tjetër dhe jo në fjalën mbi të cilën bie theksi i fjalisë. Pra, theksi logjik tregon fjalën të cilën duam ta theksojmë më shumë. Shpesh ai varet edhe nga folësi apo lexuesi dhe nuk duhet ngatërruar me theksin e fjalisë.

USHTRIME

1 **Përcaktoni intonacionin e fjalive. Shënoni me N intonacionin ngjitës dhe me Z atë zbritës.**

Shkoja pastaj dhe ulesha pranë plakut e rrija me orë të tëra pa lëvizur. ____
Sa e sa ditë kam kaluar duke e vështruar teksa punonte. _____
Dhe unë pyesja veten: si i di ky njeri gjithë këto gjëra? ____
Ai dinte gjithçka dhe ishte i gatshëm të më shpjegonte çdo gjë. M'i ka përshkruar malet tona para se të njihesha me to. Më ka folur shpesh për kthesat, shtigjet e monopatet. ____
Po pse e bënte ai këtë gjë? Mos vallë kërkonte të zbulonte diçka të panjohur? ____

2 **Shkruani tri fjali me intonacion ngjitës dhe tri fjali me intonacion zbritës.**

Intonacion ngjitës *Intonacion zbritës*

_____ _____
_____ _____
_____ _____

3 **Lexoni përrallën dhe përcaktoni intonacionin e secilës fjali dhe fjalën mbi të cilën bie theksi i fjalisë.**

Gozhda

Njëherë një tregtar u nis për në panair. Puna i eci për bukuri, të gjitha plaçkat i shiti dhe qesen e mbushi plot me argjend e flori. Futi paret në hejbe, e vari hejben mbi kalë dhe vetë i hipi kalit. U nis shpejt, se donte të arrinte në shtëpi me ditë. Nga mesdita u ndal në një qytet dhe, kur po merrte rrugën përsëri, seizi i kalit i thotë:
– Zotëri, kalit tënd i mungon një gozhdë në patkoin e majtë të këmbës së pasme.
– S'ka gjë, s'ka gjë, – tha tregtari, – s'kam veçse një vrap pele gjer në shtëpi, do ta bëjë kali im edhe këtë rrugë pa mundim. S'kam kohë të pres.
Pasdite u ndal përsëri për t'i dhënë tagji kalit. Përsëri seizi i kalit i kujtoi gozhdën e patkoit dhe e pyeti tregtarin në dëshironte ta çonte kalin te nallbani.
– Lëre të hajë, – i tha tregtari, – kali do të durojë edhe këto pak orë rrugë që i mbetën. S'kam kohë të pres.
U nis, po s'shkoi shumë dhe kali nisi të çalonte. Pas pak filloi të bënte shkapërxime, po edhe kjo nuk zgjati, se kali ra përdhe me një këmbë të thyer. Ç'i mbeti tani të bënte tregtarit? Hodhi hejben në krah e u kthye në shtëpi më këmbë.
Dhe në shtëpi sosi natën vonë.
"Ah, ç'më bëri ajo gozhda e mallkuar! – tha me vete. – Bjeri larg, se del më afër".

Fjalia	Intonacioni i fjalisë	Fjala mbi të cilën bie theksi i fjalisë
Fjalia e parë		
Fjalia e dytë		
Fjalia e tretë		
Fjalia e katërt		
Fjalia e pestë		
...		

Bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme

Kujtojmë

A a	B b	C c	Ç ç	D d	Dh dh
E e	Ë ë	F f	G g	Gj gj	H h
I i	J j	K k	L l	Ll ll	M m
N n	Nj nj	O o	P p	Q q	R r
Rr rr	S s	Sh sh	T t	Th th	U u
V v	X x	Xh xh	Y y	Z z	Zh zh

Tingujt dhe shkronjat

• Vendosni në tabelë *zanoret* dhe *bashkëtingëlloret* e tekstit të mëposhtëm.

Zanoret dhe bashkëtingëlloret

Shumë qytete, shumë krahina pashë në jetën time. Shumë gra e burra njoha. Në vargun e tyre një qytet më mbet në zemër. Një qytet dhe njerëzit e tij. Dhe rrugët e tij – të ngushta dhe të shtrembta. Shtëpitë me ballkone, lumi i shpejtë... Dhe jo vetëm kaq. Edhe tre pleq – tre të urtit e qytetit. Tre të varfrit me të cilët tallej çarshia.

Hivzi Sulejmani

Zanore	Bashkëtingëllore

Gjuha shqipe ka sistemin e saj të tingujve dhe të shkronjave. Tingujt i quajmë *fonema* (nga greqishtja: *phōne* – zë). Çdo gjuhë ka një numër të caktuar fonemash dhe një numër të caktuar shkronjash.
Të gjitha shkronjat që paraqesin tingujt e të folurit të gjuhës shqipe përbëjnë alfabetin e saj.
Gjuha shqipe ka 36 shkronja: *7 zanore* dhe *29 bashkëtingëllore.*
Nga këto, 27 shkronja *janë të thjeshta, si: a, b, c* etj., kurse 9 shkronja të tjera janë *të përbëra, si: dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh.* Shkronjat e përbëra quhen edhe dyshkronjësha.

Bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme

Kur flasim, ne prodhojmë tinguj (fonema). Këta tinguj zënë fill në mushkëri, atje ku grumbullohet ajri. Kur flasim (pra, kur prodhojmë tingujt e të folurit), diafragma ngrihet sipër, ajri shtyhet lart nëpërmjet bronkeve, kalon në laring dhe del nga goja ose nga hunda duke u shndërruar në tinguj të ndryshëm.
Bashkëtingëlloret janë tinguj që artikulohen në hapësirën e gojës duke kapërcyer pengesa.



Bashkëtingëlloret klasifikohen në:

të zëshme	b, v, dh, d, z, x, zh, xh, gj, g, m, n, nj, j, r, rr, l, ll
të pazëshme	p, f, th, t, s, c, sh, ç, q, k, h

USHTRIME

1 Sa herë është përdorur çdo fonemë (tingull) në tekstin e mëposhtëm? Plotësoni grafikun, duke ngjyrosur kutitë aq herë sa është shkruar çdo fonemë.

E kishte dëgjuar shumë herë emrin doktor, po nuk e dinte se ç'ishte ai. Ç'ishte ky doktor? "Doktor! Doktor!", thërriste vajza. "Edhe pak se arritëm, oj bijë! Duro, se doktori do të ta heqë atë dhembje!"

a	b	c	ç	d	dh	e	ë	f	g	gj	h	i	j	k	l	ll	m	n	nj	o	p	q	r	rr	s	sh	t	th	u	v	x	xh	y	z	zh

2 Nënvizoni shkronjat e përbashkëta të fjalëve:

këmbë, pëllëmbë, shtambë, mbrëmje, llambë.

3 Tregoni se cilët tinguj bëjnë dallimin kuptimor në fjalët e mëposhtme:

fal – fall, kor – korr, pulë – pullë, hallë – halë, kokërr – dokërr.

USHTRIME

4 **Vendosni në tabelë bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme të tekstit të mëposhtëm.**

Lojërat më të famshme, siç janë ato Olimpike, mbledhin atletë nga e gjithë bota. Ato kthehen në manifestime të bukura sportive dhe shpalosin paqen dhe dashamirësinë mes popujve. Spektatorët valëvitin flamujt, përshëndesin kampionët; ata e dinë se çdo medalje ari është një fitore e bukur si për atletin, ashtu edhe për vendin nga ka ardhur ai.

Bashkëtingëllore të zëshme	Bashkëtingëllore të pazëshme
_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____

5 **Plotësoni tabelën e mëposhtme.**

A ju kanë thënë ndonjëherë se sa e rëndësishme është të kesh një fjalor të pasur? Ndoshta jua ka kujtuar gjyshja, teksa përpiqeshit të zgjidhnit një fjalëkryq. Ndoshta e keni ndeshur në orën e gjuhës apo kur keni bërë detyrat e shtëpisë. Megjithëse mund t'ju tingëllojë pak e çuditshme, dijeni se pasurimi i fjalorit ka një rëndësi të madhe. Fjalori i pasur ju ndihmon jo vetëm të shpreheni bukur, qartë dhe saktë, por edhe të analizoni më thellësisht e më hollësisht çështje të ndryshme, pasi ju mundëson të shihni larmishmërinë e botës.

Sa zanore dhe sa bashkëtingëllore ka fjalia e parë?	
Sa shkronja ka fjalia e dytë?	
Sa shkronja *të thjeshta* (njëshe) dhe sa *të përbëra* (dyshe) ka në fjalinë e fundit?	

Drejtshkrim

DREJTSHKRIMI

Tërësia e rregullave që na tregojnë se si duhet t'i përdorim shenjat e pikësimit.

Tërësia e rregullave që na tregojnë se si t'i shkruajmë drejt fjalët e gjuhës standarde.



Apostrofi

Apostrofi është një shenjë si presje, e cila vendoset sipër rreshtit:

- për të shënuar rënien e tingullit -ë- te fjalët "më" dhe "të":
  m'i tregoi, t'i lexoi, do t'i mësoj, për t'i pasur, me t'i thënë, do t'u përgjigjet, për t'u lexuar, me t'iu afruar, t'ju ftojmë, t'ju ndihmojmë, t'ua sjell, t'jua sjell, t'u shtoftë, t'u realizoftë etj.
- pas pjesëzës mohuese "s":

s'arritëm	dhe jo	~~sarritëm~~
s'erdhi	dhe jo	~~serdhi~~
s'e njoh	dhe jo	~~se njoh~~

- pas përemrit "ç":

ç'e do?	dhe jo	~~çe do~~?
ç'është?	dhe jo	~~çështë~~?
ç'donte?	dhe jo	~~çdonte~~?

Kujdes

Shkruhen pa apostrof përemrat "çdo" dhe "çfarë", si edhe fjalët e formuara prej tyre: *çdo djalë, çdo vajzë, çfarë dëshiron, nuk kuptoj çfarë thua; çfarëdo, çdonjëri, çdokush* etj.

USHTRIME

1 Qarkoni alternativën e saktë.

a. çdo vajzë e klasës	b. ç'do vajzë e klasës
a. s'e njoh atë nxënës	b. se njoh atë nxënës
a. sarritëm në kohë	b. s'arritëm në kohë
a. vjen me ti thënë	b. vjen me t'i thënë
a. do tju ndihmoj	b. do t'ju ndihmoj
a. do t'jua sjell nesër	b. do tjua sjell nesër
a. t'u plotësoftë dëshira	b. t'u plotësoftë dëshira
a. çfarë mendon?	b. ç'farë mendon?
a. e njihte çdokush	b. e njihte ç'do kush

2 Gjeni fjalët e shkruara gabim. Rishkruajini ato duke vendosur apostrofin atje ku duhet.

tu marrësh nga një dhuratë _____	do tu kisha lajmëruar _____
do tu përgjigjem menjëherë _____	tjua them hapur _____
do ti kërkoja _____	do ti flas _____
smbërritëm dot në kohë _____	çështë e vërteta _____
serdhi bashkë me shokët _____	Çthoshte kampioni? _____
Çe do topin e futbollit? _____	se hapi derën _____
për ti pasur si dëshmi _____	me ti thënë një fjalë _____
ngrihet në këmbë _____	do tu kërkosh falje _____
do tjua kisha thënë më parë _____	do tjua lehtësojë shumë punën _____

3 Shkruani një tregim të shkurtër me temë "Fluturim në kozmos", në të cilin të përdorni deri në dhjetë fjalë që shkruhen me apostrof.

2 Drejtshkrimi i lidhëzave



- **Në vend të secilës vizë shkruani lidhëzën që mungon.**

Dreni _____ gjyshja e tij po hanin akullore në park. Gjyshja po i thoshte: - Mbrëmë pashë diçka të çuditshme _____ po kthehesha në shtëpi. Mund të ketë qenë ora tetë. Zakonisht, rruga e shtëpisë sime është plot me njerëz në atë orë, _____ mbrëmë nuk kishte këmbë njeriu. Nuk ishin _____ djemtë e lagjes, _____ qeni _____ më pret te porta. _____ të shmangia ndonjë të papritur, ngadalësova hapin. Mendova _____ po ndodhte diçka e keqe.

Lidhëzat që shkruat në tekstin e mësipërm, janë: *dhe, kur, megjithatë, as, që, me qëllim që*. Lidhëzat *dhe, kur, as, që* janë lidhëza të parme; lidhëza *megjithatë* është lidhëz e përngjitur; lidhëza *me qëllim që* është shprehje lidhëzore.
Siç vihet re në shembujt e mësipërm, lidhëzat e parme dhe të përngjitura **shkruhen bashkë**; shprehjet lidhëzore **shkruhen ndaras**.

Tabela e klasifikimit të lidhëzave sipas formimit

Lidhëza të parme	Lidhëza të përngjitura	Shprehje lidhëzore
apo, as, dhe, e, edhe, por, o, që, veç, si, tek etj.	*derisa, porsa, kurse, megjithëse, ndonëse, ngado, kudo, kurdo, meqë, mirëpo, përveçqë, përveçse, veçse* etj.	*në qoftë se, me qëllim që, qoftë... qoftë, jo vetëm..., por edhe, edhe pse* etj.

USHTRIME

1 **Nënvizoni lidhëzat që gjenden në fjalitë e mëposhtme. Përcaktoni llojin e tyre sipas formimit.**

Livia është e dashur, por është shumë e ndrojtur.
Ju doni akullore me luleshtrydhe apo me limon?
Lindi nuk mund të dalë jashtë, sepse është i sëmurë me grip.
Mbi krevat janë çorapet dhe pizhamet e Bledit.

2 **Nënvizoni lidhëzat që nuk janë shkruar si duhet. Shkruajini si duhet ato.**

Në se bie shi, s'vjen njeri. _____
Nuk të kam shok, nëqoftë se vazhdon të sillesh kështu. _____
Nisemi menjëherë në se hapet koha. _____
Kur ikën macja, lozin minjtë. _____
U la në det ndo nëse ishte ftohtë. _____

3 **Shkruani sipas mënyrës së formimit lidhëzat e mëposhtme.**

derisa *porsa* *kurse* *ngado* *sado*	deri + sa	*nëse* *sikurse* *megjithatë* *kurdo* *sido*

4 **Shkruani dy fjali që të kenë lidhëza të thjeshta, dy që të kenë lidhëza të përngjitura dhe dy që të kenë shprehje lidhëzore.**

Drejtshkrimi i parafjalëve

- Në vend të secilës vizë shkruani parafjalën që mungon.

Sapo dola _____ shkolla. _____ oborr dëgjohej gumëzhitja e fëmijëve. Dy vajza vrapuan _____ meje. Sot do të shkoj _____ një shok për të mësuar. _____ rrugës së shtëpisë së tij ndodhej një ndërtesë e madhe.

Parafjalët që shkruat në tekstin e mësipërm janë: *nga, nëpër, rreth e qark, te, përballë*. Parafjalët *nga* dhe *te* janë parafjalë të parme; parafjalët *nëpër* dhe *përballë* janë parafjalë të përngjitura; parafjala *rreth e qark* është shprehje parafjalore.

Siç vihet re në shembujt e mësipërm, parafjalët e parme dhe të përngjitura **shkruhen bashkë**; shprehjet parafjalore **shkruhen ndaras.**

Tabela e klasifikimit të parafjalëve sipas formimit

Parafjalë të parme	Parafjalë të përngjitura	Shprehje lidhëzore
nga, te, mbi, në, nën, me, pa, për, prej, afër etj.	*nëpër, përmbi, ndërmjet, përpara, matanë, përreth, nëpërmjet, përballë, përbri, përkrah etj.*	*ballë për ballë, rreth e qark, rreth e rrotull, për shkak të, në bazë të, në kundërshtim me, në lidhje me etj.*

USHTRIME

1 **Nënvizoni parafjalët që gjenden në fjalitë e mëposhtme. Përcaktoni llojin e tyre sipas formimit.**

Nga dita në ditë po ngrohet moti. Bari ishte njomur nga vesa e mëngjesit. Përmbi mal u dukën disa re të dendura. Fëmijët ngazëllenin duke vrapuar rreth e rrotull livadhit. Rrezet që vinin lart nga hëna ndriçonin çatitë e shtëpive që bënin gjumin e natës. Fëmijët u larguan duke ecur përmes shtegut të ngushtë. Përtej livadhit të zinte syri një tufë me dele që kullosnin barin e njomë.

2 **Nënvizoni parafjalët që nuk janë shkruar si duhet. Shkruajini si duhet ato.**

Dikush lajmëroi rreth-e-qark diçka dhe një burrë plak me fytyrë të habitur u doli përpara. Ai i përshëndeti duke vënë dorën për para zemrës dhe i ndihmoi të hiqnin palltot, që i vari pastaj për mbi gunat e fshatarëve.
Kur ata hynë në dhomën e madhe, të gjithë lëvizën, pëshpëritën, zgjatën kryet si një korije plot drurë dhe lule ngjyra-ngjyra, që gjallërohet papritur nga një erë e fortë.

3 **Shkruani sipas mënyrës së formimit parafjalët e mëposhtme.**

përmbi	*për + mbi*	*nëpërmjet*
nëpër		*përballë*
ndërmjet		*përbri*
përpara		*përreth*

4 **Shkruani dy fjali që të kenë parafjalë të thjeshta, dy që të kenë parafjalë të përngjitura dhe dy që të kenë parafjalë lidhëzore.**

Fjalëformim



Përbërësit e fjalës

Fjalët dalin në forma të ndryshme kur i përdorim në fjali:



ari

Ariu jeton në pyll.

arinj

Arinjtë jetojnë bashkë.



Në shembujt e mësipërm, pjesa e fjalës ari-, që mbetet pasi heqim mbaresën, quhet **temë** e fjalës. Pra, fjala përbëhet nga tema dhe nga mbaresa.
Pjesa e fjalës që ndryshon quhet **mbaresë**.
Mbaresa tek emri mund të tregojë gjininë, numrin, rasën. Pra, ato tregojnë tiparet gramatikore të fjalës.

Rasë: ariun	Numër: arinjtë	Trajtë: ariu	Gjini: ariu

Mbani mend

Me anë të parashtesave dhe të prapashtesave formohen fjalë të reja, kurse me anë të mbaresave formohen trajta të ndryshme të fjalëve.

Tema e fjalës *ari* nuk vjen nga ndonjë temë tjetër. Ajo është edhe rrënja e fjalës.
Rrënja është pjesa më e vogël e kuptimshme e fjalës. Ajo gjendet duke i hequr temës parashtesat, prapashtesat dhe mbaresat.

Parashtesa është pjesa e fjalës që qëndron para temës dhe formon fjalë të reja.
Për shembull: ***ri***-*botoj*, ***për***-*dredh*, ***mbi***-*vlerësoj*, ***nën***-*shkruaj*, ***zh***-*vendos* etj.
Prapashtesa është pjesa e fjalës që shtohet pas temës dhe formon fjalë të reja.
Për shembull: *gjah*-***tar***, *tërheq*-***ës***, *bark*-***as***, *lidh*-***je***, *sport*-***ist***, *vez*-***ak*** etj.

USHTRIME

1 Shkruani fjalët e mëposhtme duke ndarë mbaresën nga secila fjalë.

problemi	problem-i	fabula	fabul-a	duart	duar-t
poezia	_____	ideja	_____	lapsi	_____
patina	_____	kupa	_____	mendimet	_____
gjumi	_____	flakët	_____	pyetjet	_____

2 Nënvizoni rrënjën; ndani temën nga mbaresat:

dritaret, i motshëm, mbrëmjen, të menduarit, të përfolurit, nëntokësorët, shkrimtarin, librarit ë.

3 Plotësoni mbaresat në fjalët e tekstit të mëposhtëm.

Dikush foli. Djal__ nuk dëgjoi se çfarë tha ai. Pastaj ai dëgjoi vetëm zër__ e tij dhe të disa burr__ që flisnin e flisnin njëri pas tjetrit. Mbi kok__ e tyre shtëllung__ e tym__, pasi dilnin duke u përdredhur, bashkoheshin me të tjera në një vall__ tymnaj__, përzier me peshën e mendim__. Bised__ e tyre ishte e gjatë, e pafund, si litar__ e shiu__ ditëve të dimr__.

2 Fjalë të parme dhe jo të parme

Fjalët e gjuhës shqipe mund të jenë fjalë të parme ose fjalë jo të parme.

Fjalët që përbëhen vetëm nga rrënja, quhen **fjalë të parme**. Pra, këto fjalë nuk formohen prej fjalësh të tjera: *tokë, kokë, atë, shtëpinë* etj.

Fjalët quhen **jo të parme** kur formohen prej fjalësh të tjera (parashtesa apo prapashtesa), si dhe me mënyra të tjera. Fjalë jo të parme janë: *ëmbëlsi, udhëtim, udhëkryq, anembanë, rilexoj* etj.

Fjalët jo të parme mund të jenë **të prejardhura** *(përurim, ndërhyj, mosbesim, mbiçmoj, jonormal, gjuhësi, këngëtar, barkas, përfundoj, pafundësi, zbukuroj);* **të përbëra** *(verilindje, kuqezi, duarartë, gjellëbërës, trefish);* **të përngjitura** *(farefis, gjëegjëzë, i drejtpërdrejtë, gjithmonë).*

Fjalët e prejardhura

Fjalët që formohen me parashtesa ose prapashtesa, quhen fjalë të prejardhura: *përpunoj, përvesh, zvogëlim, verore* etj.

Fjalët e prejardhura formohen me parashtesim (parashtesë + temë), me prapashtesim (temë + prapashtesë), me parashtesim dhe prapashtesim njëherësh (parashtesë + temë + prapashtesë).

Parashtesimi

Fjala e prejardhur, e formuar me **parashtesim**, krijohet duke vendosur para temës së fjalës ose vetë fjalës parashtesa të ndryshme.

për + vesh = *përvesh*
nën + tok + a = *nëntoka*
ri + vlerësoj = *rivlerëso*

Prapashtesimi

Fjala e prejardhur, e formuar me **prapashtesim**, krijohet duke vendosur prapa temës prapashtesa.

këngë + tar = *këngëtar*

Parashteso-prapashtesimi

Fjala e prejardhur, e formuar me **parashteso-prapashtesim**, krijohet duke vendosur para dhe prapa temës fjalëformuese parashtesa dhe prapashtesa njëherësh.

z + bukur + o = *zbukuro*

Pra, fjalëve të formuara në këtë mënyrë u shtohen parashtesa dhe prapashtesa njëkohësisht. Ato nuk kanë kuptim nëse përdoren vetëm me parashtesë (~~*zbukur*~~) as vetëm me prapashtesë (~~*bukuro*~~).

USHTRIME

1 Vendosni në tabelë fjalët me të zeza të tekstit të mëposhtëm.

Një çunak i vogël ***rrinte*** *para* ***portës*** *së* ***shkollës*** *dhe më* ***shikonte*** *me* ***drojë*** *dhe* ***turp****. Ishte i* ***hollë****, i gjatë,* ***sykaltër*** *e* ***flokëkaçurrel****. Një* ***ditë*** *m'u afrua dhe më* ***zgjati*** *një letër* ***të palosur****. Ishte një* ***vjershë*** *e shkruar me* ***vargje*** *të thjeshta dhe plot dashuri e* ***ngrohtësi****.* ***Të paharrueshme*** *do të mbeten ato vargje që shprehnin* ***mirënjohje të pafundme****.*

Fjalë të parme	Fjalë jo të parme

2 Lidh me shigjetë fjalën e prejardhur me rrënjën.

mbiçmoj	*drejt*	*këmbësor*	*fryt*
jonormal	*fund*	*shfrytëzoj*	*gazetë*
përfundoj	*çmo*	*përurim*	*këmbë*
padrejtësi	*normal*	*gazetar*	*urim*

3 Te fjalët me shkronja të zeza gjeni: mbaresat, temën, parashtesat, prapashtesat dhe rrënjën.

Aeroplani merr ***lartësinë*** *me shpejtësi. Zemra më rreh me forcë. Përpara meje një mori* ***instrumentesh.*** *Disa lëvizin si të gjalla, disa* ***vështrojnë*** *të palëvizshme numrat,* ***shigjetat*** *dhe akrepat e tyre. Ja, me këto instrumente piloti bën* ***vazhdimisht*** *një dialog të gjatë, këtu, lart në qiell.* ***Gjuha*** *e tyre është e saktë, e përpiktë. Mos u beso* ***syve****, thonë* ***ata****, kur përreth është errësirë. Na* ***beso*** *neve, tani je në këtë lartësi. Po mua më duket se jam më ulet? Jo, të gënjejnë dritat e tokës. Me duket sikur* ***motori*** *po pakëson xhirot. S'është e vërtetë. Të* ***gënjejnë*** *veshët. Motori punon në rregull. Instrumentet luftojnë vazhdimisht me* ***iluzionet*** *që mund t'i* ***lindin*** *pilotit në fluturim, sidomos në* ***fluturimet*** *e natës. Piloti duhet t'u besojë gjithmonë instrumenteve. Kur humbet* ***besimin*** *në to, atëherë rrezikun e ke mbi kokë, ai fluturon bashkë me ty.*

Ismail Kadare

4 Formoni fjali në të cilat foljet e mëposhtme të përdoren si emra që tregojnë veprim.

P.sh.: *dal – dalje. Ndërtesa e re kishte dy dalje emergjente.*

hyj _____

blej _____

mësoj _____

përgjoj _____

çaj _____

pres _____

3 Parashtesat

Me parashtesa formohen fjalë të reja, me kuptime të ndryshme nga kuptimet e fjalëve prej të cilave vijnë. Parashtesat më të përdorshme në gjuhën shqipe janë:

Parashtesa	Shembuj fjalësh
mos-, pa-, ç-, sh-, zh-, z-	*mosbesim, mospajtim, paqartësi, padituri, çrrënjos, shquaj, zhvendos, zbuloj, zbath*
mbi-, për-, ri-	*mbivlerësoj, përshkruaj, përforcoj, rilexoj, ripunoj*
ndër-, në-, nën- pa-, për-, mbi-	*ndërhyj, nëpunës, nëntokë, papunësi, përbuz, përkrah, mbishkruaj*
para-, prapa-, jashtë-, brenda-, larg, - pranë-, sipër-	*parathënie, prapambetje, jashtëshkruaj, brendashkruaj, largpamës, pranëvënie, sipërmarrje*

Gjatë përdorimit të fjalëve të prejardhura me parashtesim, duhet të tregojmë kujdes që parashtesat e huaja t'i zëvendësojmë me parashtesa të shqipes: **a-/jo-**, **anti-/kundër-**, **de-/sh-**, **inter-/ndër-** etj.

~~anormal~~ - jonormal
~~antiajror~~ - kundërajror
~~deformoj~~ - shformoj
~~interurban~~ - ndërurban

USHTRIME

1 Nënvizoni parashtesat e fjalëve:

skuq, i padrejtë, shthur, nënkuptoj, zhduk, përkujtoj, i padalë, i paditur, zhveshje, shpalos, mbivlerësoj, parathënie, nëndrejtor, stërnip, stërdhëmb.

2 Me parashtesat *pa-, mos-, jo-, ç-, sh-, zh-,* formoni fjalë të reja me kuptim të kundërt me fjalët: ***dituri, aftësi, besim, shkencor, qep, vendos, thur.***

_____

_____

3 Shkruani fjali duke përdorur fjalë që formohen me parashtesat: *ç-, sh-, zh-, z-*.

_____

_____

_____

_____

Prapashtesat

Me prapashtesa formohen fjalë të reja, me kuptime të ndryshme nga kuptimet e fjalëve prej të cilave vijnë. Prapashtesat më të përdorshme në gjuhën shqipe janë:

Prapashtesa	Shembuj fjalësh
-ar, -tar, -or, -tor	*baritor, këngëtar, gazetar, drejtor, fajtor, mesatar, bimor*
-as, -çe, -je, -ës	*elbasanas, barkas, nipçe, fshatçe, marrje, thirrje, çelës, mbushës, flakës, djegës, folës, nxënës*
- i, -si, -ri, -zi	*blegtori, dituri, përgjegjësi, befasi, bollshmëri, ashpërsi, cekësi, mbarësi, barkazi, fshehurazi*

USHTRIME

1 Shkruani përgjigjet e pyetjeve dhe nënvizoni prapashtesat.

Si quhet personi që shkruan artikuj gazete? _____

Si quhet sportisti që luan futboll? _____

Si quhet personi që mëson nxënësit? _____

Si quhet personi që shet në një dyqan? _____

Si quhet personi që këndon? _____

Si quhet personi që flet në televizor? _____

2 Lidhni fjalët me prapashtesat e mëposhtme për të formuar fjalë të reja.

shkrim	-ar	mendim
piano		dal
udhë	-tar	anë
gjah		treg
montoj	-tor	sport
fshat		vend
ndihmë	-ës	lind
drejt		kuvend
marr	-ist	shah
vesh		not
shëtit	-im	punë
ditë		lajm
qytet	-je	anë

3 Krijoni fjalë me prapashtesat *-ar, -tar, -or, -tor, -im, -je* dhe përdorini ato në fjali.

Leksikologji



Fjala dhe kuptimi i saj



Fjalët e një gjuhe përbëjnë leksikun e saj. Ato shkruhen dhe ruhen në fjalor.

Çdo fjalë ka formën dhe një ose më shumë kuptime.

Forma e fjalës përbëhet nga tërësia e tingujve (kur e shqiptojmë) dhe e shkronjave (kur e shkruajmë).

P.sh.: forma e fjalës *çelës* përbëhet nga tingujt dhe shkronjat
ç / e / l / ë / s - çelës (forma).

Fjala çelës ka këto kuptime:

kuptimi 1	mjet i metaltë që shërben për të hapur a për të mbyllur një bravë a dry (çelësi i shtëpisë).
kuptimi 2	vegël pune që shërben për të liruar ose shtrënguar një vidhë (çelës anglez).
kuptimi 3	shenjë në krye të pentagramit për të caktuar shkallën e lartësisë së notave (çelësi i solit).

Kuptimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme të fjalëve

Shumica e fjalëve të gjuhës shqipe kanë më shumë se një kuptim. Këto kuptime mund të jenë:

- të drejtpërdrejta;
- të figurshme.

Analizojmë disa nga kuptimet që mbart fjala *gjyshe*.

Kuptimet e fjalëve

Kuptimi 1 Nëna e prindërve kundrejt mbesës apo nipit.	**Kuptimi 2** Grua në moshë të thyer kundrejt një fëmije.
Përbërësit e kuptimit 1 ▢ njeri i seksit femër; ▢ njeri në moshë të thyer; ▢ njeri me lidhje farefisnore me fëmijën: ◉ nga ana e babait ose nënës; ▢ kundrejt nipit ose mbesës.	**Përbërësit e kuptimit 2** ▢ njeri i seksit femër; ▢ njeri në moshë të thyer; _____ _____ ▢ kundrejt një fëmije çfarëdo.
Shembull ▢ *Pushimet e verës do t'i kaloj te **gjyshja**, në fshat.*	**Shembull** ▢ *Pse po mundohesh kaq shumë, moj gjyshe? Prit të të ndihmoj pak unë. Të kam si **gjyshen** time.*

Nga përbërësit e kuptimit 2 të fjalës *gjyshe,* kuptojmë se kjo fjalë nuk është përdorur në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës (kuptimit 1), por në një kuptim të figurshëm.

Në këtë kuptim (kuptimi 2), fjala *gjyshe* përdoret edhe për një person që ngjan me të vërtetë me të.

Mënyrat e krijimit të kuptimeve të figurshme të fjalëve

Kuptimet e figurshme të fjalëve mund të krijohen nëpërmjet mënyrave të ndryshme, që janë renditur më poshtë.

- Nëpërmjet metaforës gjuhësore. Në këtë rast, emërtimin e një fjale e përdorim për diçka tjetër, mbi bazën e një tipari të përbashkët: ***Është një dhelpër ajo, që s'e ka shoqen***.
- Nëpërmjet përdorimit të prapashtesave me nuanca përkëdhelëse dhe keqësuese.

prapashtesa	shembull
-zë	*zogëzë*
-th	*birth*
-aq	*ngordhalaq*
-ash	*balash*
-ac	*përtac*
-ec	*grindavec*
-osh	*bukurosh*

Nëpërmjet përdorimit të intonacionit të veçantë me nuanca: përbuzjeje, talljeje, shakaje, ironie: *Vërtet! Ashtu?! Posi?! Me gjithë mend?!*

USHTRIME

1 Zbërtheni kuptimin e drejtpërdrejtë (kuptimi 1) dhe kuptimin e figurshëm (kuptimi 2) të fjalëve në tabelat e mëposhtme. Argumentoni nëpërmjet shembujve përse kuptimi 2 është kuptimi i figurshëm i kësaj fjale.

Fjala *bir*	
Kuptimi 1	Kuptimi 2
Përbërësit e kuptimit 1 _____ _____ _____	Përbërësit e kuptimit 2 _____ _____ _____
Shembull _____ _____	Shembull _____ _____

Fjala *bijë*	
Kuptimi 1	Kuptimi 2
Përbërësit e kuptimit 1 _____ _____ _____	Përbërësit e kuptimit 2 _____ _____ _____
Shembull _____ _____	Shembull _____ _____

2 Gjeni prapashtesa (përveç atyre që janë dhënë në tabelën e mësimit) që u japin fjalëve nuanca përkëdhelëse dhe keqësuese. Për secilën prej tyre gjeni nga dy shembuj.

3 Formoni fjali me tri fjalë, duke i përdorur në kuptim të figurshëm. Lexojini ato, duke përdorur një intonacion të veçantë, në përputhje me kontekstin e fjalisë.

Dialektet e gjuhës shqipe

Në krahina, në fshatra apo në qytete të caktuara përdoren variante të gjuhës shqipe, që janë të kuptueshme kryesisht prej folësve të atij vendi. Kjo gjuhë nuk dallohet për respektim të standardit si në të folur, ashtu dhe në të shkruar.

Mbani mend

Dialekti është një variant i gjuhës që përdoret nga folës të një treve të kufizuar ose nga folës të një shtrese shoqërore të veçantë.

Gjuha shqipe ka dy dialekte kryesore: ***gegërishten*** dhe ***toskërishten***.

Edhe brendapërbrenda një dialekti ka dallime gjuhësore sipas krahinave të ndryshme. Këto dallime përbëjnë **krahinorizmat** ose të folmet krahinore.

Dialekti gegë përdoret në të djathtë të rjedhës së lumit Shkumbin. Pra, deri në Vermosh brenda kufijve të Shqipërisë, në Kosovë, në Maqedoninë Perëndimore dhe në pjesën jugperëndimore të Malit të Zi.

Dialekti toskë përdoret në të majtë të lumit Shkumbin. Pra, deri në Konispol brenda kufijve të Shqipërisë, dhe në të folmet çame në Greqi deri në gjirin e Prevezës.

- **Lexoni tekstet e mëposhtme dhe përcaktoni se cili prej tyre i përket dialektit të Veriut dhe cili dialektit të Jugut. Gjeni ndryshimet ndërmjet tyre.**

Shtegu që çon te kroni asht shetija e katundarvet. Buzë mbramje me buljere në krah, dalin gra e vajza për me mbushun uj në krue. Ndeshen udhës shoqe me shoqe e shëndrrojnë dy fjalë. Dita asht e mundshme ndër katunde e ato biseda mbramjeje disi janë nji pushim e nji argtim. E ndërsa dielli prendon e hana del, kroni i mbushë buljerat nji nga nji tue kendue. Secilës vajzë e secilës grue i kendon nga nji kange, përse kroni te tana i njef. Vajzat i njef të vogla e i pau dalkadalë tue u rritë; gratë i njef nuse e i pau dalkadalë tue u plakë. Pasqyra e qetë e ujit mban kujtimin e të gjitha fytyrave....

Ernest Koliqi

Emri i katundit është Bubutimë, si pas zhurmës që bën deti. Paralajmërojmë lëçitësit të mos e kërkojnë këtë katunt të lashtë në vëndin ku pat qënë klhisur sepse e kanë shembur tërmetet e luftrat dhe vëndin e mbulon sot një pyll i dendur.
Të fundit njerës që dinin të na tregojnë gjyrmat: Tat Tanushi, Imzot Nikanori, një bari edhe njëmbëdhjetë priftërinj të asaj krahine, flenë sot gjumin e tokës dhe ne s'kemi fuqinë t'i sjellëm prapë në jetë që t'i pyesëm. Një gjë që dihet mirë është se Bubutima ka qënë një katunt i math, jo shumë lark nga deti që i thonë Adriatik. Vëndi është i bukur sepse toka bleron...

Mitrush Kuteli

Dialektet e shqipes, përveç të përbashkëtave të shumta, kanë edhe dallime. Disa prej tyre janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Karakteristika	Gegërishte	Toskërishte
Kanë togun	ue: *mue, punue, grue* etj.	ua: *mua, punuar, grua* etj.
Kanë zanoren	a hundore: *kambë, nanë, hana* etj.	ë: *këmbë, nënë, hëna* etj.
Kanë -n- ose -r- ndërzanore.	Ruan -n-në ndërzanore hundore: *zani, bana* etj.	-N-në ndërzanore të gegërishtes e kthen në -r-: *zëri, bëra* etj.

Dialektet janë pasuri leksikore e gjuhës. Gjuha standarde pasurohet duke marrë vazhdimisht fjalë prej tyre, me të cilat zëvendëson fjalët e huaja ose sjell nuanca e ngjyrime emocionuese a larmi të shprehjes. Tabela e mëposhtme paraqet disa fjalë të tilla, bashkë me shpjegimet përkatëse.

dhishta	*vend dhish*	*emnaku*	*adashi*
fushëgropë	*fushë në mes malesh*	*fyshtë*	*zbrazëti, boshllëk*
hatroj	*mbaj me hatër*	*lylë*	*flluskë*
ndërmjetëza	*muri ndarës*	*i proshkët*	*i freskët, taze*
pleqësore	*pleqsh*	*i prajtë*	*i heshtur*

Edhe në fushën e fjalëformimit, gjuha standarde mbështetet shumë në modele dialektore. Për shembull, për formimin e disa emrave, si: *lexues, mësues, ndërtues, hekurpunues, i lejueshëm* etj., ka shërbyer si temë prodhuese pjesorja e dialektit të Veriut që mbaron me togun –ue (*lexue, ndërtue, punue, lejue*). Nga ana tjetër, forma e pjesores në -ua e dialektit toskë ka shërbyer si temë fjalëformuese për mbiemrat e nyjshëm: *i lexuar, i mësuar, i ndërtuar, i punuar, i lejuar* etj.

USHTRIME

1 Plotësoni diagramin e Venit për të gjetur të përbashkëtat dhe dallimet mes të folmeve dialektore dhe dialektit.



2 Plotësoni tabelën e mëposhtme, në mënyrë që të paraqitni disa nga dallimet mes gegërishtes dhe toskërishtes.

Karakteristika	Gegërishte	Toskërishte

3 Mblidhni fjalë dialektore të zonës suaj (duke pyetur të afërmit dhe të moshuarit) dhe përbri secilës prej tyre shënoni shpjegimin në gjuhë standarde.

Gjuha standarde, roli dhe rëndësia e përdorimit të saj

Gjuha standarde shqipe është varianti më i përpunuar i gjuhës së popullit shqiptar. Ajo përfshin gjuhën që përdoret në shkollë, në dokumente zyrtare, në botime, si dhe në komunikimin zyrtar.

Të gjitha mediat, në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoni e kudo ku ka shqiptarë, përdorin gjuhën standarde shqipe.

Gjuha standarde shqipe dallohet për praninë e rregullave dhe normave, që duhen zbatuar. Këto rregulla dhe norma janë vendosur pas shqyrtimit të disa formave të mundshme. Kjo do të thotë se ndër disa fjalë dhe ndërtime me të njëjtin kuptim, është zgjedhur njëra formë si **përfaqësuese** më e pëlqyeshme dhe janë përcaktuar edhe rregullat për çdo rast.

Rasti	Forma të mundshme	Forma përfaqësuese
e pakryera e foljes	shkonja, shkojsha, shkoja	shkoja
e ardhmja e foljes	do shkoj, do të shkoj, kam me shkue, kam të shkoj	do të shkoj

Mbani mend

Pra, me **normë** duhet të kuptojmë jo vetëm format e fjalëve, ndërtimet fjalëformuese dhe sintaksore më të përhapura, por edhe tërësinë e rregullave të vendosura për përdorimin e tyre në standardin gjuhësor.

Kështu norma apo standardi i një gjuhe përfaqëson kodin e përdorimit të saj. *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe* është dokumenti kryesor që përbën kodin e gjuhës shqipe. Në të pasqyrohen të gjitha normat fonetike, morfologjike, sintaksore e leksikore për të shkruar dhe për të folur gjuhën standarde.

Megjithëse gjuha standarde dhe dialektet ndryshojnë ndërmjet tyre, ato nuk janë të izoluara. Pra, japin e marrin mes tyre. Gjuha standarde thith nga dialektet vlerat e tyre më të mira.

USHTRIME

1 Plotësoni diagramin e Venit për të gjetur të përbashkëtat dhe dallimet mes gjuhës standarde dhe dialekteve.



2 Në tekstin me titull "I lumtur është njeriu që s'ka nakar", gjeni fjalët e gegërishtes. Përbri secilës fjalë shkruani formën që ka në gjuhën standarde.

3 Shkruani në gjuhën standarde fjalët e mëposhtme.

bani	*me lexue*	*kam zgjidh*	*shqyptar*
syni	*lark*	*me shkue*	*pa këndue*
tash	*ish*	*foshnjisht*	*i math*

4 Ndahuni në grupe dhe bëni një projekt me temë "Pasurimi dhe pastrimi i gjuhës standarde shqipe".

Morfologji


Fjalë të ndryshueshme
Fjalë të pandryshueshme
Emri
Lloji i përgjithshëm, i përveçëm
Lloji konkret, abstrakt
Gjinia femërore mashkullore asnjanëse
Lakimet lakimi i parë lakimi i dytë lakimi i tretë lakimi i katërt
Rasat emërore gjinore dhanore kallëzore rrjedhore
Numri njëjës shumës
Trajta e shquar e pashquar
Mbiemri
Lloji i nyjshëm, i panyjshëm
Rasat emërore gjinore dhanore kallëzore rrjedhore
Gjinia femërore mashkullore
Numri njëjës shumës
Shkalla pohore krahasore sipërore
Folja
Forma veprore joveprore
Koha e tashme shkuar e ardhme
Mënyra dëftore, lidhore, kushtore, habitore, dëshirore, urdhërore
Zgjedhimi i parë i dytë i tretë
Veta e parë e dytë e tretë
Numri njëjës shumës
Përemri
Lloji vetor, vetvetor, dëftor, lidhor, pronor, pyetës, i pacaktuar
Numri njëjës shumës
Veta e parë e dytë e tretë
Rasat emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore
Numërori
Pasthirrma
Ndajfolja
Lloji kohe, vendi, shkaku, qëllimi, mënyre, sasie
Shkalla pohore krahasore sipërore
Lidhëza
bashkërenditëse
nënrenditëse
Parafjala
të rasës emërore
të rasës gjinore
të rasës kallëzore
të rasës rrjedhore
Pjesëza

Klasat e fjalëve

Mbani mend

Fjala është tërësi e pandashme e tingëllimit dhe e kuptimit, që emërton njerëz, kafshë, sende, dukuri natyre dhe pjesë përbërëse të këtyre kategorive etj.

Klasat e fjalëve

- Fjalët që e ndryshojnë formën gjatë përdorimit të tyre në fjali, quhen **fjalë të ndryshueshme**.
- Fjalët që nuk e ndryshojnë formën gjatë përdorimit në fjali, quhen **fjalë të pandryshueshme**.



Ligjërimi shprehet me fjalë, prandaj ato quhen edhe pjesë të ligjëratës.

Klasat e fjalëve

Fjalë të ndryshueshme	Shembuj	Fjalë të pandryshueshme	Shembuj
Emri	*vaj, bukë, oriz, flutur, det, zog, shkallë* etj.	Ndajfolja	*mirë, bukur, lart, shpeshherë, asnjëherë, kurrë, pak* etj.
Mbiemri	*i gjatë, i shkurtër, i dobët, guximtar, trim, i madh, i fortë* etj.	Lidhëza	*dhe, porse, por, ndonëse, që, se, kur, edhe, sepse* etj.
Folja	*luaj, kërkoj, fluturoj, fal* etj.	Parafjala	*për, nga, në, me, prej, bashkë me, me anë, kundër* etj.
Përemri	*unë, ti, ai, i saj, e tyre, disa, vetvetja, i tyre, ata, ne, ndonjëri* etj.	Pjesëza	*të, e, ja, pa, mos, pikërisht, nuk* etj.
Numërori	*shtatë, njëmbëdhjetë, njëzet, tridhjetë e pesë* etj.	Pasthirrma	*bah, shët, oh, ah, eh* etj.

Punë në grupe

Emërtoni fjalët e fragmentit të mëposhtëm sipas klasave përkatëse.

Aleksandri ishte djali më i qetë i gjithë lagjes dhe i shkollës. Në shkollë, ai ulej i qetë me krahë të lëshuar, ashtu si duhej, dhe fiksonte me sytë e tij kureshtarë e të sigurt gjithçka thoshte dhe tregonte mësuesi. Mbahej shembull për të gjithë klasën. Në fletoret e tij nuk kishte asnjë shënim me ngjyrë të kuqe nga mësuesi dhe, në dallim nga të tjerët, në të gjitha fletët e fletoreve kishte vlerësimin "shumë mirë" apo notën dhjetë, që dallonte në të gjitha detyrat e tij.

USHTRIME

1 **Nënvizoni me një vijë fjalët e ndryshueshme dhe me dy vija fjalët e pandryshueshme.**

Të nesërmen, Miroshi dhe Qerosi, hipur në kalë, u nisën për te Liqeni i Zambakëve. Me vete kishin marrë edhe shpatën e topuzin. Rruga qe e gjatë, e vështirë, se duhej t'i ngjiteshin malit. U futën në një pyll me lajthi. Aty bënte fresk dhe djemtë deshën të pushonin përsëri. Kur befas ndien zhurmë, si hapa njeriu. Shpejt e shpejt u fshehën në disa kaçuba dhe nisën të përgjonin plot ankth. Aty pranë ndodhej një pemë e lartë. Në degët e saj hidhej e përdridhej një zog pendëkuq fort i çuditshëm, i cili s'pushonte së cicëruari.

(Nga romani i V. Canosinaj, "Zogu pendëkuq")

2 **Plotësoni fjalën që mungon. Përcaktoni se cilës klase fjalësh i përket.**

Aleksandri ishte një fëmijë _____, por sedra e gërryente nga brenda. Kishte një dëshirë të madhe për të shkëlqyer, për të qenë mbi _____ dhe mbi shokët e tij. Pothuajse i përdorte deri në ekstrem _____ e tij për të rënë _____ më tepër. Aleksandri kishte një qëllim të vetëm: donte të bëhej "i pari i klasës". Por në këtë _____, në të vërtetë, ishte një tjetër, një _____ "më pak i mirë", që ishte më i madhi _____.

(Fjalë ndihmëse: i mbarë, çdo gjë, rast, edhe, në sy, nxënës, i klasës, forcat)

3 **Përgjigjuni pyetjeve për fjalët e nënvizuara.**
Shënoni në kutinë përbri V (e vërtetë) ose G (e gabuar)

Vëllai i madh i Francit është gati një kokë më i madh se Erberi.
Këshilla e Jozefit iu duk në fillim e arsyeshme.
Vetëm pak më vonë, Franci e kuptoi se edhe këshilla e tij nuk vlente.
Francit nuk i pëlqen ta krahasojë Erberin me vëllain e tij të madh.
Lili është një studente që kujdeset për Borën pasditeve.
Kur Franci kthehet nga shkolla, ndihet i lodhur.

1. Është emër? ☐
2. Është mbiemër? ☐
3. Është folje? ☐
4. Është emër? ☐
5. Është parafjalë? ☐
6. Është lidhëz? ☐

4 **Vendosni në tabelë fjalët e tekstit të mëposhtëm dhe plotësojeni atë sipas shembullit të dhënë.**

Entela vendosi të mësonte patjetër një gjuhë të huaj. Ajo kishte dëgjuar gjithandej: "Mara te klasa IV di dy gjuhë të huaja. Bruna e klasës V di tri gjuhë të huaja!"... e kështu me radhë. Atëherë, edhe Entela jonë vendosi të fillonte sa më parë gjermanishten. Ajo pyeti mamin. "Oh, - u gëzua mami, - vajza ime do të mësojë gjermanishten!"

Fjala	Emër	Mbiemër	Folje	Përemër	Numëror	Ndajfolje	Lidhëz	Parafjalë	Pjesëz	Pasthirrmë
Entela	✓									
vendosi										

Emri

Emërtoni secilën prej figurave të mëposhtme. Ç'dini për fjalët që shkruat? A janë emra këto fjalë?

Emri tregon frymorë, sende, veprime, objekte, dukuri të natyrës, koncepte abstrakte etj.



Sipas kuptimit leksikor, dy nga ndarjet e emrave janë:

1. Emra **të përgjithshëm** dhe **të përveçëm**.
2. Emra **konkretë** dhe **abstraktë**.

Kurse sipas kategorive gramatikore, emrat ndahen në:

1. Emra **të gjinisë mashkullore, femërore, asnjanëse**.
2. Emra **të numrit njëjës** dhe **të numrit shumës**.
3. Emra **të rasës emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore**.
4. Emra **të trajtës së shquar** dhe **të trajtës së pashquar**.
5. Emra **të lakimit të parë, të dytë, të tretë, të katërt**.

Emra të përgjithshëm dhe emra të përveçëm

Emra të përgjithshëm dhe emra të përveçëm

Kur themi ***mal***, ne nuk kemi parasysh vetëm një mal *në veçanti*, p.sh., *malin* Tomor. Me këtë emër (mal) emërtojmë të gjitha malet në përgjithësi.
Po kështu, edhe emrat e tjerë, si: ***veshë, kohë, karnavale, krevat*** etj. Këta emra janë *emra të përgjithshëm*.

mal, kodër, rrugë, fëmijë, horizont, shi, borë

Emrat e përgjithshëm tregojnë në përgjithësi njerëz, kafshë, sende, dukuri që i përkasin të njëjtit lloj, apo pjesë të të njëjtit objekt, p.sh.: *krah, këmbë, kokë*.

Por, kur themi: *Shqipëri, Agron, Dita e Karnavaleve, Kosovë etj.*, kemi parasysh një shtet, një frymor a dukuri të veçantë, të njohur, prandaj quhen **emra të përveçëm**.

Adriatiku, Buna, Hëna, Evropa, Teuta, Atlantiku, Republika e Kosovës

Emrat e përveçëm tregojnë një njeri, një kafshë a një gjë të veçantë, të dalluar nga gjërat e tjera të të njëjtit lloj. Shembull: <u>Prishtina</u> **është kryeqyteti i Kosovës.**
Emrat e përveçëm shkruhen gjithnjë me shkronjën e parë të madhe: Kosovë, Evropë, Prishtinë, Teuta, Drini, Kreshniku etj.

Emrat konkretë dhe emrat abstraktë

Emra konkretë dhe emra abstraktë

Emrat e përgjithshëm ndahen në emra konkretë dhe në emra abstraktë.

- **Emrat konkretë** emërtojnë qenie apo sende që mund të shihen, të preken, të shijohen, të ndijohen me anë të shqisave, p.sh.: *ujë, djathë, lumë, mal, shtëpi, shkollë* etj.
- **Emrat abstraktë** emërtojnë veprime, ide, dukuri e cilësi, të cilat nuk mund të ndijohen me anë të shqisave, p.sh.: *emocion, mendim, gjykim, besë, qartësi, mrekulli, dyshim* etj.

USHTRIME

1 Plotësoni vendet boshe me emra të përveçëm.

Teuta jeton në rrugën _____. Në këtë rrugë ndodhen disa institucione. Aty është spitali _____. Më tutje ndodhet edhe shkolla _____. Përballë shkollës është kopshti _____. Anës rrugës është edhe monumenti _____. Në këtë qytet kalon lumi _____. _____ është qytet bregdetar.

2 Shkruani emra të përgjithshëm dhe emra të përveçëm sipas fushës përkatëse.

Fusha	Emra të përgjithshëm	Emra të përveçëm
Qytete		
Shtete		
Lumenj		
Njerëz		
Sende		
Ushqime		
Lodra		

3 Përgjigjuni pyetjeve. Shënoni EA për emrat abstraktë dhe EK për emrat konkretë.

- Si quhet gjendja e njeriut kur është pa humor? _____
- Si quhet veprimi që bëjnë njerëzit e shkencës kur kërkojnë diçka? _____
- Si quhet veprimi që bëjnë gjykatësit në sallën e gjyqit? _____
- Si quhen njerëzit që merren me sport? _____
- Si quhet ndryshe shkenca që merret me shëndetin e njeriut? _____
- Si quhet vendi ku mësojnë fëmijët? _____

4 Plotësoni vendet boshe, duke kthyer emrat konkretë në abstraktë dhe emrat abstraktë në konkretë.

Emër konkret	Emër abstrakt	Emër abstrakt	Emër konkret
aktor	*aktrim*	*punim*	*punëtor*
shkencëtar		*mendim*	
inxhinier	*inxhinieri*	*peshkim*	
mësues		*kërkim*	
protagonist	*protagonizëm*	*vëzhgim*	*vëzhgues*
diplomat		*drejtim*	
hero		*udhëheqje*	

5 Përcaktoni nëse fjalët e nënvizuara janë emra konkretë apo emra abstraktë.

Mua nisi të më dilte frika, por jo vetëm kaq. Unë nisa të kujtoja tamam ato historitë e stërgjyshërve tanë kur tregonin se si lajmëroheshin, përmes zërave nga një mal në tjetrin, si lajmëronin për lindjet, vdekjet, ardhjen e armiqve dhe për shumë sinjale dhe shenja të tjera. Duhet t'i jetosh disa gjëra, që t'i kuptosh më mirë...

6 Kthejini mbiemrat dhe foljet e mëposhtme në emra abstraktë.

Mbiemër	Emër abstrakt	Folje	Emër abstrakt
i edukuar	*edukim*	*peshkoj*	*peshkim*
i zmadhuar		*ndëshkoj*	
i zvogëluar		*propozoj*	
i përdorur		*kërkoj*	
i lulëzuar		*vlerësoj*	
i menduar		*zbatoj*	
i zhvilluar		*planifikoj*	

7 Shkruani një tekst me dhjetë fjali, në të cilin të përdorni emra të përveçëm dhe të përgjithshëm, konkretë dhe abstraktë.

3

Gjinia dhe numri i emrit

- Emërtoni secilën prej figurave të mëposhtme. Ç'dini për fjalët që shkruat? A janë emra këto fjalë? Përcaktoni gjininë e tyre.



_____ _____ _____ _____ _____ _____

Gjinia e emrit

Emri në gjuhën shqipe ka tri gjini:

- **gjininë mashkullore** kur merr në fund mbaresën **-i** ose **-u**: libr-i, djal-i, mi-u, maçok-u;
- **gjininë femërore** kur merr në fund mbaresën **-a (-ja)**: nën-a, pem-a, pul-a;
- **gjininë asnjanëse** kur merr në fund mbaresën **-it** ose **-t (-të)**: të qeshur-it, të kënduar-it, të zi-të, të ftoht-ët.

Për të dalluar gjininë e një emri, e vendosim emrin në rasën emërore, në numrin njëjës, në trajtën e shquar: (cila?) stuhia, (cili?) libri, (cili?) orari, (cila?) kënga etj.

Numri njëjës dhe numri shumës

Numri i emrit

Emri ka dy numra:

- numrin njëjës,
- numrin shumës.

Emri është në numrin **NJËJËS** kur tregon vetëm një frymor, një send apo një ide: *frymëzim, qytetar, djalë, dëshirë, ëmbëlsirë, makinë, dorë, krah*.
Emri është në numrin **SHUMËS** kur tregon dy a më shumë frymorë, sende apo ide: fshatarë, kuaj, qytete, mendime.

Formimi i numrit shumës

Numri shumës formohet:

- *duke shtuar në fund **-ë, -a, -e*** etj.: *(një) dijetar – (ca) dijetarë, (një) vajzë – (ca) vajza, (një) qytet – (ca) qytete*;
- *duke u kthyer **/g/** në **/gj/**: (një) zog – (ca) zogj*;
- *duke u kthyer **/g/** në /gj/ dhe duke marrë **e** në fund: (një) varg – (ca) vargje;*
- *njësoj si në njëjës: (një) fletore – (ca) fletore, (një) shtëpi – (ca) shtëpi;*
- *duke u kthyer **/k/** në **/q/**: (një) fik – (ca) fiq; (një) mik – (ca) miq.*

Trajta e pashquar		Trajta e shquar	
Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës
(një) mbretëreshë	(disa) mbretëresha	mbretëresha	mbretëreshat
(një) shofer	(disa) shoferë	shoferi	shoferët
(një) mace	(disa) mace	macja	macet
(një) mik	(disa) miq	miku	miqtë
(një) mendim	(disa) mendime	mendimi	mendimet

USHTRIME

1 Vendosini emrat në kllapa në gjininë dhe në numrin e duhur.

Unë atëherë e besoja, pasi (gjyshe) ishte kaq ndryshe nga të gjitha (grua) e tjera, sa mua më dukej gjithçka e mundur. Përbri (gjyshe) në fotografinë e parë të (album), ishte Lumta: e gjatë pak a shumë sa ajo, me (pamje) e një qershie bebe. Sipas (gjyshe), kur e kishte mbjellë, ajo duhej të kishte qenë tri vjeçe, moshë e përshtatshme për një (shok) (lojë) për (mami) tim. Në një (fotografi) tjetër dukej mami në një (shilarës) të varur në (degë) më të trashë të (qershi).

2 Plotësoni tabelën me emrat që përmban teksti i mësipërm sipas gjinisë.

gjinia mashkullore	gjinia femërore

3 Vendosni emrat në formën e duhur.

I zotët i bujtina e mori të bijën pranë dhe nisi ta pyeste se ç'kishte ndodhur. Vajzat tregonte ngadalë dhe herë-herë e humbte fijesh e rrëfimit, ngaqë dhe vetë nuk e dinte ç'kishte ndodhur. Veç kujtonte disa vajzave të reja fort të bukura në shtëpive e tyre. Atje ishte një mrekullitë e vërtetë. Shtëpitë ndodhej në një korijet buzë Liqenit të Zambakëve. Shtojzovallja e kishin shndërruar në një zogj që të shëtiste e të lodronte ngado që të donte.

4 Gjeni emrat dhe përcaktoni gjininë, numrin dhe rasën e tyre.

Diznei Lendi, një ëndërr e vërtetë. Çdo fëmijë do të dëshironte të shkonte të paktën një herë aty. Mund ta quash me të vërtetë "Qyteti i lojërave të lumturisë". Aty bëmë një udhëtim në Shpellën e Tmerrit. Gjithçka ishte errësirë dhe papritur të dilnin përpara syve skelete, kuçedra që nxirrnin flakë, bisha të egra. Që të hyje brenda, duhej të ishe vërtet guximtar. Por udhëtimi në të ashtuquajturat "malet ruse", ishte i mrekullueshëm.

5 Vendosni në tabelë pesë emra nga teksti i mësipërm. Shënoni gjininë, numrin dhe rasën e secilit.

Emri	Femërore	Mashkullore	Asnjanëse	Njëjës	Shumës	Rasa
	☐	☐	☐	☐	☐	
	☐	☐	☐	☐	☐	
	☐	☐	☐	☐	☐	
	☐	☐	☐	☐	☐	
	☐	☐	☐	☐	☐	

6 Shkruani fjali me emra të gjinisë asnjanëse: të qeshurit, të qarët, të ftohtët.

_____

_____

_____

7 Shkruani një tekst të shkurtër për miqësinë. Përdorni sa më shumë emra. Përcaktoni gjininë dhe numrin e tyre.

4 Trajtat e emrit

U bë shumë zhurmë për asgjë.
Zhurma u dëgjua deri në katin e fundit.

Emrat në gjuhën shqipe përdoren në trajtë të pashquar dhe në trajtë të shquar.

Trajta e pashquar	Trajta e shquar
zhurmë	zhurma

Mbani mend

Çdo emër është në trajtë të pashquar kur tregon në mënyrë të pacaktuar një njeri, një kafshë, një send të njohur etj.: *(një) laps, (një) shok, (një) mace, (një) vajzë* etj.
Çdo emër është në trajtë të shquar kur tregon konkretisht një njeri, një kafshë, një send etj.: *lapsi, shoku, macja, vajza* etj.
Edhe emrat në numrin shumës janë në trajtë të shquar dhe në trajtë të pashquar: *(disa) lapsa – lapsat; (disa) shokë – shokët; (disa) mace – macet; (disa) vajza – vajzat.*

USHTRIME

1 Gruponi emrat në tabelën e mëposhtme.

shok, laps, shkolla, kinema, pallate, fusha, televizori, lajmet, këngë, këngëtarët, fishekzjarri, rrëmuja, apartament, vajzat, teleshikues, lojtarët, tregime, përrallë, dhelpër, kukullat

Trajta e pashquar		Trajta e shquar	
Numri njëjës	Numri shumës	Numri njëjës	Numri shumës

2 Ktheni në trajtën e shquar ose të pashquar emrat e mëposhtëm.

mali _____ vargje_____ park_____
dhomat_____ zog_____ sheshe_____
guri_____ dora_____ miqtë_____
librat_____ korbi_____ dhelpra_____

3 Plotësoni tabelën me fjalët përkatëse sipas trajtës. Shkruani nga një fjali me çdo fjalë.

Trajta e shquar	Trajta e pashquar
buka	
	botë
miku	
	bujk
shpresa	
	libër
horizonti	

Lakimi i emrave

Format e ndryshme që merr emri për të shprehur lidhjet me fjalë të tjera në fjali, quhen RASA. Emri ka pesë rasa:
emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore.

Kuptimet kryesore të rasave

- Emri në rasën emërore përdoret zakonisht si kryefjalë: ***Deti Adriatik*** *lag brigjet e Shqipërisë.*
- Emri në rasën gjinore përdoret kryesisht si përcaktor: *këng**a*** ***e zogjve***, *dit**ët*** ***e dimrit***, *mësuesit* ***e shkollës***.
- Emri në rasën dhanore shpreh kundrinorin e zhdrejtë: *Alma iu afrua* ***skenës*** *pa zhurmë.* ***Andit*** *nuk i dëgjohej zilja e celularit.*
- Emri në rasën kallëzore shpreh kundrinorin e drejtë: ***Këngën*** *e Aurelës e pëlqyen shumë.*
- Emri në rasën rrjedhore përdoret si përcaktor dhe me kuptime të tjera: *Kjo është fjalë* ***miku***.

Tërësia e ndryshimeve që pëson emri kur vendoset nëpër rasa, quhet LAKIM. Nisur nga mbaresa që emrat marrin në rasën emërore të trajtës së shquar të numrit njëjës, ata klasifikohen në katër lakime:

LLOJET E LAKIMEVE

LAKIMI I
Emrat që marrin në trajtën e shquar mbaresën **-i**:
libri, nxënësi

LAKIMI II
Emrat që marrin në trajtën e shquar mbaresën **-u**:
shoku, floku

LAKIMI III
Emrat që marrin në trajtën e shquar mbaresën **-a** ose **-ja**:
klasa, shoqja

LAKIMI IV
Emrat që marrin në trajtën e shquar mbaresën **-it**, **-t** ose **-të**:
të nxehtët, të shkruarit

Tabela e lakimit të emrave në trajtën e pashquar, numri njëjës

Lakimi në trajtën e pashquar

Rasa	Trajta e pashquar, numri njëjës			
	Lakimi I	Lakimi II	Lakimi III	Lakimi IV
emërore	(një) libër	(një) mik	(një) fletore	(një) të lexuar
gjinore	i/e/të/së (një) libr-**i**	i/e/të/së (një) mik-**u**	i/e/të/së (një) fletore-**je**	i/e/të/së (një) të lexuar-**i**
dhanore	(një) libr-**i**	(një) mik-**u**	(një) fletore-**je**	(një) të lexuar-**i**
kallëzore	(një) libër	(një) mik	(një) fletore	(një) të lexuar
rrjedhore	prej (një) libr-**i**	prej (një) mik-**u**	prej (një) fletore-**je**	prej (një) të lexuar-**i**

Tabela e lakimit të emrave në trajtën e shquar, numri njëjës

Lakimi në trajtën e shquar

Rasa	Trajta e shquar, numri njëjës			
	Lakimi I	Lakimi II	Lakimi III	Lakimi IV
emërore	libr-**i**	mik-**u**	fletor-**ja**	të lexuar-**it**
gjinore	i/e/të/së libr-**it**	i/e/të/së mik-**ut**	i/e/të/së fletore-**s**	i/e/të/së të lexuar-**it**
dhanore	libr-**it**	mik-**ut**	fletore-**s**	të lexuar-**it**
kallëzore	libr-**in**	mik-**un**	fletore-**n**	të lexuar-**it**
rrjedhore	prej libr-**it**	prej mik-**ut**	prej fletore-**s**	prej të lexuar-**it**

Emrat e gjinisë asnjanëse

Vini re që në lakimin e katërt përfshihen emrat e gjinisë asnjanëse. Ata lakohen si emrat e gjinisë mashkullore të lakimit të parë. Duhet treguar kujdes në rasat emërore dhe kallëzore të trajtës së shquar, pasi ata ndryshojnë.

Vini re:

Lakimi I	Lakimi IV
rasa emërore	rasa emërore
*libr**i***	*të lexuar**it***
rasa kallëzore	rasa kallëzore
*libr**in***	*të lexuar**it***

Lakimi i emrave në numrin shumës

- Ndahuni në grupe dhe lakoni emrat e të katra lakimeve në numrin shumës, në trajtën e shquar dhe në trajtën e pashquar. Çfarë vini re?

USHTRIME

1 Nënvizoni fjalën ***nënë***. Përcaktoni rasën e këtij emri për çdo rast.

Nëna ngriti kokën dhe vështroi, vajzën që e kishte përqendruar vëmendjen në një cep të dhomës. Zemra e nënës diçka ndjeu dhe iu afrua. Nënës iu duk se ajo kishte pak temperaturë. Ajo digjte zjarr dhe nënën e zuri frika, prandaj lajmëroi ambulancën menjëherë. Kur e morën ta çonin në spital, vajza nisi të qante, sepse nuk ishte larguar asnjëherë prej nënës së saj.

2 Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe përcaktoni rasat e emrit ***libër***.

Miku më i mirë i njeriut është libri. Bota e librit është shumë e madhe, sa një oqean. Librat e kanë shoqëruar njeriun tërë jetën, që nga vitet e fëmijërisë dhe deri në fund të ditëve. Me libra dhe dije është ndryshuar bota. Prej librave, jeta e njeriut bëhet më e begatë.

3 Vendosni mbaresën e fjalës në vendet boshe.

Hapi derë ☐ dhe pa se ajo të nxirrte në një rrug ☐ të vogël, në fund të së cilës ndodhej një kopsht i mrekullueshëm, që edhe juve nuk jua ka zënë sy ☐ kurrë. Ah, sa do t'i pëlqente të dilte nga kjo sallë e errët e të shkonte, të endej nëpër ato lule ☐ e bukura! Mirëpo vrima s'i nxinte as kokë ☐, – mendoi Liza – po sa para bën koka pa shpatull ☐ ?! "Oh, sa do të kisha qejf të mbyllesha e të zvogëlohesha sa një fëmij ☐.

4 Shkruani fjalët në trajtat e duhura sipas rasave.

Rasa emërore	pemë – pema	të menduar – të menduarit	jelek – jeleku	pallat – pallati
Rasa gjinore				
Rasa dhanore				
Rasa kallëzore				
Rasa rrjedhore				

Ushtrime për emrat

1 Plotësoni tabelën e mëposhtme me emrat e dhënë.

dituri, shkollë, pirun, Drini, fletorja, Dajti, Prizreni, treni, Teuta, rruga, kopshti, gjallëria, dimri, stilolapsi, gjatësia, ndarja, miqësia, kompjuteri, ekrani

Emra të përveçëm	Emra të përgjithshëm	Emra konkretë	Emra abstraktë
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____

2 Përcaktoni gjininë dhe numrin e emrave të nënvizuar.

Kohë më parë, kur jetonin katragjyshët tanë, nuk ekzistonte fare stina e dimrit. Nuk kishte as pranverë. Nuk kishte vjeshtë. Gjatë gjithë kohës kishte vetëm verë. Bari ishte i tharë. Frutat të fishkura. Lumenjtë dhe rrëketë ishin shteruar. Pluhuri qëndronte pezull në ajër.

3 Përcaktoni rasën dhe trajtën e emrave të nënvizuar.

Ariu hapi çantën e tij. Erërat dolën prej saj. Era e veriut dhe e jugut, era lindore dhe perëndimore. Ato frynin drejt barit dhe ai kërciste. Frynin përmes shkurreve dhe frutat ranë përtokë. Frynin përmes pemëve dhe gjethet ranë.
Kukuvajka hapi çantën. Shiu dhe mjegulla dolën prej saj.
Lepuri hapi çantën e tij. Bora doli prej saj.
Që prej asaj dite filluan stinët.

4 Lakoni emrin shtëpi në trajtën e pashquar, në numrin njëjës dhe në numrin shumës.

5 Lakoni emrin gëzim në trajtën e shquar, në numrin njëjës dhe në numrin shumës.

6 Plotësoni tabelën dhe analizoni emrat.

Emri	I përveçëm	I përgjithshëm		Gjinia		Numri		Trajta		Rasa
		Konkret	Abstrakt	Mashkullore	Femërore	Njëjës	Shumës	E shquar	E pashquar	
ngjyrë										
gëzim										
ngjyrat										
gëzimet										
Gëzimi										

7 Përgjigjuni pyetjeve:

- Pse emrat ***ngjyrë*** dhe ***gëzim*** janë emra të përgjithshëm?
- Pse emri ***Gëzim*** është emër i përveçëm?
- Pse emrat ***ngjyrë*** dhe ***Gëzim*** janë emra konkretë?
- Pse emri ***gëzim*** është emër abstrakt?
- Pse emri ***gëzimet*** është në gjininë mashkullore?

7

Mbiemri

Kuptimi, llojet dhe shkallët e mbiemrave

Mbiemri është fjalë e ndryshueshme që emërton cilësi, veti të njerëzve, të kafshëve, të sendeve, të objekteve etj. (vajzë e vogël, traditë shqiptare, qiell i kaltër, stinë e freskët, njeri besnik)

Mbiemrat e gjuhës shqipe ndahen në dy lloje: **mbiemra të nyjshëm** dhe **mbiemra të panyjshëm**.

Mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm

Mbiemrat e nyjshëm kanë:

- nyjë përpara dhe mbarojnë me **-ë**: *i bardhë, i mirë, e gjatë;*
- **nyjë** përpara dhe marrin prapashtesat **-(ë)m**, **-shëm**, **-t (-të)**: *i mesëm, i shëndetshëm, e hekurt, e ftohtë* etj.;
- **nyjë** përpara dhe ndërtohen nga forma foljore: *shkruar – i shkruar, zënë – i zënë, lodhur – e lodhur;*
- **nyjë** përpara dhe mbarojnë me -ër: *i vjetër, i varfër, e verbër, e shkurtër.*

Mbiemrat e panyjshëm formohen:

- me prapashtesat: *-as, -an, -ar, -tar, -ik, -ist, -iv, -or, -tor,* me të cilat formohen edhe emra: *tiranas, shkodran, bankar, amtar, pemëtar, heroik, artist, sportiv, aktiv, jugor, baritor;*
- me prapashtesat -(ë)s, -ues, -yes, me të cilat formohen edhe emra: *pjekës, zbritës, gërmues, rrëmbyes.*

Shkallët e mbiemrit

Mbiemri përdoret në tri shkallë:



Shkalla pohore

Shkalla pohore tregon një cilësi të një emri: *Liqeni i Shkodrës është i thellë.*

Shkalla krahasore

Shkalla krahasore krahason cilësi njerëzish, kafshësh, sendesh, objektesh: *Ajo ishte më e zgjuar se e motra.*

Shkalla sipërore

Shkalla sipërore tregon shkallën më të lartë të cilësisë së njerëzve, të sendeve, të objekteve etj., jashtë çdo krahasimi: *Liqeni i Shkodrës është shumë i thellë.* Kjo shkallë formohet me ndajfoljet: *shumë, tepër, jashtëzakonisht, mjaft* etj.

USHTRIME

1 **Nënvizoni me një vizë emrat, me dy viza mbiemrat.**

Plani i tij ishte i përsosur. Për të afruar piraten, përdorëm mish të freskët. Kësaj here vendin e grackës e ngritëm në shtëpinë e Alteas, shtëpi e cila kishte në krahun e majtë një korridor fare të ngushtë që e ndante nga muri rrethues. Hyrjen e korridorit e lamë të lirë, ndërsa te dalja Dori vendosi një rrjetë të hollë, gati-gati të padukshme. Ne u fshehëm të gjithë, në pritje.

2 **Nënvizoni mbiemrat dhe thoni se çfarë lloji janë (të nyjshëm, të panyjshëm).**

Një ditë, kur ishim në udhë, ndaluam në një fshat të përgjumur. Nuk më kujtohet emri i fshatit, megjithatë, s'ka rëndësi. Imzot rrinte i krekosur majë Rosinantit dhe priste lajmin tim. Ky fisnik aspak i pashëm, i gjatë, i hollë si shkop, që kishte një fytyrë të gjatë e të dobët, verdhacuke dhe mjekër ngjyrë gri, diçka nuhaste dhe po bluante në kokën e tij të mençur një plan luftimi.

3 **Nënvizoni mbiemrat dhe përcaktoni shkallët e tyre.**

Jeta e madhe e shkretëtirës është një jetë e fshehur. Toka kristalore, që në njëfarë mënyre të kujton hënën, quhet nga njeriu shkretëtirë. Domethënë që është e shkretë dhe nuk ka asgjë në të. Por, në të kundërt, ka shumë bukuri në këto hapësira të gjera, në të cilat dora e njeriut nuk ka lënë shenjë. Ato kodra shumë të shpërndara zhvendosen prej erës, me atë qetësi të pafund, të pashqetësuar nga askush, gati përrallore.

4 **Plotësoni vendet boshe me mbiemra në shkallë të ndryshme.**

Ballkoni ynë qe kthyer në një lulishte _____: tulipanë _____, karafila _____, begonja _____, zymbyla _____. Unë dhe babai kishim rregulluar një dërrasë _____ si raft, ku nëna së bashku me motrën kishin vendosur një sërë vazosh. Vogëlushja sy sykaltër u gëzohej luleve. Rrinte me orë të tëra aty në ballkonin _____.

I ujiste çdo mëngjes, u gërmonte dheun, u hiqte gjethet _____, i lidhte pas hekurave _____. Dhe lulet rriteshin, gjelbëronin dhe lulëzonin me lloj-lloj ngjyrash.

(***Fjalë ndihmëse:*** i madh, i bardhë, i kuq, i verdhë, të vogla, të gjelbër, shumë e gjatë, të holla, e thata.)

5 **Plotësoni vendet boshe me mbiemrat e dhënë.**

Para se të shpikeshin penat _____, njerëzit kanë përdorur gishtërinjtë për të shkruar. Më vonë njerëzit _____ gdhendën figurat e shkruara në argjilë. Më pas nisën të gdhendin figurat në gurë _____. Mënyrë tjetër ka qenë gdhendja _____ në dyllë. Kinezët përdorën të parët furçë dhe bojëra grafiti për të vizatuar germat. Nisi shkrimi _____ me pendë shpendësh (pate dhe mjellme). Pas pendëve _____ nisi shkrimi me pena me maja çeliku. Më pas dolën stilolapsat me maja _____. Në vitin 1944 u shpik stilolapsi _____ me majë të rrumbullakët. Në vitin 1960 u shpik stilolapsi i parë me majë _____.

(***Fjalë ndihmëse:*** shumëngjyrëshe, i sotëm, e lashtë, puplore, stralli, të holla, i parë, e drunjta, të hollë.)

6 **Shkruani një tekst me dhjetë fjali, në të cilin të përdorni sa më shumë mbiemra të nyjshëm dhe të panyjshëm.**

7 **Nënvizoni mbiemrat që përdorët në tekstin e ushtrimit 6. Përcaktoni për secilin prej tyre shkallën në të cilën është përdorur.**

8

Përshtatja e mbiemrit me emrin

Mbiemri merr gjininë, numrin dhe rasën e emrit që cilëson.

Gjinia e mbiemrit

Gjinia femërore e mbiemrit shpesh formohet nga gjinia mashkullore:

- duke i ndërruar nyjën e përparme nga i në e:
  nxënësi i mirë, i urtë, nxënësja e mirë, e urtë;
- duke i ndërruar nyjën e përparme i në e dhe duke i shtuar mbaresën -e:
  laps i kuq – ngjyrë e kuqe;
- vetëm duke i shtuar mbaresën -e: *atlet pesëgarësh – atlete pesëgarëshe;*
- njësoj si gjinia mashkullore: *djalë/vajzë mendjehollë, grua/punëtor duarartë, nënë/djalë zemërbardhë, nxënëse /nxënës i mirë, i hollë.*

Numri i mbiemrit

Numri shumës i mbiemrave formohet nga numri njëjës:

- duke ndërruar nyjën i (e) në të: *i mirë – të mirë, e kuqe – të kuqe;*
- duke ndërruar nyjën i (e) në të + mbaresën -a: *e bardhë – të bardha;*
- njësoj si numri njëjës: *njeri kërkues – njerëz kërkues;*
- vetëm duke shtuar mbaresën -ë ose -a: *bashkëkohor – bashkëkohorë, syshkruar – syshkruara.*

Rasa e mbiemrit

Mbiemri përshtatet në numër, gjini dhe rasë me emrin me të cilin lidhet:

Përshtatje në gjini	Përshtatje në numër	Përshtatje në rasë
mjeku i ri – mjekja e re	vajzë e vogël – vajza të vogla	mjeku i ri
veprim zbavitës – histori zbavitëse	fjalë e bukur – fjalë të bukura	i, e mjekut të ri
mendim i vlefshëm – fjalë e vlefshme	zë kumbues – zëra kumbues	mjekut të ri
		mjekun e ri
		prej mjekut të ri

Mbiemrat e nyjshëm përshtaten në gjini, numër dhe rasë me emrin që shoqërojnë, duke ndryshuar formën e tyre.
Mbiemrat e panyjshëm përshtaten vetëm në gjini dhe në numër me emrin që shoqërojnë, sepse ata nuk kanë rasë.

USHTRIME

1 Kthejini në gjininë femërore mbiemrat në tabelën e mëposhtme.

i sjellshëm – e sjellshme	tokësor –	malor –	i virtytshëm –
i errët –	i mërzitshëm –	i artë –	i përbaltur –
besnik –	syshkruar –	mendjemadh –	verdhacuk –
frikacak –	shëmtaraq –	flamurtar –	guximtar –

2 Formoni fjali me grupet emërore të dhëna më poshtë.

majë e lartë, alpinist i stërvitur, shok i mirë, stërvitje e vazhdueshme, rekord kombëtar, lajm i padëgjuar.

USHTRIME

3 Gjeni mbiemrat dhe përcaktoni gjininë, rasën dhe numrin e tyre.

Ka shumë përralla dhe legjenda që flasin për gjigantët. Ato ndoshta kanë nisur që në kohëra shumë të lashta. Të gjithë popujt e lashtë kanë thurur historitë e tyre për ta. Disa nga këta gjigantë kishin vetëm një sy shumë të madh në mes të ballit. Ata ishin të zotët të ngrinin një copë të madhe shkëmbi.

4 Shkruani fjali me grupet e fjalëve duke i përdorur në numrin shumës.

- *djalë i gjatë: Djemtë e gjatë luajnë basketboll.*
- dallgë e madhe: _____
- njeri i qetë: _____
- lumë i turbullt: _____
- këngë magjike: _____

5 Kthejini grupet emërore nga numri njëjës në numrin shumës dhe anasjellas:

Numri njëjës	Numri shumës
unazë e artë	
	përrenj të rrëmbyeshëm
det i kaltër	
	brigje shkëmbore
perëndim i përflakur	
ditë e qetë	

6 Ndërtoni fjalitë. Kujdes përshtatjen e mbiemrave me emrat përkatës.

Fjalia e shformuar	Fjalia e rindërtuar
të nxirrte Dera rrugicë në një të vogël.	
të saj Në fund një kopsht ndodhej i mrekullueshëm.	
t'i pëlqente Sa do të dilte sallë nga kjo e errët.	
Donte lule të shikonte ato të bukura të freskët e ata shatërvanë!	
Gjatë kohe kësaj ndodhur kishin aq të çuditshme gjëra.	

7 Nënvizoni mbiemrat, vendosini në tabelë dhe plotësoni veçoritë gramatikore të tyre.

Çudia e çunave të vegjël të rrugicës sonë me piraten sykaltër arriti kulmin kur ajo kreu një veprim spektakolar në verandën e shtëpisë së Enios. Në atë verandë, dallëndyshet bishtgërshërë ndërtonin gjithmonë fole. Një ditë, një zog i vogël, të cilit sapo i kishin dalë puplat e buta, ra nga foleja.

Mbiemri	Gjinia	Numri	Rasa	Shkalla
(çunave) të vegjël	mashkullore	shumës	gjinore	pohore

9

Përemrat

Cilës klase i përkasin fjalët e nënvizuara?
O malet e Shqipërisë e ju o lisat e gjatë.
Fushat e gjera me lule q'u kam ndër mend dit' e natë.
Ju bregore bukuroshe e ju lumenj të kulluar [...]

Llojet e përemrave

Përemri është fjalë e ndryshueshme, që tregon në mënyrë të përgjithshme një qenie, send a dukuri, ose tipar a sasi të tyre. Përemrat janë:

• vetorë • vetvetorë • dëftorë • pronorë • pyetës • lidhorë • të pacaktuar

Përemrat	Fjalitë me emra	Zëvendësimi me përemra
Vetorë: *unë, ti, ai/ajo, ne, ju, ata/ato*	*Babai erdhi papritur.*	***Ai** ishte i lodhur.*
Vetvetorë: *vete, vetja, vetvetja*	*Beni nuk ka faj.*	*Ai nuk e fajëson **veten**.*
Dëftorë: *ky, kjo, ai, ajo, i/e tillë, i/e këtillë*	*Ti ke një fjalë për të thënë.*	***Ajo** fjalë duhet thënë.*
Pronorë: *im, i saj, yt, i tyre, sime, juaj* etj.	*Sytë e tij ishin të bukur.*	*Ata sy iu dukën si **të sajtë**.*
Pyetës: *kush? cili? cila? cilët? cilat? çfarë?*	*Një gjë i ka ndodhur djalit.*	***Çfarë** i ka ndodhur djalit?*
Lidhorë: *që, i cili, e cila, të cilët, të cilat*	*"Piter Pani" më pëlqen shumë.*	*Ai është një emision **që** më argëton.*
Të pacaktuar: *çdo, dikush, askush, secili* etj.	*Të pyeti njeri?!*	***Çdonjëri** thotë mendimin e vet.*

Përemri vetor

Përemri vetor *është fjalë e ndryshueshme që tregon në veta të ndryshme (vetën e parë, vetën e dytë, vetën e tretë, në numrin njëjës dhe në numrin shumës).*

Numri njëjës	Numri shumës
Veta e parë – UNË – tregon atë që flet.	**Veta e parë** – NE – tregon një grup vetash ku bën pjesë edhe personi që flet.
Veta e dytë – TI – tregon atë me të cilin flasim.	**Veta e dytë** – JU – tregon bashkëbiseduesit.
Veta e tretë – AI/AJO – veta për të cilën flitet, por që nuk është e pranishme.	**Veta e tretë** – ATA/ATO tregon ata për të cilët bëhet fjalë, por që nuk janë të pranishëm.

Përemrat vetorë lakohen në numrin njëjës dhe në numrin shumës. Përemrat e vetës së parë dhe të dytë, njëjës dhe shumës, nuk lakohen në rasën gjinore.

Lakimi i përemrave vetorë dhe trajtat e shkurtra

	Njëjës				Shumës			
	Veta I		Veta II	Veta III	Veta I	Veta II	Veta III	
Emërore	unë		ti	ai ajo	ne	ju	ata	ato
Gjinore	-		-	i, e atij i, e asaj	-	-	i, e atyre	i, e atyre
Dhanore	mua më		ty të	atij i asaj i	neve na	juve ju	atyre u	atyre u
Kallëzore	mua më		ty të	atë e atë e	ne na	ju ju	ata (ta) i	ato (to) i
Rrjedhore	prej meje		prej teje	prej (a)tij prej (a)saj	prej nesh	prej jush	prej (a)tyre	prej (a)tyre

Rasa dhanore: **më, të, i** (njëjës); na, ju, u (shumës).
Rasa kallëzore: **më, të, e** (njëjës); **na, ju, i** (shumës).
Këto quhen trajta të shkurtra të përemrit vetor.
Trajtat e shkurtra të përemrit vetor zakonisht qëndrojnë para foljes: *Për ditëlindje, Genti **më** dhuroi një libër.*

USHTRIME

1 Përcaktoni llojin e përemrave të nënvizuar.

Një bari i çoi dhitë e veta për të kullotur. Atje vuri re se dhitë e tij ishin përzier me dhi të egra dhe, kur erdhi mbrëmja, i shtiu të gjitha në shpellën e vet. Dhive të veta u gjeti nga pak ushqim, kurse dhive të egra u gjeti mjaft ushqim për t'i bërë për vete. I ftohti mbaroi dhe ai i nxori të tëra dhitë në kullotë. Dhitë e egra morën malin e ikën. Ai i qortoi se janë mosmirënjohëse që ikën, por ato i thanë: – Pikërisht për këtë ne ikëm prej teje. Gjersa ne, që erdhëm dje, na çmove më tepër, është e qartë se edhe me të tjerat që do të afrohen më vonë, kështu do të veprosh.

2 Gjeni përemrat vetorë dhe trajtat e shkurtra.

Unë shkoja pastaj dhe ulesha pranë plakut e rrija me orë të tëra pa lëvizur. Sa e sa ditë i kam kaluar duke e vështruar teksa punonte. Dhe ai më mësonte gjithfarë gjërash që s'i dija. Ai dinte gjithçka dhe ishte i gatshëm të më shpjegonte gjithçka; m'i ka përshkruar malet tona para se të njihesha me to, më ka folur shpesh për kthesat, shtigjet e monopatet.

3 Gjeni trajtat e shkurtra të rasës dhanore dhe kallëzore.

Motra ime më do shumë.
Motra më dha një lajm të bukur.

Ky klloun të argëton.
Kllounit i buzëqeshin fëmijët.

I ka blerë Beni këta libra?
Atij i dhuruan libra.

Librat i kemi miqtë tanë.
Sot na dhanë dëftesat.

Ju ju ftuan në festë?
Juve ju përgatitën një festë.

A i kanë biçikletat me vete?
Atyre u dhuruan lodra.

4 Vendosni trajtat e shkurtra që mungojnë.

Mos __ vër veshin, se kështu ___ ka ai, ta merr mendjen me fjalë të kota. __ ka ardhur një letër. Ç'___ kenë shkruar, vallë? Çfarë të __ them më tepër, ___ bëri për ujë të ftohtë vëllai i madh. ___ mblodhi dhe më s'___ dilet nga shtëpia.

5 Vendosni fjalët që mungojnë dhe emërtojini ato.

– Po të kisha qejf, – tha kërmilli, – se as që dua t'ia di për atë botën tuaj! E ç'punë kam _____ me të? Mua më mjafton vetja ime!

– Po, por _____ duket se të gjithë _____ e kemi për detyrë t'i ndajmë me botën çdo gjë të mirë që kemi në veten tonë... _____ japim aq sa mundim. Unë munda t' _____ jepja botës vetëm trëndafilat! Po _____? Ju që keni kaq dhunti, ç'i keni dhënë _____ botës?

10

Folja

Nënvizoni foljet dhe thoni çfarë tregojnë.

Folja është pjesë e ndryshueshme e ligjëratës, që emërton një veprim ose gjendje të kryefjalës.

Kuptimi

Folja tregon:

- veprimin, të cilin e kryen kryefjala e fjalisë:
  kërcej, mbjell, shkruaj, eci, notoj, prek, hekuros.
- gjendjen, në të cilën ndodhet kryefjala e fjalisë:
  mbetem, zemërohem, gëzohem, frikësohem, emocionohem.

Folja është gjymtyra kryesore dhe më e rëndësishmja e fjalisë.

Përshtatja në numër dhe në vetë

Folja përshtatet me kryefjalën në numër dhe në vetë. Ajo merr forma të ndryshme sipas vetës, numrit, mënyrës, kohës.

Folja	Përshtatja
Shtegu të shpinte...	në numrin njëjës, veta III
Ata i hapën vend...	në numrin shumës, veta e III
Kjo ishte parë...	në numrin njëjës, veta III
Vargmalet e Fatit nuk kishin...	në numrin shumës, veta III
gjerësinë e së cilës s'ta rrokte dot syri.	në numrin njëjës, veta II

Përdorimi i foljeve në fjali

Foljet përdoren në fjali:

- me kuptim leksikor të plotë: *Unë **mbolla** një pemë.*
- si folje ndihmëse. *Unë **jam** nisur që prej dy orësh.*

Foljet kam dhe jam quhen folje ndihmëse, kur përdoren për të ndërtuar format e kohëve të përbëra të foljes.

Zgjedhimi i foljeve

Nënvizoni foljet në vargjet e mëposhtme.

Dhe shpezët udhëtarë fluturuan.
Me shtërg e dallëndyshe e-gjithë-ç'qenë.
Veç harabeli vendit nuk po luan.
Ai nuk ia beson kujt folenë.

D. Agolli

- Foljet e nënvizuara i vendosim në vetën e parë, numri njëjës, koha e tashme e mënyrës dëftore.

  fluturuan - fluturoi
  qenë - jam
  luan - luaj
  beson - besoj

Siç shihet, foljet nuk dalin vetëm në një formë. Ato e ndryshojnë formën sipas vetës, kohës e mënyrës.

- Provojmë që dy nga foljet e nënvizuara t'i vendosim në vetën e dytë dhe të tretë, numri njëjës, koha e tashme, mënyra dëftore.

  veta e parë fluturoj, luaj
  veta e dytë fluturon, luan
  veta e tretë fluturon, luan

ky veprim quhet zgjedhim i foljes. Pra, me zgjedhim të foljes kuptojmë tërësinë e formave që merr folja sipas vetës, numrit, mënyrës e kohës.

Foljet grupohen në tri zgjedhime **sipas mbaresave që marrin.**

Klasifikimi i foljeve në zgjedhime

Zgjedhimi I **Në zgjedhimin e parë** përfshihen foljet që në vetën e parë të kohës së tashme të mënyrës dëftore marrin mbaresën **-j**: *luaj, lexoj, punoj, mësoj.*

Zgjedhimi II **Në zgjedhimin e dytë** përfshihen foljet që në vetën e parë të kohës së tashme të mënyrës dëftore dalin me temë me **bashkëtingëllore**: *mbjell, vjel, kap, flas, djeg.*

Zgjedhimi III **Në zgjedhimin e tretë** përfshihen foljet që në vetën e parë të kohës së tashme të mënyrës dëftore dalin me temë në **zanore**: *di, pi, ha, rri.*

Folje të parregullta janë foljet që gjatë zgjedhimit ndryshojnë rrënjën: *jam, qesh, qenë; kam, pata, pasur; bie, rash, rënë; shoh, pashë, parë; lë, lashë, lënë* etj.

Tabela e zgjedhimeve të foljes në kohën e tashme të mënyrës dëftore

Veta		Zgjedhimi I	Zgjedhimi II	Zgjedhimi III
I	unë	laj	rrit	di
II	ti	lan	rrit	di
III	ai/ajo	lan	rrit	di
I	ne	lajmë	rritim	dimë
II	ju	lani	rritni	dini
III	ata/ato	lajnë	rritin	dinë

USHTRIME

1 Nënvizoni foljet.

Pak nga pak shqoi në errësirë një tufë rrezesh drite të dobëta e të kuqërremta. Atë e rrezatonte një libër i hapur, i cili qëndronte pezull mu në mes të sallës vezake. Libri rrinte pak pjerrtazi, kështu që ajo ia dallonte titullin. Ai ishte i lidhur me një kapak prej mëndafshi në ngjyrën e bakrit dhe, njëlloj si te gjerdani që Perandoresha-fëmijë e mbante të varur në qafë, edhe në atë libër dukeshin dy gjarpërinj që kafshonin bishtin e njëri-tjetrit dhe formonin një figurë.

2 Plotësoni tabelën me folje me kuptim të plotë leksikor dhe me folje ndihmëse.

Me kuptim të plotë leksikor	Si folje ndihmëse

3 Plotësoni fragmentin e mëposhtëm me foljet që mungojnë.

Mënyra se si nxënësit i _____ detyrat e tyre ____ _____ në vite. Në vitin 1900, fëmijët _____ me shkumësa dhe pena. Sot fëmijët i _____ shumë kohë kompjuterit. Por ende në botë, mjeti parësor i të shkruarit _____ lapsi.

4 Lidhni me shigjetë grupet e dhëna të fjalëve, duke krijuar fjali. Nënvizoni foljet.

Pse luajmë	*me të cilët luan.*
Sepse ato janë pjesë e jetës sonë	*dhe e bëjnë atë më të këndshme.*
Por ka edhe shumë e shumë	*lidhen me idenë e "lojës".*
Pa dyshim që	*çdo lojë ka rregullat e veta.*
Të cilat duhet t'i njohësh,	*t'i zbatosh, gjatë gjithë lojës.*
Të jesh pjesë e moshatarëve	*lojëra të ndryshme?*
Të gjitha këto	*arsye të tjera.*

5 Në foljet e ushtrimit të mësipërm, dalloni mbaresën nga tema e foljes. Më pas përcaktoni numrin, vetën, kohën.

6 Shkruani foljen e duhur, duke përshtatur vetën dhe numrin me kryefjalën e fjalisë.

– Arbana i _____ një ninullë motrës së vogël.
– Përpara postës _____ shumë njerëz në radhë.
– Kushërinjtë e mi dje _____ një ekskursion mësimor.

7 Nënvizoni foljet dhe grupojini në një tabelë sipas zgjedhimeve që u përkasin.

Jeta është një mundësi, kape.
Jeta është bukuri, adhuroje.
Jeta është lumturi, shijoje.
Jeta është ëndërr, bëje realitet.
Jeta është sfidë, përballoje.
Jeta është detyrë, përmbushe.
Jeta është lojë, luaje.
Jeta është e çmuar, kujdesu për të.
Jeta është pasuri, vlerësoje.
Jeta është dashuri, jetoje.
Jeta është mister, zbuloje.
Jeta është premtim, mbaje.
Jeta është trishtim, kaloje.
Jeta është himn, këndoje.
Jeta është betejë, pranoje.
Jeta është aventurë, rrezikoje.
Jeta është jetë, mbroje.

Nënë Tereza

Mënyrat dhe kohët e foljes

Folja mund ta shprehë veprimin në mënyra të ndryshme. Mënyra të foljes quajmë format e ndryshme që merr folja për të shprehur një veprim të sigurt, të mundshëm, të dëshirueshëm ose të papritur.

Folja ka gjashtë mënyra: dëftore, lidhore, kushtore, habitore, dëshirore dhe urdhërore.

Mënyrat	Kuptimi	Shembuj
Mënyra dëftore	Gjendja ose veprimi përmes foljes shprehet si i vërtetë.	Ai punonte natë e ditë.
Mënyra lidhore	Gjendja ose veprimi shprehet si i mundshëm.	Mund të thuash të vërtetën.
Mënyra kushtore	Gjendja ose veprimi paraqitet si i mundshëm, i vërtetë, nëse realizohet një kusht.	Nuk do të kthehesha prapa, po të dyshoja.
Mënyra dëshirore	Gjendja ose veprimi është i dëshirueshëm, në formë urimi, gëzimi a mallkimi.	Kalofshi edhe shumë vite të tjera bashkë!
Mënyra habitore	Gjendja ose veprimi shprehet si i vërtetë i shoqëruar me një ndjenjë habie.	Sa larg qenkan këto dyqane!
Mënyra urdhërore	Gjendja ose veprimi paraqitet në formën e një urdhri, lutjeje, dëshire a kërkese.	Hidhu dhe priti ata topa!

Folja ka tri kohë: kohën e shkuar, kohën e tashme dhe kohën e ardhme. Ato tregojnë kohën kur ka ndodhur veprimi në lidhje me çastin e ligjërimit.

Kohët e foljes

Veprimi që kryhet nga folja, ndodh:

- në çastin kur ligjërojmë, **koha e tashme**:
  *Me vendosmëri njeriu **kërkon** të drejtat e tij.*
- para çastit kur ligjërojmë, **koha e shkuar**:
  *Me vendosmëri njeriu **kërkoi** të drejtat e tij.*
- pas çastit kur ligjërojmë, **koha e ardhme:**
  *Me vendosmëri njeriu **do të kërkojë** të drejtat e tij.*

Koha e shkuar ka pesë nëndarje, sipas skemës së mëposhtme.



Koha e ardhme ka dy nëndarje: kohën e ardhme dhe kohën e ardhme të përparme





Format e pashtjelluara të foljes nuk zgjedhohen.

USHTRIME

1 Nënvizoni foljet dhe vendosini në të gjitha mënyrat, në tabelë.

– Nuk do të flasim për këtë gjë, Budard. Shpejt do të shohësh se do të shërohem; nuk ndodhi aspak për fajin tënd! Kur pushimet po mbaronin, ne të gjithë sikur po shkallonim... Askush nuk ka pse bëhet me faj. Fani gjendej në dhomën e vet dhe Budardi i qëndronte te koka. Një zjarr bubulak përskuqte tërë vatrën dhe përhapte një ngrohtësi për zili mes një zhaurime të mbytur... Ishte e enjte. Karrocat e tregut zunë rrokullimën përgjatë rrugës. Në nëntor, nata nuk vonon të bjerë.

Mënyra dëftore	Mënyra lidhore	Mënyra kushtore	Mënyra dëshirore	Mënyra habitore	Mënyra urdhërore
flas	të flisja	do të kisha folur	folsha	folkam	fol

USHTRIME

2 Shkruani fjalinë e mëposhtme duke e përdorur foljen në të gjitha mënyrat e saj.

Mënyra dëftore	*Borën e vlerësojnë si vajzë me zemër dhe mendje të hapur.*
Mënyra lidhore	
Mënyra kushtore	
Mënyra habitore	
Mënyra dëshirore	
Mënyra urdhërore	

3 Plotësoni vendet boshe me foljet që mungojnë dhe tregoni mënyrën e kohën e tyre.

Dihet, se sa më shumë fjalë _____, aq më mirë _____ si me shkrim, ashtu dhe me gojë. Nëse _____ një tregim për dikë që _____, nga mënyra se si _____ fjalët, _____ përfytyrime të ndryshme te lexuesi. Kështu, kur ju _____ "Djali u ul _____ në divan me kokën mes duarve" – lexuesi _____ një djalë, i cili _____ në divan i shqetësuar. Po nëse _____ "Djali _____ në divan me kokën mes duarve", atëherë _____ një përfytyrim tjetër, më të ndryshëm nga i pari. Sa më shumë fjalë të zgjedhura _____, aq më bukur _____ gjithçka për një ngjarje a person të caktuar.
*(**Fjalë ndihmëse**: përdor, shprehem, shkruaj, njoh, shkruaj, jap, shkruani, duke menduar, them, tregoj, mendon, ulet, u lëshua, krijon.)*

4 Gjeni foljet dhe tregoni se në çfarë mënyre, kohe, vete dhe numri janë.

Vite të tëra, ajo rrugë nuk më shqitej nga mendja. Ishte rruga nga ku niste odiseja ime, një portë e hapur drejt një bote tjetër. Ajo rrugë të shpinte drejt asaj toke të premtuar, që unë do ta shihja një ditë, por që në fillim do ta pushtoja ca nga ca. E zbuloja vit pas viti, duke përshkruar gjithnjë një etapë të re, duke lënë pas çdo vit atë gur kilometrik ku ulesha në udhëtimin tim të gjatë.

Folja	Mënyra	Koha	Veta	Numri

5 Formoni fjali me foljet *lexoj, flas, zhvilloj, pres, laj, eci, hyj,* duke i përdorur në mënyra të ndryshme.

12

Forma veprore dhe forma joveprore e foljeve

Nënvizoni foljet e tekstit të mëposhtëm. Çfarë vini re?

Maçoku i zi madhosh po ngrohej për shtatë palë qejfe në diell, duke menduar sa mirë ndihej aty, me bark përpjetë nën ato rreze të vakëta, me të katra putrat e mbledhura dhe bishtin të shpalosur. Pikërisht atëherë kur ishte kthyer tërë përtaci për të ngrohur shpinën në diell, maçoku dëgjoi fishkëllimën e shkaktuar nga një objekt fluturues që u afrua me shpejtësi marramendëse.

L. Sepulveda

- Folja *dëgjoi* është në formën veprore, sepse tregon një veprim që e kryen kryefjala *maçoku* dhe bie mbi kundrinorin e drejtë *fishkëllimën*.
- Ndërsa foljet *ngrohej, ndihej, ishte kthyer, u afrua* janë në formën joveprore, sepse tregojnë veprime që kryehen prej dikujt tjetër dhe që i pësojnë kryefjalët ose që vetë kryefjalët veprojnë dhe pësojnë.

Format joveprore të foljeve ndërtohen:

- *me mbaresa* që janë të ndryshme nga ato të formës veprore: *dëgjohem, lahet, ftohej* etj.;
- me pjesëzën *u* në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore: *u ktheva, u lava* etj.;
- me ndihmën e foljes *jam* për të formuar kohë të përbëra: *jam drejtuar, jam këshilluar* etj.

USHTRIME

1 **Nëvizoni foljet dhe përcaktoni formën e tyre.**

Kangahu hapi flatrat dhe u ngrit në fluturim. Dallga e madhe e rrëmbeu të tërin në gjirin e saj. Kur doli sërish në sipërfaqe, drita e ditës ishte zhdukur. Pasi shkundi fort kokën, e kuptoi që mallkimi i detrave po i errësonte shikimin. Më kot krodhi disa herë kokën nën ujë, derisa ndonjë rreze e mekur drite mbërriti në bebëzat e syve të veshura nga nafta. Njolla veshtullore ia kishte ngjitur flatrat pas trupit, kështu që shkundi fort kthetrat me shpresën se do të largohej me shpejtësi nga qendra e dallgës së errët.

L. Sepulveda

2 **Shndërroni në formën veprore fjalitë e mëposhtme. Çfarë vini re?**

Çelësat e shkollës mbahen nga roja. _____
Dreni u prit nga prindërit me mall. _____
Idetë e tij ishin përkrahur nga shokët. _____
Mësueses i ishin dhuruar lulet nga nxënësit e saj. _____
Unë jam përkrahur shumë nga vëllai i madh. _____

3 **Formoni 6 fjali me foljet *mbaj, dëgjoj, marr*, duke i përdorur në formën veprore dhe në formën joveprore.**

Zgjedhimi i foljeve në formën veprore të mënyrës dëftore

Nënvizoni foljet dhe përcaktoni kohët e tyre.

Sportet janë aktivitete të mëdha që bashkojnë popujt. Sot, futbolli është sporti më popullor në botë. Njerëzit në të gjitha kontinentet luajnë – disa për zbavitje e të tjerë për të jetuar. Disa njerëz kanë zbuluar se loja e futbollit do të përhapë shpresën për njerëzimin.

Folja në mënyrën dëftore **shpreh një veprim ose një gjendje të sigurt, të vërtetë**, që ka ndodhur në të shkuarën, po ndodh në të tashmen apo do të ndodhë në të ardhmen.
Veprimi a gjendja e shprehur nga folja në shembujt e mësipërm kryhet në tri kohë themelore:

Në kohën e tashme: *Sportet bashkojnë*... (veprimi po ndodh)
Në kohën e shkuar: *Disa njerëz kanë zbuluar*... (veprimi ka ndodhur)
Në kohën e ardhme: *Loja e futbollit do të përhapë*... (veprimi do të ndodhë)

Kohët e foljes në mënyrën dëftore

Foljet në kohët e mënyrës dëftore

	Koha	Kohët	Folje dhe shembuj	Momenti i kryerjes së veprimit
kohët e thjeshta	KOHA E TASHME	e tashmja	mësoj, hap, rri Unë ndihmoj njerëzit në nevojë.	Veprimi kryhet në çastin kur flasim.
kohët e thjeshta	KOHA E SHKUAR	e pakryera	mësoja, hapja, rrija Unë ndihmoja njerëzit në nevojë.	Veprimi ka filluar më parë dhe nuk ka mbaruar së kryeri në një çast të së shkuarës.
kohët e thjeshta	KOHA E SHKUAR	e kryera e thjeshtë	mësova, hapa, ndenja Unë ndihmova njerëzit në nevojë.	Veprimi ka përfunduar në kohën e shkuar.
kohët e përbëra	KOHA E SHKUAR	e kryera	kam mësuar, kam hapur, kam ndenjur Unë kam ndihmuar njerëzit në nevojë.	Veprimi ka përfunduar në të shkuarën, por nuk i ka shkëputur lidhjet me çastin e ligjërimit.
kohët e përbëra	KOHA E SHKUAR	më se e kryera	kisha mësuar, kisha hapur, kisha ndenjur Unë kisha ndihmuar njerëzit në nevojë.	Veprimi ka përfunduar para një çasti të së shkuarës.
kohët e përbëra	KOHA E SHKUAR	e kryera e tejshkuar	pata mësuar, pata hapur, pata ndenjur Unë pata ndihmuar njerëzit në nevojë.	Veprimi ka përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës.
e thjeshtë	KOHA E ARDHME	e ardhmja	do të mësoj, do të hap, do të rri Unë do të ndihmoj njerëzit në nevojë.	Veprimi do të kryhet pas çastit kur flasim.
e përbërë	KOHA E ARDHME	e ardhmja e përparme	do të kem mësuar, do të kem hapur, do të kem ndenjur Unë do të kem ndihmuar njerëzit në nevojë.	Veprimi pritet të kryhet në të ardhmen, para një veprimi tjetër.

Kohët e përbëra

Kohët e përbëra ndërtohen nga dy pjesë:

Folja ndihmëse (*kam, jam*) dhe pjesorja e foljes me kuptim themelor.
(flas – kam folur).

Në kohët e përbëra zgjedhohet vetëm folja ndihmëse (kam, jam), pjesa tjetër rri e pandryshuar.

Zgjedhimi i foljes në mënyrën dëftore

Tabela e zgjedhimit të foljes në mënyrën dëftore

Veta		E tashme	E pakryer	E kryer e thjeshtë	E kryer	Më se e kryer	E kryer e tejshkuar	E ardhme	E ardhme e përparme
I	unë	laj	laja	lava	kam larë	kisha larë	pata larë	do të laj	do të kem larë
II	ti	lan	laje	lave	ke larë	kishe larë	pate larë	do të lash	do të kesh larë
III	ai, ajo	lan	lante	lau	ka larë	kishte larë	pati larë	do të lajë	do të ketë larë
I	ne	lajmë	lanim	lamë	kemi larë	kishim larë	patëm larë	do të lajmë	do të kemi larë
II	ju	lani	lanit	latë	keni larë	kishit larë	patët larë	do të lani	do të keni larë
III	ata, ato	lajnë	lanin	lanë	kanë larë	kishin larë	patën larë	do të lajnë	do të kenë larë

USHTRIME

1 Plotësoni tabelën duke zgjedhuar në mënyrën dëftore foljet: *mendoj, pi, flas.*

Veta		E tashme	E pakryer	E kryer e thjeshtë
I	unë		pija	
II	ti	mendon		
III	ai, ajo			
I	ne			
II	ju			
III	ata, ato			folën

2 Plotësoni fjalitë me folje në mënyrën dëftore. Në cilën kohë janë përdorur?

Një nga imazhet më prekëse të lojërave _____ kur sheh atletin në podium.
Në dorë ai _____ medaljen e artë, kur _____ himnin kombëtar të vendit të tij.
Të gjithë spektatorët _____ në këmbë në shenjë nderimi.
Për vende të ndryshme, një fitore olimpike _____ një ngjarje mbresëlënëse.
(***Fjalë ndihmëse:*** *jam, mbaj, dëgjon, ngrihem.*)

USHTRIME

3 Analizoni foljet e mënyrës dëftore në tekstin e mëposhtëm.

Donte t'i hiqte nga vetja këta atletë të vegjël që e bezdisnin. Sidoqoftë, njerëzit trupvegjël sapo i kishin dhënë për të ngrënë, e kishin ushqyer me bujari me një drekë të shijshme e të bollshme. Ishte e pahijshme të tregohej mosmirënjohës.

4 Zgjedhoni foljen *shkruaj* në të gjitha kohët e mënyrës dëftore.

5 Vendosni foljet ***bëj, kap, fle*** në të gjitha kohët e mënyrës dëftore në vetën e parë, në numrin njëjës.

Folja	E tashme	E pakryer	E kryer e thjeshtë	E ardhme	E kryer	Më se e kryer	E kryer e tejshkuar	E ardhme e përparme
bëj		bëja						
kap								
fle								

6 Vendosni foljet *bëj, kap, fle* në të gjitha kohët e mënyrës dëftore në vetën e dytë, në numrin shumës.

Folja	E tashme	E pakryer	E kryer e thjeshtë	E ardhme	E kryer	Më se e kryer	E kryer e tejshkuar	E ardhme e përparme
bëj	bëni							
kap								
fle								

7 Krijoni fjali me grupet e fjalëve të dhëna, duke i vendosur foljet në kohën e kërkuar.

luajmë në park	e kryer e thjeshtë	*Sot luajtëm në park gjithë mëngjesin.*
laj dyshemenë	e pakryer	
rregulloj krevatin	e ardhme	
rregullonte këpucën	e kryer e thjeshtë	
mbillte fidanë	e kryer	
merrej me sport	më se e kryer	
lidhte gërshetin	e kryer e tejshkuar	

14

Zgjedhimi i foljeve në formën veprore të mënyrës lidhore

Folja në **mënyrën lidhore** e paraqet veprimin *të dëshirueshëm* ose *të detyrueshëm*.

Të dëshirueshëm:	Ah, sikur **të fluturoja** në hapësirë!
Të detyrueshëm:	Duhet **të shkruash** më bukur!

*Duhet **të nxitojmë** dhe **të kapim** autobusin, se u bë vonë.*
*Ajo mund **të na kishte lajmëruar** në kohë.*

Folja në mënyrën lidhore shpreh një veprim a gjendje që **mund të kryhet** ose **mund të ishte kryer**, që zakonisht lidhet me fjalinë e mëparshme.

Folja në mënyrën lidhore ka gjithmonë përpara pjesëzën ***të***: *të kërkoj, të takoj, të përqafoj.*

Kohët e mënyrës lidhore janë:

Kohët e foljes në mënyrën lidhore

Koha e tashme	e tashmja	Më pëlqen të shëtit në bregun e detit.
Koha e shkuar	e pakryera	Do të doja të mbaronte sa më shpejt ky testim.
	e kryera	Videon mund ta kem prishur unë.
	më se e kryera	Do të ishte mirë të kisha ditur gjuhën angleze.

Tabela e zgjedhimit të foljes në mënyrën lidhore

Zgjedhimi i foljes në mënyrën lidhore

Veta		E tashme	E pakryer	E kryer	Më se e kryer
I	unë	të laj	të laja	të kem larë	të kisha larë
II	ti	të lash	të laje	të kesh larë	të kishe larë
III	ai, ajo	të lajë	të lante	të ketë larë	të kishte larë
I	ne	të lajmë	të lanim	të kemi larë	të kishim larë
II	ju	të lani	të lanit	të keni larë	të kishit larë
III	ata, ato	të lajnë	të lanin	të kenë larë	të kishin larë

Koha e tashme dhe koha e pakryer e mënyrës lidhore janë **kohë të thjeshta**.

- **e tashmja** — të laj
- **e pakryera** — të laja

Koha e kryer dhe koha më se e kryer e mënyrës lidhore janë **kohë të përbëra**. Ato ndërtohen me anë të foljes ndihmëse **kam** ose **jam** (lidhore, e tashme dhe e pakryer) dhe **pjesores** së foljes përkatëse:

- **e kryera** — të kem + larë — të jem + larë
- **më se e kryera** — të kisha + larë — të isha + larë

Në vetën e tretë, numri njëjës, të kohës së tashme, të mënyrës lidhore, foljet shkruhen gjithmonë me **-ë** në fund: (ai/ajo) të lexoj**ë**, të flas**ë**.

USHTRIME

1 Zgjedhoni foljen ***mendoj*** në të gjitha kohët e mënyrës lidhore.

Vetat		Koha e tashme	Koha e pakryer	Koha e kryer	Koha më se e kryer
I	unë	të mendoj			
II	ti				
III	ai, ajo		të mendonte		
I	ne			të kemi menduar	
II	ju				
III	ata, ato				të kishin menduar

2 Vendosni foljet në kllapa në formën e duhur.

Në ato çaste, im atë, nga dhoma përbri më thoshte: "Ç'bën kështu, more, mbaje veten! E si ndryshe mund (tregoj) që je burrë. Mirëpo darët sikur kërkonin të (ngul) edhe më tepër, ndaj duhet të (të mbaj) fort që të mos ia jepje ulërimës. Atëherë, në mes të natës, duhet (ndez) dritën dhe (kthehem) për të rënë prapë në gjumë".

3 Dalloni pjesëzën ***të*** të lidhores nga pjesëza ***të*** si trajtë e shkurtër e përemrave vetorë.

Këtu të është thyer, ë? Edhe këtu... në dy vende? Atë ditë, kur doktori të hoqi protezat, nuk të pashë të vije gjumë në sy për tërë natën. Ai të siguroi se këmba do të shërohej plotësisht e se ti, për pak kohë, do të jesh në gjendje si më parë, të rendësh, të luash e të kërcesh.

4 Shkruani fjalitë duke i vënë në mënyrën lidhore foljet në kllapa.

Koha e tashme: Djemtë vazhdojnë (luaj) futboll, megjithëse po ngryset. Nata ka nisur (pushtoj) majat e maleve dhe kulmet e çative.
Koha e pakryer: Atë mbrëmje kishim miq nga larg; do të vinte një fisi ynë (tregoj) për punën e tapive të vjetra. Na ftonte (marr) një vendim për tokat buzë lumit.
Koha e kryer: Sado që ata (punoj), ne nuk na arrijnë dot. Do të ishte mirë (filloj) punën qysh në mëngjes.
Koha më se e kryer: Nëse ai (punoj) gjithë ditën, do ta kishte mbaruar detyrën. Kampionatin e kaluar (luaj) me Dinamon.

5 Vëreni figurën dhe shkruani katër fjali me folje në kohët e mënyrës lidhore.

15 Zgjedhimi i foljeve në formën joveprore të mënyrës dëftore dhe lidhore

Besi **u rrëzua** duke bërë akrobaci me monopatinën e tij. Ndoshta **do t'i vendosin** allçi në këmbë.

Kujtojmë

Mënyra dëftore e foljes ka tetë kohë, katër të thjeshta dhe katër të përbëra: *e tashme, e pakryer, e kryer e thjeshtë, e ardhme, e kryer, më se e kryer, e kryer e tejshkuar, e ardhme e përparme.*

Forma joveprore e foljes në mënyrën dëftore formohet në tri mënyra:

1. Me anën e mbaresave	
koha e tashme:	*dëgjohem, dëgjohesh, dëgjohet, dëgjohemi, dëgjoheni, dëgjohen*
koha e pakryer:	*dëgjohesha, dëgjoheshe, dëgjohej, dëgjoheshim, dëgjoheshit, dëgjoheshin*
koha e ardhme:	*do të dëgjohem, do të dëgjohesh, do të dëgjohet, do të dëgjohemi, do të dëgjoheni, do të dëgjohen*
2. Me pjesëzën *u*	
koha e kryer e thjeshtë	*u dëgjova, u dëgjove, u dëgjua, u dëgjuam, u dëgjuat, u dëgjuan*
3. Me foljen ndihmëse *jam*	
koha e kryer:	*jam dëgjuar, je dëgjuar, është dëgjuar, jemi dëgjuar, jeni dëgjuar, janë dëgjuar*
koha më se e kryer:	*isha dëgjuar, ishe dëgjuar, ishte dëgjuar, ishim dëgjuar, ishit dëgjuar, ishin dëgjuar*
koha e kryer e tejshkuar:	*qeshë dëgjuar, qe dëgjuar, qe dëgjuar, qemë dëgjuar, qetë dëgjuar, qenë dëgjuar*
koha e ardhme e përparme:	*do të jem dëgjuar, do të jesh dëgjuar, do të jetë dëgjuar, do të jemi dëgjuar, do të jeni dëgjuar, do të jenë dëgjuar*

Zgjedhimi i foljes në formën joveprore të mënyrës dëftore

Më poshtë paraqiten tabelat e zgjedhimit të foljeve në formën joveprore të mënyrës dëftore.

Tabela e zgjedhimit të foljes në formën joveprore të mënyrës dëftore (kohët e thjeshta)

	E tashme	E pakryer	E kryer e thjeshtë	E ardhme
unë	afrohem	afrohesha	u afrova	do të afrohem
ti	afrohesh	afroheshe	u afrove	do të afrohesh
ai/ajo	afrohet	afrohej	u afrua	do të afrohet
ne	afrohemi	afroheshim	u afruam	do të afrohemi
ju	afroheni	afroheshit	u afruat	do të afroheni
ata/ato	afrohen	afroheshin	u afruan	do të afrohen

Tabela e zgjedhimit të foljes në formën joveprore të mënyrës dëftore (kohët e përbëra)

	E kryer	Më se e kryer	E kryer e tejshkuar	E ardhme e përparme
unë	jam afruar	isha afruar	qeshë afruar	do të jem afruar
ti	je afruar	ishe afruar	qe afruar	do të jesh afruar
ai/ajo	është afruar	ishte afruar	qe afruar	do të jetë afruar
ne	jemi afruar	ishim afruar	qemë afruar	do të jemi afruar
ju	jeni afruar	ishit afruar	qetë afruar	do të jeni afruar
ata/ato	janë afruar	ishin afruar	qenë afruar	do të jenë afruar

Forma joveprore e foljes në mënyrën lidhore

Forma joveprore e foljes në mënyrën lidhore formohet:

1. Me anën e mbaresave	
koha e tashme:	*të dëgjohem, të dëgjohesh, të dëgjohet, të dëgjohemi, të dëgjoheni, të dëgjohen*
koha e pakryer:	*të dëgjohesha, të dëgjoheshe, të dëgjohej, të dëgjoheshim, të dëgjoheshit, të dëgjoheshin*
2. Me foljen ndihmëse *jam*	
koha e kryer:	*të jem dëgjuar, të jesh dëgjuar, të jetë dëgjuar, të jemi dëgjuar, të jeni dëgjuar, të jenë dëgjuar*
koha më se e kryer:	*të isha dëgjuar, të ishe dëgjuar, të ishte dëgjuar, të ishim dëgjuar, të ishit dëgjuar, të ishin dëgjuar*

Kujtojmë

Mënyra lidhore ka katër kohë, dy të thjeshta dhe dy të përbëra: të tashmen, të pakryerën, të kryerën dhe më se të kryerën.

Zgjedhimi i foljes në formën joveprore të mënyrës lidhore

	E tashme	E pakryer	E kryer	Më se e kryer
unë	të afrohem	të afrohesha	të jem afruar	të isha afruar
ti	të afrohesh	të afroheshe	të jesh afruar	të ishe afruar
ai/ajo	të afrohet	të afrohej	të jetë afruar	të ishte afruar
ne	të afrohemi	të afroheshim	të jemi afruar	të ishim afruar
ju	të afroheni	të afroheshit	të jeni afruar	të ishit afruar
ata/ato	të afrohen	të afroheshin	të jenë afruar	të ishin afruar

USHTRIME

1 Zgjedhoni në kohën e kryer të thjeshtë të formës joveprore, të mënyrës dëftore, foljet: *mbështjell, kap, hedh.*

Veta	mbështjell	kap	hedh
unë	*u mbështolla*	*u kapa*	*u hodha*
ti			
ai/ajo			
ne			
ju			
ata/ato			

2 Zgjedhoni në kohën e pakryer të mënyrës lidhore, të formës joveprore, foljet: *mbështjell, kap, hedh.*

Veta	mbështjell	kap	hedh
unë	*të mbështillesha*	*të kapesha*	*të hidhesha*
ti			
ai/ajo			
ne			
ju			
ata/ato			

3 Në fragmentin e mëposhtëm, nënvizoni foljet dhe përcaktoni formën e tyre.

Mos i mbani fëmijës fjalime që ai s'mund t'i kuptojë. As përshkrime, as gojëtarira, as figura, as poezi. Vazhdoni të jeni i qartë, i thjeshtë, i ftohtë; koha për të mbajtur një tjetër lloj të foluri s'do të vonojë. Kufizohuni t'ia paraqitni objektet në kohën e duhur, pastaj kur të shihni se kureshtja e tij është mjaft e plotë, i bëni atij ndonjë pyetje që ta vini në udhë të drejtë të zgjidhjes. Në këtë rast, si ta keni soditur bashkë me të diellin që lind, mbasi t'i keni treguar atij malet dhe sendet e tjera të afërta, mbasi ta keni lënë të bisedojë sipas endjes së tij rreth kësaj çështjeje, qëndroni disa çaste në heshtje, si dikush që ëndërron, pastaj i thoni: "Po mendoj se dje në mbrëmje dielli ka perënduar aty dhe sot në mëngjes, ka lindur atje. Si mund të ndodhë kjo?".

4 Vendosni në kohët e mënyrës dëftore dhe lidhore të formës joveprore foljet e tabelës.

Foljet	dëftore, joveprore, e tashme, veta e parë	lidhore, joveprore, e tashme, veta e parë
afroj	*afrohem, afrohesha, u afrova, jam afruar, isha afruar, qeshë afruar, do të jem afruar, do të isha afruar*	*të afrohem , të afrohesha, të jem afruar, të isha afruar*
filloj		
ndërtoj		
hedh		
mbledh		
ul		
nxjerr		

5 Në pjesën me titull "Prometeu i lidhur", nënvizoni folje të mënyrës dëftore dhe lidhore, përcaktoni formën e tyre.

Ushtrime për foljet

1 **Nënvizoni foljet. Përcaktoni nëse janë folje me kuptim të plotë leksikor apo folje ndihmëse.**

Atë mëngjes të diele, një dritë e re hynte nëpër dritare, siç ndodh shpesh pas shumë ditëve me shi.
Ajo kohë dhe ai diell do të thoshte për ne "shpresa" për një ditë ndryshe nga të tjerat.
Atë mëngjes nuk vonoi që zëri i kapitenit të dëgjohej duke na thirrur për në fushë, në orën 2:00 të pasdites.
U mblodhëm të gjithë, të përpiktë dhe të shumtë në numër. Për fat, edhe pse isha nga më të vegjlit, u zgjodha në mes të 22-shes që do të luante.

2 **Lidhni me shigjetë sipas modelit.**

Qenkeni lodhur sot, shokë!	Gjendja ose veprimi përmes foljes shprehet si i vërtetë.	Mënyra dëshirore
Duhet të vish vetë në bibliotekë, Indrit!	Gjendja ose veprimi shprehet si i vërtetë, i shoqëruar me një ndjenjë habie.	Mënyra lidhore
Mësoni që të bëheni të ditur!	Gjendja ose veprimi paraqitet si i mundshëm, i vërtetë, nëse realizohet një kusht.	Mënyra urdhërore
Sytë i morën një shkëlqim të veçantë.	Gjendja ose veprimi është i dëshirueshëm, në formë urimi a mallkimi.	Mënyra dëftore
Ju këndoftë zemra gjithmonë!	Gjendja ose veprimi shprehet si mundësi.	Mënyra habitore
Po të kërkoje ndihmë nga unë, do të kisha ardhur patjetër.	Gjendja ose veprimi paraqitet në formën e një urdhri, lutjeje, dëshire a kërkese.	Mënyra kushtore

3 **Përshtateni fjalinë e mëposhtme duke e vendosur foljen në mënyrat e kërkuara, në formën veprore dhe joveprore.**

Forma veprore		Forma joveprore	
Mënyra dëftore	Mësuesen e respekton gjithë komuniteti.	Mënyra dëftore	Mësuesja respektohet nga gjithë komuniteti.
Mënyra lidhore	_____	Mënyra lidhore	_____
Mënyra kushtore	_____	Mënyra kushtore	_____
Mënyra habitore	_____	Mënyra habitore	_____

4 **Zgjedhoni foljet *lexoj, flas, di* në të gjitha kohët e mënyrës dëftore dhe lidhore, në formën veprore dhe joveprore.**

5 **Analizoni foljet që nënvizuat në ushtrimin 1, duke plotësuar tabelën e mëposhtme.**

Folja	Mënyra	Koha	Veta			Numri		Zgjedhimi			Forma	
			I	II	III	Nj	Sh	I	II	III	veprore	joveprore
hynte	dëftore	e pakryer			+	+		+			+	
...												

17 Ndajfolja

Ndajfolja është fjalë e pandryshueshme që shërben për të treguar një tipar të veprimit a të gjendjes së treguar nga folja, nga një emër apo nga një mbiemër që e ka prejardhjen nga folja: *mirë, bukur, qartë, sot, nesër, këtu, aty* etj.

Ajo tregon edhe shkallën e një cilësie apo të një rrethane.

Zakonisht, ndajfoljet në fjali qëndrojnë pranë një foljeje, pranë një mbiemri ose pranë një ndajfoljeje tjetër. Rrallë mund të qëndrojnë pranë një emri që e ka prejardhjen nga folja.

*Po vazhdove kështu, nuk do të të dalë **keq**.*
*Po shkuam shumë **larg**, do të vonohemi.*
*Duket fëmija i rritur **mirë**.*

Klasifikimi i ndajfoljeve

Sipas kuptimit dhe funksionit që kanë në fjali, ndajfoljet ndahen në: ndajfolje vendi, kohe, mënyre, sasie, shkaku.

Ndajfolje vendi	Tregojnë vendin ku kryhet një veprim.	*këtu, atje, sipër, djathtas, majtas, kudo, larg, afër, aty, lart, përpara, poshtë, brenda, ku, nga etj.*
Ndajfolje kohe	Tregojnë kohën dhe kohëzgjatjen e kryerjes së një veprimi.	*dikur, dje, nesër, pasnesër, përditë, shpesh, natën, ditën, mbrëmë, sot, brez pas brezi, përnatë, përherë etj.*
Ndajfolje mënyre	Tregojnë mënyrën se si kryhet një veprim.	*qartë, mbarë, ëmbël, natyrshëm, papritur, thellë, trimërisht, keq, dobët, shëndetshëm, barkazi, mjaftueshëm, flakë për flakë etj.*
Ndajfolje sasie	Tregojnë në mënyrë të papërcaktuar sasi.	*pak, shumë, tepër, mjaft, kaq etj.*
Ndajfolje shkaku	Tregojnë shkakun e kryerjes së një veprimi.	*pse, për ç'shkak, përse*

Shkallët e ndajfoljeve

Shkallët e ndajfoljeve

Ndajfoljet përdoren në shkallë të ndryshme me anën e të cilave tregojnë dendësinë e veprimit të shprehur prej foljes.

Shkallët e ndajfoljeve janë:

- **Shkalla pohore:** *qartë, mbarë, ëmbël, natyrshëm, papritur, thellë, trimërisht;*
  Shiu filloi papritur. Ai u zhyt thellë në ujin e ngrohtë të pishinës.
- **Shkalla krahasore:**
  Trupin nuk e ndiente aq të lehtë, sa mund të ecte më shpejt.
  Kjo është më mirë se ajo e para. Dimri i këtij viti erdhi më vonë.
  Dha një përgjigje më pak të mirë se zakonisht.
- **Shkalla sipërore:** *shumë, mjaft, fare, tepër, krejt, fort, jashtëzakonisht, bukur;*
  Ai veproi shumë mirë. Ai veproi jashtëzakonisht mirë.

USHTRIME

1 Plotësoni vendet boshe me një ndajfolje.

Rruga për në pistodrom gjallonte _____ nga qindra njerëz të moshave të ndryshme. Anija kozmike "Flumina" pas një ore do të niste udhëtimin e saj drejt hapësirës. Në vorbullën e njerëzve, së bashku me prindërit, nxitonin _____ edhe Jona, edhe Dori. Ndiheshin të gëzuar dhe të emocionuar. Së bashku me inxhinier Ninin do të niseshin _____ për në Mars me anije kozmike. Një udhëtim i këndshëm dhe i vështirë. Një rast i jashtëzakonshëm, ndaj qyteti po i përcillte _____ me zemër të ngrohtë, me besim në fitore. Kalimtarët i shikonin me kërshëri, prindërit edhe me njëfarë shqetësimi, ndërsa moshatarët ndiheshin _____ krenarë.

B. Xhama, "Klorela"

(**Fjalë ndihmëse:** zhurmshëm, lart, gëzueshëm, çuditshëm, shumë.)

2 Ktheni në ndajfolje mbiemrat e mëposhtëm.

i dobët, dobët; i keq, _____; i mirë, _____; i drejtë, _____; i bukur, _____; i shkurtër, _____; i pastër, _____; i rrallë, _____; i lehtë, _____; i ftohtë, _____; i thellë,_____; i ngushtë, _____; i fortë, _____; i qartë, _____; i gjatë _____.

3 Përjashtoni me ✘ fjalët që nuk janë ndajfolje:

atje, andej, kudo, dje, e sotmja, pra, pardje, i lartë, hollësisht, diku, drejtësi, shpesh, përditë, anembanë, por, qartë, i bukur, i lehtë, i rrallë, i butë, i thellë, gazmor, zëra, fluturoj, poshtë, i nxituar, thjesht, shtrembër.

4 Nënvizoni ndajfoljet dhe vendosini në tri shkallët e tyre.

Me nxitim, ajo fërkoi pas murit gjithë tufën e shkrepëseve, sepse donte aq shumë që ta mbante gjyshen aty. Dhe shkrepëset flakëruan me një dritë më të ndritshme se drita e diellit. Dhe asaj kurrë s'i ishte dukur gjyshja kaq e madhe dhe e bukur. Ajo e mori vajzën e vogël në krahët e saj dhe të dyja bashkë fluturuan të gëzuara e në shkëlqim, lart, lart, aty ku s'kishte më të ftohtë, as uri, as frikë.

Ndajfolja	Shkalla pohore	Shkalla krahasore	Shkalla sipërore

5 Gjeni ndajfoljet dhe zëvendësojini me të tjera pa e prishur kuptimin e fjalive.

Klorela po rritej shpejt në kabinën e saj, në kushte shumë të mira që i ishin krijuar mjaftueshëm aty brenda. Një robot elektronik i telekomanduar nga inxhinier Nini merrej vazhdimisht vetëm me Klorelën, kryente pareshtur të gjitha shërbimet e nevojshme. E mbillte thellë, e plehëronte herë pas here, e prashiste shpesh, e korrte, e thante.

6 Nga pjesa "Pikat e shiut", shkruani dhjetë ndajfolje dhe përcaktoni llojin e tyre.

18

Lidhëzat

Lexoni fjalitë. Për çfarë shërbejnë fjalët me të zeza?

Kuptimi

Arbri foli gjatë ***dhe*** *bukur*. (Fjalëza ***dhe*** lidh dy fjalë).
U kthyem vonë ***se*** *festa zgjati shumë*. (Fjalëza ***se*** lidh dy pjesë të një fjalie të përbërë.)
I ramë nga ura e vjetër, ***sepse*** *kishin filluar shirat*. (Fjalëza ***sepse*** lidh dy pjesë të një fjalie të përbërë.)

Fjalëzat që lidhin *gjymtyrë fjalie ose pjesë të fjalisë së përbërë,* quhen **lidhëza**.

Lidhëzat janë fjalë të pandryshueshme. Lidhëzat nuk kanë kuptim leksikor të pavarur. Ato lidhin dy gjymtyrë të fjalisë ose dy pjesë fjalie.

Lidhëza ***dhe*** lidh fjalë që kanë të njëjtin funksion në fjali: *gjatë* ***dhe*** *bukur*. Nëpërmjet saj shprehet marrëdhënia e barazisë.
Lidhëza ***se*** lidh dy pjesë fjalie. Nëpërmjet saj shprehet marrëdhënia e varësisë së njërës pjesë fjalie kundrejt tjetrës.

Klasifikimi i lidhëzave

Sipas **funksionit** që kryejnë, lidhëzat i grupojmë në:
- lidhëza bashkërenditëse
- lidhëza nënrenditëse

Klasifikimi i lidhëzave bashkërenditëse

Lidhëzat bashkërenditëse lidhin dy fjalë, dy grupe fjalësh ose dy pjesë fjalie që luajnë rolin e gjymtyrëve të njëjta.
Lidhëzat bashkërenditëse ndahen në: *shtuese, veçuese, kundërshtuese, përmbyllëse.*

Lidhëzat bashkërenditëse

Llojet e lidhëzave bashkërenditëse	Lidhëzat	Shembuj
Lidhëza shtuese	as, dhe, e, edhe, si (e)dhe, hem... hem, si... si, si... ashtu... (e)dhe etj.	Fëmijët dhe të rriturit qëndronin buzë liqenit.
Lidhëza veçuese	a, apo, o, ose, daç... daç, ja... ja, ndo... ndo, qoftë... qoftë etj.	Ose bëj siç them unë, ose mos shko fare.
Lidhëza kundërshtuese	kurse, megjithatë, megjithëkëtë, mirëpo, ndërsa, teksa, po(r), porse, veç, veçse, vetëm, vetëm se etj.	Libri është punuar bukur, vetëm se ka nevojë dhe për pak punë.
Lidhëza përmbyllëse	andaj, ndaj, pa, pra, prandaj, domethënë etj.	Vjersha ishte e bukur, prandaj e mësova shpejt përmendsh.

Klasifikimi i lidhëzave nënrenditëse

Lidhëzat nënrenditëse lidhin dy pjesë fjalie që nuk kanë të njëjtin rol në fjali. Njëra është pjesë kryesore, kurse tjetra është pjesë e varur prej saj.

Lidhëzat nënrenditëse ndahen në: *ftilluese, vendore, kohore, shkakore, qëllimore, krahasore-mënyrore, kushtore, rrjedhimore, lejore.*

Llojet e lidhëzave nënrenditëse	Lidhëzat	Shembuj
Lidhëza ftilluese	që, se.	Ajo mendoi se nuk do të binte shi.
Lidhëza vendore	ku, tek/te, nga, kudo, ngado, deri ku, nga ku, kudo që, ngado që etj.	Ku ka zemër, ka dhe krahë. Ngado që të shkosh, si shtëpia jote nuk ka.
Lidhëza kohore	kur, sa, si, tek, që, derisa, pasi, porsa, teksa, sapo që, kurdo, qysh se etj.	Kur dolëm jashtë, ishte errur. Sapo iku Shkëlzeni, ia behu komandanti.
Lidhëza shkakore	se, sepse, si, pasi, përderisa, gjersa, meqenëse, meqë, ngaqë, për arsye se, për shkak se etj.	Vendi dridhej, ai mbeti, se s'tronditej nga tërmeti. Kënaqej ngaqë njerëzit nuk e kishin harruar.
Lidhëza qëllimore	që, me qëllim që, në mënyrë që.	Lodheshim shumë në stërvitje, me qëllim që ta kishim më të lehtë në ndeshje.
Lidhëza mënyrore	si, po(r) si, sikurse, ashtu si(ç).	Kurrë nuk jam ndier në të tillë siklet si u ndjeva sot.
Lidhëza kushtore	në, po, nëse, kur, sikur, në qoftë se, në rast se, po qe se etj.	Në qoftë se do të ishin të mira, do të kishim marrë pesë kilogramë.
Lidhëza rrjedhimore	kështu që, sa, saqë, që etj.	Koha po ikte, kështu që njerëzit u mërzitën pakëz.

USHTRIME

1 Dalloni llojet e lidhëzave në fjalitë e mëposhtme.

Po kthehesha nga gjuetia dhe po kaloja shtegut të kopshtit. Qeni vraponte para meje kur, papritur, ai ngadalësoi hapat dhe filloi të fshihej, sikur të kish përpara gjahun.
Hodha sytë shtegut të kopshtit dhe pashë një trumcak të vogël me ngjyrë të verdhë rreth sqepit dhe me push në kokë. Ai kishte rënë nga foleja (era lëkundte fort mështeknat e kopshtit) dhe rrinte pa lëvizur me krahët e ngritur, si me druajtje, me ata krahë që sapo i kishin dalë. Qeni im po i afrohej zogut ngadalë kur, befas, aty afër u shkëput nga pema një trumcak plak gushëzi dhe ra si një gur para turinjve të qenit, i shpupuritur, i shtrembëruar.

2 Vendosni lidhëzat e duhura. Tregoni llojin e tyre.

Ata kaluan urën ___ vështruan pas ___ donin të thoshin diçka. _____
I hipi trenit ___ të mos takohej ___ të përshëndetej me Almën. _____
___ të flisje edhe ti për të kështu, nuk ma priste mendja. _____
Mirëpo zëri i fyellit dëgjohej ngado ___ nuk mund të mohonte njeri. _____
Rruga dukej ___ donte ditë ___ të hapej, ___ u kthyen në një fshat aty pranë. _____

USHTRIME

3 Nënvizoni me një vizë lidhëzat që lidhin dy gjymtyrë fjalie dhe me dy viza ato që lidhin dy pjesë të fjalisë.

Të gjithë sa qenë atje shtangën në vend nga tmerri dhe pritnin me ankth se ç'do të ndodhte. Buçiti një e shtënë dhe artilieri ra përmbys e vuri duart në kokë. Se ç'u bë më tej, nuk pamë dot gjë. Atë çast, tymi na i zuri sytë e filluam të kolliteshim. Kur tymi u shpërnda nëpër ujë, u dëgjua nga të gjitha anët një pështërimë. Dalëngadalë, pështërima u bë më e fortë, derisa më në fund buçiti një britmë e përbashkët gëzimi. Artilieri plak hoqi duart nga koka, u ngrit në këmbë dhe ktheu kokën nga deti.

4 Përcaktoni llojet e lidhëzave duke shënuar në tabelë me shenjën + llojin e tyre.

Lidhëzat bashkërenditëse	Shtuese	Veçuese	Kundërshtuese	Përmbyllëse
megjithatë				
edhe	+			
hem... hem				
apo				
mirëpo				
si... ashtu dhe				
veçse				
as				

5 Formoni fjali me lidhëzat bashkërenditëse: *e, edhe, po, prandaj, ose, por, as*.

6 Nënvizoni lidhëzat në dy paragrafët e parë të pjesës së leximit "Sarajet e bardha". Shkruani çfarë lloji janë.

7 Përshkruani pamjen që shihni, duke përdorur sa më shumë lidhëza bashkërenditëse.

Parafjala



Kuptimi

Parafjalët janë fjalë ose shprehje të pandryshueshme që shprehin marrëdhënien e një fjale të fjalisë me një fjalë tjetër të saj.

Parafjala qëndron:

- para një emri: *me motrën, pranë shtëpisë, në kinema* etj.
- para një përemri: *me atë, nga ata, në mes tyre* etj.
- para një numërori: *nga dhjetë, me dy, prej shtatë* etj.
- para një ndajfoljeje: *nga afër, prej së largu* etj.

Parafjalët sipas rasave

Në cilat rasa fjalët mund të marrin parafjalë?

Parafjalët qëndrojnë para emrave, përemrave e numërorëve të rasës emërore, gjinore, kallëzore e rrjedhore.

Shembull: **Nga** pasdrekja zunë bubullimat e vetëtimat.
Ecte **në** drejtim të pyllit.
Lirinë e kishit kudo, **në** kraharor, **në** ballë, **në** shpata dhe **në** ushta.
Ishte fermer **prej** Vore.

Përdorim të gjerë në gjuhën shqipe kanë parafjalë të tilla, si: ***me, më, mbi, prej, ndër, nga, për, në, me anë, në drejtim, në saje***.

Sapo doli **nga** shtëpia. (në rasën emërore)

Në oborrin e shtëpisë kundërmonte era e luleve. (në rasën kallëzore)

Para dritares u dëgjua një zë i fortë burri. (në rasën rrjedhore)

	Parafjalët sipas rasave
Emërore	nga, te, tek
Gjinore	me anë, me rastin, me përjashtim, në saje etj.
Kallëzore	me, pa, mbi, në, nëpër, përmbi, nën, për, për në etj.
Rrjedhore	prej, ndaj, sipas, pas, gjatë, kundër, anës etj.

Kujdes

Parafjala ***te*** përdoret kur fjala pas saj fillon me bashkëtingëllore: *te gota*.
Parafjala ***tek*** përdoret kur fjala pas saj fillon me zanore: *tek ibriku*.

Disa parafjalë, për nga forma, ngjajnë me ndajfoljet. Ato dallohen prej tyre nga vendi që zënë:

- Parafjalët qëndrojnë vetëm para emrit, përemrit, numërorit. Ato nuk mund të ndërrojnë vend.
- Ndajfoljet qëndrojnë kryesisht pas foljeve. Ato përgjithësisht ndërrojnë edhe vend.

Vëreni rastet kur kemi parafjalë dhe kur kemi ndajfolje.

Kur qëndrojnë prapa foljes, kemi ndajfolje.	Kur qëndrojnë para emrit, kemi parafjalë.
Mos më rri **afër**.	**Afër** zjarrit ishin mbledhur djem e vajza.
Papritur ajo më doli **përpara**.	**Përpara** pallatit kishte shumë njerëz.
U shpreh **kundër** për ligjin që diskutohet.	Ata hodhën parulla **kundër** punësimit të fëmijëve.
Nora erdhi **rreth e rrotull** për pak minuta.	**Rreth e rrotull** shtëpisë lëviznin disa të panjohur.
Ajo priti **gjatë**.	**Gjatë** natës ra shi pa pushim.

USHTRIME

1 Plotësoni fjalitë me parafjalët që mungojnë.

Sapo dola _____ shkolla. Do të shkoj _____ një shok për të mësuar. _____ një gur, s'bëhet mur. _____ oborrin _____ shkollës dëgjoheshin zhurmat e fëmijëve. Dy vajza vrapuan _____ meje. _____ rrugës ndodhej një ndërtesë e madhe.
(Fjalë ndihmëse: *nga, me, në, pas, para, matanë, te*)

2 Lexoni tekstin dhe nënvizoni parafjalët.

Një ditë, ne luajtëm me top lecke derisa u err, po të nesërmen, kur u ngritëm e shkuam në fushë, nuk e njohëm fushën tonë. Fërkonim sytë dhe vështronim. Ajo nxinte nga topat, nga makinat e çadrat. Nëpër fushë lëvrinin njerëz të panjohur. Ca ushtarë, me kapele hekuri në kokë, po rrethonin fushën me tela. Atje ku ne kishim portën ku luanim, fashistët kishin vendosur një rojë me pushkë.

3 Plotësoni parafjalët që mungojnë.

Ne luanim me top lecke _____ syve të rojës gjermane. Ai lëvizte _____ pushkë _____ krah _____ hyrje të fushës _____ tela. Bashkë _____ të bënte roje dhe një qen i madh, leshtor e _____ turi si të ujkut. _____ fillim, ne nuk ia dinim emrin qenit, por një ditë dëgjuam rojën që i thirri: "Gof!" Tomka ishte kryetari ynë dhe ne ia dëgjonim fjalën. Megjithëse nuk e kishim zgjedhur, prapë ai ishte komandanti ynë. Ne e donim të gjithë. Tomka ishte i drejtë, nuk mbante _____ hatër, s'gënjente kurrë dhe ne i besonim atij për shumë gjëra.
(Fjalë ndihmëse: *para, me, në*)

USHTRIME

4 Nënvizoni emrat që shoqërohen me parafjalë dhe përcaktoni rasën e tyre.

Nga gëzimi qau. Nga dita në ditë po ngrohet moti. Bari ishte njomur nga vesa e mëngjesit. Përmbi mal u dukën disa re të dendura. Fëmija ngazëllente duke vrapuar përmes livadhit. Rrezet që vinin lart nga hëna ndriçonin çatitë e shtëpive që bënin gjumin e natës. Fëmijët u larguan duke ecur me kujdes. Përtej bregut të zinte syri një tufë me dele që kullosnin barin e njomë.

5 Parafjalët e ushtrimit të mësipërm vendosini në tabelë sipas rasave përkatëse.

Parafjalë të rasës emërore	Parafjalë të rasës kallëzore	Parafjalë të rasës rrjedhore

6 Plotësoni parafjalën apo ndajfoljen që mungon *(pranë, para, me, drejt, nga, rreth).*

Ndajfolje	Parafjalë
I qëndroi _____ me vite.	_____ sobës qëndronte me sy të mbyllur macja.
Nxënësit i dolën _____ dhe e përqafuan.	_____ lule në dorë vrapoi drejt gjyshes.
Ai qëndronte _____ dhe nuk fliste asnjë fjalë.	Artani doli _____ shtëpia duke vrapuar.
Ata u bënë _____ dhe nisën të tregonin çfarë ndodhi.	U mblodhën _____ tavolinës dhe nisën të zgjidhin problemin.

7 Shënoni me P (parafjalë) ose me N (ndajfolje) për fjalët e nënvizuara në grupet e fjalëve më poshtë.

pas derës _____	erdhi rrotull ____	iu afrua pranë ____
pas darke _____	sipër çantës ____	rrotull shtëpisë_____
kalon përpara ____	gjatë udhës _____	i kaloi afër _____

8 Emrat *klasë, motër, nënë, makinë, mal* shoqërojini me parafjalët *nga, me, në, afër, nëpër* dhe më pas formoni fjali me çdo grup fjalësh.

_____

_____

_____

9 Rindërtoni fjalitë duke përdorur një parafjalë tjetër.

- Janë nisur sot për Prishtinë. → Janë nisur sot drejt Prishtinës.
- Shkoi me Edlirën për të blerë gazetën. → _____
- E kishte vendosur pa dashje sipër shtratit. → _____

20 Numërorët

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe nënvizoni numërorët.

Klasa jonë ka tridhjetë e një nxënës, gjashtëmbëdhjetë djem dhe pesëmbëdhjetë vajza. Ne ulemi nga dy veta në bankë dhe bëjmë katër, pesë ose gjashtë orë mësim në ditë. Një ditë e zakonshme kalon pa u ndier.

Mbani mend

Numërori tregon sasi të caktuar frymorësh ose sendesh, apo pjesë të sendeve. Ai përdoret:

- i shoqëruar me emra: *një flutur, tre djem, dymbëdhjetë metra;*
- i pashoqëruar me emra:
  9 + 3 = 12 (*në veprimet matematike*)
  Mësimi fillon në orën 8:00. (*për të treguar orën*)
  Pavarësia e Kosovës u shpall më 17 shkurt 2008. (*për të treguar datën*)
  Kam banuar në Pejë nga viti 2009-2017. (*për të treguar periudhë kohore*)
  Kam ecur 30 metra, pra kam bërë 50 për qind të rrugës. (*për të treguar përmasa ose përqindje*)

Kategoritë gramatikore të numërorit

Numërorët në përgjithësi nuk e kanë kategorinë e gjinisë.
Nga ky rregull bën përjashtim numërori tre, i cili e ka kategorinë e gjinisë:
pesë djem – pesë vajza
tre djem – tri vajza, por edhe tridhjetë e tre djem – tridhjetë e tri vajza

Nga rregulli i mësipërm bëjnë përjashtim edhe numërorët me kuptim përmbledhës:
Erdhën të dy djemtë. – Erdhën të dyja vajzat.
Morën pjesë të tre djemtë. – Morën pjesë të tria vajzat.

Thyesat Përveç numërorëve që shprehin numra të cilët janë njësi të plota, ka edhe numërorë të tjerë që shprehin numra të cilët nuk janë njësi të plota, por janë pjesë e një ose e disa njësive. Këta numërorë janë ata numra që në matematikë njihen si **thyesa**:

dy të pestat ($\frac{2}{5}$); një e teta ($\frac{1}{8}$); shtatë të dhjetat ($\frac{7}{10}$)

Thyesat dalin gjithmonë në gjininë femërore dhe lakohen në trajtën e shquar.

emërore	*tre të nëntat*
gjinore	*i, e tre të nëntave*
dhanore	*tre të nëntave*
kallëzore	*tre të nëntat*
rrjedhore	*(prej) tre të nëntave*

Emërzimi i numërorit Numërori, për të mos e përsëritur edhe një herë emrin e dhënë në fjali ose për të mos e përmendur atë, përdoret i emërzuar: *Dymbëdhjeta hyn te treshi katër herë. Rrënja katrore e katrës është dyshi. Jemi brezi i dymijës.*
Në këtë rast ai ka kategoritë gramatikore të gjinisë, numrit dhe rasës.

Kujdes

Fjalët që tregojnë radhë si: *i parë, i dytë, i dhjetë* etj., në matematikë quhen numra rendorë, ndërsa në gramatikë kanë funksionin e mbiemrave. Kjo është arsyeja që ata do t'i trajtojmë si mbiemra dhe jo si numërorë.

Drejtshkrimi i numërorit

Numërorët shkruhen edhe me shifra, edhe me fjalë.

Shkruhen njësh numërorët:

- zero, një, dy, tre, katër (*deri në dhjetë*);
- njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë... (*deri në nëntëmbëdhjetë*);
- tridhjetë, pesëdhjetë, gjashtëdhjetë, shtatëdhjetë etj.

Shkruhen ndaras numërorët:

- në formë shprehjeje, fjalët e të cilëve lidhen me **e**: *dyzet e shtatë, gjashtëdhjetë e tre, njëqind e dyzet, tetëdhjetë e nëntë* etj.

USHTRIME

1 **Gjeni numërorët dhe shpjegoni përse janë përdorur ata.**

Mos vallë duhet të qëndrojmë një çikë më shumë në këtë pikë? Populli, ose banorët e pallatit, shkuan pas plakës e jo pas Markut. Sa vjeçe ishte plaka?

– Rreth shtatëdhjetë, – u përgjigj hetuesi pak i hutuar.
– Po Marku?
– Pesëdhjetë e dy vjeç.
– Kë njihnin më shumë banorët e pallatit dhe të asaj rrugice, plakën apo Markun?
– Marku ka jetuar aty 25 vjet, kurse plaka tri vitet e fundit të jetës së saj.

Dh. Xhuvani

2 **Plotësoni grupet e mëposhtme me numërorin tre/tri. Mbani parasysh gjininë e emrave.**

_____ libra	_____ fletore	_____ stilolapsa
_____ nxënëse	_____ sportistë	_____ volejbolliste
_____ kuti	_____ gurë	_____ shkronja
_____ telefona	_____ shishe	_____ paragrafë

3 **Shkruani me fjalë dhe lakoni thyesat:**

$\frac{6}{6}, \frac{9}{3}, \frac{8}{2}, \frac{1}{7}, \frac{2}{5}, \frac{1}{2}, \frac{3}{8}, \frac{7}{7}, \frac{7}{9}, \frac{4}{5}, \frac{4}{12}, \frac{5}{15}, \frac{6}{12}, \frac{5}{2},$

_____

_____

4 **Shkruani me fjalë numërorët e mëposhtëm.**

65, 89, 119, 7, 98, 1993, 12, 17, 36, 52, 43, 99

_____

_____

Sintaksë


FJALIA
Sintaksa studion mënyrat si lidhen fjalët në grupe fjalësh, fjali dhe vetë fjalitë në mes tyre.
Gjymtyrët kryesore
Gjymtyrët e dyta
kryefjala
me emër
me grup emëror
me numëror
me përemër
kallëzuesi
emëror
foljor
i thjeshtë
i përbërë
përcaktori
me përshtatje
me drejtim
me bashkim
me ndajshtim
kundrinori
i drejtë
i zhdrejtë
me parafjalë
pa parafjalë
rrethanori
kohe
vendi
mënyre
sasie
shkaku
qëllimi

Teksti, paragrafi, fjalia, gjymtyra

Kujtojmë

- Mendimet tona i shprehim me fjalë të lidhura në fjali.
- Disa fjali të lidhura me njëra-tjetrën dhe që flasin për një ide të caktuar, krijojnë një paragraf.
- Një tekst përbëhet nga disa paragrafë.
- Paragrafi shpreh një mendim të plotë dhe të pavarur.
- Në çdo fjali dallojmë grupin emëror dhe grupin foljor.
- Fjalët në fjali quhen **gjymtyrë të fjalisë**.

Ushtrohemi

Përcaktoni paragrafët, fjalitë dhe gjymtyrët e fjalive në tekstin e mëposhtëm.

Kaloi vera dhe erdhi vjeshta. Kërcelli i trëndafilit lulëzonte dhe shpërndante përreth aromën e tij. Filloi të binte dëbora. Moti u bë krejt i lagësht dhe i ftohtë. Trëndafili u struk në tokë.

Erdhi përsëri pranvera, lulëzuan përsëri trëndafilat, doli jashtë edhe kërmilli ynë.

– Ju u plakët, – i tha ai rrënjës së trëndafilit. – Tani mjaft më! Ju i dhatë botës gjithë ç'mundët, se sa me vlerë qe kjo, është një çështje me të cilën nuk kam kohë të merrem. Por ama, është e qartë se ju nuk keni bërë asgjë për zhvillimin tuaj të brendshëm. Së shpejti do të katandiseni në një shkurre të thatë! A e kuptoni se ç'dua të them?

Funksionet e fjalëve në fjali

Fjalët në gjuhën shqipe analizohen edhe nga pikëpamja sintaksore dhe quhen **gjymtyrë**.



Fjalia

Fjalia është një bashkim fjalësh ose një fjalë e vetme që shpreh një kumtim.

Në përgjithësi të gjitha fjalitë kanë folje. *Stina e vjeshtës më pëlqen shumë.* Por, ka edhe fjali pa folje: *E bukur! Çfarë dite! Flokë kaçurrelë e sy të zinj. Ditë. Freskët. Borë e madhe.*

Kujtojmë



Fjalia e thjeshtë

Fjalia e thjeshtë ka vetëm një kallëzues të shprehur me folje.



Fjalia e thjeshtë e pazgjeruar ka dy gjymtyrë kryesore: kryefjalën dhe kallëzuesin. Fjalia e thjeshtë e zgjeruar, përveç gjymtyrëve kryesore (kryefjalë, kallëzues), ka edhe gjymtyrë plotësuese (përcaktorë, kundrinorë, rrethanorë).

Fjalia e përbërë

Quhet fjali e përbërë fjalia që ka më shumë se një kallëzues.

Gjymtyrët e fjalisë

Gjymtyrët e fjalisë ndahen në gjymtyrë kryesore dhe gjymtyrë të dyta (plotësuese).



USHTRIME

1 Dalloni fjalitë e thjeshta.

Marxhi psherëtiu. Ishte duke menduar kohët e vjetra. Atëherë gjyshi e stërgjyshi ishin fëmijë. Të gjithë djemtë dhe vajzat rreth e qark lagjes qeshnin me zë të lartë. Ata shkonin së bashku në shkollë. Ktheheshin në shtëpi së bashku. Mësonin të njëjtat gjëra. Kështu mund të ndihmonin njëri-tjetrin për të bërë detyrat. Ata mund të flisnin me njëri-tjetrin për ato që kishin për të studiuar.

2 Formoni fjali të thjeshta me grupet e fjalëve.

Kohë të shkuara...	
Mali me borë...	
Aspak e kënaqur...	
Gjysmë peshk, gjysmë njeri...	
Mesnatë...	

3 Përcaktoni llojin e fjalive: e thjeshtë (Th) apo e përbërë (P).

Kam shumë të reja për të të treguar. (____) Nuk di nëse do t'i quash të mira apo të këqija, por, sidoqoftë, janë krejt të reja. (____) Rita, me të cilën jam shoqëruar shumë këto kohët e fundit, ma mbushi mendjen të shpoja veshët. (____) Dhoma ime tani është krejt e ndryshme nga viti i kaluar. (____) Muri ka gjithmonë e më pak hapësirë të bardhë, pasi kam ngjitur disa vizatime të miat dhe lloj-lloj posterash nëpër të. (____) Bashkë me Lean, për karnavale, bleva një kuvertë krevati plot ngjyra. Ngjyrat të kujtojnë Indinë. (____)

4 Vendosni fjalën që mungon dhe tregoni çfarë lloj fjalie formohet.

Ndryshe nga unë, qeni Lukas sillet shumë mirë, _____ nëna ime, më në fund, u mësua me praninë e tij.
Mund të them ____ nëna ime mban rekord për t'u përshtatur me gjërat e reja.
Duket ____ risitë i shkaktojnë një pështjellim të madh.
Veç, _____ është fjala për modën, ndryshon puna.
_____ mbetet gjithmonë e vëmendshme dhe tregon kujdes për të qenë në orarin e caktuar.

(Fjalë lidhëse: se, aq sa, që, po qe se, kështu që.)

5 Tregoni llojet e fjalive. Nënvizoni me një vizë gjymtyrët kryesore (kryefjalë, kallëzues) dhe me dy viza gjymtyrët e dyta (përcaktor, rrethanor, kundrinor).

Aleksandri ishte djali më i qetë i gjithë lagjes dhe i shkollës. (_____) Në shkollë ai ulej në bankë i qetë dhe fiksonte me sytë e tij kureshtarë gjithçka thoshte dhe tregonte mësuesi. (_____) Ishte shembull për të gjithë klasën. (_____) Në fletoret e tij nuk kishte asnjë shënim me ngjyrë të kuqe nga mësuesi.(_____) Në dallim nga të tjerët, të gjitha fletët e fletoreve të tij kishte shënimin "shumë mirë" apo notën dhjetë. (_____) Ai dallonte në të gjitha detyrat e tij.(_____)

2 Përbërësit e fjalisë së thjeshtë

Grupi emëror (i kryefjalës) dhe grupi foljor (i kallëzuesit)

Grupi emëror dhe grupi foljor i fjalisë

- Vëreni figurat dhe shkruani nga një fjali për secilën.

- Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe nënvizoni me një vizë grupin emëror dhe me dy viza grupin foljor.

Një grup fëmijësh të vegjël udhëtoi me avion për në Paris.
Ata dhe mësuesit e tyre vizituan shumë vende historike.
Kulla Eifel u pëlqeu shumë fëmijëve nga Shqipëria.

- Provoni të hiqni sa më shumë fjalë nga grupi emëror dhe nga grupi foljor pa ua prishur kuptimin. Gjeni fjalinë më të shkurtër.

Fjalia më e shkurtër

Fjalia më e shkurtër

Fjalia e plotë	Fjalia më e shkurtër
Një grup fëmijësh të vegjël udhëtoi me avion për në Paris.	*Një grup fëmijësh udhëtoi me avion për në Paris.* *Një grup udhëtoi me avion.* *Një grup udhëtoi.*
Ata dhe mësuesit e tyre vizituan shumë vende historike.	*Ata dhe mësuesit vizituan shumë vende historike.* *Ata dhe mësuesit vizituan shumë vende.* *Ata vizituan shumë vende.* *Ata vizituan vende.* *Ata vizituan.*
Kulla Eifel u pëlqeu shumë fëmijëve nga Shqipëria.	*Kulla Eifel u pëlqeu shumë fëmijëve nga Shqipëria.* *Kulla Eifel u pëlqeu shumë fëmijëve.* *Kulla Eifel u pëlqeu shumë.* *Kulla Eifel u pëlqeu.* *Kulla u pëlqeu.*

- Cilat fjalë mbeten në fjalinë më të shkurtër? Kryefjala? Kallëzuesi (folja)?
- A ka fjali pa kryefjalë?
- A ka fjali pa kallëzues?
- Kryefjala apo kallëzuesi (folja), a mund të nënkuptohen, kur nuk janë të shprehur në fjali?

Grupet e fjalëve në fjali

Fjalia e thjeshtë përbëhet nga dy grupe themelore:

GE	GF
grupi emëror	*grupi foljor*
grupi i kryefjalës	grupi i kallëzuesit

Një grup fëmijësh të vegjël	*udhëtoi me avion për në Paris.*

Fjalët **grup** dhe **udhëtoi** janë fjalë bërthamë në fjali.

Fjalët plotësuese të grupit emëror ose të grupit foljor mund **të hiqen** ose **të shtohen.**

Grupi emëror i kryefjalës

Grupi emëror i kryefjalës

Emri është bërthamë e grupit emëror të kryefjalës. Ky grup ndërtohet:

(Bërthama) emër +

- emër — *grup fëmijësh*
- mbiemër — *fëmijët e vegjël*
- përemër — *ata fëmijë*
- numëror — *një fëmijë*

Në përgjithësi, **emri** është **bërthama e grupit emëror**: ***Shtëpia*** *e re e vëllait.*

Fjalët që përcaktojnë bërthamën e grupit emëror mund të jenë emra me ose pa parafjalë të rasës gjinore ose rrjedhore, mbiemra, përemra ose numërorë.

Grupi foljor i kallëzuesit

Grupi foljor i kallëzuesit

Folja është bërthamë e grupit foljor. Ky grup ndërtohet:

(Bërthama) folje +

- kundrinor i drejtë — *Mori dëftesën.*
- kundrinor i zhdrejtë — *U tha shokëve.*
- rrethanorë të ndryshëm — *Eci shpejt.*
- kallëzuesor — *Fliste i qetë.*

Kryefjala dhe kallëzuesi, si njësi bazë të fjalisë, formojnë bërthamën e saj: *Kulla u pëlqeu.*

USHTRIME

1 Zvogëloni grupet emërore dhe grupet foljore në fjalitë e mëposhtme.

Nata hedh gunën e zezë mbi qytetin e stërmadh. Dritat e shtëpive po shuhen njëra pas tjetrës. Në një dhomë, buzë një rrugice të ngushtë, ato ndrijnë ende. Një burrë shkruan mbi një tavolinë të vogël mbushur me letra. Drita e paktë e kandilit lëshon hije mbi to. Rrjedhin fjalët njëra pas tjetrës si uji i rrëkeve të vendit të tij.

2 Gjeni grupet emërore dhe grupet foljore në çdo fjali. Vendosini në tabelë.

Në kohët e lashta, një princ i pashëm nga Troja, Paridi, arriti në Spartë. Në Spartë mbretëronte Menelau, i shoqi i gruas më të bukur të botës, Helenës. Menelau e pranoi me kënaqësi në pallatin e vet Paridin e hijshëm. Ndërkohë, atij i doli një punë e ngutshme.

Grup emëror	Grup foljor

3 Ndërtoni fjali të thjeshta duke zgjeruar grupin emëror (të kryefjalës) dhe grupin foljor (të kallëzuesit).

Deti është i bukur.	Prishtina ka ndryshuar.	Mjedisi duhet mbrojtur.
Deti Jon është shumë i bukur. Pamja e detit Jon është shumë më e bukur se e detit Adriatik.		

4 Shkruani fjali duke i zgjeruar fjalët e mëposhtme me grupe emërore të kryefjalës.

mbrëmje të bukura _____

gjimnastika _____

5 Plotësoni fjalitë me fjalët që mungojnë: *gazetarët, pronarët, u bë, u përhap, lajmi, jetonte, filluan të dalin në.*

_____ se një qen _____milioner papritur e pa kujtuar, _____ nëpër qytet me shpejtësinë e erës. Te gardhi i vilës ku _____ Topi prej Bore, vërshuan _____. _____ _____ e qenit të pasur _____ faqet e gazetave dhe ekranet e televizioneve.

6 Plotësoni grupet foljore që mungojnë.

Shokët e mi të kursit _____

Lulet e mimozës _____

Plaku i Vitit të Ri _____

Nëna ime e dashur _____

Këngëtarja e famshme _____

Kënga e re e _____

Fjalia foljore dhe fjalia jofoljore

3

Lexoni tekstin e mëposhtëm. Nënvizoni foljet në fjalitë me ngjyrë të kuqe. Çfarë vini re?

Gjithçka e tij ishte e bardhë. Edhe mjekra. Edhe mustaqet. Edhe flokët. Edhe plisi. Edhe tufa e deleve. Edhe shtëpiza… Edhe…
Por më e bardhë ndër të gjitha, ishte zemra e tij.
Vërtet atë nuk ia kishte parë askush. Por tjetër zemër nuk mund të kishte ai, i cili tërë jetën ishte përpjekur që çdo gjë rreth tij të ishte e bardhë si qumështi që milnin për drekën baritore.
Prandaj e quanin të gjithë Plaku Zemërbardhë, kurse emrin e tij të vërtetë shumë fëmijë nuk e dinin.

Arif Demolli

Gjatës punës me tekstin e mësipërm ju vutë re se disa fjali janë me folje dhe disa fjali të tjera janë pa folje.

Fjali me folje:

Gjithçka e tij ishte e bardhë.
Vërtet atë nuk ia kishte parë askush.
Prandaj e quanin të gjithë Plaku Zemërbardhë, kurse emrin e tij të vërtetë shumë fëmijë nuk e dinin.

Fjali pa folje:

Edhe mjekra.
Edhe mustaqet.
Edhe flokët.
Edhe plisi.
Edhe tufa e deleve.

Fjalitë jofoljore përdoren si në gjuhën e folur, ashtu edhe në gjuhën e shkruar. Për ta kuptuar qartësisht një fjali jofoljore, duhet njohur edhe konteksti apo situata e komunikimit në të cilën ajo është përdorur.

Mbani mend

Fjalia foljore ndërtohet rreth një grupi foljor, të cilin zakonisht e shoqëron edhe një grup emëror.
Fjalia jofoljore përmban një ose disa fjalë, por asnjëra prej tyre nuk është folje.

USHTRIME

1 **Në tekstin e mëposhtëm gjeni fjalitë foljore dhe fjalitë jofoljore.**

Kur u ktheva në shtëpi, babanë dhe xhaxhanë i gjeta rreth oxhakut. Dukej se bisedonin diçka të rëndësishme. Thashë: – Hajt t'i dëgjoj, mos po flasin për Plakun Zemërbardhë. U ula në një kënd tërë sy e veshë.
– Kujt i kishte shkuar mendja tek ai?! – thoshte babai. – Atë as e thirrën në mbledhje! Plak i mbetur! Pa fëmijë dhe nipa për shkollë! Njeri që fort rrallë e sheh midis burrash, që pothuaj tërë jetën e ka kaluar pas deleve dhe me kalamajtë! Ja, mu ai, nga i cili s'është pritur asgjë, të ngrihet dhe të thotë: "Burra, unë po e lëshoj odën time për fëmijët. Ato dy vajza që pata, i martova. Tani vetëm me plakën jam. Mundem edhe pa të. Le të hapet shkolla, le të ndritë mendja e fëmijëve, të cilët i dua si të ishin të mitë".

Arif Demolli

2 **Në pjesën e leximit me titull "Udhëve të fëmijërisë" gjeni fjalitë jofoljore.**

3 **Shkruani një tekst të shkurtër rreth miqësisë në të cilin të përdorni rreth pesë fjali jofoljore.**

4 Fjalia dëftore dhe fjalia pyetëse

Llojet e fjalive sipas kumtimit

Sipas kumtimit, pra sipas asaj që shprehin e transmetojnë, fjalitë klasifikohen në:

- fjali dëftore
- fjali pyetëse
- fjali dëshirore
- fjali nxitëse

Shikoni figurat dhe shkruani përgjigjen për secilën nga pyetjet poshtë tyre.

Çfarë po bëjnë fëmijët?

_____

Çfarë kupton nga kjo fotografi?

_____

Kush e fiton garën?

_____

Pyetjet poshtë fotografive, janë fjali pyetëse.
Përgjigjet që shkruat, janë fjali dëftore.

Fjalia dëftore

Fjalitë dëftore janë fjalitë që përdoren më shpesh në ligjërimin e përditshëm. Me anë të tyre shprehim informacione, mendime, arsyetime apo përshkrime. Ato zënë shumë vend edhe në letërsi, dhe shkencë. Në fund të këtyre fjalive intonacioni është zbritës, pra toni i zërit vjen duke u ulur. Përgjithësisht ndërtohen me folje të mënyrës dëftore.

Fjalia pyetëse

Fjalitë pyetëse përdoren nga folësi kur kërkon të mësojë nga bashkëbiseduesi diçka që nuk e di. Dallojmë dy lloj fjalish pyetëse:

- Fjali pyetëse tërësore, që kërkojnë një përgjigje me ***po*** ose ***jo***.
  - Ishe sot në shkollë?
  - Po.
- Fjali pyetëse të pjesshme, që kërkojnë një përgjigje të pasur me informacion.
  - Kur mund të kthehesh?
  - Ditën e enjte.

Mbani mend

Fjalitë me të cilat tregojmë diçka, janë ***fjali dëftore***. Ato fillojnë me shkronjë të madhe dhe mbarojnë me pikë (.).
Fjalitë me të cilat pyesim për diçka, janë ***fjali pyetëse***. Ato fillojnë me shkronjë të madhe dhe mbarojnë me pikëpyetje (?).

USHTRIME

1 **Nënvizo me ngjyrë blu fjalitë dëftore dhe me ngjyrë të kuqe fjalitë pyetëse.**

Orë gjeografie. Marr globin në dorë. U flas.
– Po Shqipnia ku asht? – pyesin dy-tri veta, e tjerët i ngrehin qafat që të shohin më mirë.
– Kur ua dëftoj shejin: nji pikë e kuqe në mes të ngjyrave të tjera, dëgjohen zane të pakënaquna, disi të shqetësueme:
– Sa e vogël...
– E vocërr, e vocërr, me mëzi shifet…
– Posi Zotni, kaq e vocërr Shqipnia? – çohet njeni tue kundërshtue me dorë.
Vërej shpirtet e vegjël të shqetësuem, pse atdheu i tyne kaq i madh – si u duket atyne në natyrë – asht vizatue aq i vogël dhe mendojnë se asht gabim. E dij se nesër Shqipnia në glob ka me u rritë, ka me u ba kushedi sa e madhe prej dorës së ndonjenit nga shqipot e klasës.

Migjeni

2 **Fjalitë e mëposhtme kanë të njëjtat fjalë. Ku ndryshojnë ato? Lexojini, duke përdorur intonacionin e duhur.**

Erdhi Ina nga pushimet.	Erdhi Ina nga pushimet?
Hyri mësuesja në klasë.	Hyri mësuesja në klasë?

Shkruani tri fjali dëftore dhe më pas kthejini në pyetëse.

3 **Vendosni shenjat e pikësimit në fund të fjalive.**

*Në këtë fshat të vogël kishte disa dyqane_ Ata ishin akoma hapur_ Përkundrejt portës së Tenardjeve ishte një dyqan lodrash për fëmijë_ Tregtari kishte vënë në radhën e parë të vitrinës një kukull të madhe, veshur me rroba bojë trëndafili, me tirtir bojë ari në kokë_*
*Kishte flokë të vërtetë dhe sy prej smalti. Të gjithë fëmijët e fshatit qëndronin tërë ditën përpara dritares duke vështruar atë kukull_ Vajzat e Tenardjesë, Eponina dhe Alzelma, orë me radhë kishin qëndruar përpara dyqanit_*

V. Hygo

4 **Ndërtoni fjalitë pyetëse, përgjigjet e të cilave janë fjalitë me shkronja të kuqe të ushtrimit 3.**

5 **Vendosni shenjat e pikësimit në fund të fjalive.**

- Bija ime, a është e rëndë për ta kjo kovë_
- Po, zotni, - iu përgjigj Kozeta_
- Lëshoje se e mbaj unë_ E ke larg shtëpinë_
- Një çerek ore prej këtej_
- A ke nënë ti_
- Nuk e di, - u përgjigj fëmija, - s'e besoj_ Fëmijët e tjerë kanë nënë_ Unë s'kam_

6 **Formoni fjali pyetëse që fillojnë me fjalët: *cili, ku, si, çfarë, kur*. Shkruani përgjigjet për pyetjet e formuara.**

7 **Shkruani tri pyetje për figurën e mëposhtme dhe nga një përgjigje për secilën prej tyre.**

5

Fjalia dëshirore dhe fjalia nxitëse

Ah sikur të ishte kohë e bukur!

Bie shi.

Po tani, çfarë do të bëjmë?

Eja të vizatojmë së bashku.

Mbani mend

Fjalitë nëpërmjet të cilave folësi shpreh një dëshirë, një urim a një mallkim, janë fjali dëshirore. Ato fillojnë me shkronjë të madhe dhe mbarojnë me pikëçuditje (!).

Ah sikur të ishte kohë e bukur!
U bëfsh 100 vjeç!
Mos dalsh për dy ditë nga shtëpia!

Fjalitë nëpërmjet të cilave folësi shpreh një kështillë, një lutje, një ftesë, një propozim, janë fjali nxitëse. Ato fillojnë me shkronjë të madhe dhe mbarojnë me pikë (.).

Mos qëndro shumë para televizorit.
Të lutem eja me mua.
Eja të vizatojmë së bashku.

Mendoj që nesër të shkojmë në det.

Kujdes

Fjalitë dëftore, pyetëse, dëshirore dhe nxitëse, kur shprehin habi, kënaqësi, keqardhje dhe zemërim mbarojnë me pikëçuditje (!). Për shkak të intonacionit ngjitës që përdoret në këto raste, ato quhen fjali thirrmore.

USHTRIME

1 **Plotësoni urimet:**

U bëfsh_____ Qofsh_____
Kalofsh _____ Plotësofsh _____
E gëzofsh _____ Marrsh _____

2 **Plotësoni kështillat:**

Qëndroni_____ Besoni_____
Mbani _____ Luani _____
Përqendrohuni _____ Vështroni _____

3 **Shkruani një tekst të shkurtër në të cilin të përdorni fjali dëshirore për të shprehur dëshirat apo urimet tuaja.**

4 **Shkruani një tekst të shkurtër në të cilin të përdorni fjali nxitëse për të shprehur kështillat apo propozimet tuaja.**

Format pohore dhe mohore të fjalive

6

Zogjtë qëndruan mbi degën e pemës.

Ata fluturuan në qiell.

Zogjtë nuk qëndruan mbi degën e pemës.

Mbani mend

Fjalia në të cilën pohohet diçka, ka formë pohore. Në të pohohet një realitet ose tregohet prania e diçkaje. Fjalia në të cilën mohohet diçka, ka formë mohore. Në të mohohet një realitet ose tregohet mungesa e diçkaje. Sa herë që fjalia përdoret në formën mohore vihet re përdorimi i fjalëve me kuptim mohor: nuk, s', mos, as, pa, jo etj.

Kujdes

Forma pohore e fjalive dallohet për praninë e fjalëve: ***gjithandej, të gjithë, gjithkund*** etj., forma mohore e fjalive ka në përbërjen e saj fjalë, si: ***askush***, ***asnjeri, askund*** etj.

Vini re! Mos ngatërroni fjalinë dëftore me fjalinë pohore. Marrim në shqyrtim fjalitë e mësipërme.

- *Zogjtë qëndruan mbi degën e pemës.*
- *Zogjtë nuk qëndruan mbi degën e pemës.*

Të dyja këto fjali janë dëftore. Fjalia e parë tregon këtë fakt: *praninë e zogjve mbi degën e pemës.* Për këtë arsye, ajo është në formën pohore. Kurse fjalia e dytë tregon faktin që i kundërvihet faktit të shprehur në fjalinë e parë: *mungesën e zogjve mbi degën e pemës.* Për këtë arsye, ajo është në formën mohore. Në këtë rast, këto dy fjali dallojnë vetëm nga përdorimi i pjesëzës **nuk** në fjalinë e dytë.

USHTRIME

1 **Nënvizoni me një vijë fjalitë në formën pohore dhe me dy vija fjalitë në formën mohore.**

Ajo çka, në vend që të më mundonte, më mahniste gjithmonë, sa herë që takoja Lasgush Poradecin, ishte ndjesia e së pamundurës. Porsa hyje tek ai, madje porsa trokisje në portë, aty për aty gjithçka tjetërsohej. Tjetër logjikë në të biseduar, tjetër kod, të tjera fjalë, të mbështjella me kuptim tjetër. Diçka mungonte përherë, e diçka qe e tepërt. Më e habitshmja ishte se ty të pëlqente kjo. Nuk doje aspak që të prishej kjo magji, ashtu si nuk doje që fjalëve që thuheshin t'u ikte dysia, velloja me të cilën sapo ishin mbështjellë... Një njeriu meskin do t'i dukej i krisur, një tjetër mund të mendonte se atë mjegullirë ia krijonte pleqëria. Por s'ishte as e para, as e dyta.

Ismail Kadare

2 **Shndërroni fjalitë pohore në mohore dhe anasjellas.**

Jehona shkon çdo ditë në stërvitjen e grupit të volejbollit.
Nxënësit pasuruan me shumë tituj të rinj bibliotekën e klasës.
Kreshnikut nuk i pëlqen të shkojë në teatër.
Djali i vogël mësoi më shpejt nga sa pritej të luante shah.

3 **Krijoni pesë fjali pohore dhe shndërroji ato në fjali mohore.**

7

Fjalia e përbërë

Lexoni fjalitë e mëposhtme. Thoni nëse janë fjali të thjeshta apo të përbëra.

Beni pëlqen vallëzimin, kurse Agimi pëlqen poezinë.
Fëmijët vrapuan drejt detit sapo dielli me rrezet e tij të nxehta u ngrit lart në qiell.

Mbani mend

Fjalia e përbërë ndërtohet nga dy ose më shumë pjesë fjalie të lidhura bashkë.
Ajo ka dy ose më shumë kallëzues.

Lidhjet e pjesëve në fjalinë e përbërë mund të jenë:
- me bashkërenditje;
- me nënrenditje.

Fjalia e përbërë me bashkërenditje

Fjalia e përbërë me bashkërenditje

Pjesët e fjalisë së përbërë me bashkërenditje lidhen midis tyre me lidhëza bashkërenditëse. P.sh.:
*Frynte erë **dhe** njerëzit nxitonin.*
*Atë këngë nuk ua mësuan mësuesit, **por** e këndonin të gjithë.*

Llojet e fjalive të përbëra me bashkërenditje

Fjalia e përbërë me bashkërenditje shtuese

Pjesët e fjalisë lidhen me lidhëzat bashkërenditëse shtuese:
e, edhe, as, edhe… edhe, as... as, jo vetëm... por edhe etj., të cilat i shtojnë pjesë njëra-tjetrës. *Tregimi jo vetëm më preku, por edhe më entuziazmoi.*

Fjalia e përbërë me bashkërenditje veçuese

Pjesët e fjalisë lidhen me lidhëzat bashkërenditëse veçuese: *ose, o, apo, ose… ose etj.*, të cilat përjashtojnë njëra-tjetrën. *Ose më kërko falje, ose do t'i tregoj mamit.*

Fjalia e përbërë me bashkërenditje kundërshtuese

Pjesët përbërëse të saj lidhen me lidhëzat bashkërenditëse kundërshtuese: *por, kurse, mirëpo, megjithatë etj.*, ku e dyta kundërshton të parën. *Ne udhëtuan me avion, kurse ata u nisën me traget.*

Fjalia e përbërë me bashkërenditje përmbyllëse

Pjesët përbërëse të saj lidhen me lidhëzat bashkërenditëse përmbyllëse: *andaj, pra, prandaj*, ku e dyta jep përmbylljen e kuptimit të fjalisë.
Tea u stërvit shumë, prandaj fitoi medaljen.

Fjalia e përbërë me nënrenditje

Fjalia e përbërë me nënrenditje

Fjalia e përbërë me nënrenditje përbëhet nga dy ose më shumë pjesë. Njëra pjesë e fjalisë së përbërë është pjesë kryesore dhe tjetra e varur (e nënrenditur) nga kryesorja.

Sapo dilja nga shtëpia në mëngjes, vrapoja drejt shkollës.



Analizojmë fjalitë e mëposhtme:

Nxënësit prisnin me ankth, sepse do të dilnin rezultatet e provimit.
Nxënësit prisnin me ankth rezultatin, që dëshironin në provim.

Në shembullin e parë, pjesa e nënrenditur ***sepse do të dilnin rezultatet e provimit*** varet nga pjesa kryesore e fjalisë së përbërë: ***Nxënësit prisnin me ankth.***
Në shembullin e dytë, pjesa e nënrenditur ***që dëshironin në provim*** varet nga një gjymtyrë e pjesës kryesore të fjalisë së përbërë: ***Nxënësit prisnin me ankth rezultatin***.



Pjesët e fjalive të përbëra

Në fjalitë e përbëra, pjesët e fjalisë mund të jenë:

- *të bashkërenditura;*
- *të nënrenditura (të varura).*



Llojet e fjalive të përbëra me nënrenditje

Në fjalinë e përbërë me nënrenditje, pjesa e varur lidhet me pjesën kryesore me anë të lidhëzave nënrenditëse (sipas llojeve) ose me anë të fjalëve lidhëse.

Fjalitë e përbëra të nënrenditura sipas llojeve janë:

ftilluese	*Dihej se **ai** do ta fitonte garën.*
përcaktore	*Ngjarja **që** ndodhi dje, ishte e papritur.*
kohore	*Ajo doli **nga** klasa kur e thirri mësuesja.*
vendore	***Ku** ka zemër, ka krahë.*
shkakore	*U kënaq **se** njerëzit nuk e kishin harruar.*
qëllimore	*U lodhën shumë, **me qëllim që** të përfundonin punën brenda natës.*
mënyrore	*Ai fliste lirshëm **si** të ishte në shtëpinë e tij.*
kushtore	***Në** doni të shkoj, më lejoni ta mbyll këtu këtë bisedë.*
rrjedhimore	*Trafiku ishte shumë i ngarkuar, **kështu që** e humbi avionin atë ditë.*
lejore	*Ata arritën në kohë, **edhe pse** rruga ishte e paasfaltuar.*

USHTRIME

1 **Lidhini pjesët e fjalive. Tregoni çfarë fjalish janë (me bashkërenditje/me nënrenditje).**

Entela vendosi	se do të vihej në skenë ai teatër. _____
Ajo kishte dëgjuar	të mësonte patjetër një gjuhë të huaj. _____
Ardi është nxënës i klasë së gjashtë	dhe po shkon në kursin e anglishtes_____
Meri di dy gjuhë të huaja	dhe di gjuhë të huaja. _____

2 **Shënoni me ✓ llojin e fjalisë.**

	E thjeshtë	E përbërë
Dardi dhe Fluturushja vraponin për te fëmijët.	☐	☐
Do të luanin futboll dhe do të bënin gara vrapimi.	☐	☐
Fluturushja do të merrte pjesë në sfilatën e modës.	☐	☐
Pas tyre vinin gjyshi dhe dy vizitorët e huaj.	☐	☐

3 **Plotësoni fjalitë. Ndiqni modelin.**

- Unë u frikësova dhe u zgjova papritur.
- Ai kujtonte historitë e gjyshes, prandaj _____
- Ajo tregonte se si _____
- Kur i kujtoj ato histori, _____

4 **Shndërroni fjalitë me bashkërenditje në fjali me nënrenditje.**

- Këto lule janë shumë delikate e vyshken shumë shpejt.
- Vajzat mësonin së bashku e këndonin të gëzuara këngë.
- I lexoj me dëshirë tregimet me vizatime, por argëtohem edhe me librat me aventura.
- Skënderbeu ishte një luftëtar i madh, prandaj fitoi shumë beteja.

5 **Provoni të zgjeroni me një pjesë të nënrenditur fjalitë e mëposhtme.**

- Që fëmijë, më pëlqente të luaja me top. (sepse)
- Skuadra e Korçës këtë vit mund të fitojë kampionatin. (sepse)
- Nga dritarja e hapur hyri një i ftohtë i madh. (i cili)
- Dëgjova koncertin e një flautisti të famshëm. (të cilin)

6 **Fjalitë e përbëra me nënrenditje shndërrojini në fjali të përbëra me bashkërenditje.**

a) Meqë jashtë bën shumë ftohtë, më duhet të vesh pallton.

b) Që ta shohim ndeshjen e futbollit, duhet shkuar në stadium shumë shpejt.

c) Kur të piqet mirë keku, fike furrën.

7 **Bëni një përshkrim natyre, në të cilin të përdorni sa më shumë fjali të përbëra, me bashkërenditje dhe me nënrenditje.**

_____

_____

_____

Kryefjala

- Për secilën nga figurat ndërtoni nga një fjali pyetëse që të fillojë me fjalën pyetëse *kush*?

Kryefjala është gjymtyrë kryesore e fjalisë që tregon kush, cili, cilët, kryejnë një veprim.

Për të gjetur kryefjalën, i bëjmë kallëzuesit pyetjet: **Kush?** (për njerëzit) **Cili?**

Pyetje për të gjetur kryefjalën

Fjalia	Pyetja	Përgjigjja
Kjo pikturë është një magji.	Cila është magji?	
Fëmijët janë yjet e shkollës.	Cilët janë yjet e shkollës?	
Gjethet e pemëve qenë tharë.	Cilat qenë tharë?	
Dy piktura më pëlqyen shumë.	Cilat më pëlqyen?	
Fëmija është dashuria më e madhe për prindin.	Kush është dashuria më e madhe?	
Xhaxhi Vili na solli ca libra të bukur.	Kush na solli libra?	

Mbani mend

Kryefjala mund të shprehet:

- me një emër, zakonisht në trajtën e shquar, në rasën emërore, në njëjës ose në shumës: ***Tirana*** *është kryeqyteti i Shqipërisë.*
- me një përemër: ***Ai*** *është një qytet modern.*
- me një grup emëror, me gjymtyrë homogjene: ***Pamja dhe gjallëria*** *e bëjnë atë një qytet evropian.*
- me numëror: ***Dhjeta*** *është dyfishi i pesës.*

Kryefjala dhe grupi që e shoqëron, formojnë grupin emëror në fjali.

Zëri i saj i lartë *kumbonte fuqishëm në auditor.*
Flokët e tij të zinj *kishin një shkëlqim të veçantë.*

Kryefjala qëndron në krye të fjalisë, para foljes, por mund të qëndrojë edhe pas saj. P.sh.: *Çantën e mori nga makina Ardi.* (kryefjala është fjala *Ardi*)

USHTRIME

1 Nënvizoni kryefjalën në fjalitë e mëposhtme.

Një natë prej netësh shpërtheu një furtunë e madhe. Shiu u derdh me kova. Qielli u ndez nga vetëtimat. Bubullimat tundën dheun. Atë çast, papritur dhe pa kujtuar, në mes të kiametit, dikush trokiti në derë. Mbreti plak u ngrit çalë-çalë dhe vajti e hapi portën. Para portës kishte qëndruar një princeshë.

2 Përgjigjuni pyetjeve me fjali të plota. Nënvizoni kryefjalën.

Kush e ka shkruar romanin "Kronikë në gur"? _____
Cili është filmi i fundit që keni parë? _____
Cila lëndë është më e vështirë për ju? _____
Cili është këngëtari më i suksesshëm i kohës? _____
Cili sport ju pëlqen më shumë? _____

3 Zëvendësoni kryefjalën me një përemër vetor.

Trima për kokën e trimave ishin Muji dhe Halili. Trimat kishin mbushur tërë krahinën e Kralisë me bujën e bëmave të tyre. Gjeto Basho Muji kishte lënë shtatë bij bjeshkëve. Të gjithë ishin djem të njomë. Jutbina u këndonte trimëritë. Bijtë e Mujit kishin luftuar e kishin vdekur si kreshnikë, për të mbrojtur dheun e tyre.

4 Formoni fjali duke përdorur si kryefjalë fjalët:

kjo lagje, pallati i ri i kulturës, të tërë, shkolla ime, matematika dhe fizika, mami dhe babi, motra dhe vëllai.

5 Vendosni kryefjalën pas kallëzuesit në fjalitë e mëposhtme.

Momenti i ndarjes së dhuratave erdhi shpejt. _____
Fëmijët iu afruan pemës dhe nisën të merrnin dhuratat. _____
Për pak minuta, ata pothuajse e zhveshën fare pemën e Vitit të Ri. _____
Ata, të gëzuar dhe të lumtur, me dhurata në duar nisën të largoheshin . _____
Të gjithë e harruan bredhin. _____

6 Në tre paragrafët e parë të pjesës "Provimi", kërkoni dhe gjeni kryefjalët. Thoni me se janë shprehur.

7 Qarkoni në tabelë fjalët që janë kryefjalë në fjalitë e ushtrimit numër 5. Shkruajini ato.

_____
_____
_____
_____
_____

			M	D	T	
			O	H	Ë	
			M	U	GJ	
			E	R	I	
			N	T	T	
		A	T	A	H	
F	Ë	M	I	J	Ë	T

Kallëzuesi

Formoni fjali duke u mbështetur në figurën në krah. Tregoni çfarë bën çdo nxënës. Nënvizoni foljet.

_____

_____

_____

Kallëzuesi është gjymtyrë kryesore e fjalisë dhe tregon një veprim apo një gjendje të kryefjalës.

Llojet e kallëzuesit



Kallëzuesi emëror	Kallëzuesi foljor
Shprehet nga folja jam + një emër, mbiemër, përemër, grup emëror.	Shprehet **me folje.**
Shembuj: Dritarja ishte e mbyllur. Ata ishin nxënës. Të gjitha ishin të sajat. Agroni ishte i pari i klasës.	*Shembuj: Ata po përshkruanin natyrën. Fëmijët kishin kaluar ditë të veçanta me gjyshërit.*

Kallëzuesi foljor mund të jetë i thjeshtë ose i përbërë.

Kallëzuesi foljor i thjeshtë	Kallëzuesi foljor i përbërë
Përbëhet nga një folje në të gjitha kohët, mënyrat, format, vetat.	Formohet nga dy pjesë, pjesa e parë e të cilave është folje gjysmëndihmëse dhe tregon një mënyrë veprimi, kurse pjesa e dytë tregon veprimin e shprehur me folje në lidhore ose me emër foljor asnjanës.
Shembuj: Sa shumë njerëz kishin ardhur atë ditë! Ajo mori në krah foshnjën dhe doli në oborr. Kënga e saj është dëgjuar shumë larg.	*Shembuj:* ***fillim:*** *zuri të fliste, nisi të ecte;* ***vazhdim:*** *vazhdoi të vraponte, vazhdon të shkreptijë;* ***mbarim:*** *mbaroi së lexuari, s'pushonte së qeshuri;* ***domosdoshmëri:*** *duhet të shkojmë, duhet ta gjejmë;* ***mundësi:*** *mund ta kishin gjetur, mund të luajë.*

Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën

Foljet që tregojnë *fillim, vazhdim, mbarim, domosdoshmëri, mundësi* etj., quhen **folje gjysmëndihmëse:** *do, zë, filloj, nis, vazhdoj, mbaroj, mund, duhet* etj.
Kallëzuesi përshtatet me kryefjalën në vetë dhe në numër.
Atij i qeshën sytë. Folja ***qeshën*** është në vetën e tretë, numri shumës (sytë – ata).
Kur ndryshojmë vetën dhe numrin, kemi: *Ai qeshi. Unë qesha. Ne qeshëm.*

USHTRIME

1 Nënvizoni kallëzuesit.

Disa vjet më parë, në një vend larg nga këtu, po organizoheshin garat e aeronautikës. Merrnin pjesë aeronautë nga shumë vende të botës. Bobi ishte një i tillë. Ai vinte nga Amerika. Bobi kishte marrë pjesë në shumë gara të tilla, kishte fituar edhe shumë medalje dhe tituj. Tashmë ishte bërë kampion bote në këtë sport të ri dhe shumë të pëlqyer. Në qiell po fluturonin shumë aeronautë nga e gjithë bota. Mes tyre ishte edhe Bobi, i cili bënte lëvizje dhe figura mahnitëse.

2 Formoni fjali me foljet *nis, zë,* duke i përdorur foljet një herë si pjesë të kallëzuesit të përbërë dhe një herë si kallëzues i thjeshtë foljor.

P.sh.: a) *Filmi* ***filloi*** *menjëherë pas lajmeve.* b) *Arba* ***filloi*** *të fliste pa pushim.*

Kallëzues të thjeshtë	Kallëzues të përbërë

3 Shkruani nga dy fjali për çdo figurë dhe nënvizoni kallëzuesit.

4 Ktheni kallëzuesit emërorë në kallëzues foljorë.

Fjali me kallëzues emërorë	Fjali me kallëzues foljorë
Pushimet ishin në prag. (jam + emër)	Pushimet erdhën.
Fëmijët ishin të gëzuar. (jam + mbiemër)	
Djali ishte brisk nga goja. (jam + grup emëror)	

5 Bashkoni pjesët e fjalëve të urta dhe gjeni grupet foljore. Dalloni llojet e kallëzuesve.

Me një ka	*vlen sa një thesar.*
Me një tra	*nuk mban shtëpia.*
Miku i mirë	*nuk përzihet në hallet e shtëpisë.*
Miku është mik kur	*nuk bëhen pendë.*

6 Në pjesën e leximit "Ishulli i delfinëve të kaltër" nënvizoni dhe shkruani pesë kallëzues emërorë dhe pesë kallëzues foljorë. Dalloni me se janë shprehur.

Përcaktorët

Fjalia përbëhet nga gjymtyrët kryesore dhe nga gjymtyrët e dyta (plotësuese). Gjymtyrët e dyta janë: përcaktorët, kundrinorët, rrethanorët.

Gjymtyrët e dyta

Përcaktorët — **Kundrinorët** — **Rrethanorët**

- Në fragmentin e mëposhtëm dalloni ç'funksion kanë grupet e fjalëve të nënvizuara dhe thoni me se janë shprehur. Dalloni emrin bërthamë nga fjala plotësuese e tij.

Ditët e pranverës dukej se po vinin më herët se zakonisht. Çdo fëmijë është i gëzuar. Do të dilnin jashtë për të luajtur më shpesh. Këto ishin ditët e fundit të dimrit dhe nuk na besohej se ai po shkonte. Po shkonte, apo bënte me sikur? Për këtë nuk ishim të sigurt. Ishte kjo stina që mezi e pritnim. Pranvera ishte në prag. Ditët me diell filluan të dukeshin më shpesh. Lamtumirë netët e ftohta me ngricë!

Mbani mend

Përcaktori është gjymtyrë e dytë e fjalisë që shpreh një tipar, një marrëdhënie, një shtesë informacioni ndaj fjalës bërthamë.

Ushtrohemi

Gjeni emrin bërthamë të çdo grupi në tabelën e mëposhtme.

Grupi i fjalëve	*Struktura*	*Fjala bërthamë*
ditët e pranverës	*emër + emër*	*ditët*
çdo fëmijë	*përemër + emër*	_____
ditët e fundit të dimrit	*emër + mbiemër + emër*	_____
ditët me diell	*emër + emër me parafjalë*	_____
netët e ftohta me ngricë	*emër + mbiemër+ emër me parafjalë*	_____
të dyja shkollat	*numëror + emër*	

Plotësoni tabelën.

Fjalia	Kryefjala	Kallëzuesi	Gjymtyrë të dyta
Ditët e pranverës po vinin më herët se zakonisht.			
Çdo fëmijë i pëlqen lodrat.			
Ditët me diell filluan të dukeshin më shpesh.			

Grupet e fjalëve: *ditët e pranverës, çdo fëmijë, ditët me diell*, janë grupe emërore, sepse bërthama e tyre është një emër.

Fjalët: *e pranverës, çdo, e fundit, me diell*, janë fjalë plotësuese të grupit emëror. Fjalët plotësuese të emrit bërthamë të grupit emëror quhen **PËRCAKTORË**. Përcaktorët janë gjymtyrë plotësuese në fjali.

Përcaktorët e emrit

Përcaktorët e emrit shprehen me:
Mbiemra: *e bukur, i ftohtë, i ngrohtë, e mirë, dinak* etj.
Përemra: *tanë, ynë, im, çdo, të gjithë, të gjitha, ime* etj.

Një emër pa parafjalë në rasën gjinore dhe rrjedhore: *ditët* ***e dimrit****, muajt* ***e pranverës****, sytë* ***e dhelprës****, ditë* ***dimri****, krevat* ***hekuri****.*
Një emër me parafjalë: *ditë* ***me diell****, ditë* ***me shi****, këpucë* ***për vrap****, këngë* ***për të rinj****.*
Numërorë: *tre, tri, të tre, të tria, dy, të dy, të dyja.*

Llojet e përcaktorëve

Llojet e përcaktorëve	Shprehet	Shembuj
Përcaktor me përshtatje	me mbiemër, me përemër, me numëror.	(ca) punë të ngutshme, qyteti ynë, klasa e gjashtë.
Përcaktor me drejtim	me emër në gjinore, me emër me parafjalë	kryekomandant të ushtrisë, zemrën e Helenës, shporta me vezë.
Përcaktor me bashkim	me fjalë që nuk lakohen, nuk ndryshojnë, si: ndajfolje, përemra (të palakueshëm), paskajore.	shumë njerëz, asnjë nxënës, çdo njeri, dëshira për të lexuar.
Ndajshtimi	zakonisht me emër të pashquar ose grup emëror, në rasën emërore.	hyjnesha Afërditë, anija "Vlora", xha Mihali, Nënë Tereza etj.

USHTRIME

1 Gjeni grupet emërore dhe nënvizoni emrin bërthamë me një vizë dhe përcaktorin me dy viza.

Shpesh, babai i Brunës vendos në karrocë buqeta me lule dhe së bashku me Marsin i shpërndajnë në familjet që kanë festë, ditëlindje apo dasma. Marsi gëzohet pa masë. Por edhe njerëzit që e shohin dhe takohen me të, ndiejnë një adhurim për këtë zgjidhje. Ata nuk e dinë që Bruna është shpikësja e kësaj karroce, por buzëqeshjet e tyre flasin shumë për Brunën.

2 Plotësoni vendet boshe me përcaktorë (këta, të madh, e lashtë, prej tyre, e botës, e tyre, të madhe).

Të gjithë popujt _____ kanë thurur historitë _____ për gjigantët. Disa nga _____ gjigantë kishin vetëm një sy _____ në mes të ballit. Ata ishin të zotët të ngrinin një copë _____ shkëmbi. Disa _____ nuk gjakoseshin asnjëherë. Kishte gjigantë që e duronin zjarrin dhe nuk digjeshin kurrë. Njerëzit _____ besonin se gjigantët ishin paraardhësit e tyre.

3 Plotësoni emrat e mëposhtëm me përcaktorë dhe thoni çfarë lloj përcaktorësh janë.

rruga e re – përcaktor me përshtatje	*fëmijë*	*sportist*
makinë	*fshat*	*letër*
shkëmb	*luftëtar*	*mik*

4 Lidhni me shigjetë emrat me përcaktorët e përshtatshëm.

lisi	*e shtëpive*	*djalë*	*e shtatë*	*ngjyrë*	*rinor*
qyteti	*trungmadh*	*jorgan*	*misri*	*kënga*	*tjetër*
dyert	*e zogjve*	*fustan*	*me lule*	*fjalë*	*e rinisë*
kënga	*ynë*	*klasa*	*trupmadh*	*motiv*	*gruri*
djalë	*besnik*	*bukë*	*me pupla*	*dita*	*përshëndetjeje*

5 Shkruani fjali me grupet emërore të mëposhtme. Dalloni përcaktorët.

Këto ngjarje _____
Të tjerë nxënës _____
Të gjithë nxënësit _____

Ndajshtimi

Ndajshtimi është lloj përcaktori i shprehur, zakonisht, me një emër në trajtë të pashquar: *Nënë Marës iu bë zemra mal nga lajmi që mori.*

- Ndajshtimi qëndron para gjymtyrës që përcakton, kur shprehet me emër të përgjithshëm që tregon profesion, gradë, titull, përkatësi farefisnore.

Mësuese Eda e ka gati programin për takimin poetik me nxënësit e saj.
Kolonel Saimiri e vlerësoi shumë titullin që mori.
Profesor Tani përfundoi me sukses një projekt me nxënësit e tij.
Teze Anila kishte ditëlindjen.

- Ndajshtimi qëndron edhe pas gjymtyrës që përcakton. Në këtë rast, ai shprehet me emër të përveçëm njeriu, kafshe, sendi, muaji etj.

Shkrimtari Ismail Kadare ka shkruar romanin "Kështjella".
Gazeta "Panorama" botoi një kronikë për ndeshjen.
Muaji maj është më i bukuri i pranverës.

- Shkruhen midis thonjëzash e me shkronjë të madhe ndajshtimet që shprehin emërtime institucionesh, tituj librash, emra rrugësh etj.:

Shkolla "Hasan Prishtina" ka ambiente sportive bashkëkohore.
Në rrugën "Agim Ramadani" ka shumë lëvizje.
Librin "Piter Pan" e kam lexuar me një frymë.

Gjatë lakimit të grupit të fjalëve, ndajshtimi nuk ndryshon.

USHTRIME

1 **Plotësoni fjalitë e mëposhtme me një ndajshtim.**

_____ Mira kishte një libër interesant. (*farefisni*)
_____ Samiu është ngritur në detyrë. (*gradë*)

2 **Krijoni fjali me grupe fjalësh ku të përdoren ndajshtime që shprehen me emra të përveçëm dhe qëndrojnë pas gjymtyrës që përcaktojnë.**

- Me emër njeriu.
- Me emër kafshe.
- Me emër sendi.
- Me emër muaji.

3 **Shkruani fjali në të cilat të përdorni ndajshtime që emërtojnë institucione, emra rrugësh, tituj librash.**

a. Shkolla _____
b. Rruga _____
c. Libri _____

4 **Formoni fjali ku emrat: *arkitekt, nënë, motër, djalë* të jenë një herë përcaktor me drejtim dhe një herë si ndajshtim.**

Arkitekt Artani është shumë i talentuar.	*Ishte përgjegjësia e arkitektit.*
Nënë	
Motër	
Djalë	

12

Kallëzuesori i kryefjalës

Lexoni me kujdes tekstin e dhënë, vëreni kallëzuesin. Me ç'lloj foljeje është shprehur ai?

– Sanço, miku im, – tha ai, – liri quhet një nga dhuratat më të mira të qiellit. Një burrë duhet të rrezikojë edhe jetën për lirinë. Robëri quhet e keqja më e keqe e botës.
I lumtur quhet ai njeri që mund të hajë një copë bukë, për të cilën i detyrohet vetëm Perëndisë.

(*Servantes, "Don Kishoti"*)

Vini re! Fjalitë e fragmentit të mësipërm janë ndërtuar me foljen *quhem* dhe përveç gjymtyrëve kryesore, kryefjalë e kallëzues, ato kanë edhe një gjymtyrë të dytë që lidhet edhe me foljen, edhe me kryefjalën njëkohësisht. Kjo gjymtyrë e dytë quhet kallëzuesori i kryefjalës.

Shembuj

Le të shqyrtojmë fjalinë:

Liri	quhet	një nga dhuratat më të mira të qiellit.
↓	↓	↓
kryefjala	*kallëzuesi*	*kallëzuesori i kryefjalës*

Shqyrtoni fjalinë e mëposhtme. Shkruani në vendet bosh gjymtyrët e saj.

Robëri	quhet	e keqja më e keqe e botës.
(_____)	(_____)	(_____)

Siç shihet edhe nga emri, kallëzuesori i kryefjalës "kallëzon", shpreh gjendjen e kryefjalës. Për shembull: *Dita dukej e bukur dhe e ngrohtë.*

Pyetja që bëjmë për të identifikuar kallëzuesorin e kryefjalës në këtë rast është: *Si dukej dita?*

Përgjigjja e kësaj pyetjeje është: *e bukur dhe e ngrohtë.*

Pra, siç kuptohet edhe nga pyetja që ngremë, grupi emëror "e bukur dhe e ngrohtë", që është edhe përgjigjja e pyetjes së bërë, lidhet edhe me kallëzuesin edhe me kryefjalën.

Mbani mend

Kallëzuesori i kryefjalës është një funksion që e luan emri, mbiemri ose një grup emëror dhe që lidhet me kryefjalën me anë të foljeve: *dukem, bëhem, quhem* etj.

Me se shprehet?

Kallëzuesori i kryefjalës mund të shprehet me:

- mbiemër – *Mëngjesi dukej* ***i mrekullueshëm***.
- *emër* – *Mësuesja jonë quhet* ***Diana***.
- *grup emëror* – *Vëllai im u zgjodh* ***kujdestar i klasës***.

Vendi i kallëzuesorit të kryefjalës në fjali

Kallëzuesori i kryefjalës zakonisht vendoset menjëherë pas kallëzuesit. Para kryefjalës del në raste të veçanta. Kjo bëhet për të theksuar e për të vënë më shumë në dukje emocionalisht cilësinë a gjendjen e kryefjalës.

Mëngjesi i asaj dite dimri dukej i mrekullueshëm.
***I mrekullueshëm** dukej mëngjesi i asaj dite dimri.*

USHTRIME

1 Cilat nga foljet e mëposhtme mund t'i përdorim për të ndërtuar fjali në të cilat, përveç kryefjalës, ka edhe kallëzuesor të kryefjalës? Shënoni me ✓.

mësoj	☐	rri	☐
jam	☐	quhem	☐
dukem	☐	mbush	☐
këndoj	☐	ka	☐

2 Në fjalitë e mëposhtme, të shkëputura nga romani "Obelisku i zi" i Remarkut, nënvizoni kallëzuesorin e kryefjalës.

- *Puna e idealeve s'quhet gjë tjetër veçse egoizëm.*
- *Të djersitësh do të thotë shëndet.*
- *Të plakesh duket gjëja më e lehtë në botë.*
- *Cektësia, padituria dhe materializmi quhen aleatë të ngushtë.*
- *Besnikëria quhet palca e njeriut.*
- *Ai që tradhton shoqërinë, rri i përbuzur gjithmonë.*
- *Ajo që nuk ke, gjithmonë të duket më e mirë se ajo që ke.*

3 Plotësoni tabelën e mëposhtme për kallëzuesorët e kryefjalës që gjetët në ushtrimin 2.

I shprehur me mbiemër	I shprehur me emër	I shprehur me grup emëror

4 Aforizmat e mëposhtëm nuk kanë folje. Shndërrojini në fjali që përmbajnë "foljen e duhur", si dhe kallëzuesorin e kryefjalës.

Fjalori, ... një kullotë e pasur fjalësh. *(Homeri)*
Fytyra... pasqyra e shpirtit. *(Ciceroni)*
Një nga humbjet më të mëdha... humbja e kohës. *(Bufon)*
Vetmia... më e mirë se shoku i keq. *(Sami Frashëri)*

5 Zgjidhni njërën nga thëniet e ushtrimit 2 dhe shkruani një ese të shkurtër (15-20 rreshta). Përpiquni të përdorni sa më shumë kallëzuesorë të kryefjalës.

13

Kundrinorët. Kundrinori i drejtë

- Vëreni figurat dhe bëni pyetje duke nisur me fjalët: *Ç'? Çfarë? Kë? Cilin? Kujt? Me se? Për kë? Nga se?* etj.
- Shkruani vetëm fjalët që u përgjigjen pyetjeve që bëtë.

- **Në fragmentin e mëposhtëm, dalloni grupet e fjalëve të nënvizuara. Me cilat pyetje gjenden ato fjalë në fjali?**

Dinozaurët dhe zogjtë e zinj i shihnin shumë mirë ata. Kjo gjë, sigurisht, nuk u pëlqente aspak kameleonëve. Ata donin të rrinin në paqe atje mbi pemë duke ngrënë miza dhe nuk donin që t'i shqetësonte askush. Nuk kalonte ditë që një kameleon të mos pyeste kushërirën e tij dhe të mos dëgjonte përgjigjen.

Fjalët e nënvizuara në tekstin e mësipërm quhen kundrinorë.

Kundrinorët janë gjymtyrë të dyta (plotësuese) të fjalisë që lidhen me foljen. Kundrinorët shprehin frymorë a sende mbi të cilat bie veprimi i kryefjalës. Ata bëjnë pjesë **në grupin foljor.**

Kundrinorët ndahen në **kundrinorë të drejtë** dhe **kundrinorë të zhdrejtë.**
Kundrinorët e zhdrejtë ndahen në **kundrinorë me parafjalë** dhe **kundrinorë pa parafjalë.**

Kundrinori i drejtë

- Kundrinorët e drejtë gjenden me pyetjet: ***Kë? Cilin? Cilën? Cilët? Ç'? Çfarë?***

*Kam **ca libra të rinj** për të të treguar.*	*Çfarë kam?*	***ca libra të rinj***
*Mora **mamin** në telefon.*	*Kë mora?*	***mamin***
*Kam blerë **lloj-lloj gazetash***	*Çfarë kam blerë?*	***lloj-lloj gazetash***
*Bashkë me motrën, bleva **një kuvertë krevati**.*	*Ç' bleva?*	***një kuvertë krevati***
*Ai vend më kujton **librin e Kadaresë**.*	*Cilin më kujton?*	***librin e Kadaresë***

- **Kundrinori i drejtë** është gjymtyrë e dytë e fjalisë.
- Kundrinori i drejtë tregon objektin mbi të cilin bie veprimi i kryer nga kryefjala.
- Ai mund të jetë një emër, një përemër, një grup emëror, një trajtë e shkurtër e përemrit vetor në rasën kallëzore.

Kundrinori i drejtë nuk mund as të hiqet, as të zhvendoset. Nëse ai hiqet, ndryshon kuptimi i fjalisë.
Kundrinori i drejtë qëndron përgjithësisht pas kallëzuesit.

Kundrinori i drejtë shprehet:

- me emër në rasën kallëzore: Ai e kërkoi ***nënën*** në telefon.
- me grup emëror në rasën kallëzore: Ajo bleu ***arushin me pelush***.
- me përemër në rasën kallëzore: ***Atë*** e kam pritur tërë jetën.
- me trajtë të shkurtër të përemrit vetor: ***E*** mora për shaka.

Trajtat e shkurtra si kundrinorë të drejtë

Veta	Numri njëjës	Numri shumës
Veta e parë	më Nëna *më* puthi. Kë? (mua) *më*	na Drejtori *na* përgëzoi. Cilët? (ne) *na*
Veta e dytë	të Vilma *të* ftoi. Kë ftoi? (ty) *të*	ju Ai *ju* ftoi. Cilët ftoi? (ju) *ju*
Veta e tretë	e Fjona *e* falënderoi. Kë falënderoi? (atë) *e*	i Gjyshi *i* ftoi. Cilët ftoi? (ata/ato) *i*

USHTRIME

1 Nënvizoni kundrinorët e drejtë.

Një natë, babi na mblodhi ne të gjithëve dhe na tha:
– Unë dhe mami kemi menduar që të birësojmë Lilin. Në shtëpinë tonë do të vijë një motër për ju të dy. Ne të dy shtangëm në vend, se nuk e kishim pritur këtë gjë. Na u duk në fillim pak e vështirë. Tani do të kemi një motër tjetër. Si flet? Si luan? Babi na e prezantoi Lilin. Tashmë në shtëpi kishim një kasetë, në të cilën ishte filmuar Lili në shtëpinë e fëmijës ku jetonte.

2 Vendosni kundrinorë të drejtë pranë çdo foljeje dhe formoni fjali me ta.

kërkoj: _____ mbuloj: _____ përshkruaj: _____
gjej: _____ zhvilloj: _____ përdor: _____

3 Nënvizoni kundrinorët e drejtë dhe trajtat e shkurtra.

Dielli i lëshonte rrezet e tij kudo dhe ngado. Nisi të na digjte shumë. Era kërcente dhe fluturonte me shpejtësi të madhe si asnjëherë tjetër. Njerëzit nisën të fshiheshin prej saj. Retë dhe vetëtimat nuk u kursyen për ta shoqëruar spektaklin me sfond të bardhë, me drita vezulluese dhe me krisma të forta.

4 Shkruani fjali sipas modelit. Nënvizoni kundrinorët e drejtë.

Shembull: Unë nuk e pëlqej shumë muzikën rok.

Unë pëlqej _____ Unë nuk pëlqej _____
Ne nuk e ndjekim _____ _____
Nuk pëlqej shumë _____ _____

5 Dalloni kundrinorët e drejtë dhe kryefjalët. Plotësoni tabelën.

Fjalitë	Kryefjalë	Kundrinor
Djali kishte parë një burrë me lahutë.		
Ai kishte vetëm gruan dhe një shtëpi.		
Ky pronar kishte shumë vreshta rrushi.		
Fermerët e kthyen tokën në vreshtë.		

14 Kundrinori i zhdrejtë

Kundrinori i zhdrejtë mund të jetë:

- pa parafjalë,
- me parafjalë.

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë

Kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë e gjejmë duke i drejtuar kallëzuesit pyetjet: **kujt? cilit? cilës? cilëve? cilave?**

Këtij djali *nuk* ***i*** *mungon gjallëria.* (**Kujt** nuk i mungon gjallëria?)

Vajza ***i*** *jepte zemër* ***nënës***. (***Kujt*** *i jepte zemër?*)

Fjala që i përgjigjet në fjali pyetjes *kujt?*, është kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë.

Pyetjeve të mësipërme u përgjigjen emra ose grupe emërore në rasën dhanore.

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë qëndron zakonisht pas foljes, përveç trajtës së shkurtër që vendoset para foljes.

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë shprehet me:

- emër në rasën dhanore + trajtë e shkurtër: ***Anës i*** *shkriu akullorja në dorë.*
- me grup emëror + trajtë e shkurtër: ***Shoqes së ngushtë i*** *dhuruan një libër.*
- numëror i emërzuar + trajtë e shkurtër: *Lajmi* ***u*** *erdhi* ***të dyjave***.
- përemër dëftor + trajtë e shkurtër: ***Këtij i*** *thonë lajm.*
- trajtë e shkurtër e përemrit vetor: *Sytë* ***i*** *shkëlqenin nga gëzimi.*

Trajtat e shkurtra si kundrinorë të zhdrejtë

Veta	Numri njëjës	Numri shumës
Veta e parë	më Nëna *më* foli për nesër. Kujt? (mua) *më*	na Drejtori *na* foli me besim. Cilëve? (neve) *na*
Veta e dytë	të Vilma *të* foli për dasmën. Kujt? (ty) *të*	ju Ai *ju* foli rëndë. Cilëve? (juve) *ju*
Veta e tretë	i Fjona *i* foli rëndë. Kujt? (atij) *i*	u Gjyshi u foli me zë të lartë. Cilëve? (atyre) *u*

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë gjendet në rasat që marrin parafjalë: emërore, kallëzore, rrjedhore.

Ai është një emër, një përemër ose një grup emëror me parafjalë.

Vajza e vogël u shoqërua ***nga motra dhe vëllai****.* (rasa emërore)

Vajza u takua ***me djalin*** *pas disa ditësh.* (rasa kallëzore)

Përulemi me respekt ***para kujtimit*** *të të rënëve.* (rasa rrjedhore)

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë gjendet duke bërë pyetjet: *Nga kush? Nga se? Prej kujt? Me se? Me kë? Me çfarë? Për kë?*

Kundrinori i zhdrejtë, ndryshe nga kundrinori i drejtë, mund të lëvizë lirshëm në fjali.

Po raportonte para shokëve për punën e bërë. Për punën e bërë po raportonte para shokëve. Po raportonte për punën e bërë para shokëve.

USHTRIME

1 Nënvizoni kundrinorët (të drejtë ose të zhdrejtë).

Mbrëmë pashë ëndrrën më të çuditshme që mund të përfytyrohet. M'u duk sikur isha në shtëpinë e pleqve, në vendlindjen e gjyshes. Nuk ishte dhe aq keq, pasi kishte muzikë, një shkollë dhe një lloj kopshti për fëmijë. Më kujtohet që isha në një shtrat të bardhë. Në çast m'u shfaq një kopsht i mahnitshëm. Vendosa të ngrihesha nga shtrati dhe të dilja.
Sot qe një ditë e paharrueshme. Pas kaq kohësh, munda më në fund të hyja në dhomën e gjyshes sime, ku gjeta nënën që rregullonte disa gjëra.

2 Dalloni kundrinorët e shprehur me trajtë të shkurtër të përemrit vetor.

Një ditë, burri u ul në një shkëmb përballë detit dhe nisi t'i binte lahutës me përmallim, duke kujtuar gruan dhe shtëpinë. Për fat, në breg u afrua një vapor plot me ushtarë, të cilët, të mrekulluar nga muzika e ëmbël, që nuk e kishin dëgjuar kurrë në këto vise, zbritën për të marrë vesh se kush ishte njeriu që këndonte dhe i binte lahutës. Komandanti ia bëri me shenjë burrit që të afrohej dhe e pyeti.

3 Plotësoni fjalitë e mëposhtme me kundrinorë të zhdrejtë duke u ndihmuar nga pyetjet.

Babai i kujtoi (kujt?) _____
Ajo po i kërkonte (kujt?) _____
Nuk po i vinin në mend fjalët (kujt?) _____
Bora i ishte përgjigjur (kujt? për çfarë?) _____
Lola këtë vit do të mbaronte (çfarë? për kë?) _____

4 Në vendet boshe shkruani nga një kundrinor. Shënoni përbri llojin e tij.

Ajo kishte dalë të shihte në _____.
Ishte verë dhe nxehtësia e diellit na kishte bërë _____.
Shitësit ambulantë rregullonin _____ dhe u thërrisnin _____.
Matanë urës morëm _____. Gruaja që qëndronte te dera e dyqanit, na bëri _____ kur kaluam. Ajo _____ bëri _____ të mos pipëtinim.
(***Fjalë ndihmëse: me djersë, kthesën, sheshin e madh, pyetje, na, shenjë, tezgat, kalimtarëve***)

5 Gjeni fjalinë së cilës i përgjigjen pyetja dhe kundrinori i dhënë.
Plotësoni tabelën me shenjën plus (+).

Pyetja	Kundrinori	Kundrinor i drejtë	Kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë	Kundrinor i zhdrejtë me parafjalë
Çfarë ndjeu nëna?	Një dhimbje.			
Cilave nuk u jepte rëndësi?	Fjalëve.			
Me çfarë ishte mbushur sheshi?	Me fëmijë.			

6 Përdorni emrin *kështjellë* në fjali: *si kryefjalë, si kundrinor të drejtë, si kundrinor të zhdrejtë pa parafjalë, si kundrinor të zhdrejtë me parafjalë.*

15 Rrethanorët

Fjalët që tregojnë një rrethanë të veprimit të kallëzuesit - vendin, kohën, mënyrën, sasinë, qëllimin, shkakun etj. - quhen rrethanorë.

Vëreni figurën dhe jepni përgjigje duke përdorur fjalët pyetëse të mëposhtme.

- Ku janë fëmijët? _____
- Kur kanë dalë për shëtitje? _____
- Sa fëmijë janë? _____
- Si po i mban duart djali? _____
- Pse është i mërzitur? _____
- Përse shoqet e shikojnë në atë mënyrë? _____

Llojet e rrethanorëve

Rrethanori	Pyetja	Shembull	Shprehet
Rrethanori i vendit	ku?	Të tërë janë mbledhur <u>në shtëpinë e gjyshes në fshat.</u>	me grup emëror
Rrethanori i kohës	kur?	<u>Pas një jave</u> fillon shkolla. Do të vij <u>nesër</u>.	me emër me parafjalë me ndajfolje
Rrethanori i mënyrës	si?	Prindërit, të alarmuar, dolën <u>shpejt e shpejt</u>, nga shtëpia.	me ndajfolje ose shprehje ndajfoljore
Rrethanori i shkakut	pse?	Djali i vogël u rrëzua <u>nga të vrapuarit</u>.	me emër me parafjalë
Rrethanori i qëllimit	përse?	Punonte shumë <u>për të arritur</u> rezultatet.	me paskajore
Rrethanori i sasisë	sa?	Ndihej i lodhur, pasi kishte <u>pesë orë</u> pa ujë.	me grup emëror, me njësi matëse

Rrethanori në përgjithësi e ka vendin të lirë në fjali. Ai mund të qëndrojë para ose pas kallëzuesit (foljes).

Rrethanorët shprehen:

me ndajfolje ose shprehje ndajfoljore	Dolën <u>shpejt e shpejt</u> nga shtëpia.
me emër me parafjalë	U lodhën <u>nga të vrapuarit.</u>
me grup emëror	Për të arritur <u>te ligeni i Shkodrës</u> duheshin edhe dy orë.
me paskajore	Ai punonte <u>për t'i mbajtur</u> mirë fëmijët.

Rrethanori i vendit

Rrethanori i vendit

Rrethanori i vendit **shënon vendin ku kryhet veprimi** ose ku zhvillohet një ngjarje.

Shembuj: *Babai i tij punonte **në aeroport.***

*Nesër do të shkoj **në mal** dhe do të qëndroj atje tërë muajin gusht.*

Pyetjet për të gjetur rethanorin e vendit

Rrethanori i vendit **gjendet** duke i drejtuar foljes pyetjet: ***ku? nga ku? për ku? prej ku?*** etj.
Vendi i tij në fjali mund të jetë para ose pas kallëzuesit (foljes).

- me ndajfolje vendi: *Atje pushohej.* (ku pushohej?) **Atje**.
- me emër me parafjalë: *Ai studionte **në Londër**.* (ku studionte?) **Në Londër**.
- me grup emëror: ***Nga kjo sallë** ka nisur aventura ime e sportit.* (nga ***ku***?) **Nga kjo sallë**.

Rrethanori i kohës

Rrethanori i kohës **shënon kohën kur kryhet veprimi** ose kur zhvillohet një ngjarje. Pra, ai ka vend të lirë në fjali. Hiqet pa e ndryshuar kuptimin e fjalisë.

Pyetjet për të gjetur rethanorin e kohës

Rrethanori i kohës **gjendet** duke i drejtuar foljes pyetjet: ***kur? që kur?*** etj.
Vendi i tij në fjali mund të jetë para ose pas kallëzuesit (foljes).

- me emër me dhe pa parafjalë: *Konkursi do të bëhet të mërkurën.*
- me ndajfolje kohe: *Alma doli vonë nga shtëpia.*
- me grup emëror: Atë moment u duk sikur u shua gjithçka.
- me formë foljore të pashtjelluar: *Andi hyri në shtëpi pa mbërritur i ati.*

USHTRIME

1 Nënvizoni rrethanorët dhe thoni llojin e tyre.

Çdo ditë, para se të largohemi nga shkolla, ne duhet ta lëmë shumë të pastër klasën. Çdo gjë duhet vendosur në vendin e vet: lapsat, ngjyrat, shkumësat, mjetet e vizatimit etj.
Sot unë kisha pastrimin. Kisha marrë fshesën në dorë dhe po pastroja. Papritur, bishti i fshesës kapi një shishe që ishte e mbushur plot me bojë të kuqe. Ajo ra dhe u derdh në tokë.

2 Rrethanorët që nënvizuat në pjesën e mësipërme, vendosini në tabelë sipas llojit.

Rrethanor kohe	Rrethanor vendi	Rrethanor mënyre	Rrethanor sasie

USHTRIME

3 Zgjeroni me rrethanorë vendi dhe kohe grupin foljor të fjalive të mëposhtme.

Vëllai i madh ngriti supin _____
Biseda u pre _____
Zemra e tij u ngazëllye _____
Ata ngritën zërin _____

4 Nënvizoni rrethanorët dhe shënoni në kllapa llojin e tyre.

Ditët kalonin me shpejtësi. (_____) *Do të ngjitem me gjyshin në mal.* (_____)
Dje shkova në Durrës. (_____) *Ai mori shumë libra me vete.* (_____)
Kurrë nuk i kam thënë jo nënës sime. (_____) *Nuk do ta harroj kurrë atë ditë.* (_____)

5 Qarkoni S (e saktë) ose G (e gabuar).

Rrethanori nuk mund të hiqet lehtë nga fjalia.	S	G
Rrethanori mund të hiqet nga fjalia pa e prishur kuptimin e saj.	S	G
Rrethanori është gjymtyrë e dytë e fjalisë.	S	G
Rrethanori tregon objektin e veprimit.	S	G
Rrethanori shprehet edhe me ndajfolje.	S	G

6 Rrethanorët e nënvizuar zëvendësojini me të tjerë rrethanorë pa ia prishur kuptimin fjalisë.

Dhurata e Krishtlindjes

Ishte nata e Krishtlindjes. Unë prisja me padurim dhuratën time. Shikoja nga të katra anët e shtëpisë, por asgjë, asnjë shenjë...

Mos ndoshta fleta e letrës mbi karrige donte të më thoshte diçka? Jo, nuk po e prek.

Prindërit më thanë se Babagjyshi akoma nuk kishte ardhur ende.

U shtriva... u përpoqa të fle... gjumi nuk më zuri. M'u kujtua letra mbi karrige. Diçka do të thoshte edhe ajo...

Në mëngjes u çova dhe po shikoja rreth e rrotull. Syri im nuk shikonte asgjë.

– Ndoshta babagjyshi më ka harruar këtë vit? Ndoshta kam bërë ndonjë gabim dhe më qorton?

Fillova të lëviz nëpër shtëpi. Isha shumë i trishtuar. Gati sa nuk qaja...

Shikoja e kontrolloja në çdo cep, por asgjë. Sytë i kisha plot me lot.

Më vinte në mend copa e letrës. – Ç'të jetë vallë?

Më mbushi me shpresa. Vrapova dhe e mora. E hapa.

Brenda saj ishte vizatuar një biçikletë. Ishin shkruar edhe disa fjalë: Në fund të shkallëve!

I zbrita shkallët me një shpejtësi marramendëse. Ç'të shikoje?

Poshtë shkallëve qëndronte si nuse e bukur një biçikletë e madhe që shkëlqente.

Ua! Si mundi Babagjyshi i Vitit të Ri të ma lexonte ëndrrën time?

(M. Rosen)

Rrethanori i shkakut dhe rrethanori i qëllimit

Lexoni fjalitë.

Shtëpia buçiste ***nga zëri i ngritur i televizorit*** *dhe* ***nga zëri i lartë i djaloshit****. Oshtinin pa kuptim* ***për të shprehur*** *gjallërinë e tyre për ardhjen e një dite të re.*

Fjalët dhe grupet e fjalëve: ***nga zëri i ngritur i televizorit, nga zëri i lartë i djaloshit, për të shprehur*** sqarojnë më tepër kuptimin e fjalisë, duke treguar shkakun apo qëllimin e një veprimi.

Për të gjetur se çfarë roli luajnë këto fjalë në fjali, ne mund të pyesim me pyetjet: ***përse? pse? për ç'shkak? për ç'qëllim?*** etj.

Nëpërmjet këtyre pyetjeve, ne pyesim për **shkakun** dhe qëllimin e kryerjes së një veprimi.

Pse? (Nga se buçiste shtëpia? *Nga zëri i ngritur i televizorit.*)
rrethanor shkaku.

Përse? (Për ç'qëllim oshtinin zërat? *Për të shprehur (gjallërinë).*
rrethanor **qëllimi.**

Rrethanori i shkakut



Rrethanori i qëllimit

Mbani mend

Rrethanori i shkakut	Rrethanori i qëllimit
Është gjymtyrë e dytë e fjalisë. Tregon shkakun që sjell pasojën. U përgjigjet pyetjeve: pse? dhe për ç'shkak?. Qëndron zakonisht pas fjalëve që plotëson.	Është gjymtyrë e dytë e fjalisë. Tregon qëllimin e kryerjes së veprimit. U përgjigjet pyetjeve: përse? dhe për ç'qëllim?. Qëndron zakonisht pas fjalëve që plotëson.

USHTRIME

1 **Lidhni pjesët e fjalive me rrethanorët e shkakut.**

Makina doli nga rruga	*nga lajmi që mori.*
Adriani nuk erdhi në shkollë	*për shkaqe shëndetësore.*
Nxënësi u përgëzua	*nga dhimbja e kokës.*
Elona u gëzua shumë	*si rrjedhojë e shpejtësisë së madhe.*
Mësuesja ishte e heshtur	*për shkak të sjelljes së shoqes.*
Vajza është e mërzitur	*për sjelljen e tij fisnike.*

2 **Qarkoni S për pohimin e saktë dhe G për pohimin e gabuar.**

- Rrethanori i shkakut shpreh qëllimin e kryerjes së veprimit. S G
- Rrethanori është gjymtyrë kryesore e fjalisë. S G
- Rrethanori i shkakut dhe ai i qëllimit tregojnë objektin e veprimit. S G
- Rrethanori mund të hiqet nga fjalia pa e prishur kuptimin e saj. S G
- Rrethanori i qëllimit tregon mënyrën e kryerjes së veprimit të shprehur nga folja. S G
- Rrethanori i shkakut nuk mund të zhvendoset brenda fjalisë. S G
- Funksionin e rrethanorit mund ta kryejë një parafjalë. S G

3 **Plotësoni fjalitë duke përdorur rrethanorë shkaku ose qëllimi.**

Flokët i kishte ngritur për _____

Nuk e dinte _____

E lodhur nga _____

Humba shumë vite duke _____

4 **Formoni fjali me grupet e fjalëve duke i përdorur ato si rrethanor shkaku ose qëllimi.**

nga dashuria, prej habisë, duke shkruar, për punë, për ç'qëllim, për nënën, për t'u argëtuar, përse? pse?

5 **Shkruani një tekst me temën "Shkolla po mbaron", duke përdorur sa më shumë rrethanorë shkaku dhe qëllimi.**

Referenca

- Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës 9 e rishikuar), Prishtinë, Gusht 2016
- Kurrikula lëndore/programi mësimor për lëndën Gjuhë shqipe 6 – Gusht 2018
- Kurrikula **bërthamë** e arsimit të mesëm të ulët të Kosovës, Gusht 2016
- N. Mjeda - Vjersha për të vegjël, Naim Frashëri, Tiranë, Shqipëri 1967.
- R. Qosja - Antologji e lirikës shqipe - Prishtinë 1970
- Gjuha letrare shqipe, (Pjesë nga poezia shqipe dhe pasqyra gramatikore) - Tiranë Shqipëri 1989.
- Z. Rrahmani - Njohuri nga teoria e letërsisë – Tiranë, Shqipëri, 1996
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë - *Fjalor i gjuhës shqipe,* Tiranë, Shqipëri 2006
- B. Beci - *Për një konceptim bashkëkohor të mësimit të gjuhës amtare në shkollë"* - "Gjuha jonë", ASH, IGJL, Tiranë, Shqipëri 1993
- N. Chamsky - *Aspects of the theory of Syntax* - MIT Press, *Boston* 1965
- Chaney, T. Burk - *Teaching Oral Communication in grades K-8,* 1998
- Prof.Dr. M. Gjokutaj - *Didaktika e gjuhës shqipe,* Tiranë, Shqipëri, 2009
- Prof.Dr. M. Gjokutaj, Dr. Nj. Kazazi - *Prirja e sotme për mësimin e gjuhës shqipe,* Shkodër, 2003
- Prof.Dr. M. Gjokutaj, N.Mërkuri - *Modele të suksesshme mësimdhënieje* - Tiranë, Shqipëri 2008
- Prof.Dr. M. Gjokutaj, *Probleme të sotme të mësimit të gjuhës shqipe në shkollë* - Tiranë, Shqipëri, 2001
- K. Grillo - *Fjalor edukimi* - Tiranë, Shqipëri 2002
- R. Memushaj - *Shqipja standarde* - Botimet Toena Tiranë, Shqipëri, 2005
- R. Gjoshi - Didaktika e gjuhës shqipe, Prizren, Kosovë, 2017
- R. Gjoshi - Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë(aspekte historike dhe didaktike), Prishtinë,2016.
- Sh. Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe,* Tiranë, Shqipëri, 2007
- https://www.dreamstime.com/

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

37.016:811.18(075.2)

Gjuhë shqipe 6 / Mimoza Gjokutaj...[et al.]. - Prishtinë: Botime Pegi, 2019. - 294 f. : ilustr. ; 20.7 x 28 cm.

ISBN 978-9951-786-11-9

Lejohet për botim me vendimin e Ministrisë
së Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë,
nr. 420/01-B, të datës 23.08.2019.